Dr.KRISTO FLOQI
Gjyqtar i Diktimit

S H Q Y P T A R Ë T

ose

NJË BISEDIM

MIDIS NJË SHQIPËTARI E NJË MAXHARI

(**Vjershë**)

SHKODËR

Shtypshkroja Franciskane
1920

PASQYRA E LANDËS

Kemi qënë shokë.	faqe 4
Këndonjësve.	“ 5
Në vent të prologut.	“ 6
Shqyptarët..	“ 8
Shtojcë.	“ 78
Origjina e mbiemnave. . . .	“ 79
Shkaba dy krenore.. . .	“ 86
Dëshira e vërtetë e Shqiptarëvet (përkthim botuar më 1904).. . .	“ 89
Mbi ardhjen e eshtrave të Naim Frashërit. .	“ 109
Naim Frashëri baba i vjershësisë Shqiptare .	“ 112
Kushtim Ât Gjergj Fishtës. . . .	“ 121
Mikut të vlertë D. Ndrè Mjeda. . .	“ 126
Dy lottë mbi varrin e K. Kristoforidhit. .	“ 128
Mbi nevojën e një fjalori Shqip. . .	“ 129
Aqif Pashë Elbasanit. . . .	“ 133
Mbi kështjellin Rozafat. . . .	“ 135
Flamurit.	“ 138
Flamuri ynë.	“ 140
Kont Ugolini.	“ 141
Në të ngrysurit e jetës. . . .	“ 147
Ankim i qiparizit.	“ 150
Dy shpirtra zihen.	“ 151
Është i pavdekur shpirti ?. . .	“ 152
Poeti dyke vdekur (përkthim). . .	“ 155
Vala dhe hija.	“ 156
S’ime bije Teftës.	“ 159
S’ime bije Shpresës. . . .	“ 161
Shpirtit s’im’ ëje.	“ 162
Z$^{-ës}$ Margë Pozio.	“ 164
Sali Nivicës.	“ 166
Ponte Del Gada.	“ 173
Në mest t’oqeanit.	“ 174
Një vështrim mbi poezinë. . . .	“ 177
Vdekja e Sokratit.	“ 204

Filozofët e mëdhenj. . . . “ 209
Drinit të Zi. . . . . “ 213
Shënt–Naumi. . . . . “ 217
Hymn’ i Zotit. . . . . “ 223
Kontributet e K.Floqit për arsimimin e kulturimin
e Shqiptarëve. . . . . “ 224
A.-Kontributi në themelimin e Biblio-
tekës Kombëtare Shqiptare Tiranë. . . “ 224
B.-Kontributi në lëvrimin e gjuhës e
kulturës Shqiptare.. . . . “ 227
Rândsi e gjuhës për një komb. . . “ 227
Kulturë. . . . . “ 229
Shqypnija çilsi i parë i Lindjes s’afërme. . “ 231
C.-Kontributi në promuovimin e
Shqiptarëve të çquar në fushën e arteve. . “ 233
Gratë Shqyptare në fushën e literatures. . “ 233
1.- Dora D’Istria. . . . . “233
2.- Kristina Sqiro. . . . . “ 237
3.- Sevasti Dako. . . . . “ 239
4.- Parashqevi Qiriasi. . . . “ 241
Ç.-Artistë të tjerë Shqiptarë. . . “ 242
5. -Artet në Shqypni. . . . “ 242
6.- Anastas Kullurjoti. . . . “ 244
7.- Panajot Kupitori. . . . “ 246
Një nga mâ të mbëdhejtë shkrimtarë t’Italisë. “ 248
Fanatizmi. . . . . “ 254
Karakteri. . . . . “ 257
Veprat letrare të Kristo Floqit. . . . “ 305



422

KEMI QËNË SHOKË!

(Nji bisedim i interesatshëm)
Nërmjet Shqiptarit e Mazharit.

Jshin dy të dashur miq,
Shoq të mir' e të pa-ndarë,
Njerës t'urt' e jo të liq,
S'ishin zën' as ishin sharë.
Njeri ishte Shqipëtar,
<~~Që~~ Një Korçar prej Toskërisë,>
Tjetri qënke një Maxhar,
Officer i Maxharisë.
Bisedojshin nat' e dit,
Kudo haskshin e rrinin,
Edhe miqësia u rrit,
Njëri-tjetrin mir' e njihnin.
E fjalonin ~~gjërr' e gjatë~~, për ç' do sent
Për ç' do çashtje ~~e për ç' do sent~~ gjërr' e gjatë,
2.) Jshin të dy avokatë.
~~Po~~ 1. ~~Që~~ Pa të msuar e me ment.
Jshin
Officeri plottësisht
Deshte shum' e dëshironte,

AQSH F.429-3-268.1

Fort të dashurës shoqes së tij

z. Uranì Kr. Floqi

si shkaktares morale të ksaj vepre e për shênje nderi e dashurije ja kushtoj.

KR FLOQI

KËNDONJESVET

Në kohë të pushtimit austro–hungar kish ardhun në Shkodër një baron maxhar[1] Dr. Josef Kraus oficer i reservës. Ky ish tepër i interesuar për historìn shqyptare e karakterin e popullit Shqyptar, e deshte të bënjë do studime të veçantë që të shkruante m'andej gjer'e gjatë në një të përkohëshme ethnografike të Budapeshtit për popullin Shqiptar. Filloj kështu një bisedim i gjatë midis këtij edhè mua, tue qenë aty edhé disa miq të tjerë. Bisedimet u xgjatnë për disa dit deri sa ju dhamë funt. Emë shoqe, si e kurreshtuar për këtë bisedim, ku shumë sende u çvilluan m'u lut e me nguti t'a qit në një libër të veçantë. Që të mos ja prish qefin trajtova këtë vjershë, që po ja paraqit popullit shqyptar[2].

---

[1] Maxhar = hungarez

[2] Titulli i parë i kësaj vjershe shkruar nga K.Floqi më 1917 ka qenë: "KEMI QËNË SHOKË"! (Nji bisedim i interesatshëm nërmjet Shqipta-rit e Maxharit). Dorshkrimi ndodhet në AQSH F.429-3-268.1 e vijues. Më 1920 titullin e ka ndryshue vetë autori

NË VENT TË PROLOGUT

Psé kish zêrin fort të keq
Zogu i Ferrit, i Sketerrës
Vrejtjen gjith kujt ja heq
S' e nqas kush në prak të derës !
Prej Parajset – qysh at' dit, –
I rëzuem, i perzënë,
U perbuz e u zvetrit,
Një kujtim të keq ka lënë.
E kështû gjithkush e dron
Nuk kuxon t' a zerë ngoje
Embri vetëm e tmeron
Frik e ka gjith kush e droje !
Për me i dhënë rëndësì
Ftyrës s' tij fort të mërzitur
U munduan gjithsesi
Do piktorë të stërvitur,
E me shumë mjeshtërì
D j a l l i n gjith e pikturuan
Kush me bisht e kush me brî
Ftyrë-keq gjith' e përshkruan.
Kshtu e dinte per nji-ment
Gjithë Bota, Ruzullimi,
Më ç' do rasje, më ç' do vent
Djallin kshtu e là mallkimi !
Një dit – s' di se qysh takoj, –
Një piktor e hassi dreqin
Me tê foli, bisedoj
Veset e tij e tërheqin,
Edhe shumë ja pelqen
E habitet fort piktori
T' arsyshëm fort e gjen

Sa s’ u mbajt, po fjalën mori,
E fillon e e levdon
– Nuk e njeh zogn’ e Vampirit –
Emnin i lyp, i kerkon
Ktij të butit e të mirit.
– Si ? s’ më njeh ? (i thotë ky),
D j a l l i jam nuk me ké parë ?
– Jo ! betohem per kta sŷ !
(Flet piktori si i marrë).
Qysh ? t’i kenke kaq i rîi
Fort i bukur, i pelqyer !
Ty të mban Bota mërì ?
Oh, Sa qenka e gënjyer !
O ! mos luaj, mos u tunt
(I bertet i bir’ i Ferrit)
Edhe lè t’ i japim funt
Si e lyp rregull’ i nderit.
Bota s’ më ka as një faj
Fajn’ e kini ju, o horra,
Q’ i këputë ç’do uzdaj
Ketê n â m prej jush e morra !
Ç’ t’i, bësh fatit kur ju 1â
Pênden juvej, o të marrë
Edhé shkruat gjithë ç’ kâ,
Ju të gjithë doni vrarë !
Kshtu piktori u nemit
Edhé shkoj i turpëruar
Edhé – thonë – qysh at’ dit
Rinte tepër i mejtuar,
Edhe kurrë me s’ kuxoj
Djallin mê m’ e piturue
Se e pae, e kuptoj
Që fort teper kish gabûe !

SHQYPTARËT

Ishin dy të dashur miq
Shoq të mir' e të pa-ndarë,
Njerës t' urt' e jo të liq
S' ishin zën', as ishin sharë.
Njëri ishte Shqipëtar
(Një Korçar prej Toskërisë)
Tjetri ishte një Maxhar,
Officer i Maxharisë.
Bisedonin nat' e dit,
Kudo haseshin e rijnin,
Miqësija shum' u rrit,
Njeri-tjetrin mir' e njihnin.
E fjalonin për ç'do sent,
Për ç'do çeshtje gjërr e gjatë,
Ishin t' urtë e me ment
Ishin të dy advokate.
Officeri plotësisht
Deshte shum' e dëshironte
Historisht e moralisht
Shqipërinë t'a studjonte,
Jetën, ndjenjat e gjith ç'kâ,
Vetëtijat e zakonet,
Si punon, si rron, si hâ
E legendat e kanonet.
– Unë fort i lumtur jam,
(Po i thotë Shqipëtarit),
Ty thesar të math të kam,
Se do t'i ndihmosh Maxharit.
Edh' apostafat jam nis,
Po të them, o mik i dashur,
Që t' i vinj kësaj Shqypnis

Një zell fort të math kam pasur.
Gjithsecilit Shqipëtar
Karakterin me i nxënë,
Ç'do shpjegim për të do marr
Si u rrit e si ka qënë.
Sa të mundem do të thelloj
Dhe për gjithë Shqipërinë
Do të pyes, do të msoj,
Për Gegnin e Toskërinë,
Me një fjalë kjo Shqiprì
Dua tej-përtej të njihet
Atje tej në Maxharì
Të nderohet e të dijet;
Pra, ç'do di të m'a kallzosh,
Po të lutem zotris-s'ate,
Si t'a dish të m'a tregosh
Edhé sa të mundesh xgjate.
– Këjo n'a intereson,
(Po i gjegjet Shqipëtari)
Edhé Maxharija mson .....
Pra fillojmë. Pik-së-pari
Po të pyjes, mos m'a fsheh
Dhe m'a fal të lutem pakë,
Maxharija a e njeh
Këtë Shqipërinë plakë ?
– Po, e di se kâ Shqipni
Po ku gjindet nuku çquhet
N' Europ' a n' Abyssini,
Besa s' dijet, as që thuhet !
– Nuku kâ dhe fort zarar,
Shumë bukur, falem nderit,
Se Shqyptari â Shqyptar
Si n' Europ' edhé tej Ferrit.

Dhe një tjetër po të pves,
A e dijni S k ë n d e r b e n ë,
Q’ e nderojmë bres më bres,
Atë trim q’ habiti Dhenë ?
– Skënderbenë ? Psé, Shqyptar
Paska qen’ edhé s’e dinja ?
Këtë burrë kordhëtar
Pasha Zotin Shqah e njihnja !
Shqipëtar ka qënë ky ?
Paska qënë burri juaj ?
Mos i paça këta sŷ,
Un’ e dinja për të huaj !
– Mashallah Shqiptarofil
Qënke, morè t’ u ngjat’ jeta,
E n’a njohki mirë-fill
Pun’ e madhe e pa të mbeta,
Ndonse nè si bagëtì.
A si shtâz’ a si na dijnë,
Si gjithmonë dhè tani
Nè e njohim Maxharinë.
Vallë nè në Maxharì
Si n’a njohin, si n’a quajn
Çajnë kryet për Shqiprì
A po së lodhen, as që luajn ?
– Tundu vendit ! Ç’ka po flet ?
Ju kujtojnë shumë herë,
Aq sa mendja s’u a pret,
Ju mentojnë për të mjerë
Dhe shpeshere ju vjen keq
Për Shqypnì e Shqypëtarë
“Komb’ i ngratë, thonë, heq,
“Jan’ të trashë e barbarë” !
Po, të lutem, mos u ftoh

Se po flas pakëz shpenguar
Edhè mos m'u hidhëroh
Si Shqiptar që jè i xgjuar.
– Të hidhënohem ? E përsè ?
Se mos jè zotrote i pari
Që n' a merrni per mezè
E poshtrohet Shqipëtari ?
Jo, mor Zot, folë si do,
Jam i ftohtë si mermeri,
Ti iq drejt, mos u tundo
Edhè komplimentat leri.
– Besa Zotit, tash të çmoj,
Qënke karakter i ftohtë,
Më pëlqen të bisedoj,
Ndonse unë jam m' i ngrohtë.
Po t'i lemë tash për tash
Të gërgamet, në jè burrë
Se kështû shkon pash-më pash
Bisedimi s' mbaron kurrë.
Pra më thuaj e fillo
Gjendjen mbarë të Shqiprisë
Edhè holl' e zhdrivillo
Mbas kanun' e Historisë,
– Si urdhnon, po e fillonj,
Mbasi paske kaq deshirë,
Do mundohem t'a tregonj,
Sa të munt mir' e më mirë
E po nis dale-nga dal
Me të qet' e si di vetë
Dhe kusuret ti m' i fal
Edhe ..... qënke mos n'a jetë.
– Ha, ha, ha ! pralla kallzon ?
– Pralla ndofta ti po thua,

Po këto që po dëgjon
Janë histori për mua.
– Urdhno, folë e më ndjè.
– Historia jon e vjetër,
Morè zot, fillon q' atjé,
Kur s' ka qenë as gjë tjeter
Për veç uj' e qjell e dhè
Dhe kur krisnë piksëparit
Bubullimat me rrufè
Dolli zogu i Shqiptarit !
E gjëmuan Qjej' e ç' jan
Edhè mbijnë male-sërë
E G j i g a n d ë e T i t a n
Edhe Perënditë tërë !
Perënditë kush e kush
Deshin që të mbretëronin
Dhe u vran' e dheu u mbush
Plott me gjak, që sijsh pikonin,
Te e mbramja mundëtar
Dolli Hŷji – Jupiteri –
Dhe ky mori gur e âr
Dhe të gjith i kapi tmeri !
Edhè Mbretrin e tij e ndau
Me N e p t u n d i n e P l u t o n i n
Dhe T i t a n ë t i përlau
Edhè Hŷji zurri fronin !
Mal m' i math T o m o r i ish
E m' i nalt' e madhështuer
Edhè Hŷji atje kish
Fron e par' e mbretënuer !
Kish në dorë një rrufè
Po si një shkëndi të zjartë,
Që friksonte Qjell e Dhè

Dhe selìn e kish të ârtë.
Rrotull tij kish shoqërì
Perêndi e Perëndesha
T û r m ë s i për mjetësì
A t h e n a j a virgjinesha.
M a r s, A p o l o n e Vu l k a n
E D h e m o t e r e D i a n ë
A f ë r d i t ë edhè P a n
Edhè D e t e O q e a n ë
Edhè kush e di se saa
Rrotull Hŷit i shërbenin
Dhe e dronin per gjith ç' ka
E dëgjonin, fjalë s' kthenin !
Kshtû filloj, i dashur zot
Histori e Kombit t' onë,
Kshtû e gjetm' e sot e mot,
Kshtû do mbetet per gjithmonë,
Pak të shkurtër po t'a flas
Prallën e M y t h o l o g j i s ë
Po me ktë të jap një shkas
T' historis së Shqipërisë.
– Ha, ha, ha, ti po përsrit
Historin e Grekve të parë
Që mes shekujve shëndrit
E q' e dijnë Bota mbarë !
– Thua ti dhe shoqt' e tu,
Që s'e njihni Shqipërinë,
Po tani q' ardhe këtû
Do t' ja nxesh mir' historinë.
Se t' i vet' urdhrov' e thè
S' dini se kû â Shqypnia
Në Europ, a në Mes-dhè
A e merr Abysinija !

– Bukur fort, po nuk marr vesh
Psé Mythologjìn e huaj,
(Dhe të lutem të më ndjesh)
Psé ja ngjitni vehtes t'uaj ?
– Ti m' a fal, nuk ësht' ashtû,
Lark nesh qoftë ç'do lëvdatë,
Po në daç për me hetû,
Me shqyrtue gjërr e gjatë,
Këtë drejtë do t'a njohsh.
Se në gjuhën shqip të gjallë
Kto të gjitha do t'i shohsh
Dhe Mytologjì e prallë
E ahere do mbesosh
Se kjo ishte vërtet jona
E as pak nuk do dyshosh
Dhe do bindesh te e vona.
– Shumë mirë, po dëgjonj
Dhe jam i pa-korrêt[1] shumë,
Edhé dua që t' i msonj
Mbassi paskam qën në gjumë,
– Grekët, moré zotëni,
E kurdisnë bukur mirë
Këtë koxhâ-Mytologjì,
Se n' a gjetnë n' erësirë.
Né të shkretët, si barrinj,
Kur ja mrijnë Grekët e parë,
S' kishim gjuh' ishim fatzinj,
Ne barrinj, ata bujarë,
Ndonse tjetër herë né,

[1] i pa-korrêt = nuk jam në korrent, jam i paditur

Gjer në shekullin e shtatë[1]
Kishm harrirë gjer atjé
Sa s'kish komp më i begatë,
Si në gjuh' e qytetnì
Si në shkenxat e të tjera,
Po, mjerisht ajo lumnì
U çduk e kaloj e mjera,
E kështû në këtˆ Atdhé
S' mbetnë përveç se shëmtyra[2],
Që i ruajm edhé né,
Tjerat i mbuloj natyra !
Si të vjetër q' ishim né
Kush di sa shekuj mâ parë
E të ngulun në këtˆ dhé,
Bujq, barrinj edhé druvarë,
Dijnin vetëm me livrû
Tokt' e majme e të gjerra
E me pré kërcûj e drû
Me kullos' baktì e berra,
Kthize[3], kshtjella me i ngrehë
Me godit shtëpi e ksolla
E prej armësh mos m' u çkrehë
Jo me bâ tregti e të holla,
Për gjujtarë s' kishim shok
Gjuanim pa-prâj' e masë,
Në të nderit patalok[4]
S' muntte kush të na përkasë !

[1] 2.200 deri 717 para Kr. Jetonte një komp që quhej "Hetêj" i cili ishte pelasg, fis i jonë që u dallue në qytetnim, dije e vepra, deri më 717 para Kr. Ky u prish prej Assyrëvet.(K. Floqi)
[2] Shëmtyra = gërmadha
[3] kthize = ndërtesë madhështore e pozicionuar në qendër të një vëndi.
[4] Patalok = shesh i madh ku zakonisht bëheshin dyluftime

S’kishim krye për me çâ
Me ndjek shqenxat, diturin
Edhé mendjen me e vrâ
Për me shkrûe historinë,
Kur se Grekët më të zott,
Tue u shtrijmun në vent t’ onë
Kohën më s’ e humpnë kott
U munduan gjithë-monë.
Muarr fenë, q’ u pelqeu,
Fenë t’ onë hijerore
Dhe zakonet q’ u rëfeu
Prall’ e bukur Pelasgore
Dhe nga dale mbi këte
Kaq të kandëshme rafshtinë
Thurrë Grekët një-mbas një
E l l i n o m y t h o l o g j i n ë !
More vesht, more Doktor,
Mik i dashur e i vyer,
Fé e Grekve si u torr[1]
Edhé si paska kërcyer ?
Gjith ashtu pra, mbas kësaj,
Për disà e sa ndollina,
Grekët kanë ndo nji faj
Sepsé bënë mrekullina ?
Shqiptarët pa një cmir
Kto i shihnin, po s’ kuptonin,
E se Grekët kishin hîr,
Këtas në për ment s’ e shkonin.
Dyke parë Grekët pra
Hallin t’ onë, plogësinë,
Ngrehnë ëndrat e mbëdhâ

[1] u torr = u tjerr

Edhé shkruan historinë,
Dhe me nj' atë mjeshtëri
Që u perket Grekve të parë
Çpikn' atë Mythologji
Që çuditi shekujt mbarë ;
Po themeli q' u godit
Kjo ndërtesë historike
Prapë them, mos u çudit,
Ishte P r a l l a p e l a s g j i k e !
– Pasha fenë me habit
Me këto që po më thua,
Dhe sa vjen po më mahnit,
Mendja fort m' u turbullûa !
Dashç Perndinë ma trego
Ketë "prallën pelasgjike"
Hollësoj' e ma shpjego
Në pikpamjen historike.
– Po pasonj e kij durrim
Dua të mos dyshosh fare,
Si për Fée e A d h u r i m
Dhe zakonet shqipëtare,
Se për fat e lumeri,
Fjalëtë mythologjike
I gjen sot në Shqipërì
Në atë gjuhën pelasgjike.
Emrat greke T h e t i s, P â n,
A p o l o n e A f r o d h i t ë
H e r m e s, H e r a, O q e â n,
H o r r a i, E r e v o Perndité
Dhe disa te tjera plott
Që sheh në Mythologjinë
E që s' mundesh t' u gjesh dot
Rênjën, etymologjinë,

Shqip i ké perpara ti,
Mos u loth se flasin vete
I këndon me lehtësì
Dhe s' të mbetet gjê e metë:
H e r ë, D e t edhé S t o p a n,
T û r m ë s, H o r r a t, Erësinë.
A f ë r d i t ë, O k é â n
A - p o - l é n e R e n' e S h i n ë
K r o n i n, H ŷ j i n - a t ë Z o t
D j e l l i n, H ŷ l l e t edhe Hânën
E Të t h â n e n[1] me ment plot
A r ë - t y m ë s e n - D i j a n ë n
Ké të M a r t e të M e r k u r ë
Ké të P r ê n d e e të S h t u n ë
N ë m ë n A f s h t - i n[2], të zi ûrrë
E të tjerë kû di unë !
Ké T o m o r r i n në Berat
Që sijsh mjergulla nuk çohet
Edhé majën ja fërkat[3]
Edhé zë q' andej degjohet[4] !
Ti s'e din, o miku jim,
Mir po unë q' e kam parë,
Edhé tash ndjenj nj' adhurim
E nërshtypje plott kam marrë.
Edhé sot në Toskërì

---

[1] T' thanën = perëndesha Athena, Athinaja

[2] Greqisht E f e s t o s, Perëndi e zjarrit, gjithmonë i zì si urri (urë = dru i djegur, urë zjarri) Shënim i Kristo Floqit.

[3] ja fërkat = ja përlan

[4] Në artikullin e tij "Tempull' i Dodonës" K. Floqi shpjegon se Hyji Pelasgjik,sipas mitologjisë Pelasge,kishte banesën e tij në majën e malit të Tomorrit, më pas, disa qindra vjet më vonë, Hellenët, me imagjinatën e tyre e transferuan banesën e Hyjit në Olymp. Tempullin e Dodonës K. Floqi e ka vizituar personalisht dy herë,gjë që e përmend edhe në vargun e mëpasëm

Në katundet e Arbnisë
Gjen të gjallë historì
T' Ellino-mythologjisë.
Pra legenda e folklor,
Pralla, kengë, droj' e tjera,
I gjen brenda në Tomor,
Fort të kândëshme, të vlera.
Edhé puna si e desh,
Ç'do që çpikn' ata të parët,
Po si prallë vesh-me vesh
Mbet trashgim për né Shqiptarët.
Kto legenda, që perment
Të kohës prohistorike[1]
Janë cok[2] edhé nji ment
Nj' ajo Pralla Pelasgike,
Kështû Greku shtegëtar,
Kur e shkeli Shqipërinë,
Mbi ket prallë e altâr
E trajtoj Mythologjinë.
Prej Sanskritëve m' andej
E strugati[3] e stërholli.
Tue e sjell' andej-këtej.
Fantasia si i a polli.
S' â nevoja me u ngjât
Jé i mençim, i sheh vetë,
Tash e njeh të shkretin fat
Historinë e vërtetë.
– Falem nderit, rrofsh e qofsh,
Ti m' i çele sytë mirë

[1] Koha prohistorike apo prehistorike = koha përpara se historia të shkruhej
[2] Cok = pikërisht ashtu, tamam ashtu
[3] E strugati = e zdrukthoi, e lëmoi, e bëri më tingëllues, më të "ëmbël" për veshin e njeriut.

Dhe prej meje meritofsh
Evarì[1] e nder e hîrë.
– Kqyr H o m e r e H e r o d o t
T h y q y d h i d h i n e S t r a b o n ë
E P l u t a r k e S i q e l j o t,
S t a g j e r i t i n M a q e d h o n ë[2]
H e s i o d e P t o l e m ê n j
E P i n d h a r i n e S a p f o n ë,
E shkrimtarët e mbëdhenj
M a l t e–B r u n, H a h n i n, D o z o n ë,
H u g o G r o t t, H é q u a r d e P l i n ë
E P o l y v i n e B y r o n ë
Frënq, Gjermanë e Latinë,
Greq, Engleze ç' ka po thonë ;
D o k t o r S a y c e, D a r r e s s y
B o p p, J u l i e n, e D u b u i s s o n ë
Dora d' Istria, K o m n e n i[3]
B l a u–n, A r a v a n t i n o n ë
E L e g r a n d e P a u q u é v i l l
E kush di se sa të tjerë
Dhe do njohësh mirë-fill
Këtë komp të zi të mjerë,
Që nuk di se për ç' mëkat
Kaq' u muar në për këmbë
E gjithkush sot e rropat
Kush me grusht, kush me pëllëmbë.
– Po, vërtet i kam këndû
Gjith sa thua bukur, mirë,
Edhé vetë jam mendû
Këtë të drejtë me e dlirë.

[1] evari = mirënjohje
[2] Stagjerit Maqedhon = Aristoteli
[3] Anna Komneni, shkrimtare e dëgjuar (K. Floqi)

Dhe, si thashë, për këtë
Ktu të vijna dëshironja
Mos me lënë mangut gjë
Gjindjen t' uaj të studjonja,
Andaj prapë mos u rënt[1],
M' i kallzo dalë-nga dalë,
Kjo bisedë, ky kuvent
Më kënaq fjalë për fjalë.
Tash zotrote më ftillo
Dhe një sent t' interesuar
Edhé hollë m' a çvillo,
Si ato që ké çvilluar.
– Urdhro folë, jam gatì
Bisedimin t'a pasojmë,
Edhé si t'a duash ti
Gjer t'a sosim, t'a mbarojmë.
– Maqedonët, q' i lëvdon
Kaqe tepër Historia,
Cili komp i numuron,
Greku apo Shqipëria ?
– Maqedonët, zotëni
Ata burra të dëgjuar,
Që treguan aq trimnì.
Sa dhe sot nuk jan' harruar,
lshin Shqipëtarë krejt
Si H a o n ë t, T h e s p o t i n j t ë,
Prindët t'onë drejt për drejt,
Si këta, si I l l y r i n j t ë.
A l e k s a n d r i, që s' kish shok
Në trimni kuxim e shpresë
E q' u ndâ në patalok

[1] mos u rënt = mos u rëndò, mos të të vijë rëndë

Për burrnì edhé për besë,
Ishte burrë Shqipëtar,
Që kurrkush s'e pat kalûe
General e mundëtar[1],
Që s' la vend pa e pushtûe
Edhé Bota gjith' u bind
Për kuximin e burrninë,
Që gadhnoj[2] Persì e Hind
E Misir[3] e gjith Asinë.
– Shumë bukur, po për sé
Grekt' e quajn për të 'tyren
Dhe me ç' prova e me sè
Mundesh ti t' ja ndrosh natyren ?
Kur ata me gojën plott
A l e k s a n d r i n e F i l i p p i n
Kaq' i mburrin sa dhe sot,
Për mbi Qjêj i vên' i hippin ?
– Mos u ngut, Doktor, po prit
Se ketû s'do lodhem shumë
Edhé nuk do t' të mërzit,
As do flas shum' e për lumë,
Të mos ishte Shqipëtar
Aleksandri, ajy burrë,
Grekët s'i thojshin "barbar"
Edhé s'e përçmonin kurrë.
Për Filippn' e math, q' u dha
Grekëve aqe shuplakë
D h e m o s t h e n i s'thesh të mbdhâ

[1] Mundëtar = fitues betejash, ngadhnjimtar
[2] Gadhnoj = pushtoj
[3] Misir = Egjypti

Nëntë plott O l y n t h i a k e[1] !
T' huj' i quante të dy,
Bisha t' egra e barbarë
E i kish alë në sŷ
Kush mban ment sa i kish sharë !
Në Athin' ahere ish
Një E s c h i n, orator tjetër,
Që Filippi mik e kish,
(E pagonte me të tepër).
Dhemostheni m' atë zê
Aqe t' ashpër e të flaktë,
Nuk lâ gurr e dhé mbi të,
Tradhëtin ja zbloj me fakte.
"Jé i thesh një tradhëtor
"Sheshas n'a tradhton Atdhénë"
Sa të ngratit orator
Më në funt i lûjti fenë[2] !
Kshtû i shkreti orator
Q' ishte mbas këtij i dŷtë,
Prej Athinës krejt u çporr
Shkoj e më s'i kthevi sytë !
Po të ish Filippi Grek,
Psé luftonte me Greqinë,
Aleksandri psé s'la shtek
Psé u ngûlë në Athinë ?
Edhé pse Thiva u doq
U rrënua me themele,
E psé Greku tepër hoq
E u çqye zhêle-zhêle ?
Edhé prapë kur afroj

[1]Filipiake dhe Olynthiake janë fjalime të Demostenit kundra Filipit të II-të të Maqedonisë (Babës së Lekës së Madh)
[2] i lujti fenë = ia kallzoi vendin

A n t i p a t r i mû në derë
Dhemostheni psé s' duroj,
Po vrau vehten, vdiq i mjerë ?
Tjetër çprovë po të nap
Mjaft të plotë e të gjallë
Që do shohç se më ç'do çap
Sa Shqyptar ish burr' i rallë !
Në shatorren Leka kish
General' e tij Filotën
Që me të ky lidhun ish
(Kishin marrë gjithë Botën),
Ky Filota reptësisht
Fort i hidhur, i zembruar,
Na e shan një dit greqisht
Një ushtar, qi ish fajtuar;
Aleksandri e dëgjoj
Edhé prej shatores doli
Dhe Filotën e qortoj
Edhé ashpër shum' i foli:
"Nuk ké turp, i tha që flet
"Në një gjuhë q' ësht e huaj" ?
Dhe Philota ngrivi, mbet
E s'u duk për disa muaj !
Praa, të them se ish shqiptar
Dhé shpesher' e kish çprovûe
Aleksandri si barbar
Kombin nuk e pat mohue !
– Moré mik, ti më çudit
Me të tilla hollësina,
Fol' e një nga një i qit
Kto të bukura ndollina.
– Edhé mu mirë më vjen
Kur ti mbetesh i kënaqun

Edhé thuaj ç’ të pëlqen
Me të zblûe, me të çfaqun.
– Po, tamam, për lllyrinj
Di ç’kâ thé aty më parë,
Për Haon’ e Thesprotinj
Thé se ishin Shqipëtarë.
Ndaj, të lutem mos harro
M’ i ç’ koqit mirë si duhet
Edhé gjatas i numro
“Komp Shqiptar” kush e kush quhet.
– Si urdhnon, po t’ i kallzoj,
Ti veç fol’ e lyp ç’ të duash,
Unë s’ rëndem, as pritoj,
Të tregonj ç’ do që të thuash.
Mâ i madhi Gjeografist
E m’ i famshmi i Greqisë
Shih se ç’thotë caktimisht
Për banorët e Shqiprisë.
Esht e tepër, ti e di
Se Dheshkruesi Straboni
Një Dheshkronj’ e nj’ Historî
La të bukra, mbas zakoni.
Kur u derdhë në Shqiprì
(Flet Straboni per Ellinët)
Gjetn’ atjé një barbarì,
Njerës t’egër të pa-ngjinjët[1].
Ishin bulqër e barrinj
E kthis-bâmës[2] e druvarë,
E të mveshur si harrinj,
Fort të gjattë po si trarë.

[1] të pa-ngjinjët = të pangopur
[2] Kthis-bamës = puntor ndërtimi

Adhurojshin Dhé e Qjell
Edhé Hënë edhé Hŷje,
Edhé Herë edhé Djell
Edhé male edhé pyje.
Ishin burra si drangoj.
Shproha[1], ûjqër e luâne,
Dhe – këtë nuk ju mohoj –
Se të hijshëm kishin shtanë[2].
Rode dy-mbë-dhetë plott
Ishin gjith këta të huaj,
Dhe në rrugë s' vijshin dot
Brithnin maleve si kuaj.
Këto skota[3], që tregonj
Q' ishin gjithsej dy-mbë-dhetë
Tash këtû t' i numuroj
Pa kur-farë një të mbetë
M o l l o s i n j e I l l y r i n j
S h e l ë edhé P a f l a g o n ë
E Q y k l o p' e T r i b a l l i n j
T h r a k, S y b a l l ë e H a o n ë,
Edhé T h e s p r o t i n j disâ
E L e l e g' e M a q e d o n ë,
Thjesht Pelasg' ishin këta
Që banojshin në vent t' onë.
Por këta i sheh dhe tash
E i njeh si dhe më parë,
S'janë fjalë them - e thash,
Flasin shqip, janë Shqiptarë.
Çam e Lap e Himarjot
Gegë e Toskë e Malsorë

[1] Shproh = kuçedër, dragua (K. Floqi)
[2] shtanë = shtatin
[3] Skota = rod, fis

E Dangllîjas e Suliot
Epirotasit e gjorë
E bajraqet e Gegnìs
Malesija Kossovare,
Gjithë Fiset e Arbnìs
Gjith krahinat Shqipëtare.
– Bukur, besa, i tregon,
T' qofsha fal' e t' qofsha trûe
Po dhe një në mos priton
Dëshironj me m' a shpjegue.
– Folë, folë, po digjonj.
– Sa për Illyrinj që thua,
Nuk është vërtet kujtonj ,
Edhé cok un' atë dua
Të ma çquash hollësisht
Illyrinjtë cilët janë,
Që t' a kupëtonj qarisht
Kryen, rrênjên ku e kanë,
Se ketë duhet të dish
Që Harvati e Sllavoni,
"Illirija sllave ish"
Thon' e jo si flet Straboni.
– Tesh e shoh dhe do m' a falç,
Në qoftë se xgjatem pakë,
Dua mirë vesh ta març
Çështjen e Shqiprisë plakë,
Para Krishtit gjasht-qint vjet,
(Q' ësht mjaft një koh' e gjatë)
Nis, fillon me të vertet
Kjo historì e begatë[1]
Prîjës ish një B e l o v e ç,

[1] Kqyr D u c a n g ë - in, d.m.th. Herodotin e Sllavëvet (K. Floqi)

(Qe shtergjyshi quhet t' onë),
Burr' i trashë e neneç,
Si tregonjnë e si thonë.
Shkodrën kish krye-qytet
Mbretërì e Illyrisë,
Shtrihej gjatt' e mbi brek-det
Të Jonit e të Adrisë.
Mbas këtij mbretroj një R o x
Edhé mbas tij N e m a n j y l i,
Gjith ashtu një S h j e f n një V r o x
Gjer sa vijmë te B a r d h y l i.
Illyrì ahere ish
Deri n' P o l l e deri n' T û n ë
E B r e k-d et i n e Z ì i kish
Dhe nga Jugu në Z e t û n ë.
E p i r e M a q e d o n ì
Edhé T h r a k ë e të tjera
Ishin ngastra në Shqypnì
Të begatshme e të gjerra.
Mos t'a ngjatim aqe lark,
Se ky s'â qellimi ynë,
Andaj prapë i vinj qark
Illirise, si e msynë,
Ky Bardhyli ish një mbret
Madhështor e i pa-ngjinjët,
Plott fuqi e plott vulnet,
Sa, marras e kishin fqinjët.
Ndonse ishte Shqipërì
Edh' ajo Maqedonija,
Ky mbret desh që n' Illyrì ,
T' ishte froni e selija.
Qé pra lufta që çmbërtheu
Me Filipin-Maqedonë

Sa Bardhylin ky e theu
E ja là Filippit fronë.
Prapë duket se më von
Një mbret tjetër i Illyrisë
Del, e quheshe A g r o n
E ish shëmbëll i trimrisë.
Illyrinë e mëkëmp,
E xgjeron e forcon tepër
Dhe anmikët gjith' i tremp
Me trimnì, kuxim e vepër.
Po Agroni râ e vdiq
Edhé la të shoqen T e f t ë n
Cila bëri shum anmiq
Illyris i humbi vleftën.
Illyrinjtë, që po them,
Ishin të këqinj piratë[1],
S' lanë gjë pa bër' ujêm
E më fort Romën e ngratë.
Roma per këto ankon,
I çon Teutës dy bajlozë
Edhé shumë e frikon,
Kusarija të mos lozë.
Mirpo Teuta me madhshtì
Që të dyve ju pret krerët
Edhé Romës si dhunti
Ja përcjell këta të mjerët.
Edhé ky ka qenë shkak
Që u msŷ rreptsisht kjo tokë
E u dha në zjarm e flak
E u bê pluhur, bërlokë.
Po dhe nj' herë u storas

[1] Kusarë të detit (K. Floqi)

Mbretërì e Illyrisë
Dhe selì edhe pallas
Prap ish Shkodra e Shqypnisë.
D h e m e t r o x e G j e n ç i rii
Edhé P e r s i më së fundi
Mbretëruan n' Illyrì
Gjer sa Roma prap i mundi
E dërgoj në Illyrì
P a v l o - E m i l i n e rrëpirë
Që me hov e me furrì
Ra si shkaba pa mëshirë
Dhe përmbysi e rrenoj
Shtatë-dhetë plott qytete,
Edhé Persin rob e çoj
Me qindëra mijë vetë !
Kështu rrishtas kjo mbretnì
Nënë Romën u poshtrua
Dhe fat-zeza Shqypërì
U përmbys e u shkretua !
Roma pat të math fitim
Prej ktij kombi t' Illyrisë
Q' i dha burra me çkëlqim
Shëmblla mendjes e trimnisë.
Një K l a u d e n j ë V a l e n t
P r o b u s, A u r e l i a n i n,
Edhé një të math K l e m e n t
Edhé D i o k l e t i a n i n.
Gjith këto që po kallxonj
Para Jesu-Krishtit ngjarë,
Janë prova që çprovonj
Se Illirinjt' ishin Shqiptarë,
E jo si urdhrov' e thé
"Janë Sllavë e Harvatë",

Se këta mbi këtë Dhé
Ardhë në shekull të shtatë !
Nuk po them, është vërtet
Se Harvatet kan' sunûe
Tuj pasë Shkodrën kryeqytet,
Illyrin e kan' gadhnûe,
Po këjo nuku çprovon,
Se Illirinjt' ishin Harvatë
Gjith' ashtû dhe për Sllavon,
Sa do xgjedha ish e gjatë ;
Se dhe Gotthët kan' sunû
Aso-kohet Illyrinë,
Serb, Bullgar' e kan' poshtnû
E Roman' e Byzantinë
Dhe i famshmi Venedik
Edhe Turqit më së fundi,
Por ç'do xgjedh' e ç'do rrezik
Kombësin as pak s'e tundi,
E sa do që kâ lëftû
Kombi me racën Harvate
Dhe këta kanë ndryshû
Kushdì sa katund' e fshate,
Sa do krejt e kan' sllavû
Për m' u shdukë Illyria,
Sllavi rrënjë nuku zû
Si kâ qënë mbet Shqypnija.
Gjuhën, gjakun po i sheh,
E ndërgjegjen e zakonë,
Shqipërija kështû qé,
Si ahere si gjithë-monë.
Mbret' i Unëve njiment
Aj Attilla i tmeruar,
E ka shkelë këtë vent,

E kâ prish' e ka rrenuar,
E përmbysi me themel
Dhe trokoj livadh' e ara,
Sa s' mbet bâr e grûr' e mel,
Sa ju shua drithit fara,
Dhe rëmeti[1] tër' u tund,
U shkretuan sa qytete,
Shqipëria krejt u shkunt,
S' qëndroj pemë, as lëmpjetë,
Por a thua kjo Shqiprì
Ndroj zakon' e gjuh' e ftyrë !,
Sa do hoqi mizorì.
Sa do rrebët q' ishte msyrë ?
Gjith' ashtû në Ungarì
Turku ndej nje shekull mbarrë,
Po kujton se kjo furì
Mos e bëri Turk Maxharë ?
Shqipëtarët i sheh ti
Të shpërkoqur, të shpërndarë
Në Greqí e n' Italí,
Në Siçilje e në Zarë,
Po sa do që lark jeton
Me të huaj i rrethuar,
Gjuhën, Kombin s'i harron
As zakonet s'i ka ndruar !
– Ké të drejtë, po e shoh,
Tash e kqyr punën më mirë,
Ashtû është un' e njoh,
Mjaft të qartë e të dlirë.
Po një gjë kam vënë ré
Në rrijedhjen e fjalimit,

[1] Rrëmet = grumbull njerëzish, njerzija

Dhe të lutem ma rrëfé,
Si pasìm të bisedimit.
Thé më lart për nj' at' Epir,
Q' ishte cop' e Shqipërisë,
Ndaj në dritë tash m' a nxir,
Un' e di vent të Greqisë.
– Me gjith qef edhé këtë
Po t'a thom, pa një pritesë,
Se të thashë, per kurrgjê
S' dua të kesh një vesvesë[1].
Për Epirin, pra, s'mjafton
Një volum i math, i gjërë
Edhé shum gjatë shkon
Të t'i them sërë-mbë sërë.
Esht e ditur për Epir,
Shumë n' a zhigatin[2] fqinjët
Dhé më fort nakâr e cmir
Kanë miqtë t'on' Ellinët.
Se atjé janë çvillû
Vepra, sende të shënuar,
Atjé janë plotësû
Gjith' ato që janë shkruar.
Atŷ Hŷji me rrufé
Atŷ Perëndit e tjerë,
Atŷ tundet Qjell e Dhé
Atŷ K o k k y t u s me F e r r ë
Atŷ shesh e patalok
Edhé luftra shum' u bânë,
Atŷ brihen[3] shok me shok

[1] Vesvesë = mëdyshje
[2] zhigatje = tundim
[3] Brihen = luftojnë

Hemithéj[1] edhé Titanë.
Atŷ shpirtat ven' e vijn,
Duke shkuar A c h e r r o n i n[2]
Atŷ T u r m ë s i lëvrin
Tok në lundër me H a r r o n i n.
Atŷ flet e shtije fall
Hieroreja D o d o n a
Atŷ fatin dushku çpall,
Atŷ tingëllin kumona,
Atŷ len ç' do adhurim
E kushtimetë hyjnorë
Atŷ drojë e nderim
E çpërblime e kunorë,
Atŷ K a d h m i shkrolat bjen
M' Apolonjë e në Vlonë
Diturija aty len
Që shëndrit shekujt më vonë.
Atŷ sqenat e mbëdhâ
Edhé dramat theatrale,
Atŷ tragjedì disa
Komedì e karnevale.
Atŷ linden për çudì
Edhé marrin frym' e ngjallen,
E përhapen me fuqì,
Ëndra edhé Pralla çpallen.
Atŷ prall' e kândshme mbin,
Prall' e bukur pelasgore,
Q' as një prallë s'e harrin,
Prall' e vlefshme e prindore.
Shkurt me folë, në Epir

[1] Hemithé = gjysëm-perëndi
[2]lumi Acheron (gr. **Ἀχέρων**) ndodhet në Epir dhe simbas mitologjisë greke ishte vëndi ku shpirtrat hynin në "Botën e nëndheshme"

Leu e “Nalta fantasija”
E u shkrue me aq hîrë
E l l i n o m y t h o l o g i j a !
Me një fjal’ Epiri sot
“Eshtë çerdh’ e historisë”
Këtë e thotë nj’ Herodot,
Është djep’ i Shqipërisë !
Këto që po them këtû
Edhé Grekët i tregojnë,
Po për ta nuk ësht’ ashtû
T’ huajt i përgënjeshtrojnë;
Se me folë caktimisht
Grekët “Finikas” kanë qënë,
Q’ andej duall pikërisht,
Më von ardhë në vënt t’ ënë.
Tjetër gjuhë kishin kta,
Gjuhën t’ ashpërtë finike,
Dhe këtû e kanë pa
Gjuhën t’ ëmbel pelasgjike,
Q’ ësht’ e dlirët por si fllad
Si veriu me ând’ e hirë,
Që tërheq edhé të sdat[1]
Me aq shij’ e ëmbëlsirë.
Është “trunk Japetik”
Gjuh’ e kjartë “Iranike”
Bisk ësht “Hindû-gjermanik”
Këjo Shqypja-Pelasgjike ...
Grekët, pra, me tregëtì
Merreshin e rreshperonin[2],
Dhe kështû në Shqipëri

[1] sdat = inkurajoj,frymëzoj (K.Floqi)
[2] reshperoj = bëj tregti të gjerë, me shumicë.

U shpërngûlë dhe fitonin.
Si tregtarë e me mënt,
Mbassi ndejtin e u msuan,
Tepër ju pëlqeu ky vent
Dhe këtu gunën e shtruan.
Brumën e gjetnë gatì,
(Pralla, historì zakonë)
Dhe u turrë me fuqì
E punuan gjithëmonë,
Edhé ngrehn' atë godì
Që çuditet Ruzullimi
Historì - Filosofì
Që leu gjith Qytetrimi
Po këtû ish Shqipërì
Edhé bruma shqipëtare,
Pra për nj' atë mjeshtëri
Ké ç' u thua Grekve fare ?
Andaj them dhe për Epir,
Q' ishte pjes' e Shqipërisë,
Shqipëria e pat bir,
Msoj në Shkollat e Greqisë.
Jé i ditur, i merr vesh
Këto fjal' alegorike,
Kshtû t'a dish e t'a rrëfesh
Këtë çështjen Pelasgjike.
Katër dialekte plott
Kishte gjuha Ellinishtja
Që prej syresh edhé sot
Flitet ajo Eolishtja.
Këjo duket tjetër t' ish
Jo ashtû si Grekët thonë,
Se ndryshime tepër kish,
Ishte cok kjo Shqypja jonë.

Edhé kishte shumë hîr,
Ish vjershtore e lyrike,
Që e kqyrnin me aq cmir
Grekët, se ish Pelasgjike,
Dhe ata që eolisht
Flisnin edhé vjershëronin,
"Bârbaroi" qujshin greqisht
Edhé Grekët i përçmonin.
Po kjo rron e gjall sot
Në Muséot e Athinës,
Që greqisht s' këndohet dot
Për mbi rrasat e Mekinës.
Në Epir, sado greqisht
Flasin sot disa banorë
Po të kqyrësh hollësisht
Gjen kudo shqipen e gjorë.
Ké H i m a r r' e Ç a m ë r i
L l a k' e S û l gjer në Prevezë
Q' ësht' e thjeshtë Shqipërì
Ndonse mbeti sot fatzezë,
E në vesh të tingëllon
Gjuh' e lehtë Toskërishte
E e ndjen e e dëgjon
Q' është shqip' e jo greqishte.
Po dhe burra një mbi një
Ky Epiri kâ pasë nxjerë,
Shqipëtarë e në zê
P i r r o n e disa të tjerë,
Që R o m a n ë t në T a r a n t
S i q e l ì e ku do qènë
I ka mundur anë e kant
Ashtû dhe në K a r t h a g j e n ë,
Por se n' A r g o s i n mjerisht

Ky trim u asasinua
(Se Shqyptar ish, s'dij gërqisht)
Pabesisht e vrau një grua !
T' tjera prova po t' kallzoj
Për këtë çashtjen e Epirit,
Se kam qef e dëshiroj
Që t' i njohësh mirëfillit.
Kur sundonte në Epir
Dynastija Byzanteshë.
Desh me hîr me të pa-pahîr
Shqipërinë krejt t' a çveshë,
Gjuh' e ndjenja ja ndaloj,
E e prishi nga morali
E mundoj e përdhunoj
Vet' ajy K o m n e n i, krali.
Po Shqyptari Epirot
Këtij krajli nuk ju shtrue
E luftoj me fuqi plott,
Prej Epirit e ka dbue !
Pra, masi Komneni ish
Një Byzantas, Grek prej fisi
M' Epirotët psé e prish
Deri sa u çporr e krisi ?
A ké mê, or zot, dyshim,
Për Epirin e Shqipnisë
A maston ky bisedim,
I zê besë Historisë ?
Gjith' ashtû Serb e Harvat
Janë nxjerë prej Epiri
Dhe Shqypnij' aher' u xgjat
E gjer' n' A s p r o[1] ish kufiri !

[1] Lumi i Akarnanis A h e l ô o s (K. Floqi)

A e din se cili ish
Ajy burr' ajy drague,
Që në jetë shok nuk kish
E që Sllavët i ka dbue ?
Msoje pra, moré Doktor,
Ç' burra që ka pas Shqypnija,
Ish Matjan e madhështor
Ish ajy K a r l o - T o p i j a !
Dhe Epir e Gegënì
Dhe krahinat gjithë mbarë,
I bashkoj me nji lidhnì
Gjithë burrat Shqipëtarë,
E jo vetëm u perpoq
Si një Gegë për Gegninë,
Po dhe për Epir u doq
Kshtû e njihte Shqipërinë !
– Një çudi po më tërheq
Miku im i dashur shumë,
Dhe prej teje dorë s' heq
Qysh se këtë bised' e zumë,
Edhé bukur shoh tani
Hollësit edhé ndryshimet
Edhé njoh për Shqipëni
Pa-drejtësitë e gabimet.
– Ké të drejtë, si po flet
Se ashtû i kini msuar,
Kemi shum' armiq vërtet
Që na kanë tradhëtuar !
Tash prej mejet mê a do,
Të të them për mbi qëllimin,
Apo janë mjaft këto,
E e presim bisedimin ?
– Mos e pré, të lutem fort,

Bisedimi s’ u mbarûa,
Këjo rasje e ky short
Ishin një lumnì për mua.
Pra dhe një s’ kemi shpjegû,
Për të madhin Skënderbenë,
Dua hollë me dëgjû
Per atë, që tundi dhenë.
– Oh, ma fal, bëra gabim,
Ti e din se s’ mbaron kurrë
Ç’ do tregim e ç’ do shpjegim
Për ç’do trim e për ç’do burrë;
Po per Gjergjin Kastriot,
Që për Shqah e paske marrë,
Nuku rëndem, morè Zot,
Edhé tash ké për të parë.
Nuk dyshonj se do t’ a dish
Historin e Kastriotit,
Ç’ bab’ e nan’ e vllazen kish
Ky shpirt math, engjell i Zotit.
Jetëshkrimn’ e Skënderbeut.
Ti e ké këndu dhe njeti,
Po për burrin e Atdheut
Flet mê kjartas aj Barleti[1]
Që e njihte hollësisht
Bukur fort e pa të mbetë
Ky ka shkruar latinisht
Historinë e vërtetë.
Masi, ky në Krûe leu,
N’ atë kthizën e Shqypnisë
Si munt t’ ishte Skënderbeu

[1] M a r i n B a r l e t i prej Shkodret, “Historia de vita e gestis Scanderbegi”(K. Floqi)

Shqah e zogu i Shqenisë ?
Sepsé kisht' e ëm' e tij
Një far' emnit Vo i s 11 a v ë
Se mos â kjo një dëshmì
Q' ajo grua ishte sllavë ?
Unë thashë dhe me lart
Kur Shqipnija u gadhnûa
E prej Sllavëve u çart
Tok' e fush e lum' e prua,
E qytet edhé katund
Krejt sllavisht e emëruan,
Mos Shqypnia mori funt
Dhe Shqiptarët u sllavuan ?
Ti po shef dhe sot nder né
Emna sllave sa të duash,
Por as një dyshim nuk ké
Për shqiptarët si ti quash.
Skënderbeu pra ish Shqiptar,
Per Shqypnin e linte jetën,
Ish i lindur luftëtar
Për me folë të vërtetën.
Të mos ishte patriot
Nuk do t' a shkelmonte fatin
As qe do të linte dot
Padishah-Sultan-Muratin;
Po ky burrë e çprovoj
Se e donte fort Shqiprinë,
Për të cilën ky luftoj
Sa e çkatëroj Turqinë.
Ky luan s' ish vetëm trim
Po dhe mendje-i begatë,
S' ndahej vetëm në kuxim,
Po dhe fjalën e kish shpatë.

Zembr' e tij ishte plott hîr
Edhé shpirt' i tij i qetë,
Ç' do ushtar e kish si bir,
Gjith' i donte si të vetë.
lsh i butë, ngushëllor,
Po dhe luftëtar i rrallë,
Ish krenar e madhështor,
Në ç'do rresht e në ç'do ballë !
Tash fort shkurtër po tregoj
Me pak fjalë e jo gjatë
Luftat që ky veproj
Q' jishin plott një zet e shtatë !
F e r i z - P a s h ë - mjekër - ziu
Ish i pari qi e msyni,
Mbas këtij edhe A l i u
Me mizri kalorës mrini.
Për së treti M u s t a f a j
Me dy lufta fort gjaksore
U munduan pa uzdaj,
Skënderbeu s' u munt kso dore !
Për të pestën ky dajì
U lëshua si i marrë
Me të madhe kalorì
Për të mposhtur Shqipëtarë.
Po për fat të tij të zi,
Skënderbeu i bëri ballë ,
M u s t â – P a s h e n – K o n j a 11 ì
E zû por si mî të gjallë !
Po shpirt–madhi Kastriot
Pashën ja çoj prap Sulltanit,
Ishte burrë, ishte zot,
S' ja la tehut t' jataganit !
F i r u z-P a s h a një tartar,

Ish nër Turqit i lëvduar,
Si i rrebët luftëtar,
Që kurrkush s' e kishte shkuar;
Vjen me lavd' e me furrî
Dyke çfryr' e dyke tundur,
Me një bûj' e madhërî
Skënderbenë për të mundur.
Burri t' onë e njeh holl
Firuz-pashë generalë,
E kâ parë në Stamboll,
Se këtij s' i shpëton âlë,
Dhe në sŷ por sa e pà
Krye lartin A n k r a l l i n ë
"Bujrum, effendëm" i tha,
"Haj t' a njohësh Shqipërinë" !
Dhe më s' priti, as vonoj,
Në duello del me nj' herë
Edhé kryet ja shkurtoj
Edhé Turqit muarr tmerë.
Prapë M u s t â – P a s h a vjen
Me tridhet' e kusur mijë
Edhé Skënderben e gjen
Të gaditur t'a përpijë.
Luft' e madhe krisi shpejt
Fort e vshtirë e tmeruar
Mustâ – Pashën ky e vret,
Turqit mbetnë të turpruar !
Këtë dhunë s'e duroj
Padishah – Sulltan – Murati,
Edhé shpejt ky urdhëroj
Gjith' asqeri të ish gati.
Treqint e ca mijë vet

M u s t a f ëz[1] e J e n i ç e r ë,
Arm' e topa e ç'do mjet
Nisen për Shqypnin e mjerë !
Skënderbeu nuk u lëkunt,
Por burrnisht i pret ordhitë.
S'e la zembra, as u tunt,
Pregatit dhe ky të tijtë.
Lufta plasi me rrebesh,
Fort' e rënd' e pa-dëgjuar,
Njeri-jatrin s'e merr vesh,
Kaqe jishin turbulluar !
Dhe Sulltani urdhëron
Zjar' e flagë an' e mb' anë,
Edhé Krûën e qarkon,
Si qytetin, si kalanë
Skënderbeu por si luan
I lëshohet Turçellisë,
Korr, përmbys, shkatron, përlan,
I kall tmerin ushtërisë !
Luft' e shkretë shumë ngjat,
Mijra shpirt kafshojnë dhenë,
Po Sulltani fitim s' pat
Nuk e mundi Skënderbenë,
I dërmuar funt e krejt,
E i marr' e i tërbuar,
E lé Krûën me të shpejt,
Ikën pa ngushëlluar.
Po zembrimin s'e harron,
Mni' e tij më tepër shtohet,
Skënderbenë e mallkon,
Prej marrazit ment marrohet.

[1] mustafëz = ushtar rezervist

Tjetër Pashë i vërvitit,
S e b a j i l i n e dëgjuar,
Dhe me lott, e porosit
H a j n i n t' ja bjerë nër duar.
Po sa do që ja dërgoj
Sebajilin me kaq mijë,
Edhé vetë nuk pritoj,
Duar-kryq s' mundi të rijë.
Dyqint mijë i nis pas
Edhé vet i hippën âtit,
S'i durohet as nji ças
Padishah - Sulltan - Muratit.
Skënderbeu me ftohtësì
I dëgjon këto potera,
E nxiton me nxehëtsì
Posht e lart, si rrfé, si era
Shqiptarëve u thret
Me zê t' ashpër e të gjallë,
I gatit, Sulltan e pret
Edhé vet i del në ballë.
Oh, s' rëfehet ky remet,
Këjo luftë, kjo kanâre,
Topi an' e kant buçet
Me gjëmime me batâre,
Por fatozi nuk u tut
Po ju ju raa por si një shkabë
E i çvat kryekëput
Edhé bën kërdi e grabë[1] !
Kshtû kjo luftë mori funt
Edhé Turqit u dërmuan
Dhe Sulltani prap u munt

[1] grabë = grabitje (K.Floqi)

Dhe Shqiptarët i plaçkuan.
Padishajt zêmra ju pik,
Ikën fort i dëshpëruar,
Kjo mynxyrë krejt e fik
Cmiri shkon duke u shtuar,
Gjersa bije në lëngim,
Dergjet, tretet si qiriri,
Dhe gjëkunt nuk gjen shërim,
Gjer sa vdes .... e vjen i biri.
Si i âti edhé ky
Dhe më tepër gjak i nxehtë,
Skënderbegun do m' e çqŷ
Do t' ja marrë hakkun vetë.
H a m z a – P a s h ë n fill e nis
Me ushtrì si mizërija
Edhé luftën e kurdis
Si të shuhet krejt Shqypnija.
Fat' i zii nuk e ndihmoj,
Po u munt e râ në dorë,
Hamza – pasha nuk shpëtoj,
Rob u zû dhe ky i gjorë !
Kur i vajti kjo në vesh
Padishah – Sulltan – Mehmetit
U tërbua, u kërlesh,
Desh t'i verë zjar Dovletit.
D e b r e j â n ë shpejt e çon
E gatiti me një herë ,
Skënderbenë t'gjall' e don,
Ose kryet ktij t'i bjerë.
Debreâj në Krûë zbret,
Me tallaze e me valë,
Skënderbenë n'emër thret
Dhe e shan me të poshtra fjalë.

Skënderbeu s'priton po nget,
Duke therur kalit hijen,
Dheu shungllon, hera buçet,
Kal' e hippës nuku njihen !
Po si rrfeja qé, ja mrîn,
Dhe përpiqen ball më ballë,
Debreâj fuqin' e çkrîn,
Si e si t' a zerë gjallë.
Por sokoli s' zijet dot,
Mjeshterì e tij s'ka anë,
Shpatën e përdreth, e lot
Rzon të vdekur Debreânë !
I pret kryet e ja merr
Edhé kthehet në të vettë,
Dhe prej strajstet ju a nxjer,
Q' ishte edhé e ngroht' e sbetë.
Kështû funt e krejt u prish
Ushtërì e Debreâsë
Edhé arm e ç'tjetër kish
Ju plaçkit edhé mbet drasë.
Këjo lajmë kur i erth
Mbretit, i ra vilanija,
Edhé lottë shumë derth
E më fort i shtohet mnija.
E premtohet, e bën bé
Me rrënûe krejt Shqypninë,
Mos t' i lerë gurr e dhé
Gjer t'a bënjë shesh, lëndinë.
Kështû prapë në Shqypnì
E çon S e b a i l' e parë,
E m' andej me shumë ordhî,
Dy, tri, katër Pashallarë,
Që m' i famëshim prej sijsh

Ishte S i n a n - P a s h H a r a pi,
Edhe një Baba - Dervish,
Q’ ishte I s â – P a s h’ H a s d a p i.
Më në funt i çon dhe një,
H y s e n – K a r a m a n – P a s h a n ë,
Q’ ish i bûjshim e në zë
Edhe shok me Debreânë.
Pashallarët Turçellinj,
Skënderbeu i pret pa drojë,
Ishin t’ egër të këqinj,
S’ ish shaka me ta e lojë !
Katër lufta të mbëdhâ,
Vepëroj i madhi burrë,
Dhe i mundi gjith’ ata,
Sŷr’ i tij nuk u tremp kurrë,
Edhé rob ka zënë një,
Hyssen – Pashën e dëgjuar,
Sa Sulltani s’ kuxoj më
Ushtërî për të dërguar.
Edhé kohë mjaft kaloj,
Që Sulltani e lâ qetë,
S’e gërgavi, s’e tundoj
Bëri pagje me të shpejtë.
Po hidhnimin s’e harron
Edhé prejtje nuk gjen Mbreti,
Skënderbenë s’e durron
Padishah Sulltan Mehmeti.
Kështu shkoj në qetësì
Disa kohë Shqipërija
Po mjerisht kjo terezì
U trondit e shkrep duhîja.
Skënderbegu vet’ e prish
Pagjen, që me Mbretin lidhi,

Se prej Papës ishte grish
Dhe kështû pushimn' e xgjidhi.
K a r a x h â n' e një I s s û m,
Edhé P a s h ë – S e r e m e t i n,
Q' ish prej fisit një d u d û m
Edhé tepër mik me Mbretin,
Që të tré, burra dragoj
Pashallarë të dëgjuar,
Padishahu i dërgoj
Shqipërinë për të shtruar.
I përcjell me dhuratì
Me peshqeshe, me premtime,
Gjith' i kndell, i bën gatì
Me urata me bekime.
Po dragoni nuku flé,
Që të tré pa frik' i priti,
As gjë mangut nuku lé,
Ushtërin e pregatiti.
Një nga një të gjith' i munt
Pashallarët e lëvduar,
I çkatron me kry' e funt
Prap' i lé të turpëruar
Dhe Shqyptarve ju bërtet
Të plaçkitin pa mëshirë
Edhé robët nuk i pret
I përcjell i lé të lirë.
Kto Sulltani kur i ndjeu
U tunt vendit, u harbûa,
Dhe zemrim' i tij çbërtheu
Aqe fort sa u tërbua.
Hidhënimi kaq' ju shtû,
Sa kush di sa vrau e mbyti,
Do të tjer' i shkoj në hû

Dhe disa me lak për fyti !
I çon fjalë Skënderbeut
Që të jepet me të mirë,
Po nuk jepet burr' i Dheut,
Sa do q' e sheh të vështirë.
Muhametin e tmeron
Këjo sjellje ca më shumë,
Nat' e ditë e mendon,
As i hahet, as kâ gjumë,
Edhe kurrë nuku hesht
Po, shpejt, P a s h ë – B a l l a b a n ë,
Katër herë ja çon rresht
Ankth' i math nuk i kâ anë.
Ballabani ish një trim
Që s' i gjindej shok në jetë,
Fis-Shqyptari me kuxim
E me famë të vërtetë.
Mbas ktij të tjerë dy
J a k u p – P a s h a me J o n i n ë,
Skënderbegun me e msŷ
Me mizrî asqerë vijnë,
Dhe mbas pakë nuk mënon
Por edhé Sulltani vetë
Për Shqypnî niset e shkon
Me treqind mij' e përpjetë.
Skënderbeu nuk u topit,
As rreziku s'e tmeronte,
Dhe të tijt' i paraqit
Dhe burrnisht po ju qendronte.
Si e mposhti me furrî
Ballabanin e shënûar,
E s' i mbet më ushtërî
E u thye fort shëmtuar,

Më së fundi gjall e zé
J o n i n – P a s h – K a j s e r l l i n ë,
Edhé gjê më këmbë s'lé,
Krejt e dliri Shqipërinë.
Jakup – Pashën tuj e pa
Se po mbahej me qendresë,
Çau ushtrin' e msyn e ra
Dhe e vravi pa vonesë !
Edhe Mbreti, vetëm mbet,
Si ju shua gjith' ushtrija,
Ngrihet, ikën e më s' pret,
Se e pa që s'ish e tija,
Edhé kurrë s'e harroj
Këtë dhûnë, këtë qollë,
Sa do që m' andej fitoj
Shtatëbregasin Stambollë !
Kshtû Sulltani dorë hoq
Prej gadhnimit të Shqypnisë
Shum' u loth e u përpoq
Po s' ja fali dot Turqisë !
Këto jan' ato çudî
Veprat e atij të gjalla
E të shentta mrekullî,
Të verteta e jo pralla !
Të mos qënke Skënderbeu,
Që i dolli zot rrezikut,
Mehmeti për fill këceu
Tej atij Adriatikut,
Dhe e ngrata Italì,
Q' është sot Shtet i begatë,
Qé çiflik nënë Turqi,
Mos të ishte nj' ajo shpatë.
Mbretit hovin ky ja preu,

Duke mprojtur Shqipërinë
Dhe Sulltanin ky e theu,
Që s'e shkeli Italinë,
Ndryshe i madhi Padishah,
Do t'a kishte bâ të tijnë,
(Në S h ë n – P j e t ë r kishte da
Me ja qit' kalit tagjinë) !
Këtë të frikëshëm anmik,
Dynastinë Ottomane,
Këtë poterë e rrezik
E stuhinë myslimane,
E kish njohur ç'do Roman
Edhé dridheshe nga frika,
Dhe Pallasit V a t i k â n
Gjer në âsht i vajti thika !
Andaj këtë bâmirësî,
Papa-P î o j a i dytë,
E pat' dijt' me përvujtsî
Gjer sa vdiq e mbylli sytë.
Ky, sa rronte e ish gjall
Skënderben' e kish nderuar
Dhe me lotte e me mall
Gjithëmon' e kish kujtuar.
Te e mbramja edhé mbret
Mbi të gjithë mbrett' e tjerë,
Skënderben' emnon e thret,
Për mbi Qjêj kërkon ta verë,
E në Krûe me arth desh
Mbret këtë me emenue
Edhé shpatën me ja ngjesh
Edhé me e koronûe !
Po nuk mundi e s' harrîu
Këtë dëshirë t'a vepronjë,

Se arth vdekja e përfshiu,
Nuk e la që t' a mbaronjë
– Me verrejtje po dëgjonj,
Po marr vesht gjithë sa thua,
Po i shoh i veshgëllonj,
Sa që flet për këtë dragûa;
Po dhe këtë mos e harro,
Q' Italjanët mjaft punuan,
E gjyko, mos e moho
Se dhe këta fort luftuan.
– Nuk them jo, mor zotëni,
Por dhe ti duesh me ditë
Se kjo plaka Shqypënì
I ka dhën' Europës dritë !
Me këto ti ndofta qesh,
E kujton se flas të tepra,
Po duro, se do t'a gjesh,
S' flas me fjalë, po me vepra.
Ti njiment nuk i mohon
Dokumentat historike
Dhe as pakë nuk dyshon
Ç' qé S t u h î j a – Ç a g a t i k e[1],
Q' u përhap me aq shpejtì
Edhé mbyti gjithë Dhene
Gjer sa ardh në Shqipërì
Edhé hasi Skënderbenë.
Pra në qoftë se ky trim
Nuk e ndalte Muhametin,
Kush, pandeh do kish kuxim
Që mos t'i lëshonte detin ?

[1] stuhija çagatike = stuhija e turqve (gjuha çagate është gjuha pararendëse e turqishtes)

Dhe po t' jish, që ky Sulltan
Kapërxent' Adriatikun,
Thua populli Italjan
Do mos ishte sot i fikun ?
Këtë s'e ndali as njeri,
As që mundi me bâ ballë,
Veç nj' e vogël Shqipëri,
Skënderbeu me nj' atë pallë.
Pra, t'a zemë, si kur t' ish
Në Europ Sultan – Mehmeti
Këto dritta do t'i kish
Këtë qytetëni Remeti ?
Psé mbet prapa, s' përparoj
Kontinenti i Ballkanit,
Qysh atbotë q' e gadhnoj
Dynastia e Osmanit ?
Po t'i delte vehtes zot
Italjani si po thua,
Pse Shqyptari – Kastriot
Prej atyrvet u kerkua,
Edhé vajti ju ndihmoj
Edh' e dliri Italinë
Dhe prej xgjedhjës e shpëtoj
Kur luftoj me N o r m a n d i n ë ?
– Si ? pa fol' e përsërit.
Ti më shtyn gjat' e më gjatë
Mendja tepër m' u mahnit
Shdridhe, mos e lerë thatë,
– Aso kohet n' ltalì
Ishte mbret edhé sundûës
F e r d i n a n d i, djal' i ri
Që gjithkunt ishte fitûës.
Si luftoj me kush di sà

E e shkriu fuqin e vetë
Më në funt u ûl e rà
E u ndrye në B a r l e t t ë.
Kishin msye me furrì
A n g o â n e t, o N o r m a n ë t
Me një for' e rebtësì
I rrethuan Italjanët.
Ishin komp i ashpër fort
Fis e gjak jishin Françezë,
Përfituan më ç'do short
E mbretruan aqe brezë.
Këtë herë me fuqì
Ardh' e msyn Italinë
Edhé priës n' ushtërì
Kishin K o n t e – J a k P i k n i n ë.
Ferdinandi, fort u lodh
Që t'i bënj' armikut ballë
Dhe fuqitë gjith i mbloth
Dhe luftoj si trim i gjallë,
Po nuk pat as një dobì
As prej S f o r z ë s të Milanit
As Fredriku nuk i ndih ,
Ajy D u k u i U r b a n i t.
Pikinini e ngushtoj,
Italinë e lëkundi,
Ferdinandin e qarkoj
Edhé shoqt e tij i mundi.
P u g l' e N a p ë l e T a r a n t,
A r a g o n ë e B a r l e t t ë
Normandezët an' e kant
I zaptuan me të shpejtë.
Ferdinandi si e pà
Që mbaroj e më s' kish shpresë,

Skënderbeut në këmb' i ra,
I lyp ndihmën pa vonesë.
Edhé Papa gjith ashtû
Skënderbeut ju lut sa mundi,
Italinë m' e shpëtû,
Psé i arth mbarimi, fundi.
"Shpejt" i thonë. "mos vono",
"Jemi t' humbur, të rrethuar",
"Ngjitna dorën, n' a shpëto,
"Ndryshe krejt kemi mbaruar !
Skënderbeu befas kujtoj
Të A l f o n s i t[1] miqësinë
I arth keq, i përdëlloj
E lith pagje me Turqinë,
Dhe i shpejtë si rrufé
Me dhet-mijë Shqiptarë,
Kalon detin, vjen atjé
Fillon luftën me të parë.
Ferdinandin e shpëton,
Se në kohë ky ja mrini
Edhe P u g l j en e liron
Nga Françezi Pikinini.
Kshtû Normanët i coptoj
I largoj prej ltalisë,
Ferdinandin prap e çoj
Në selì t' A r a g o n i s ë.
Me mirnjohtje e gëzim
Ferdinandi, q' ish për lumë,
Skënderbegun, nj' atë trim
E kënaqi tepër shumë,
Me dhurata e gjith ç'kâ,

[1] I jat' i Ferdinandit (shënim i K. Floqit)

Arm’ e kuaj edhé pare,
Dhe qytete tré i dhâ
Burrënisë shqipëtare.
Dhe me sŷte çurk me lott
Me falnderje, ngjatjetime
E percjell me duar plott
M’ evarì e me nderime.
Nuk po ngjatem gjerrësisht,
Janë mjaft këto që thashë,
Edhé merre vesht qarisht
Një gabim aqë të trashë,
Që po t’ jishin aq të zott
Italjanët, si po thua,
Nuk do grishnin me aq lott
Atë trim, atë dragûa !
Shqipëtarët e këqinj,
Të përbuzurit barbarë,
Sa do t’ egër e barrinj,
Po shpëtuan Boten mbarë !
Në dy vepra të mbëdhâ
Â përmbledhë ky shpëtimi,
Prej këtyne lindi praa
D r i t a e Q y t e t ë n i m i !
Me sa thashë kam kallzû
Atë veprën me të parë,
Që Sulltani u ndalû
Italinë për m’ e marrë.
Vepr’ e dytë ajo qé
Skënderbeu kur la Turqinë
Edhé shoq e miqë zé
H u n y a d i n – U n g a r i n ë,
– Si, të lutem, folë si,
Kemi qenë bashkë miqë ?

Kemi pasur miqësì
Edhé lidhje për anmiqë ?
– Kemi pasur, si urdhron,
Me Hunyadin, atë burrë,
Dhe këtë besë e nderon
Historia që s' rren kurrë !
Hunyadi, ajy trim
E fatos i Maxharisë,
Ishte lidhur në bashkim
Me luanin e Shqiprisë.
Luftoj Turqit rrebtësisht
Si ky si Skënderi ynë,
Dhe qendruan trimërisht
Gjith sa herë që u msynë
Lufta ngjati plott tre vjet,
Dhe Serbia u lirua,
Skënderbeu nj' at' herë gjet
Kohen q' iku, u largûa.
Ishte çûe me ushtrì
Për me poshtënû Serbinë
Po ky vjen e lith miqsì,
Me Hunyad' e Maxharinë.
E së bashkut vepëron
E lufton kundra Turqisë
Gjon Hunyjadin e nderon
Aleat' i Ungarisë !
Të dy burrat miq e shoq
Me trimnì kuxim e besë,
Gjithsecili u përpoq
Që i ranë Osmanllisë.
Kshtû qendroj e me s' u xgjat
Turçellija kah Prendimi,
Dhe në ëndrat q' ajo pat

Kta ju bënë shkak ndalimi !
Asobote n' Ungarì
V l a d i s l l a v i mbretëronte,
Q' ishte fort një djal' i rì !
Por Turqinë nuk e dronte.
Vet' i prîjte ushtëris,
Kalit hippur shpatën nxjerrë,
Ishte hyll' i Maxharìs,
Edhé s' kishte shoq të tjerë,
Në një luftë me gjaksì
Në V a r n ë të Bullgarise,
Ju turr Turqve me rreptsì
Ky luân i Maxharìsë.
Si i rrebët luftëtar,
Bash në ball e gjith i pari,
Vlladisllavi kordhëtar
Nuku ngjinjeshe së vrari.
Po shigjet' e shkret e has
Në krahnor e tij të nxehtë
Dhe prej kalit posht' e plas
E rëzon pa-shpirt të zbetë,
Dhe në krye mbasi kish
At kunoren e qendisur
Që me kryqn' e ârtë ish
Të S h e n – S h t j e f n i t, e stolisur
Kur prej kalit befas râ,
Kjo kunora ju anûa,
Edhe kryqi sijsh u ndâ,
E u thye, u shtrembrûa !
Qé pra, një këtë kujtim
Edhé sot ju s'e harroni,
Dhe me droj' e adhurim
Ju Maxharët e nderoni;

Dhe në stemmën t' uaj ndrit,
Çashtj' e kryqit fytyrohet,
Ç'do Maxhar e ëndërit,
Vlladisllavin që s' harrohet !
– Ty të lumtë, more mik,
Më zbavite tepër bukur
Edhé mendja me vertik
Tash kujton burrat e dukur,
Skënderbegun kordhëtar
Edhé J a n o s h H u n y a d i n,
Një Shqyptar e nji Maxhar
Si dhe regjin Vladislavin !
Tash dhe unë e verrenj
Historin' e të dy palve,
Dhe të drejta kto i gjenj
Mrekullinat e të parve.
Ti sa mirë q' i mban ment
E sa mirë që m' i thua,
Prej këtij fjalimit t' ënt
Msonj ç' ka dëshëronj e dua.
Falma se nuk e kam dijt
Q' ishim shoq' e aleatë
Edhé prap' e përsërit
Bëtë mirë që m'a thatë.
Edhé kurrë s'do t' harronj
Miqësin e besën t' uaj
Gjithënjë do t'a kujtonj
Nuk ju quanj mê për t' huaj,
– Falem nderit, miku im,
Nuk gjenj fjalë përhirimi,
Që s' na qitni në harrim,
Mjaft për né dhe ngushëllimi.
Ah, po ishim njëment miq

Edhé shokë të vërtetë,
Po sot mbetmë lakuriq
Se na lanë si të shkretë.
E mjerisht kurr kush s' na njeh,
Jemi t' humbur e të mbetur,
S'na përfill, kurrkush s'na sheh,
Për né kush nuk është gjetur !
Sot ju kini një mbretnì
Pasanike, të mbaruar,
Kini dij' e qytetnì
Jeni mjaft të përparuar,
Po né mbetmë si barrinj,
Si në kohën më të parë,
E n'a quajn sot fatzinj
E të trashë e barbarë !
Italjanët kan' harrû
Skënderbeg e Shqipëtarë.
Fqinjët i kanë mohû
Sa të mira nesh kan' parë,
Po miknesha Maxharì
Do t' a lerë dot Shqypninë,
Të përkulun n' agonì,
Do t' harronjë miqësinë ?
Këtë Atdhé të dobët sot
T' A l e k s a n d r i t të dëgjuar
E të G j e r g j i t K a s t r i j o t
P i r r o s t' madh të paharruar,
Të B a r d h y l i t t' Illyrìs
E të T e u t ës e t' A g r o n i t
E të G j e n ç i t, të G l l a f k i s[1]
Të F i l i p p i t M a q e d h o n i t

[1] Një mbret edhé ky i Illyris (Shënim i K. Floqit)

Do t'a lijni në mjerrim,
Të përbuzun e të shkretë
Pa ngushllim, pa qytetrim
Që të vdesë kshtu për jetë ?
Nuk më ngjan dhe kam besim
Kam uzdajë e kam shpresë
Se prej jush pa përfitim
Shqipëria s'do të mbesë
Të kam mik e flas qarisht
Edhé ti nuk më zembrohesh,
Psé flas trash' e barbarisht
Ti i mentçim jé, s' hidhnohesh,
E, në qoftë se më ndjen,
Do t' të them edhé një fjalë,
Që në gojë po më vjen,
E prej dhëmbësh do të dalë.
– Folë, folë, mos e mbaj
E prej meje mos u druaj,
Çile gojën me uzdaj
Edhé si t'a ndjesh e thuaj.
– Them se ju, more zotnì,
Ju Maxharët e uruar,
Këtë të ngratën Shqypënì
Duhet t' a kishit kujtuar.
Kur e shkeltë këtë vent
Edhé me né u bashkuat
Një detyrë për njëment
Nuk e bët' as e kujtuat,
Dhe detyra juaj qé,
Që, në Krûën e Shqypnisë,
Mbi kalan' e saj atjé
Q' ishte s h t y 11 a e L i r i s ë,
Një statû e Skënderbeut,

Krejt të bardhë prej mermeri,
Shokut t' uaj burrit t' Dheut,
Q' ishte i Turqisë tmeri,
Ju t'i ngrehnit pa pritim,
Kalit - hippur, shpatën n' dorë,
T'ja kushtonit për kujtim,
E t'i thurnit një kurorë !
Do t' jish shëmbëll e nderim
I asaj miqsìs së parë,
E kurâjo e kushtrim
Për shtërnipat Shqipëtarë ;
Psé mos t' ish një Skënderbé
Edhé Hunyadi j' uaj,
Turkun s'di sa vjet atjé
Do t'a kishit në gjî t' uaj !
Po të lutem e të them,
Këto mos i merr për ndryshe,
Se un' e nderoj sa t' jem
Miqësinë katragjyshe.
– Ké të drejtë, bukur flet,
Ashtu është, si po thua,
Kjo detyrë n'a përkét,
Për nj' at trim, atë fajkua,
Se njiment i meriton,
Një statue, atij trimi,
Se te ky e detyron
Jetën gjith Perëndimi !
Atij burri, Skënderbeut,
Shpëtimtarit të vërtetë,
Gjith' Europa funt - e - kreut
Një respekt duhet t' i ketë,
E jo vetëm , si po thé
Një statûë t'i kushtonjë,

Po dhe gjunjëthi mbi dhé
T’ ûnjet e t’a adhuronjë
Po të lutem pak durim
Ty dhe gjithë Shqipëtarvet,
Se këjo s’ ri pa shpërblim
Si do mos prej nesh Maxharvet,
Veç punoni pa pritim,
E veproni nat’ e ditë,
Se me pun’ e me mundim
Del edhé këjo në dritë.
Kombi punë jush kërkon,
Mos u lodhni pra, punoni,
Se ashtu gjithkush ju don,
Ç’do të mirë ashtu ngjeroni.
– Falem nderit për këto
Kaq të bukura këshilla
Dhe të lutem n’a kujto
Në ca rasa të këtilla.
Po, mor zot, nuk kemi faj
Né të ngratët Shqipëtarë,
Trimn’ e vraj e mos e shaj,
Kemi shumë kundrështarë,
Që s’n’a lanë qet’ as pak
Të shëkojmë punën t’ onë,
Psé në zjar, në flag, në gjak,
Né n’a shtynë gjithëmonë !
Né n’a vunë vllà me vllà
Me u therr’e m’u coptue,
Me u grii e me u vrâ
Para Botës m’ u poshtnue !
Turku, Greku, Sllavi, Shqau,
Me gogole fanatiqe
Ne n’a ndau e n’a përçau,

Sijsh n'a shkrepnë aq rreziqe
Shkelë ç'do bamirësì,
Gjakun që u derth si lumë,
N'a shaktuan ç'do ligsì,
N'a munduan tepër shumë,
Ndonse gjithë i shpëtoj
Krahu i këtij të marrit,
Që burrnisht për 'ta luftoj,
Krahu i hekurt i Shqyptarit !
B a j r a k t a r' e Qypërlînj
S i n a n P a s h a e të tjerë
Luftuan për Osmanlinj
E jo për Shqypnin e mjerë
Që në B r u s ë gjer në W i e n,
Prej K a u k a z i t e n' A f r i k ë
Prej S t a m b o l l i t në J e m è n
Pa një drojë e pa një frikë,
Shqyptar' ishin ata
Që Turqinë e nderuan
Që luftuan pa ja dâ,
E për vehte gjê s' fituan !
Shpëtoj një Koxhâ - M i s i r
Prej atij Mehmet Alisë,
Por ç' dobi kur s' pat një hîr
Edhé tok' e Arbënisë ?
I b r a h i m i, djal' i tij
Shqipëtar e trim me fletë
Sepse bëri mbrekulll
Fitoj gjê Shqypnì e shkretë ?
Gjith ashtu sa herë né
Për brì Sllavit gjakn' e derthmë
E u shtymë gjer atjé,
Sa dhe buzë varrit erdhmë ?

Le per Grekët masandaj
Që u shuam e u vramë,
Tue luftue me uzdaj,
Turqve robër s' ja u lamë !
M a r k o – B o ç a r i, D a n g l l i u,
X h a v e l l ê n j t ë e M j a û l i,
L l o n d u a, V o k u a, K r y e z i u
M i l u a, B o t a s i, B u b û l i,
V u l l g a r i e Ç a m a d h o j,
K u n d u r j o t i e S a k t û r i,
G r i v a, Z e r v a, P e r r e v o j,
B u k u v a l l a e B u d û r i,
D r a k u a, L l à m b r u a e disa
Himarjotë të shënuar,
B u b u l i n a që n'a la
Një kujtim të pa-harruar,
G o g u a, G u s h t i N o t a r â j[1],
Që luftuan por si burra,
Me një shpres' e një uzdaj
Tue derdh gjak nër rripa e curra
Gjith dëshmorët që refenj
Gjithë trimat kordhëtarë
E Suljotët e mbëdhenj,
Mjerisht, ishin Shqipëtarë !
Qen' ata, që, tue luftû
Per një besë të krishterë,
Grekët i kanë lirû
Po jo dhe Shqypnìn e mjerë !
Këta burra që kan râ
Djelm të gjithë të Shqiprisë,

[1] Të gjithë këtyre Shqiptarëve që luftuan, disa prej të cilëve dhanë edhe jetën për Pavarsinë e Greqisë, Kristo Floqi u ka bërë një biografi të shkurtër tek "Historija e Shqipërisë", që do botohet më vonë për herë të parë pas 100 vjetësh.

Që jan grî e jan e vrâ
Për shpëtimin e Greqise,
S'e mejtuan, ah, mjerisht
E s'e muar vesht gabîmin,
E shpesherë vullnetisht
Vranë vllezrit për besimin !
Ç' kupëtoj kjo Shqipëri
Që ka lindur aqe burra,
Që kaq lanë therorì
E u bën e tjetrit urra ?
Se psé kish një të math bir
Nj' A l i – P a s h ë – T e p e l ê n ë,
A mos pati ndo një hîr,
Veç mashtrim, rrezik e rrênë ?
Ky trajtoj koxha mbretnì
Me tré – katër millionë,
Por, ç' dobi kur kjo Shqypnì
Mbet në xgjedhë per gjithmonë ?
Dhe ahere kur u bë
Shqipërija shtet i vetë,
Prap anmiqtë një mbi një
Né s'n'a lanë kurrë qetë.
Ç' pret pastaj kjo Shqipërì,
Si një shtet të vepëronte,
Pa një ndihm' e një fuqì
Muntte dot të përparonte ?
Ne s'po jemi do barrinj,
Njerës t' egër si po thonë,
As barbar' e të këqinj
Nuku kâ ky vendi jonë.
Ju n'a njihni mir' e holl
Tash sa kohë me né rroni,
E n'a dijni bukur boll,

E kështu s’ kini ç’ka thoni.
Disciplin’ e bindësì
Për ç’do urdhën e ç’do masë
Kemi mjaft në Shqipëri
Sa kurrkush s’ mund t’a përflasë.
Sepsé S h k r e l’ e S h a l’ e S h o s h,
Edhé gjithë Malésitë,
Shi prej malit T a r a b o s h,
Deri kû mrijnë kufitë,
Ju me pak’ ushtarë sot,
Po i mbani i sundoni,
Dhe askush prej urdhnit s’ lot,
E çprovuat, s’e mohoni.
E në daç për Arësim **,**
E për msim e gjerra t’ holla,
Në nji vjet né, pa përtim
Kemi çilë tréqint shkolla.
Në burnì e në njerzì
E në fjalë e në besë,
Në shtektì[1] e në miqsì,
Në kuxim e në qendresë
Shqipëtari nuk ka shok
Përgjith her’ e kâ çprovûe,
Në ç’do ras’ e patalok
Kursesi nuk kâ mungûe.
Rron me nder e dashunì
Si me shokët e të tijtë,
Besën e ka një l i d h n i,
Dhe më tepër Malësitë,
Q’ është send për m’ u çudit
Deri kû ja mrin besimi,

[1] shtektì = veprim sipas të cilit shtektari kërkon strehim e mbrojtje.

Mrekullî për m’ u habit,
Sa, kufî nuk ha tregimi.
Si për shëmbëll paravé
Një ndollinë që ka ngjarë
Prej së cilës dyshim s’ ké
E do njohësh Shqipëtarë.
lsh një nën’ e kish një bir,
Bir të vetëm, të pa – ndarë
Që pa-dashur e pa cmir
Shoku i vet ja pati vrarë !
Fis’ i djalit q’ ishte vrâ,
Porsa vrasjen e dëgjojnë,
Vrasësit pas i kan rà
Edhé gjakun ja kërkojnë.
Por i ngrati paske shkû
Te e ëma e të vrarit,
I râ në këmbë e në gjû
I lyp “besën e Shqyptarit”!
Nën’ e shkretë sa do mbet
Si qyqar’ e pikëlluar,
Vrasësin nuk e përket,
Po e merr e fsheh në qûar !
I jep besën, e e mbron,
Prej atij, që lypte gjakun,
Nuk e nâm, as e mallkon,
As e lé t’ i marrin h a k k u n !
A sheh nj’ herë, more mik
Këtë “besën Shqipëtare”
Qysh e kqyrin një anmik,
Sa dhe gratë jan’ bujâre ?
“Gjith ashtû tjetër çudì
Është jeta familjare,
Edhé vetëm në Shqypnì

Sheh këtë jetë kurreshtare.
Në një qark, në një avllî[1]
Sheh kush di se sa fëmija[2]
Që një gjak jan' e vllaznì,
Burra, grâ e bij' e bija ;
Rrojnë tok e me qetsì
Fort të lumur, të pa - ndarë,
Një zot kanë në shtëpì
Ky do jap' e ky do marrë.
Është plaku që urdhron
E i bindet grua, burrë,
O i shan, o i qerton,
Fjalë s'kthejnë, rrijnë gurrë !
Thua q' është një mbretnì,
Një e vogël principatë,
Që në nj' urdhën pa një mnì
Binden burrat, binden gratë.
Plaku është kryetar
E urdhron si që të dojë,
Ky sundon e kommandar,
Gjithëkush do t'a dëgjojë.
Edhé gjinden edhé sot
Ksij fëmijash, tok që rrojnë,
Sa nuk mundesh t'i njehsh dot
E si një familje shkojnë. –
Ka m' i lumtun se ajy,
Që ka gjithë rredhin pranë,
Dhe të tijt' i sheh me sŷ
Nip shtërnipa e gjith ç' janë ?
Po të pyeç për Gjyqsì

[1] avlli = oborr jo vetëm mbretëror, por edhe familjar
[2] fëmija = familje

E për ligje e zakone,
Do të shohç që në Malsì
Kanë mjaft nom' e kanone,
Që veprojnë rregullisht,
Edhé janë t' arësyshmë
E zbatohen drejtësisht
Në mënyrë fort të ndryshmë ;
Me një fjalë në Shqypnì
Sheh që edhé s' janë çdukur
Ajo Ligjë e Lidhnì
Kaq' e vjetër sa e bukur !....
Nuk do ishte, pra, mëkat
Para Zotit e Njerzisë,
Një ksij kombit m' u rropàt
Me u ndryth far' e Shqypnisë ?
Sepsé mbetmë prapa né
Në padi' e n' errësirë,
Këjo mjergull e kjo ré
A nuk mundet dot m' u dlirë ?
Është turp për Qytetnî
Është turp e është marre
Të porritet[1] një Shqypnì
Edhé gjuha Shqipëtare,
Nj' ajo gjuhë, që nuk vdiq
Kaqe shekuj që kaluan
Sa do shkelë aq' anmiq
Dhe Shqypnin' e copëtuan !
Është nder, është lavdim
Për secilën lettraturë,
T' jepet Shqypes një lëvrim
Që të çquhet në kulturë,

[1] porrit = shuaj, fik

Se kjo gjuhë â themel,
Baz' e Archéologjisë
E k o m p a s s o e p e r g j e l [1]
Edhè pish' e diturisë.
U çprovûe plotësisht,
(Gjith' arqelogët thonë)
Pelasgjishtja caktimisht
Është nj' ajo Shqypja jonë,
Që e gjallë dhe sot rron
E e flasim né Shqyptarët
Edhé shumë na nderon,
Si nderonte dhe të parët.
Ka detyrë para nesh
Gjithë Bot' e qytetnuar,
Të na rnarrë mirë vesh,
Të na ndihë me dy duar,
Të na ngjallin me ç' do mjet,
Të na çelin sŷtë mirë,
Bujarisht si u përket,
Mos na lenë n' erësirë;
Se né qêm' ata Hettej,
Që gjith Botën e shëndritmë.
Edh' Etruskët e mbëdhej,
Që në dritë gjith i qitmë ;
Prindët t'onë qenë ata,
Që ng' Asia fluturuan,
Dhe me veprat e mbëdhâ
Kombet gjith i zbukuruan.
Ishim né e persërit,
Që me gjuhen Pelasgjike
E përhapmë në Gjirit[2]

[1] pergjel = kamalec (1. mjet për të matur sipërfaqe toke,kompas; 2. mbështetse)
[2] Gjirit = Ishulli Kreta (Greqi)

Q y t e t n i n ë M i n o j i k e,[1]
Që shkelqevi masandaj
Gjith' E l l a d ë n e dëgjûar,
Dhe u shtrii, u hap si vaj
Mbi L a t i n ë t e shënuar.
Dhe sot mundesh t'i këndosh
Monumentat pelasgjike,
Po t'i shohësh e t'i njohsh
Rrasat H e t e o – K r e t i k e[2]
Gjith âshtû dhe n' Italì
Mbi P a s q y r a t E t r u s q i k e
Do verrejsh me lehtësi
Nj' atë gjuhën Lelegjike.[3]
Janë fakte e çprovim,
(Sado që u gjetnë vonë)
Dokumenta e kujtim
Të së vjetres gjuhës s' o n ë
Janë ndihmë edhé msim,
Qytetnin' e zhdrivillojnë,
E i japin përparim
E mê fort e zbukurojnë.
Një detyrë tjeter ka
Bota e qytetënûme
Për Shqypninë, që e lâ
T' ishte sot e robënûme
– Folë, folë, po dëgjonj,
Më pëlqen t'i di të tëra,

[1] Gjytetnia e **Hetêjve, Kitti** ose **Kata** lulëzoj deri më 717 para Kr. E mâ fort në Kretë e njojtun nën emnin **Qytetnì Minojike**. (Shënim i Kristo Floqit)
[2] Rrasa të gjetuna në Kretë e në Lemnos më 1897 mbas Kr. (Shënim i Kristo Floqit)
[3] Kto rrasa u gjetnë në Lombardi t'Italis të njojtuna prej arqeologve Gjermanë si **Etruskische Spiegel** (Shënim i Kristo Floqit)

Se tani marr vesht e msonj
Kaqe sende, kaqe gjërra,
– Kur kish lidhë Skënderbeu
Paqje me Sulltan-Mehmetin,
Mbreti evarí rëfeu,
Psé ja lâ qetë Dovletin.
Kështû pra, si u çkujdes,
Që s' ka luftë me Shqyptarë,
Kundr' Europes Mbreti ndes
Luftë t' ashpër e të marrë.[1]
Tmer, ahere, e trishtim,
Kap Europën e Krishterë,
Një betâjë[2], një ligshtim,
E një bolb' e një poterë !
Edhé Papa fort u droth
S' dinte si t'a kurajonte,
Edhé kruspull u përmbloth,
Një rrezik të math shikonte !
N' atë tmer e agoní
Që s' ka pêndë m' u përshkrûe,
Sŷt i sjell mbi Shqypënì,
Skënderben' e kâ kujtûe.
Ish e dyta herë kjo
Që i lutej burrit t' onë,
E q' i thoshte "na shpëto"
Se u fikmë për gjithmonë !
Skënderbeu si burrë q' ish
Papës shent i çon një shkresë
Që me Turqit lidhje kish,
S' munt t'u delte i pa besë.

[1] Në kohën e luftave kryqnore (Croisades) Shënim i Kristo Floqit
[2] betâjë = Frikë e madhe, lemeri

Papa ahere ca më fort
Çon bekime e urata
E me sŷtë plot me lott
Skënderbeut i lutet Âta.
E e bint që s'â mëkat
Me çart besën të p a – b e s i t(?)
Kur rrezik e taksirat
E frikson Europën sheshit !
Skënderbeut i ardhi keq
E e prishi me Turqinë,
Dhe prej paqes dorë heq
Me Sulltan' e çart miqsinë.
Edhé lufta kshtû çbërtheu
Ndër mjet Turqsh edhé Shqiptarë
E Europa shkapërxeu
Ç' do mjerim që do kish ngjarë !
Po mjerisht ky ish gabim,
Që veproj i madhi burrë,
Se Sulltani për çpërblim
Luftën më s'e prâni kurrë
Gjer sa krejt e çkatëroj
Këtë Shqipërin' e ngratë,
E përmbysi, e shkretoj,
E la trok' e la të thatë !
Shtriga Europë e kaloj
Gjith' atë furrì të marrë;
Po Shqiprinë e pengoj
S'e kujtoj më Shqiptarë !
Është kjo një drejtësì
E ka thenë Zoti vetë,
Një e tillë bâmirsì
Të harrohet kaqe lehtë ?
Jo, për Zânat, jo zotni,

Zot’ i math mos e premtoftë,
Mjaft ka vojtë këjo Shqypnì
Ky mëkat mos u duroftë !
Folë, more miku im,
Kam të drejtë të ankohem,
A po ndofta kam gabim
Edhé mirë nuk mendohem ?
Pra të them e mbaje ment
Edhé mos e harro kurrë,
Që Europa për njiment
Duhet të rëfehet burrë;
Të na japë dorën shpejt.
Mos n’a lerë n’ erësirë,
Të n’a ndihë me ç’do mjet
Daç me hîr, daç me pahîrë.
Ndryshe gjithë vanë kot,
Po dhe né kështu nuk rijmë,
Se kam shpresë t’Ajy Zot,
Që në rrugë shpejt do vijmë.
Po ahere më kjarisht
Ka me folë Historija,
Dhe Europa pendimisht
Ka me pa se s’ vdiq Shqiprija !
Tjetër s’ flas e s’ të mërzit
Se të lodha me kto fjalë
Ç’ më ndje zembra, ah, s'e qit
Sa do që rreh valë-valë ! …….
. . . . . .
. . . . . .

Bisedimi kshtu mbaroj
Miqt' u ndanë të qetsuar,
Po Maxhari kur kaloj
Mjaft u dukte i mentuar !

Shkodër 23 Prillit 1917.

FUND

Ky libër ka pasur edhè një radhua shpjegonjës të fjalëve mytologjike e historike prej 40 faqesh, i cili nuk u rreshtue këtû për do arsyena[1] (shënim i Kristo Floqit).

[1] Këtë radhua shpjegonjës Kristo Floqi e ka botuar më 1935 tek revista "Hylli i Dritës" Nr. 7 e vijim me titull "Pellasgë e Hellenë" tek nëntitulli "KRAHËSIM LINGUISTIK MIDIS SHQIPES E HELLENISHTES". Ky radhua gjëndet edhe tek libri i K. Floqit "Pellasgë e Hellenë" ribotuar në vitin 2023. Arsyeja më e besueshme që ky radhua nuk është botuar në këtë libër është se shtypshkronja franceskane e Shkodrës,në atë kohë, nuk ka patur germat greke për shtyp, por i ka blerë më vonë dhe i ka përdorur gjërësisht. (H. Kaçulini)

SHTOJCË

Duke kërkuar për veprat e Kristo Floqit, të mbuluara nga pluhuri i harresës, gjeta shumë prej syresh që nuk ishin botuar asnjë herë të tilla si "Epopeja e Skënderbeut", drama në 4 akte "Skënderbeu në Itali", komeditë "Doktorllëket","Fat i papritur","Përfundimet e zilisë", por edhe shumë essé, artikuj, vjersha origjinale apo të përkthyera me vlerë artistike e morale.

Një pjesë të këtyre veprave po i botoj më poshtë, në mënyrë që të sistemohen dhe të mos humbasin. Të tjerat janë gati për botim.

Në lidhje me "Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve" shkruar nga Naim Frashëri në gjuhën greke, përkthyesi i saj Kristo Floqi, tek "Autobiografia ime" shprehet: "Kjo vjershë ishte shkëndia e parë që ndezi flagën e pashojtur të patriotizmit. Këtë vjershë që posa e këndova më pëlqeu kaqe fort sa e mësova mëgojë[1]. Më ndezi kaqe shumë ndjenjën kombëtare, sa munt të thom se qysh ahere s'pushova të jem një shqipëtar i flaktë".

Kjo shtojcë përmban vjersha, artikuj, etj.me karakter patriotik, por edhe moral, mbështetur në parimet e librave të shenjtë, sidomos të Biblës, të cilat janë botuar nga Kristo Floqi në të përkohëshmet e kohës, por që nuk përfshihen në librat e botuara prej tij.

Në një artikull të vitit 1913 botuar tek gazeta "Perlindj'e Shqipnies" që i atribuohet Kristo Floqit shkruhet: "Dituria dhe morali janë sendet me të cilat munt të përparojë dhe të vejë mbrodh një komp". Dhe përfundon: "**Dituria pa moral është një fatkeqësië e madhe për atdhenë**, prandaj të gjithë ata që duan të mësojnë, po të duan që të jenë njerës si lipset, duhet të kenë para sysh moralin, se pa atë, s'kanë dobië mësimet e dituria e 'tyre". Nga përmbajtja mund t'i kishim vue këtij libri nëntitullin "Kristo Floqi – filozof e moralist"

Henrik Kaçulini

Tiranë, Maj 2025

[1] mëgojë = përmendsh

ORIGJINA E MBIEMNAVET
SHQYPTARË, SHQYPNI, ALBANOI, ALBANIA.
(Artikull i Kristo Floqi botuar te "Hylli i Dritës
Nr. 03 viti 1935, faqe 135 e në vazhdim)

Shkrimtarët e historijanët e huej janë ndodhë në një bilemë të vështirë që cili ashtë mbiemni i vërtetë i racës Shqyptare, i kësaj race të vjetër e prehistorike. Disa kanë pretendue se mbiemni **SHQYPTAR** âsht krejt i panjoftun në histori edhé se vetëm qysh prej shekullit XI del në dritë për të parën herë mbiemni Ἀλβανός (Shqyptar) dhe Ἀλβανόϊ (Shqyptarë), si edhé fjalët Ἀλβανόν, Ἀρβανόν, Ἀλβανοῦπολὶς, Ἀλβανìα, e cila Albania quhej deri atëhere"Ιλλῦ-ρìα"(**ILLYRICUM**),dhe Shqyptarët Ιλλῦ-ρϛὶ, *Ἠπειρώτας*, Μαϰεδόνες, kur se gjithmonë, shtërgjyshët t'onë janë titullue si *Shqyptarë*, ose *Shqiptarë* dhe vendi "Shqypni", ose "Shqipni" (Shqipri).

Nuk ashtë e para herë që del në bisedë kjo çashtje, sepsé shumë dijetarë të huej e vëndas kanë folë mbi këtë themë. Unë, tue marrë për shkak disa bisedime e artikuj që kam vrejtë andej e këndej në këto kohnat e mbrame, kam dashtë me shoshitë pak imtas këtë pikë, prandaj edhé u tërheq vërejtjen kënduësve që edhé në rast që gabohemi diku, të kenë të drejtë të më kritikojnë, që ksodoret të sqarohet edhé mâ mirë kjo problemë historike.

I.

Historiani klasik Grek Hesiodhi, në **THEOGONINË**[1] e tij n'a tregon se, baba i burravet e i Perëndive **ZEUSI** (**Zoti**) që kishte rrufenë në dorë, kishte për symbol edhe shkabën, si shêj trimnije e fuqije. Gjithë Pellasgët e vjetër që i faleshin atij, ata Pellasgë do me thanë që kishin zânë vend në Gadishullën Ballkanike qindra vjetë para se të vijshin aty Hellenët, e hiqshin vehten e tyne si të kushtuem ndaj **Hŷjit** të math (Ἐρίγβουπος, Νερελ-ηγερέτης), dhe qysh atëherë ata Pellasgë, njani nga të cilët duket

[1] Theogonia = është një poemë mitologjike, vepër e Hesiodit, ku tregohet historia dhe gjenealogjia e perëndive greke. Mendohet se është shkruar rreth vitit 700 para Krishtit dhe është themeli i mitografisë greke.

të jetë edhé fatosi i math e legjendar Ahileusi[1], e quanin vehten *si të bijt'e shkabës*, që fjala *shkabë* duket synonime e fjalës greke γύψ, që sinjifikon *skyfterin*, që edhé këjo duket se derivon nga fjala "shqype" (Sqypter, Shqyptar, Skifter, Sklifter). Historikisht s'munt të vërtetohet këjo, por në qoftë se marrim parasysh se fjala "Shqype" (Shkaba) ashtë mâ e vjetër se fjala hellenike γύψ (Skyfter), gjâ që nuk ka as një dyshim, që kështu merret vesht se e dyta vjen nga e para, ahere duhet të pranojmë se fjala "Shqype" (Shkabë) ashtë një fjalë e vjetër, një fjalë prehistorike, do me thanë fjalë Pellasge, mbassi fjalën γύψ, që symbolizon edhé domethanjen e fjalës "Shqype" e stërditim[2] edhé në krye të Iliadhës së Homerit, megjithë që Shqypja ose Shkaba quhet edhé άετὸς greqisht.Pra nuk asht çudi që Shqyptarët qysh asokohet të kenë qujtun **SHQYPTARË** nga fjala **SHQYPE,** symbolit të Jupiterit.

Që indigjenët e Gadishullës Ballkanike ishin shtërgjyshit t'onë Pellasgët e jo Hellenët, na e tregon edhé vetë baba i historisë Herodhoti, i cili ata i quan **BARBARË** dhe i cili çuditet qysh akoma në kohën e tij (500 e sa vjet para Kr.) ndodhen akoma gjyrma kësij barbarësh në Thessalì ku në Kopajidhë, kishin edhé faltore të Apollonit (Djellit) ! Por e shohim akoma edhé në Iliadhën e Homerit, ku Ahileusi hiqet si një i huej përpara prîsit të Ahajivet hellenit Agamemnon e kû mbassi vritet miku i tij Patrokli dhe rrok armët për me i marrë gjakun vrasësit Hektorit ky (Ahileusi), si Pellasg që ish prej fisit, përshëndet edhé thret në ndihmë Zotin e tij Dhodhonas Pellasgjik, *Ζεύ, Ἄννα, Δωδωναίε Πελασγίχέ* Homeri II. XVI, 233[3]) ! Pra, këta Pellasgë, si fatosa që ishin, nuk ashtë çudi të jenë qujtun qysh ahere **SHQYPTARË** prej "Shqypes" si thamë, symbolit të Zotit e personifikimit të burrnisë.

---

[1] Ahileusi = Akili.

[2] Stërdit = has, takonj, gjenj përpara.(K.Floqi)

[3] DODONA,për të cilën kemi shkrue edhé tjetër herë ashtë faltorja mâ e vjetër e mâ e përmenduna Pellasge dhe gjindet në Veri-Prëndim të Janinës (Shënim i Kristo Floqit). Këtë artikull mund t'a gjeni në Revistën "Agimi" në bibliotekën digjitale Marin Barleti Shkodër Nr. 1,2,5,6 viti 1919

I paharruemi Pashko Vassa, ose Vasa Pasha Shkodrani, në librin e çmuëshëm të tij **ORIGJINA PELLASGJIKE E VJERSHAVET HOMERIKE**, mbas një studimi të gjatë, të thellë e të himtë, na tregon me fakte, që edhé Iliadha e Odhyseja e Homerit origjinën e kanë nga legjendat Pellasgjike. Këtë e shofim edhé në shumë fjalë homerike, që i përshtaten kësaj gjuhës shqype s'onës, si p.sh. άτάρ (atëhere), ούσς (veshi), προπάριθι (përparathi) etj.

Disa shkrimtarë dyshojn edhé për fjalën **PELLASGE**, tue kujtue se kjo ashtë një utopi, por se mjafton për këta Homeri dhe Herodhoti për me u zânë gojën. Por edhé émni **PELLASG**, që derivon prej fjalës shqype "pellg" **Pellgas, Pellagas, Pellasgas, Pellasgë**[1]) s'ka dyshim që asht mbiemni i atij populli, që lundroj prej Asijet nga ana e Pellgut, ose **Detit EGJÉ** (Αίγαίον Πέλαγος) dhe zuni shtek në Gadishullin e Ballkanit, ndonse ky popull kur ishte akoma në Asin'e vogël, njihej me emnat **LELEGJES, KARRES, FRYGJES, LYDHOI, PAJONES, PAFLLAGONES**, etj. etj.që ishin raca Pellasge.

Historjani grek Plutarchos në **JETAT** e tij **PARALELE** kur flet mbi mbretin e Epirit **PIRRON**, na tregon se kur mundi ky Grekët e Maqedhonasit, ushtarët e tij të dehun prej gadhnimevet, e kanë titullue me emnin **SHKABË** (άετός). Pirrua, i kënaqun prej këtij mbiemni, i falenderoj ushtarët, tue u thanë se verevërtet ket titull e meriton, por mbassi luftat i ka fitue po me ata trima ushtarë, urdhnoj që edhé ushtarët e tij të quhen "Djelmt'e Shqypes" d.m.thanë **SHQYPTARË.** Dhe kështu duket se jo vetëm ushtarët e tij, por edhé gjithë populli i Epirit mori këtë mbiemën (272 para Kr.) si edhé vendi u qujt **SHQYPNI** (Shif **WASSA** Efendi **LA VERITÉ SUR LES ALBANAIS ET L'ALBANIE,** të përkthyem edhé gjermanisht **WASSA PASHA** *Albanien und die Albanesen*, Berlin 1879. Ky libër u përkthye edhé në shumë gjuhë të tjera Europjane, e u çmue tepër).

[1] Straboni,VIII, 6,9, thotë se fjala Pellasgôs âsht fjala Pellargôs e përbâme prej fjalëvet **πέλω** = banoj dhe **άργος** = fushë (fusharakë K.Floqi).

Nji tjetër shkrimtar Sllav prej Raguzet[1] thotë se emnat **SHQYPNI** e **SHQYPTAR** përmenden për të parën herë nga viti 1392, prej emnit të nji familje që jetonte asokohet në qytetin historik të Drishtit, afër Shkodrës, e cila mbiemnohej **SCHIBUDAR, SCHIBUDER, SCHAPUDAR, SCHAPUDER,** prej së cilit emën kërkon të thotë se derivon emni **SHQYPTAR**. Kjo, me gjithë që ka një shëmbullim nuk duket të jetë një argument i mjaftë, kurse te Plutarku duhet të japim besimin mâ të math, sepsé âsht nji shkrimtar i vlefshëm e authentik.

Që të mund të sigurohemi edhé mâ tepër se emnat **SHQYPTAR** e **SHQYPNI** kanë qënë mâ të vjetra se sa përmend historjani Kroat mâ sipër, mjafton të theksojmë se gjuha Shqype âshtë shumë mâ e motshme se Hellenishtja. Këjo përveç provave të tjera që parashtrojnë një shumicë historjanësh, provohet edhé prej asaj akoma Mythollogjisë Hellenike, e cila s'âshtë tjetër veç se Mythollogjija Pellasge, që edhé Pellasgët duket se e kanë adoptue prej kombeve mâ të vjetër, si kur se e adoptuan edhé Latinët prej Hellenëvet.

Në këtë Mythologji emnat e Perëndivet shifen të gjalla edhé në gjuhën t'onë, si p.sh. Ζεύς (Zoti), Ήρα (Era), θώτίς (Deti), Γώα (Dheu) Δημήτηρ(Dhémetër),Άφρδίτη (Afërdita),Έρεβος (Erët,terrët), Χάος (Ha, hapët, hapsinë, prej rrâjës sanskrite Hâ), Νύς (Natë), Νέμεσις (Nëma), etj. etj. E për këtë arsye s'ka dyshim që edhé Shqyptarët, si njerzit e Hŷjit që kish për symbol shqypen edhé si mâ të vjetër e mâ trima, mythologjikisht të kenë pasë marrë këtë prosonymi[2] tue u qujtun **SHQYPTARË**.

Por edhé nji e treta e fjalëve të gjuhës s'onë janë fjalë të thjeshta Pellasge. Këtë e vërtetojnë edhé shkrimtarët në zâ **MALTE-BRUN, Dr. HAHN, EDWARD SCHNEIDER, LEAKE, MIKLOSICH, XYLANDER** (*Die Sprahe der Albanesen, oder Schkiptaren. Frankfurt,1935* etj. etj.)

Si thamë edhé mâ sipër, Grekët e vjetër e quanin shkabën me fjalën γύφ, e cila fjalë s'âshtë tjetër veçse parafthora e fjalës

[1] Raguza = Dubrovniku i sotëm

[2] prosonymi (προσωνυμία) = emër.

Pellasge **SHQYP, SHQYPE,** mbassi edhé fjala γύφ shkruhet si edhé fjala shqype me ypsilón. Në gjuhën Neohellenike të sotmen kemi fjalën Ειφτέρι (Skyfteri), që duket se përbahet prej fjalëvet Ειφος-πτερού shpatë-pèndë, por kjo fjalë munt edhé të derivojë prej fjalës shqype "Skypter, Skyfter, Skifter" që rrâj e saj asht prap fjala "shqyp", "shqype", origjinali i së cilës duket mâ i vjetër se fjala greke γύφ.

Me emnin e shqypes kemi edhé qytetin e bukur të Kossovës **SHKUPIN**, që gjindet i ngrehun mbi brigjet e lumit **AXIOS**[1] (Vardharit), për të cilin qytet bân fjalë dhe Ptolemeu, si dhe argjipeshkvi i përmendun Shqyptar Pjetër Bogdani (1675), në një letër që i adresohet ipeshkvit të Prisrenit, tue i shpjegue se fjala **SKOPLJE** ishte nji mbiemën i rí sllav, që i a kishin ngjitë Serbët atij qyteti, kurse fjala **SHKUP** âshtë fjal'e thjeshtë shqype.(Shif dhe A. Arrowsmith, **THE EUROPEAN MAP**, London).

Një profesor i dëgjuem grek, **PAPARRUSSI**, profesor i historisë në një gjymnaz të Stambollit, në një artikull që shkruante me datë 4 Maj 1910 në gazetën **NEOLOGOS** të atij qyteti, që e patmë këndue dikur edhé né, dhe që shkaktoj pushimin nga detyra të këtij profesori, mbassi paraqitte shumë argumenta të historianëve klasikë e modernë, përfundonte se "Epiri ka qënë gjithmonë një pjesë e padâme e Pellasgjisë, (Shqypnisë) e kurrë ndonjë herë e Greqisë, se Epirotët nuk ishin Grekë" edhé se "fjala **SHQYPTAR** âshtë fjalë shum' e vjetër, që origjina e saj duhet të ketë fillue shumë vjet para Krishtit.

Prej këtyne munt të konklludojmë pa gabim se Shqyptari âshtë qujt kështu prej shumë shekujsh mâ parë, dhe se fjalët "Shqyptar e Shqypni" janë tituj të saktë, me të cilët shtërgjyshat t'onë kanë qujtë vehten dhe vendin e tyne, kur se fjalët **ALVANOS**, **ALVANIJA**, janë fjalë ose mbiemna të reja, me të cilat na kanë titullue të huejt, edhé për të cilën çashtje do bajmë pak fjalë mâ poshtë.

---

[1] Për këtë problem shih artikullin e Kristo Floqit "Kossova (Serbi e vjetër?)" botuar në revistën "AGIMI" të Shkodrës Nr. 2 qershuer 1920 deri në Nr.12 Prill 1921

II.

Por pse të huejt na kanë qujtë gjithmonë, si edhé sot akoma me mbiemnin **ALVANOS**, **ARVANITIS, ALBANESE**, dhe vendin t'onë **ALVANIA,ALBANIA, ARVANTITIA?**Po shpjegohemi.

I famshmi astronom, gjeograf e historijan Ptolemèu (Ptolemaîos o Klavdhios, nga Aleksandija e Egjyptit, 130 pas Krishtit), në librin e **III**. 13§ 23, përment për të parën herë emnin Ἀλβανοί (Shqyptarë) si dhe një qytet Ἀλβανούπολίς përtej kufive të Dallmacisë, në Maqedhoni, tue pretendue se ky qytet duhet të jetë **KRUJA** e sotme, ku gjenden edhé shëmbtyrat[1] e qytetit. Ptolemêu thotë se deri asaj kohe ajy vent i Maqedhonisë si dhe gjithë ngastrat e tjera të Shqypnisë quheshin Ἰλλνρία (**ILLYRICUM**) Libri **III** 12 § 20 dhe fillonte prej qytetit Dhyrrahion (Durrësit) e deri në malet Kandavia dhe shton se ky komp qysh ahere filloj të quhet **ALVANOI**, kurse deri ahere quhej me emnat **ILLYROI, MAQEDHONES, EPIROTAI.**

Për qytetin **ALVANOUPOLIS** bân fjalë edhe historijani Austrijak, i përmenduni **TOMASCHEK** (Zür Kunde der Hämus Halbinsel, Wien 1882) të cilit ja shënon kufitë afër Kruës, por se një historijan tjetër **DESDEVISES**, bashkë më këtë edhe **Dr.HAHN-I** thonë se **ALVANOUPOLIS** ishte ngrehë në vendin ku gjindet sot **ARBONA**, prej së cilës vendasit u qujtnë *Arbën* ose *Arbër* dhe vendi **ARBENÍ**, ose **ARBERÍ**. Por ndodhen edhe të tjerë shkrimtarë që thonë se ky qytet duhet të jetë **ELBASANI** i sotmë (i cili tjetër herë quhej **SKAMPA**, prej fjalës "shkumbë" ose prej fjalës "shkamp" ose edhé prej lumit të tij "Shkumbinit" ndonse shumë pretendojnë se fjala **ELBASAN** derivon nga fjalët turke *el basmak* d.m.th. vé dorë), dhe sjellin si shëmbull se ky qytet ka qenë qendër e madhe, qendrë Prefekture, ku më 1257 ishte çue[2] prej imperatorit Byzantinit Iascaris si Praetor (Prefekt) i qujtuni Gjergj Akropolitis.

---

[1]shëmbtyra= gërmadha

[2] Ishte çue = ishte ndërtue, ngritur

Anna Komnena flet për një qytet me emnin Ἀρβανὸν, prej të cilit u qujtën Ἀρβανοί shqyptarët e sotmë, si dhe vendi Ἀρβανία.

Në këtë mendim janë si edhe historijanët e tjerë Byzantas Nikefor Gregoras, Nikoll Halkokondhylis, Jan Kantakuzinôs, Gjeorgjios Skylitsis, Gjergj Franzîs, Gjergj Akropolitis, etj. Këta thonë se prej qytetit **ARVANON**, imperatorët e Byzantit i qujtën *Arvanitas* gjithë banorët e Shqypnisë, dhe vendin *Arbanitia*, ose *Alvanitia*.

Të tjerë shkrimtarë thonë se Shqyptarët u qujtnë **ALBANI**, si dhe mâ von vendi mori emnin **ALBANIA** prej Italjotëve, sidomos nga fjala latine Alba[1] që do me thanë *e bardhë*, për shkak se Shqyptarët mbajshin (si edhe sot akoma) petka të bardha, fustanella, braqesha të bardha etj. Kështu dhe vendi u qujt **ALBANIA**.

Me fjalën *Alba* janë qujtë edhe shumë qytete Italike, sikur se *Alba Longa* etj. si dhe male, sikurse **ALBANUS MONS**, që sot Italjanët e quajnë **MONTE CAVO**, mal gati 1.000 metrash naltsije, i vargut të Latium-it, mbi majën e të cilit shëndritte tjetër herë tempulli i Jupiterit të Latinëvet, si dhe në skundill[2] të tij qyteti *Alba Longa*, ku sot gjindet qyteti *Albano*. Por edhé liqene janë qujtë me emnin alba, sikur se liqeni **ALBANUS LACUS**, të cilin Plutarku në jetën e Camilus-it e quan *Alvanis limni*[3]. Gjith'ashtu duket se edhe liqeni i Shkodrës **LABEATIS** lipset të derivojë prej fjalës *alba*. Por janë edhé të tjerë që pretendojn se fjala **ALBANI** âshtë ajo fjala **ALPINI**, që sinjifikon malësorët dhe emni **ALBANIA** malësinë, mbassi Shqypnija âshtë një vent malsuer.

Historijanë të tjerë thonë se emni **ALVANIA** vjen prej një qyteti afër liqenit të Kaspisë dhe se nga ky vent zbritnë Shqyptarët e sotme në Europë. Por né Shqyptarët e thrasim vendin edhé *Arbëni*, ose *Arbërí*, ose *Arbërí* dhe Shqyptarin *Arbën,* ose *Arbë*r dhe *Arbnesh,* ose *Arbresh*.Mos të jetë këjo nga fjalët *Arvania* dhe

[1] Albus, a, um = i bardhë, Albo = zbarth, Albeo, ose albesco = zbardhem. (K.Floqi)

[2] skundill = Buza ose cepi në fund të një rrobe; pëqi, kind

[3] Që sot quhet *Lago Albano* (K. Floqi)

Arvanitai që na quajn Grekët,që edhé Turqit banë fjalën *Arnautë*? Ndoshta, po nuk âshtë çudi që fjala të derivojë prej fjalëvet *arë–bâmë*s ose *arë–bêrës*, mbassi Shqyptari i motshëm ka pasë për mjeshtëri të lëvruemit e tokës, ose të aravet, bulqësinë.

Si do qoftë, për né Shqyptarët fjalët **ALVANIA** dhe **ALVANOI** janë fjalë të hueja, kur se né vehten e kemi qujtë me mbiemnin **SHQYPTARË** dhe vendin **SHQYPNI**, që duket, nga sa thamë, se këto fjalë nuk janë të reja, po shumë të vjetra.

Dr. Kristo Floqi

———

Shkaba dy krenore

(botuar në revistën "LEKA", 1934,
Nr. 12 Dhjetor, f.414-415).

Një mik më pveti pardjè qysh edhè si ka mbetë Shkaba dykrenore si emblema e flamûrit t'onë kombtar. Natyrisht ja shpjegova sa munda çështjen, tue e arsyetue në baza të sakta. Pra m'a bjen rasti të baji pak fjalë mbi këtë ndollinë edhè me anë të përkohshmes së ndershme "Leka" për lexuesit e saj.

Dihet se në Mythologjinë greke shpendi i "Shkabës" si mbret i shpendave tjera, ka pasë nji randsi të posaçme. Ishte shpendi i Hŷjit dhe, si thonë, kishte lemun bashkë me atë. Shkaba i kishte prue rrfenë e zjartë Hŷjit, tue ja u rëmbye revet. Kur Hŷji ishte i vogël akoma e rrnonte shkaba.

Për të parën herë shofim Leken e Math, i cili përdori shkabën si shêjë për stemën e tij dhe për monedhën aleksandrine që pat shtypë. Prej ktij e murne mâ von edhè trashigimtarët e tij.

M'andej e kanë përdorë edhè Romanët në flamûret e legjionave të tyne, si shêjë fuqije. Në kohën e imperatorit Marius, Shkaba përfytyrohej me krahët e hapta në flamûret e perandorisë.

Shkaba me dy krenë dal–ka–dale u bâ emblema edhè e imperatorive të Byzantit, dhe u qujt "mbretnore" dhe shkaku i bashkimit të dy shkabave ka qenë symbolizimi i imperatorisë dyfishore Romano – Byzantine, mbassi ajo perandori ish e ndame

dysh, në perandorin'e Oksidentit me qendrë Romën e në atë të Orientit me qendrë Byzantin.[1]

Prej romanëve mâ von e muern ketë Shêjë dhe mbreti i Francës Karli i Math (Charlesmagne) edhè imperatorët e Russis e t'Austris. Imperatori Bysantinas Jan Paleollogu, në vitin 1439, kur ka shkue në Firenzë t' Italis për bashkimin e kishave u dha të drejtë aristokrasis së vendit me bartë Shkabën dy-krenore, të artë, si emblemë shtëpijake.

Sa do që me pagzimin e Konstantinit të math si të krishtenë,Shkaba dy – krenore ja la vendin kryqit, prapë se prapë emblema e parë shkabore përdorej në të gjitha balloret e ndertesave publike të perandoris Byzantine.

Një traditë tregon se Byzantinët e muern shkabën dy – krenore prej Turqvet të cilët, e sidomos *Selxhukët* që e hiqshin vehten *Rumi,* d.m.thanë Romanë, e kishin përdorë qysh prej vjetve 1158-1280. Tjetër traditë n'a kallxon se Byzantinët e kishin marrë prej Persanëvet, kur i kanë mujtë, se Persanët e përdorshin Shkabën prej qindra vjetesh, si shêjen e flamûrit të tyne.

Shkaba dy – krenore u përdor edhè mbassi ra Stambolli në duert e Turqvet. E përdorshin mâ fort si emblemë Patriarkale të gjithë Patrikët e Fanarit. Gjithashtu përdorej dhe në shumë kathe-

[1]Këtë tezë e pranon edhe Wikipedia.Në këto rrethana flamuri i Skënderbeut me shkabën dykrenare, kur të valojë në Bruxel përkrah flamurit të Bashkimit Europian që simbolizon me sfondin blu të errët Qiellin e Europës Perëndimore dhe 12 yjet, aureolën e Shën Marisë në "medaljen mrekullibërëse" që përkujton dukjen mariane në rue du Bac a santa Caterina Labouré më 1830 të cilën e mbante mgjithmonë me vehte hartuesi i flamurit Arsene Heitz.(Wikipedia) Flamuri i Skënderbeut do jetë simboli më i mirë i Europës kristiane mbasi të krijohen Shtetet e Bashkuara të Europës nga Atlantiku deri në malet Ural, përfshirë Rusinë, ëndërr kjo që realizohet vetëm me vullnetin e Perëndisë. Pra, është Europa ajo që ka nevojë të ketë në gjirin e vet Shqipërinë, flamuri i së cilës ka vlerë morale po aq të madhe sa ka edhe flamuri i sotëm i Bashkimit Europian. Aq më tepër që Europa i ka një borç Skënderbeut, i cili sa ishte gjallë nuk lejoi kalimin e hordhive Ottomane në Itali duke shuar ëndrrën e sulltan Mehmetit të II-të për myslimanizimin e Europës, dhe siç thonte ky sulltan që donte "të kulloste kalin e tij në altarin e Shën Pjetrit në Vatikan". Europa, për interesin e vet mund të vendosi nesër – pasnesër një emblemë të Shkabës dykrenare, por emblema nuk ka vlerën e flamurit.

drale orthodokse, si edhè në shumë vorre (mausolès) më randsi, po akoma edhè nder petkat e burrave, si shkabë dy-krenore e qendisun me âr.

Fatosi i kombit t'onë Skënderbeu, mbassi u shkëput prej Sulltanit e përdori ketë shêjë të Shkabës dy – krenore si flamur kombëtar në luften e parë që filloj kundra urdive turke nënë gjeneralin turk Ali Pashën, i cili me 25.000 shpirt ishte çue prej Sulltan Mehmet Gaziut me i ra Skënderbeut. Flamûri i Skënderbeut ishte aso kohet nj'ashtu si e shofim edhè sot, dm.th. Shkaba dy-krenore ngjyrë zezë në sheshin e kuq.

Ky flamûr u përdorue në 27 a sa lufta që bâni Skënderbeu kundra Turqve,gjithashtu valoj edhè në Puglien italiane, kur Skënderbeu i shkoj në ndihmë me 10.000 burra Shqyptarë mbretit të Puglies e të Aragonis, Ferdinandit, i cili ishte qarkue keqas prej Frêngjvet, dhe të cilin Skënderbeu e libroj.

Këjo me pak fjalë âsht historija e Shkabës dy-krenore, historija e flamûrit t'onë kombtar.

Dr. Kristo Floqi

DËSHRA E VËRTETË
E
SHQIPËTARËVET

Vjershë Kombiare

Prej
Naim H.Frashërit

Shqipëruar nga greqishtja
prej Kristo V. Floqit

Shqipëri! ti më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar,
Zëmërnë ti ma gatove, plot me dëshirë dhe me zjar.
Shqipëri ! ô mëma ime ! ndon-se jam i mërguar,
Dashurinë t' tënde kûrrë zèmëra s'e ka haruar !!

(*Bag. E Bujq. flet' e I-rë*)

S O F J E
Shtypëshkronja shqipe "Mbrothësia", Kristo P. Luarasi
1904

Dhurohet Shpirtmadhësisë

të

Trimavet Shqipëtarë.

Shqipëronjësi

Impremérie albanaise, Christo P. Luarassi – **Sophia**
(Bulgaria)

DƐGIR' E VƐRTETƐ

E

ƆQIΠƐTARƐVET

O djɛmt' ɛ Memeđɛut, ô trima Atđɛtare!
Te ditur, te deɡuar, ɛ bupa luftetare,
Sikundre te baɛkuar, qe ndođeɛim te tere,
Te bɛsese per kombin, ɛ miq per jɛte bere;
Te duhɛmi na lipsɛt, si duheɛim per hɛre,
Te jɛmi te baɛkuar, si iɛime ŋe hɛre;
Πer punen ɛ pɛrendijte, per liresine tène,
Kur sot i ligu humbi, kur s' eɛte si ka qene.
O far' ɛ trimerise, ti femij' ɛ Alɛksandrit,
E trimit te Ɡqipetarevɛt, ɛ Πirose te parit!
Бɛ djɛmt' ɛ Skendɛr-bɛgut, te trimite te ndritur,
Te cilin kupe noŋe hɛre, as ŋê s' ɛ pat haritur.
Πandɛhni, ɛprɛhni, bupa, mos trembi, sa na jipɛt
Te ɡiđe mɛ ŋê mendjɛ, te bejm' até qe lipsɛt,
Πɛλazge jɛmi lindur, nga Hena mê perpara,
Ahɛrɛ kur Ađamit as qe i dukɛj fara!
Jo vɛtem ŋɛrezise te vjɛtrit bupat tàne,
Πô đɛ te Πɛrendivɛt, pra prinder kane qene;

DËSHIR' E VËRTETË
E
SHQIPËTARËVET

Poemë nga Naim Frashëri shkruar
në greqisht e kthyer në shqip prej
Kristo Floqit
(Transkriptuar nga origjinali që ndodhet në
Bibliotekën Kombëtare Tiranë,ribotuar
më 1912,e përpunuar nga K.Floqi)

O djemt' Mëmëmdheut, ô trima Atdhetarë !
Të ditur, të dëgjuar, e burra luftëtarë,
Sikundrë të bashkuar, që ndodheshim të tërë,
Të besësë për kombin, e miq për jetë bërë;
Të duhemi na lipset, si duheshim për herë,
Të jemi të bashkuar, si ishimë një herë;
Për punën e perëndijtë, për lirësinë tënë,
Kur sot i ligu humbi, kur s' është si ka qënë.
O far' e trimërisë, ti fëmij' e Aleksandrit[1],
E trimit të Shqipëtarëvet, e Piros të parit !
Dhe djemt' e Skënder-begut, të trimitë të ndritur,
Të cilin kurrë nonjë herë, as një s'e pat haritur.
Pandehni, shprehni, burra, mos trembi, sa na jipet
Të gjithë me njê mëndje, të bëjm' atè që lipset,
Pellazgë jemi lindur, nga Hëna mê përpara,
Ahere kur Adhamit as që i dukej fara !
Jo vetëm njerëzisë të vjetrit burrat tànë,
Pô dhe të Perëndivet, pra prindër kanë qënë;
Gjuh' e pa vdekur jona, e qruara[2] e lara,
Perëndi miqer kreu, në kohëra ta para !

[1] fëmij' e Aleksandrit = familje e Aleksandrit të Madh
[2] Qruara = shquara

As një s' përflet dot kurrë, trimërin' e prindërve të vyer,
Se gjithë istoria plottësisht i ka rëfyer.
Por si Shqiponjat një herë, mi Asinë fluturuan,
Lëftuanë Darinë[1] e fronë jà rëzuan,
I shuan tërë Persët, i çqyen i dërmuan,
Qytetarin' e vlerë nga brenga e shpëtuan !
Në luftëra të repta, u derdhë trimërisht,
Tmer' e dërmën u kallë Romanëvet burrërisht !
Ç' ish vall' ay petrit, dragua Maqedhoni,
Që Grekërinë funt e krej, e muntte pas zakoni?
Ç' ish vallë ky njeri i math që Grekët mê s'mënuan[2],
Tà grekërojnë fët e fët, pô vonë u munduan ?
Po kur u ther' armiqtë prej duarsh luftëtarit,
Cilët e doqnë Thivën[3], e vetëm të Pindharit ?
Shtëpin' e prehjen s' nganë, s'e prishnë, s'e trazuan,
Për nder' e Perëndisë s'e doqnë s'e përvluan.
Ata nuk ishin Grekër as Shqeh, si ca që thonë
Përveç se prindrit tànë, të huajt Maqedhonë,
Plutarhu, Dhimosteni, të vjetrit me Strabonë,
Si edhe ç' do i ditur të gjithë than' e thonë :
Që kombi ynë ishte që moti fort i vyer,
I çelur, i begatë, i fortë, i rëfyer.
Ata ishin si nevej të qruar Shqipëtarë,
Të besës edhe trima, e burra luftëtarë;
U qojt me ketè emër që-moti Shqipëtari,
Nga "Shqipja", q' ish i fortë në luftëra m'i pari.
E ngaj që mbante krye në flamur kurdoherë
Shqiponjënë, shënjë të trimëris' së vlerë;

[1] Dario I Mbret i Persisë (522-486 para Krishtit)
[2] Mënoj = vonoj
[3] Thiva = Thebes,qytet në Greqinë Qëndrore që u shkatërrua nga Aleksandri i Madh më 335 para Krishtit.

Në Shqipëri qëndronte, Perëndi e të Qëmotit[1],
Në majet të Tomorit shkëndijte Kish' e Zotit !
Të parët duke lutur shëndijnin m' atë Kishë,
Pra lùsninë me kaqë nder, Perëndin' e Shqipërisë !
Edhe në dashçi ç' do njeri, të drejtën të gjykoni,
E në shikofshi me qëllim, të parët të këndoni;
Aristotel e Ptolemenj, dhe sa të ditur dini,
Do msoni q' është Shqipëtar i madhi Kostantini[2],
Që ishte fis nga Dhardhanenjtë, e bir' i Mëmëdhesë,
Pra ndrite kaqë me vetëtim, me trimërin' e fesë.

Mbi gratë mbretëreshë sot e zonj' e diturisë ,
Nuk' është Dora d' Istria, e bij' e Shqipërisë ?
E cila kurrë nuk harron vëllezërit, Mëmëdhenë,
E kurdoherë i lëvdon, të huajt siç rëfejnë !
Plot me dëshir' e dashuri, për kombin po përpiqet,
Me nder të math, me dhëmpçuri e mëndja mê s'i hiqet.

Sa kombe vallë humpnë, të botësë të tërë,
E sa prej kllirash[3] syresh të kryer janë bërë !
Po Shqipëtarët kurrë, fytyrën s'e ndryshuan,
Zakonet, sjelljat, gjuhën, as një herë s'i haruan !
Thesprotinj, Mollosinj, Ilirinj, Maqedhonë,
Shqipëtarë jemi gjithë, si edhe sot na thonë !!

Ndo-një nuk mundi kurrë, nga të huajtë sa hynë,
Të prishnjë kombin tënë, të shkelnjë Shqiptarninë;
S'e ndruan gjuhën fare, vetijat e zakonë,
Pas fesë q'uà lanë, i patnë gjithë monë !

---

[1] Perëndi e Qëmotit = Zeusi Pellasgjik. K. Floqi shpjegon tek "Tempull' i Dodonës" se stërgjyshërit e Shqiptarëve – Pellasgët – shpikën Perëndinë e tyre, Zeusin Pellasgjik, që kishte banesën e tij në majë të malit të Tomorit, Berat, por mbas disa shekujsh Hellenët e përve-htësuan këtë perëndi dhe banesën e tij, me imagjinatën e tyre, e tran-sferuan në Olimp.

[2] Perandori Byzantin Kostantini

[3] Kllirë = mbeturinë

Të hekurtë, të zjartë, me shpatën kllefit nxjerë,
Vdisnin, e binin trimërisht për Shqipërin' e mjerë.
Grekët, Sllavët e Qeltërit, Romanët e Bullgarët,
I quanin të huaj t'atëhershimit Shqipëtarët !
Të Botësë të tëra, sa çetëra që janë,
Ranë me vrap në xgjedhë, të frikçmëve Romanë,
Po Shqiptarët, trima fort, me t' urt' e me të pritur,
U mbajtnë gjithë burrërisht, e duallë të ndritur.
Sa luftra të përgjakta, sa kanë bërë punë
Të ndriturit të parët, e kurrë s' hoqnë dhunë !
Oh! ranë tërë trimërisht, si burratë me besë,
U vranë gjithë trimatë, për nder' e Mëmëdhesë!
U xvat, u mbyt me gjakëra e Mëmëdheut trimërija,
U shkretua armiqësisht, u doq, u poq, pô feja
Sa-do që hoqi mjerësi, po s'mbajti rëndësirë,
Dhe Shqipërinë e nderoj, e nxori si jo mê mirë!
Njeri s' kuxojti kurrë, të poshtnjë Shqipëtarë,
Të vërë nënè xgjedhë të rallin luftëtarë !
Është i urtë në paqësi, i butë si manar,
Po kur ndjen luftë bënetë dragua, gjakatar.
Në kohë të trazimevet kur zunë togje, togje,
Të dilnin të përhapurë të Lindjes kaqe sllogje[1],
Të egër ushtëtarë, Skëterën duke hapur,
Nuk lanë mbretërira, pa çqyer e pa xvatur.
Aty dhe Bizandinjët,që ishinë të rallë,
Zapatn[2]' e keq jù dhanë, në tmer, në zi i kallë.
Të ndezurit halldupë,lugetë të mërzitur,
Të liqtë gjakatarë, të egër, të mahnitur,
Rëmuan tërë botën si ujqër të tërbuar,

[1] sllogje = grup,togë apo kompani ushtarake
[2] zapat = shkatrrim,mjerim,fatkeqsi.

Rëzuan themelitë të Shtateve[1] shënuar !
Të gjitha mbretëritë, s'qëndronin dot më këmbë,
Sa dhe Ariu[2] thuaj, po rij me shpirt nër dhëmbë.
Në tmer, në vaj të shumë, në logori në valë,
As fare s' pipërinin, mê s' nxirnin dot as fjalë.
Si u tmeruan robërisht, dhe ranë nënë dorë,
Një komp i vlejtur midis tà, jù mbajti krahërorë.
Si zuri luftë me këtà t'egritë kusarë,
Edhe njëherjesh i dërmoj, u mori ç' kishin marë
Shpëtoj dhe përsërithi nga gënjeshtrat e mbëdha,
Evropën' e pështirë, që hirënë mê s' jà pa !
Ç' ishte vallë ay njeri, i kombit kryetari,
Kjo shkabë kaq' e fortë, ky burrë kordhëtari ?
Mos ishte Mars[3], a Athina[4], a po ky Zoti[5] vetë?
A mbase mos ish nonjë njeri, që nukë la gjë të metë !
O ! ëngjëll, gojë-artë, ti, që di të drejtën tërë,
Trego, të lutem, trego dhe rëfè kush i ka bërë !
Këndo, vajto, moj Musë, qaj, të lutem bukur,
Lëvdona sot njerinë, të vjetërin të dukur !!
Leri më rrofsh, më njànë Virgilë e Omirë,
Leri prallat' e vjershat, e merja pakë me lirë !
Trimn' e vërtetë e dinë të gjithë dhe e rëfejnë,
Kryetar' e Shqipëtarëvet, të madhë Skënder-bejnë !
O ! ti, ô i pavdekur ! ô shpirt i shenjtëruar !
O ! bir, i dashur shumë, ti, o zëmbaku i shkruar,
Q' e lartësove tepër të tërë Shqipërinë,

[1] Shtat (vent, mbretëri, shtet Greqisht **χώρα**).Shënim i K. Floqit
[2] Ariu (**ἡ Ἄρκτος τοῦ Βορρά**). Shënim i K. Floqit (Rusia)
[3] Mars (**Ἄρης** = Perëndi e luftës që kishin të vjetërit). Shënim i K. Floqit
[4] Athina (Perëndi e diturisë, siç i thonin Grekët **Ἀθάνα, Παλλάς, Ἀθήνη**) Shënim i K. Floqit
[5] Zoti (Greqisht **Ζεύς, Διός, Ζηνό, Ζήνα, Δωριισ** Zana shqip *Zone*). Shënim i K. Floqit

E cila të ka shënjë mbi tërë njerëzinë !
O ! djalë i lëvduar, i Mëmëdhes' së gjorë,
Që vdiqe e le jetime, të varfër, e pa dorë !
Të gjithë Shqipëtarët të lusim, e të njohim,
E të nderojmë tepër, por si vëlla të shohim.
Me lottë të piklluar, të lusimë të tërë,
Se dimë ç' ke punuar, të mira sa ke bërë !
Oh ! vallë kur do të vinjë një ditë nga Perëndia,
Shtatuen[1] të mermertë, të të ngrerë Shqipëria !
Luftrat e tua, kryetar, na çelin e na ndrijnë,
Na zbukurojnë mëndjen fort, si yjtë vetëtijnë !
Vdiqe si burrë ! e na le të varfër Mëmëdhenë !
Ah ! mos o Zot, e turpërofsh, po siç ka dhënë benë
U ngrittë ! edhe varri yt që të përmbloth të shtrirë,
Gjëmoftë m' eshtrat' e tua, në Shqipërin' e lirë !!
Shpejtoni sa të mundni, ô miq Mëmëdhetarë,
Për Shqipërin' e gjorë, ô burra Shqipëtarë !
Jemi të gjithë far' e fis, një komp, një gjak,një gjindje,
Kemi të gjithë një shpirt, një gjuhë, një zëmër, një mëndje.
Nuk' jemi Grekër, jo as Shqeh,as Tyrq nukë jemi,
Përveç se Shqipëtarë ! këtè emër gjithë kemi !
Këtè emër, Shqipëtarë, tà lusim e tà nderojmë,
Se vetëm ky ka hie, pra mburemi dhe rrojmë.
Ësht' i lik dhe gënjeshtar, i ndyrë, e i pabesë,
Kush tradhëton kombin e vet, qëllimin e Mëmëdhesë.
Si mjerë, mjer' ay i gjorë, që zë shkelmon vëllanë,
Gjindjen e ti, kombin e vet dhe t' ëmënë e t' anë !
Gjer kur këtà të huaj, o miq, me të pa-hirë,
Do na ndalojnë me magji, në robëri të pështirë ?
Gjer kur për të huajt vallë, do theremi të tërë,

[1] Shtatue (Latinisht: Statua, greqisht: **Ἄγαλμα**) Shënim i K.Floqit

Kjo mëndje, kjo forcatë për të huajt qënka bërë ?

Sa punëra të mëdha bënë, tànëtë për të tjerë !
Shërbyen Shqipëtarëtë ! si mjerë ne, si mjerë !!
Ah! Po të gjitha vanë kot, të gjitha humbur vanë,
Halldupëvet u ndihmë fort, që vdekjen na dhanë;
Por si Mongolë t' egër, si kafshë të përdhunë,
Ah ! për shpëtimn' e tyre ne, nà vate gjaku lumë !
Si mjer' ajy njeri që ndih armiqt' e Mëmëdhesë !!
Oh ! sa punuanë kështu burra trima me besë !

Cilët s'kursyen jetënë, jà falë kot Turqisë ?
Oh ! ishin gjithë Qyprilinj[1], fëmij' e Shqipërisë[2] !

O moj e dashur Shqipëri ! o Mëmëdheza ime,
Të kesh kaqë burra ti, pra sot të jesh jetime ?!
Të kesh një Mehmet-Ali[3] dhe Ibrahimnë vetë,
Misiri i liruar sot, dhe ti … kopil[4]' e qetë !
Fat-keqësi, ô fat i lik ç' të reme po na sjellën !
Të kesh Marko-Boçarin, Miaulin e Xavellën !
Të kesh Bubulinënë dhe trima kaqë të tjerë,
Greqia të lirohetë, dhe ti të jesh e mjerë !!

O burra, që s' harroji dot, më kot qëllimi juaj,
Shpëtoj vetëm Greqia sot, së derdhuri gjaku j' uaj !
Me armët' e perëndijta jù, me gjuhën' e shenjtëruar
Lëftuat gjithë burrërisht, me shprim duke nxituar,
Po të huajt panë hirë jush, për fat tënë të mjerë,

---

[1] Për familjen e Qyprillinjëve Kristo Floqi ka shkruar një dramë me të njëjtin titull, e cila ka humbur, por historinë e kësaj familjeje ai e ka shkruar në prozë me shkrim dore që gjëndet në AQSH F.429-5-276 e në vazhdim.

[2] fëmij' e Shqipërisë = familje e Shqipërisë

[3] Mehmet – Ali Pasha (1769-1849) me origjinë nga Korça, sundimtar i Misirit (Egjyptit), quhet themelues i Egjiptit modern. Dinastia e krijuar prej tij sundoi Egyptin deri më 1952. I biri i tij, e pasardhësi i tij si sundues i Egjyptit, Ibrahimi, me ushtritë e tija theu disa herë ushtritë ottomane. Arriti me ushtrin e tij deri në dyert e Stambollit.

[4] Kopil = Shërbyes për punë të rënda të shtëpisë në familjet e të pasurve.

Dhe shpresa juaj e perëndìjtë, u shua me një herë !
Erdhë Tyrqit gënjeshtarët, Romanët, Byzandinjtë,
Kallamaranj e Fanariot dhe tërë Çorbaxhinjtë;
Komb' i begatë kaqe fort, Ellinët, miq të parë,
Të "huajë" ju qojtën dhe *Palioshqipëtarë.*

Popo ! rëmuan varretë, të ndyrët, të mallëkuar,
I hodhnë për mbi udhëtë eshtrat' e shenjtëruar !
Ah ! po e drejta mbretëroj, dhe duke mos dashur, thanë
Që vërtet të huaj ishitë, pô burra Shqipëtarë !
Ushqeh në munç gjarprin e lik e ngrohe në gjit tènt,
Pa mos prit helmin të hidhur fort, të të hedhë më ç'do vent?
Ç' kërkoni, ju, ô Grekër sot, nga Shqipëria vallë,
Të bëni me gënjeshtra kot? a mos ju kemi mallë?
Dashki të vritet dhelpërisht, e Pirosë fëmija ?
Po dijeni mirë, ô Zotërinj, që nuk' u zê mazija[1].
Bullgarëtë i bëtë Greq sa munttë gjer më sot,
Po ky ndryshim i fesë turp, ësht' i madh turp, ô Zot !
Kush ndron sa kaq gjuhën e vet, e Mëmëdhen'e ndjerë
O ! ësht' i lik kush nuk përfill, mëmën e ti të mjerë !
Ç' thoni, djemt' e Sokratitë ! ju duket masse mbarë
Një komp i vjetër kaqë vjeç, këtè ndryshim të marrë.
Të harronjë, gjuhë e zakon, të gjitha ç' pati mësuar
Dhe përnjëherjesh ky me jù të dalë i ndryshuar ?

A ! a ! gënjehi shumë fort, poshtë gënjeshtr' e pështirë,
Se s' na verboni aqë nê, sa të mos njohim mirë.

Themistoklin' e Qimonë, këta kini të parë,
Miltiadh' Epaminondhenë, të ndriturit kordhëtarë,
Mos kini Efialtinë, tradhëtorë Pafsaninë,
Që van' u dhan' armiqvet Atdhenë, njerëzinë ?

Mëma kurrë nukë do, bir' e saj tradhëtorë,

[1] nuk u zê mazija = nuk u nxihet fytyra

Q' e shtie nënë robëri, e mbetet e gjorë !!

Prej ç'do që ka njeriu në shpirt të dashur të përgjëruar,
Mëmë, a motrë, a vëlla, ç' do gjê të shenjtëruar;
Nuk' është Mëmëdhethi sot, m' i nderçur m' i pëlqyer,
M' i dashur, e m'i dhëmpshurë, dhe nga ç' do gjê m' i vyer ?
Gjendet në botë sot për sot, gjê kaq' e shenjtëruar,
Se ndjenj' e Mëmëdhes' së vet, m' e lartër m' e bekuar ?

Mos jemi nevej Grekër ?....jo, ashtu pashim Zonë,
Përveç se Shqipëtarë, siç ishim gjithë monë !

Është mëkat e turp i math, rezik i pa dëgjuar,
Ne të ndryshojmë kombin e vet, ô Zot i lavdëruar,
Siç ësht' i vyerë për ju, emëri "Grek" i ndjerë,
Ashtu dhe emëri "Shqipëtar" është për ne m' i vlerë !
Në thoni q' ini edhe ju, Pellazgë që një herë,
Ndofta; po kombe Pellasgonj janë disa të tjerë,
Frëngjër, Spanjol' e Italonj, dhe kush e di sa janë;
Juve u quajn' Italonj, po Frëngjër kur' u thanë ?

T' Adamit e të Evesë jemi vërtet të bijtë,
Po nër kombe sot për sot, përndahen njerëzitë,
Pra një qëllim i vetëmë, ka shenjtërim e pjesë,
Të mpronjë mirë gjith-kush lirin' e Mëmëdhesë !

A ! qënki të krishterë ju ! fort mirë; pa na thoni,
Pra dhe ç' do të krishterë, Ellin me pahir doni tà bëni ?
Ahere ndofta si e pse Evropa an' e mb' anë,
S' quhen Grekër, po gjithkush ësht' hequrë më njànë ?
Nuk' ishte Grek pra Zoti Krisht, as nxènësit të dukur
Kombin e fjesht' e Zotit Krisht, e di si-kush fort bukur !
A ! qënki orthodhoksë jù ! vërtet, paski të dreqtë[1],
Po Rusërvet vallë përse, këtè lajthim s' u à ndreqtë ?

Kur Sllavët janë mbase sot, ngaj ju mê të krishterë,

[1] paskeni të dreqtë = paskeni të drejtë (në fundin e shek.XIX, kur është bërë ky përkthim, thuajse gjithmonë fjala "drejt" shkruhej "dreqtë"

Vallë përse të rini Greq, Sllavë pse s' bëhi njëherë ?
Si nukë përmendinë këtà, t'u qassen t'u afërohen ?
Qysh nuku bëhen Grekër dot, vallë përse largohen ?
Qysh ! kur njê besë e njê fê, një dogmë një kishë kini,
Shqehvej përse mërgohi kaqë, pas Slavëve pse s'vini?
Hiret[1] e Sllavet gjithënjê, ju çelë e ju ndrinë,
Armët' e tyre juve sot, ju dhanë Thessalinë;
Po ju në vënt t' u kini hirë, këtyreve shpëtimëtarë,
Largohi, i mërzitni fort, e s' ngopi duke sharë !
….Se paska frikë gjith-kush, me Sllavët mos afërohet,
Se mos përzjehet robërisht, në xgjedhë mos tmerohet !
Ahere, të krishterët t' im, të dashur miq Ellinjë,
Harroni duket, shumë shpejt, e s' mbani porosinë;
Të Zotit Krisht, të Zotit Math, të fesë krishterë,
Që thotë: "mos i bjerë dëm ati që ti s'do të të bjerë".
Që do-me-thënë juve sot, nga ajo q' i trëmbi Sllavet,
Mos prisni me gënjeshtra kot, t'u çpikni Shqipëtaret !
"Duaj t' afërmin si vet-hen" urdhron ky Zoti vetë,
E jù përpiqi gjithë-kujt, t'i kllisni ç' do të metë !!
Jù kaqë Grekër hê për hê, në robëri po kini,
E po kërkoni dhe ç' do komp, në robëri ta shtini ?
Cilin ? Shqipëtarë ? këtë trim ? të Botës trim ! të rallë ?
Q'i ndenj me grusht armikut të lik, q'i theu dhëmb e dhëmballë?
Në janë shumë Grekër sot, në mest të Shqipërisë,
Se mos të pakë ka prej nesh, Shqipëtarë të Greqisë ?
Në ndodhen prapë ndo ca Shqeh, në Mëmëdhe tënë,
Janë dhe mjaft Shqipëtarë, mundë Shqehri të zënë.
Posht' ato duar, jù o Shqeh ! mërgohi Shqipërisë !
S' jù ngopin dot dherat pa funt, të gjerra të Shqehrisë ?
Jemi të zotrit ne këtu, të mbajmë Shqipërinë,

[1] Hiret (Greqisht : **Εϋνοια, πλθ. Εϋνοιαι**) Shënim nga K. Floqi

Pràpsi prej nesh, shporri q' andej në doni miqësinë.
Në doni pra si fqinjë, në mes tènë të rrojmë,
Në paqësi të sosur, në vllazëri të shkojmë,
Fort na pëlqen kjo mëndje, e mir' edh' dëshëruar,
Të rrojmë posi fqinjë, si miq e të gëzuar.

Ndryshe, në qoftë, zotërinj, se shkelni vëndin tènë,
Vdekjen mi ne, pô më në funt Zoti na e pat thènë;
Zjari ahere rëntë shpejt, u djektë dheu me njëherë,
Kur të rrëmbeni ju prej nesh, Atdhenë tènë të vlerë !!
Rëntë dhe qielli për mi dhê, me yjtë e zjartë,
Në humpshim duarsh sot, Shqipërizën' e artë !
U vutë njëherjesh kësi soj të kapni Shqipërinë,
Mëmëdhen' e kaqë trimave, që poshtnë Perëndinë !

O fqinjt' e Shqipërisë, ti Dhipllomati thinake[1],
Dijeni thell' e pa ndyshim, dije, ô moj dinake[2],
Sa rron Shqipëtar' i gjallë sot, s' jà çkulni Shqipërinë,
Mê mirë vdekjen dëshëron, po jo dhe robërinë !!

Juve jà njohtë mirë fort, dëshirën e pa prerë,
Jà kupëtuat me qëllim, ndjenjën që s' ka të blerë !
Këtè nuk' e poshtnë gjer tani, nuk' i qëndruan mb' anë,
Roman' e Byzantinj, a Tyrq, të fortë Venecianë,
E po përpiqi juvej sot, në robëri tà shtini ?
Poshtë ! Mërgohi fare sish, këtè pandehm' e lini !!

O ! ô ! Qëndroni ! se më vjen që shëmbëllenj një hije,
Del me vërtik e me buçim, reza këtej po shtije !
Shihni ! pa shihni atje lart, majën e malit të lartë !
O ! qenka vetë *Skënder-beu*, me shpatënë të zjartë !!

Pushoni pakë se po dëgjonj njê zê në tmer në valë,
Një mallëngjim, një vaj të math, një ligjërim të rallë:
"Ku jini burrat' e Shqipnis ! flini, ô djem, o çuna !

[1] Thinake (e thinjur, e mplakur). Shënim i K. Floqi
[2] Dinake (thingjill' i mbuluar). Greqisht: **πονηρά.** Shënim i K. Floqit

“Ku je trimni e naltë, ti që ke bâ pra kaqë puna !
“Djelm q’i patë dhanun nder Shqypnis,mâ shifni dot po varrë,
“Ta shkel me kamb’ nj’ i huaj sot ! e mbani dot këtë barrë?!
Përhapet hieja perëndon, humbet sa kaq herë,
Dhe malet gumëzhitin fort, në një rënkim të mjerë !

[1] Ëndër po shoh, i madhi Zot, a jam në të vërtetë?
O hije ! dale qëndro pakë, mos ikë me të shpejtë !
Mëndje ! harije dot në munç, pas gjyrmëvet të saj nisu,
Mblidhe forcatënë që ke, fuqin’ e shpirtit dhe ngjishu !
Falm’ edhe ti, ô Perëndi, në zëmër tërsëllimnë[2],
E mos më trëmpt’ as një pengim, gjer sa të shoh dot trimnë!
T’ arthtë keq fort për një të zî, që vuan në lëngime,
E ki mëshir’ ô Perëndi, për këtè zëmërnë t’ ime !

Afromë Leshit[3] ndo njê orë, të përgjonj pra i gjori,
Tregomë këtê hirë sot, dhe mua prej Tomori !
….Më rrofsh ! Të jam falë e përmbys të lavdëronj taninë,
Lëshom’ e lemë vetëmë, të qanj pakë trimërinë !!

O ! qënkam pranë varrevet të ndritur, të të paret,
Qënkam vërtet në Leshn’ e math t’ atyre Shqiptaret,
Mëndje ! përse lëkundesh kaqë ? Mbahu e mos trënditu,
O ! mos u trëmp, mos u tmeroh, mos u dridh, mos ndronitu[4]!
Pushoh, mos qaj e mos vajto, mos ligjëro pa prerë,
Mba vet-hen pak’ e mos rënko, mos m’ u këput e mjerë!
Vdiqe, u thave, tù përzhit thelb’ i dëshirës s’ ate,
Vajte, u trete tù xvertit[5] jeta, me brengët që patte,
Të ftohtit e natës nuk të le, gjaksia e thëllimi,

---

[1] Këtu largohemi pakë ngaj e brëndëshmja (**κείμενον**) duke lëvrirë nga fantasia. S’munt të përshkonim në pushim plagën e lënduar për kryetar’ e kombit tënë.(Shënim i K. Floqit)
[2] tërsëllëm = vrull, forcë e madhe
[3] Leshi = qyteti i Lezhës
[4] ndronitu = frikësohu (droje = frikë)
[5] xvertit = zbeh

A mos m'u dobëtove kaqe ngaj hij' e atij trimi ?
Shihe, pa shihe jà ku xbret, vëndin e saj të gjenjë,
Hyn me nga dalë në varr të zi, të çprehet të dëfrenjë !
Është e lodhët në mundim, prej udhësë së gjattë,
Futet, përmblidhet me pushim mundë fole të thatë !
O ! mê s'm'u mbajtkan lotët sysh, të shoh një trim, një burrë,
Që tundi botën funt e krejt, tà mshtjellë një tok gurë !

O ! hije ! hije e perëndijtë, ô Skënder-bèj i gjallë,
Ty që s' të mposhti dot njeri, të mposhti vdekja vallë ?
A ! s'e mbesonj vërtet, ô trim, këtu përpara meje,
Të jet' i shuarë shtati yt, trimëri e asaj feje !
O kordhëtâr' i Shqipërisë, ô burrë, ô i mburur,
Dil pakë prej varit të të shoh, kurorë-art' i thurur !
Mos më lëndo me ngashërim, zëmërn' e varfër t'ime,
Mos më hidhëro me psherëtim, me lott, me pikëllime !
Jà tek të shoh dhe të përndanj, me shpatën kur do herë,
Jà tek të njoh në vringëllimt, që po krastit plot krerë !
Jam Shqiptar dhe nipi yt, po s' kam kuxim i gjori,
Të dal përpara shtatit tènt, që Zot' i math më nxori !
Folna njê her' ashtu nà qafsh, tregona dashurinë,
Serm' a ç' të kan' ata dy sy, që retë mënt përpinë ?
Dërguar jam tek ty, ô shpirt, prej Mëmëdhes' së gjorë,
Lavdi të lartra po të sjell, kaniskun[1] plot kurorë !
Mbanj veshnë qark dhe të dëgjonj, folmë të mjerit mua,
Zbritna atè jetën që të pa, të fortë si dragua !
Më vjen se flet …. jà tek pushonj; gjërë dëgjonj dhe gjattë,
….A ! mê s'durokërkam dot, zëthin tènt të begatë !!
"Ç' më qënke lodhun vllathi yn, ç' më ke pas arth kti veni?
"Ç' më pate mar rrugën e gjan, ç' doni këtu von të gjeni?
"Nâ që ky dhè ktu po na mba, nâ, që të dekun jena,
"Ç' munt me ju bamun juve o shoq ? Lena pafsh Zonë, lena!

[1] Kanisk = Peshqesh që i dërgonte dhëndri nuses në javën e dasmës

“Në jeni të gjall’ e me shpirt, kapni pushk’ e martinë,
“Por në jeni dekun por si nâ, tmerohi me robërinë !!
Mbaron së foli dhe me vrap, sheh qark si vetëtime,
Tretet në tym dhe shpat e ti i bije duarsh thrime !!
Rënkojnë eshtrat pa pushim, oshtijnë si shigjetta,
Kërrusen varret në rëndim, mbetet e shkretë jeta !”
[1]Gjëmon Hapsira me kërcllim, dhe një rrufe nga retë,
Këputet prej Tomorit shpejt, e heth ky Zoti vetë,
Për të trokëllitur gjithësisht, të liq’ e të pështirë,
Dërgon mbi dhêt zjar pa pushim, skëter’ e shkretëtirë !
Mërzejnë[2] malet në buçim, nxjerrin pyjet një valë,
Tmerohet nata në pushim, dita s’ guxon të dalë !
T’u mirë mbeç, o moj Liri, t’u mirë mbeç aherë,
Por hapni syt’ o miqt’ e mij, se mos e hedhim nderë!
Ndritna, o Zot, o Perëndi, lëshona paqësinë,
Ndihna, të lutemi tani, të shohim pakë lirinë !
Mos Solomon, mos u shpejtoh, të preç t’im bir të mitur,
Lere ashtu më rrofsh, ô Zot, të tërë pa cenitur[3]!
E jù të qiejshime Perëndi, që majë Qiellit rrini,
Epni të Zotit që e ka, Mollën e Grindjes[4] lini !
Përpara ejani, o ju vllezrit t’im të dashur,
Shpëtimi ynë po na pret, jà tek na është qasur.

---

[1] Këtu vimë prapë ne e brendëshmja(Shënim i K. Floqi). Duket se vargjet që nga shënimi nr. 1 të faqes 103 e deri këtu janë të Kristo Floqit, mbassi vetë ay shkruan se ka dalë nga **κείμενον** = teksti (i Naim Frashërit), sepse nuk përshkruante dot “plagën e lënduar” të Skënderbeut

[2] Mërzej = Rri e pushoj në hije në kohën e vapës, kaloj vapën

[3] Sipas Biblës Mbreti Solomon njihej për drejtësinë e tij. Një ditë i paraqiten dy gra që pretendonin secila se ishte nëna e një fëmije. Solomoni do vendoste se kujt i përkiste fëmija.Ai i tha grave: “Unë me këtë shpatë po e ndaj fëmijën më dysh, gjysmën ta marrë njëra e gjysmën tjetra”. Nëna e rreme ra dakord me këtë vendim, kurse nëna e vërtetë e kundërshtoj, që fëmija e saj të mos vdiste por të rronte. Ahere Solomoni kuptoi se kush ishte nëna e vërtetë dhe ia dha fëmijën gruas që refuzoi ndarjen dysh të fëmijës.

[4] Greqisht:**Τό μήλον τής έριδος**(Shënim i K. Floqit)“Molla e sherrit”.

Jemi një komp i xgjuar fort, një komp fort i begatë,
Trim, mëndje-hollë me ç'do gjê, që s' fle as dit' as natë.
Kemi një gjuhë të shkëndijtë, t' ëmbël e të lirë,
Që munt të ngrehetë me funt, po q'e punuam mirë.
Përnjëherjesh, shpejt edhe sa kaq' e gjejmë mbarësinë,
Po q'u shtrënguam gjithë tok, e zumë mbrothësinë[1].
Ç' na duhet vall' o miqt' e mij, qëllimnë të goditim ?
Oh ! përveç se një bashkim, një dashuri të ritim !
Fè-mëmëdheje, kombësi, drejtësi, urtësi të mbarë,
Njê-mëndjesi, e miqësi, vëllazëri të pandarë;
Ç'do pun' e mirë me pëlqim, ç'do gjë që ka nevojë,
Për ne të bëhet pa pendim, këtè gjith-kush të dojë.
Vëllezër Shqipëtarë ju, jemi njê komp, një gjendje[2],
Kemi njê trup, një far e fis, një gjak, një shpirt, një mëndje,
Na lindi gjithë një Mëmëdhe, njê gjuh' e shenjtëruar,
Na dha njê gjak, një vetijë, zakone të uruar,
Na fali zëmrës një bekim, dhe mëndjesë fuqinë,
E për detyrë pret nga ne, të mprojmë Shqipërinë.
Jakëni, jakëni se tani, që ra përmbys i Ligu,
Njê vdekje vetëm pret, mynxyr-madhi Shtrigu !
Lini më njànë thash' e themet, ngjishni vëllazërinë,
Mos ashpërohi midis jush, mentohi për lirinë.
Mos vini rê sot besëtë[3], q'u lanë n'erësirë,
Besën e ka cili-do, në shpirt në vetëdijë !
Njê bes' e vlerë mbretëron, e njeh dhe Diturija,
Pra s' është gjê tjatrë këjo, përveç se Njerëzija !
Mos vini rê në fjalëtë, që flet armiku juaj,
Mos shihni fare spicatë, q' u kallin, ç' do i huaj;
Jù zënë sytë verbërisht, t'u ndalin, t'u përndajnë,
Jù paratfaqin besënë, jù lyejn' e jù lajnë;

[1] Mbrothësi = Mbarësi, përparim; lulëzim
[2] gjendje = gjindje, grumbull njerzish, njerzija
[3] besëtë (shumësi i fjalës "besë") = fetë

Që t'u humbasin robërisht, t' u vënë nënè dorë,
T'u urdhërojnë ndyrësisht, ô miqt' e mij të gjorë !!
O ! njihe vet-hen Shqipëtar, rëfe-je burrërinë,
Posht rrëzoje ç' do fatkeqësi, tregoje trimërinë !

Kur mbretëronte midis ne, padija m' erësirën,
Kur ishim të pellgosurë, kur s' njihnim dot të mirën;
Kur qemë të fundosurë, në babëzin' e ndyrë,
Kur na mahnitnin besëtë së shtêni në mynxyrë,
Lëftonim gjithë pa përtim, armiknë të shpëtonim,
Suleshim tërë pa qëllim, as flak' as tym s' shikonim,
Po van' e kapërcyenë, kohërat e para vanë,
Edhe më kot mundohen sot, për ne armiqtë tànë !
U xgjuanë Shqipëtarëtë, nukë flen' as që gënjehen,
S' vrapojnë mê për të huajt, nga udh' e mbarë s'kthehen,
Pra edhe besën gjithë-kush, e njeh në shpirt të tfaqur,
Se Njerëzia është sot, bes' e vërtet' e përhapur;
Kish' e vërtet e Zotit math, ësht' Hapsir' e pa-anë,
E shenjtëruar libr' e ti, ê[1] Gjithësia e tërë ç' janë.
Shkronjat e saj të bukura, lëmshet e Qiellit të lartë,
Ç' do na sheh syri që lëvrin, ç' do yll që ndrin i zjartë,
Dhe prift' i kishës që mëson, ê dituria vetë,
Që sjell së shpejti ç'do njeri, ne Zot' i vërtetë.
Ay që lusim nevej sot, Gjithësia ësht' e tërë,
Reth tij lëçin e rotullon, ç'do q'e kreu me sërë.
Po mbi këto fytyrës' së ti, njeriu i ka përngjarë,
Fron i sërmanjt'[2] i Zotit math, zemr' e këtij e larë !

Gjykonjës ka sicili-do Vetijen që së qeti,
E hirëson kur mirë bën, e hidhëron po fjejti
Detyrë kemi ç' do njeri, këtu kemi lerë,
Të lusim besën gjith-kush, t'i sjellim tërë nderë;

[1] ê = është (K. Floqi)
[2] Serm = argjend

Po të nderojmë si këtè, edhe ç' do besë tjetër,
Pa vënë re në është kjo, e rê a po e vjetër.
Ka shenjtërim edhe bekim, ç'do besë e veçantë,
Ësht' e nderuar në lavdi, e bukur e sërmanjtë;
Po që e pat vëllathi yt, q'u linttë prej një mëme,
Se jini ti edhe ay, të bijtë të s' at' ëme.

Njeriu i urtë që menton, që rron me diturinë,
Njeriu i mirë që duron, q'u rrit me njerëzinë
Është i xgjuar e thellon, e sheh të drejtën tfaqur,
Rri për së larti e gjykon, ç' do gjë me sy hapur;
Nuk' ësht' i marrë lëvdonjës, për besën i mahnitur,
Nuk pshihet[1], s'është sharlatan, s'gënjen, s'ësht' i mërzitur.
Bota dëshmon sot pa pushim, *Besën*' e Shqipëtarit,
Miqësin' e dashurin' e ti, që patnë dhe të parit.
Të mirat[2], urtësin' e ti, fenë si edhe kuximnë,
Jà njeh gjith-kush Shqipëtarit sot, se qysh e ka mentimnë;
Shpresë ka ç' do Mëmëdhetar, q' i ka Atdheut dëshirë,
E Zot' i math qoftë pas tij, e kreftë tej të lirë.
Shkronjat që gjuha po përdor, dhe drit' e Diturisë,
Përpara do na sjellin shpejt, përpara asaj Lirisë !
Vëllazëria midis ne, na sjell fatbardhësinë,
Shekull'i artë po na lint, me gjithë mbarësinë;
Pra na shikon cili-do, dhe ne të gjallë njëherë,
Të ngrehur siç u ngreh ç' do komp, me kombe të përzjerë.
Pastaj përhapen me nxitim, armiqtë të pështirë,
Mbetur në turp e në rrezik, duke na parë mirë,

[1] Pshihet = fshihet
[2] Greqisht: **τάς άρετάς** (K. Floqi)

Rrofsh gjuha jonë për mbi dhê! Rrofsh *Shqipëriz*' e ndjerë!
Rrofsh kombi ynë Shqipëtâr ! Vëllazëri e vlerë !
Poshtë tradhëtor, armik i lik ! përhapu erësirë !
Rrofsh, ô moj Bes' e ti dashuri ! Rrofsh, moj *Liri* plott hirë !!!

F U N T

Poemë e shkruar greqisht dhe është botuar së pari në Bukuresht më 1886, me titullin "O alithis pothos ton Skipetaron".

———

Mbi ardhjen e eshtrave të
NAIM FRASHËRIT
prej
KRISTO FLOQIT

(Vjershë e botuar në gazetën "Drita", 1937,
6 qershor, faqe 3)

Naim, mir' se n'ardhe n'Atdhé, q' e dëshrove,
Në tokën e shenjtë, te mëma Shqiprí,
Ku vjete ëndronje të shohsh një lirí,
Që gjall s'e shijove !

Bilbil i Pranverës me zëthin e naltë,
Që kaqe këndove pa çlodhj' e pushim
Burrninë Shqiptare, vllazri e bashkim
Sot çlodhu, goj-artë !

N'atë arqivolin, të vogël, të çmuar
Përmblidhen, ah, eshtrat e shkreta që lé,
Gjith' ëndrat q' ushqeve për Komp e Atdhé
Oh ! I pate përshkruar !

Poét krye-naltë, profet, që s' harrohesh
Me mendjen e thellë të gjithve na thé
Se toka Arbrore, i shenjti Atdhé
Një dit do lirohesh !

Qé, shkrepi dhe dita, fatbardh' e bekuar,
Ku flamur' i shenjtë u ngrit valoj,
Q' u tret por si vesa, u zhduk e kaloj
Robrí' e mallkuar !

Ah, fjalët e urta, të buta fisnike,
Të ëmbla, të kjarta, plot frym' e fuqí,
Tingllojnë akoma në zembër, në gji,
Si shëmblla jetike.

Si një manushaqe Shqiprin' e përshkrove,
Të zhytur në shpendra[1], në hithra, në vaj,
Po prap' i dhé shpresë, shpëtimin e saj,
Ja pé, ja diktove !

Robrin si dimbër të math e lëçitte,
Po brenda dëshprimit një dritë e pé,
Që shpirt' i Shqiptarit një dit' për Atdhé
Me zhurm' do buçitte !

Tani, Naim, zgjohu të shosh se ç' ka ngjarë,
Lirin' e dëshruar q' e prisnje me mall,
Të shohsh Skënderbenë si befas u ngjall !
Në ZOGUN e parë !

[1]shpendër =Bimë barishtore shumëvjeçare e ngjashme me shtogun, që rritet në djerrina dhe nëpër ledhe e gërmadha, me kërcell pak të degë-zuar, me gjethe të përbëra prej shumë fletëzash, me lule të bardha si tufë, të cilat bëjnë disa kokrriza të zeza që përdoren nganjëherë për të ngjyer.

AJY nuk t' harrovi, s' i dolle mentsh kurrë,
N' atë Merdivên-qoj[1] s' të la që të flesh,
Se vendin e çlodhjes këtu do t' a kesh,
Prandaj të ka prurë.

E di se s' të mbanin as gjemba, as fletë,
At' frymën e naltë ndaj neve t' a falsh,
Si ëngjëll prej Qielli lirinë t' a ngjallsh,
Lirin' e vërtetë !

"Atdhé" fjal' e fundit, "Atdhé" fjala jote,
Në orën e vdekjes "Atdhé" tjetër s' thé,
Me 'te e dhé shpirtin, që vetë s' e pé,
Q' e qave me lotë[2] !

Tani hij' e shenjtë n'Atdhé le të prehet,
Se malli, dëshirat të shkuan në vend,
Për ty u mallëngjye ç' do cep e ç' do kend
Sa s' munt të rëfehet !

Kujtimi të qoftë, Naim, i pavdekur,
Ç'do zembër Shqiptari për ty sot loton,
Dhe veprat e gjalla gjithmon' i kujton,
Ah ! .... sa jé përpjekur !

———

[1] Merdivên-qoj = emri i varrezave të Stambollit, ku u varros Naim Frashëri më 1900

[2] Në lidhje me këtë strofë shih edhe artikullin e Kristo Floqit "NAIM FRASHËRI" botuar më poshtë.

NAIM FRASHËRI

BABA I VJERSHËSIS SHQIPTARE
(Artikull i Kristo Floqit botuar në gazetën
"Bota e Re", 1940, 19 Tetor f.2-3)

Dyzet vjet plot u mbushnë qysh se n'a lá të shkretë ky njeri i naltë, njeriu i rallë, baba i poezis Shqiptare.

E njoha në Stamboll dy muaj para se të ndahej nga kjo jetë. Ishte muaji i Shtatorit i vitit 1900, kur vajta në Stamboll për të dhënë provime të dyta në Fakultetin e Drejtësis atjè në gjuhën turqishte dhe për të legalizuar dipllomën që kisha marrë në Athinë disa vjet më parë si doktor i Drejtësisë.

Nuk më duroheshe gjer sa e pashë me sy Naimin, ndonse kishim nji farë letër shkëmbimi të rallë me atë, ashtu si kishim edhe me Jan Vreton e me t'em gjysh Efthim Mitkon, me Spiro Dinen e me të tjerë patriotë të njohur.

Kur e pashë më tërhoqi vërejtjen më të madhe me shtatin e tij të hollë e të gjatë, me syt'e tij të mbëdhej e të zgjujtë, me fytyrën e tij të ëmbël e të butë e me mjekrën e tij të rallë e pak të thinjur, si fije ibrishimi[1].

U gëzua fort kur më njohu dhe atë ditë, pa dashur e teprova se ndejta përmbi dy orë pranë tij që m'u dukën si dy minuta. I kërkova ndjesë kur ika, por ay me buzën në gas e me një farë melankolije, që ja vura rè disa herë kur fliste, më përcolli me fjalë të ëmbla e m' u lut të vinja shpesh t'a shëkonja.

Gjatë bisedimit t'onë vërenja fjalët e tija të matura e modeste, të kthellta e plot kuptim. Sikurse duket në vjershat e tija Naimi ashtu ishte edhe në të folurit. Lirizmi i tij, gojtarija, shprehja e kjartë dalloheshin në ç'do fjalim. I kënduar mjaft, i gjërë në mendimet e tij, i zoti i fjalës edhè tepër i thjeshtë në sjelljet e tija e s'e hiqnja aspak syrin nga fytyra e tija, fytyrë e një njeriut fisnik, fytyrë e ëmbël e tërheqëse.

Një herë u ndodha kur po shkruante nuk di cilën vjershë. Më dha dorën, më tregoj fronin ku të rri edhè nuk e lëshoj dorë-

[1] ibërshim = mëndafsh i dredhur

shkrimin e vjershës. E shëkonja dikur që ungjeshe e çkëputte ndonjë fije leshi prej ndonjë shtrese të shtruar, e çepkatte me një farë durimi, mendoheshe dhe fill kapte lapcën e shkruante, shkruante, shkruante. Dikur merrte ndo një a dy libra, a më tepër e kështilloheshe me ato e prap shkruante, pa vënë re se cilin, ose cilët kishte rrotull.

Një ditë i thashë për mentsh gjithë "Bagëti e Bujqësinë" të cilën e mbanja mënt më gojë[1],duke i theksuar pjesët që më kishin bërë më të madhen përshtypje. Gjithashtu i recitova po atë ditë edhe vjershën e tij të pavdekur "**Dëshira e vërtetë e Shqiptarëvet**" vjershë kjo, si një shkëndi e zjarrtë ndezi zembrat e Shqiptarëve, vjershë që flakroj e ngjalli ndjenjat e atdhetarëve. Naimi më dëgjonte me durim e me vërejtje dhe buzëqeshte.

Një herë tjetër bisedonim mbi "Qerbelanë", epopënë e pavdekur të Bektashinjve. Rastësisht ju luta të më shpjegonte **moton** e Bektashizmit. Ç'të të thom, më thotë, hith sytë në Qiell, shih rrotull natyrën, gjithësinë dhe mbyll sytë e dëgjo vetëdijen t'ënde, biri im, dhe ajo do të t'thotë ç'do me thënë "Bektashizmë"; është gjithësija, njerëzija, fjala e urtë e e mirë, dashuria te i afërmi, zembër-gjërësija, dashurija te Perendija, te Atdheu, si të t'a thom, djali im, ja ky është Bektashizmi. Dikur ngriti pak jastëkun e tij, kur ish i sëmurë dhe më tregoj edhè Kurânin edhè Ungjillin, që i mbante nënë krye. Kjo mjafton të kemi një idhè se ç'farë njeriu ishte Naimi për njerëzinë pa dallim fêje.

Por një ditë tjetër, ah ajo ditë, ishte mjaft sëmurë, i zbetë dhe i prishur në fytyrë. Kishte, mbanj mënt kancer në grykë, i cili i shkaktoj edhè vdekjen. Ishim mbledhur afër tij disa Shqiptarë. Zû të flasë ngadalë dhe mendjen e kish në vënt. Midis të tjerave n'a la edhè disa porosi patriotike, si të punojmë e si të mos i shmangemi idealit kombëtar, se Naimi ishte i bindur se Shqipëria do të fitonte një ditë lirinë, prandaj edhè nè duhej të punonim e të mos kurseheshim asnjë rreziku dhe, si metafizik i fortë që ishte, i dha funt fjalimit të tij me fjalët e pa-harruara : "Unë do vdes, po me të vërtetë nuk do vdes, se do jem gjithnjë me ju, e në

[1] Më gojë = përmendsh

mos pata fatin t'a ngjeronj Shqipërin e dashur për së gjalli, do vete të çlodhem atjè, në Shqipërin e lirë, atjè ku:

Nata është tjetër natë edhè dita tjetër ditë,

ku:

Në pyjet e gjelbëruar atjè rrijnë Perënditë"

dhe përfundoj:

Ata q' ishim nève jemi
Jemi nè ata që qemë
Gjetkë s' kemi ku të vemë !

Pas pêsë ditsh Naimi e linte këtë Botë të shkretë,ku ngjeroj[1] aqë hidhërime e mjerime, dhe ku ju doq zembra në vënt të huaj prej një nostalgjije të pa-përshkruarshme për Atdhen'e dashur, për të cilin s'i kishte shpirti **derman!**

Me pikëllim të math e me sy të lotuara e përcuallm në banesën e fundit, në Merdivenqoj të Kadiqojt ! Ajo ditë, ditë trishtimi e vajtimi për Shqipërinë, s'n'a del mentsh kurrë, edhè aqë më tepêr kur kujtojmë se Naimi vdiq tepër i ri, në moshën 53 vjeç, në vlugun e veprimit, ku munt të nxirte shumë e shumë vepra të tjera të çmuarshme.

Kur mendonte vdekjen e kur kujtonte se do varrosej në vënt të huaj, pa dashur i vinin në gojë fjalët e vjershëtorit persjan, që linte porosi para se të vdesë në vënt të huaj :

Der gurbèt, èggjer mèrqu rezèd bedeni men,
Ajá qi qynèt kabri men duzèt qefenì men,
Tabutem sui belènd bèqu rá-zid
Shájet bad u vatán birezèt der bedeni men.

E përkthejmë shqip:

Në mërgim, në qoftë se më gjen vdekja
O ju miq, kur të më çoni në varrin t' em
M' a ngrehni lart qivurin e më hapni qefinin,
Ndofta vjen era e Atdheut e më freskon krahrorin.

[1] ngjeroi = shijoi, provoi

Ashtu dëshëronte për vehten e tij dhe i ngrati Naim beu. U zgjata pak, por s' mund të përshkonja në heshtje dyzet-vjetorin e vdekjes së këtij njeriu të vyer pa bërë fjalë mbi jetën e tija.

* * *

Tani lè të shohim cili ishte Naimi si poet. Po, përpara se të hynj në këtë meritë dua të flas pak mbi poezinë e artin e tij, që kështu të mundim t'a çquajmë Naimin në lartësin e tij.

Të gjithë e dijmë se poezija s'është tjetër përveç se "mjeshtrija të shkruajm në vargje të matur e të rimuar", si thosh edhe frëngu **Quicherat: "Poesi c'est l' art d' ècrire en vers, en usant le rythme et la rime".** Po**,** si kur t'i pyeç vjershëtorët e vërtetë, nuk do mundin të të japin asnjë definicjon të plotë. **Lamartini** p.sh. thosh se: **C' est l' incarnation de ce que l'homme a de plus intime dans le ceur et de plus divine dans la pensèe de ce que la nature a de plus magnifique dans les images et de plus mèlo dieux, dans les sens. Sully Prudhome**, një tjetër poet freng shprehej kështu: **Poesie c'est le le rêve par le quel l' homme aspire á une vie supèrieure.**

Me gjithë që poezinë e dallon rythmi dhe rima,po janë edhè shumë poetë që përdorin vargun e lirë, sikurse **Racina** e **Lafontaini,** sepsè shpesh herë rima është një tirani për poetin, si thosh edhè **Hugoj**, i cili e quante rimën, **la reine esclave**. Po edhè Shkolla Parnasiake,si edhè Symbolistët ishin kundra rimës, andaj edhè nuk e përdornin. Ata preferonin të shkruanin poezi në prozë, se sa në rimë.Këtë sistemë ndiqnin edhè **Chateaubriand, Bossuet, Rousseau,** e të tjerë, dhe thojshin se përshtypjen e ëmbël e bën vetëm melodija e harmonija e zërave me të cilat duam të flasim dhe të cilat formojnë poezinë e vërtetë: **Figurat retorike, krahasimi**, **metafora** dhe **symboli.**

Bolleau, i cili i kish hyrë shumë thellë poezisë, në veprën e tij të pavdekur **L'art poetique** që n'a la trashëgim, e që formon një Kodë letrar të poezisë, thotë se në poezi duhet të dallojmë pikërisht tri cilësi:**thjeshtësinë**(la simplicitè),**kjartësinë**,(la claritè) dhe **llojërinë** (la varietè).

Që të kritikojmë Naimin duhet pikë së pari të marrim para syve gjuhën t'onë qysh ishte n'atë kohë, d.m.th. e pa-zhvilluar edhè e pazdrukthuar, kurse sot trajta e gjuhës shqipe ndryshon

shumë, se është më e rregulluar edhè mê e pasuruar. Naimi, duke shkruar ndër ato kohë, prapë e ka rojtur aksentin, rythmën e rimën në një mënyrë të lakmuarshme; ka mbajtur thjeshtësinë, kjartësinë dhe llojërinë sa ka qënë e mundur; edhè në qoftë se ka zgjatur fjalët, si për shëmbëll "bëhetë","nisetë", etj, etj. në vënt "bëhet","niset" edhè në qoftë se ja ka dashur puna të rimojnjë duke theksuar si pas rrokjeve të shtuara, kjo s'munt t'i ngarkohet si gabim Naimit,sikurse s'munt t'i ngarkohen si gabim gjithë gabimet shtypore që kanë interkaluar në çpalljet e pasarthme të veprave të tija, sikur se shohim në "**Lulet e verës**", në "**Bagëti e Bujqësinë**", e në disa vepra të tjera të tija që janë shtypur për të katërtën, a për të pêstën herë.

Kush i ka përshkuar thellë edhè mirë veprat e Naimit do t'a ketë kuptuar se ky me të vërtetë ishte një poet i lindur, një natyrë poetike, poet epik e lirik nga më të çquarit dhe ndofta mê i miri e mê i larti nga gjithë poetët shqiptarë. Po të marrim ndër sy se Naimi i dha trajtën e duhur poezisë shqiptare dhe krijoj poezin e rè shqipe në nji kohë që gjithë fragmentat e tjera poetike shqiptare dhe gjithë folklorët dhe këngët e tjera poetike shqiptare dhe gjithë folklorët dhe këngët e tjera popullore nuk formonin një vepër synthetike të dêjtë për poezinë shqiptare, do përfundojmë se Naimi ka qenë pijoneri i vjershësis s'onë, **baba i vërtetë** i poezisë shqiptare.

Dikur ishte kritikuar Naimi prej disa shkrimtarëve gegë dhe dikur u ndodhë edhè asijsh që s'e pranonin Naimin bilè as si poet, e mjerisht u ndodhë edhè toskë akoma që s'i a njihnin këtë vleftë Naimit. Këtyre u jam përgjigjur sot e nja gjashtë vjet me një faqe të tërë të gazetës "Drita", që e drejtonte Z. Zoi Xoxa. Atij artikullit t'em nuk iu përgjeq njeri, ndonse provokonja cilindo që do të dëshironte t'a hapnim mirë këtë bisedë dhe t'a shqyrtonim mê gjërë çështjen që të delte e drejta sheshit, gjë për të cilën jam gati edhè sot, mbassi ky ka qenë edhè është konviksjoni[1] i jem për Naimin.

[1] konviksjoni = bindja

Kujtojnë disa nga poetët t'onë se e pasurojnë poezinë kombëtare e i bëjnë një shërbim popullit, duke na servirur vargje të ngarkuar me fraza të ditëshme, me neologjizma arbitrare e me ideologji të pa-gdhendura, qinse çfaqin ndjenja të larta, që edhè ata s'i kuptojnë, por Naimi është lark nga këto, se ay është jo vetëm i thjeshtë, po edhè mjaft i kthjellët e i qartë në shprehjet e tija, dhe në vënt t'a lodhë e t'a mërzitë lexonjësin, përkundrazi e enthusias dhe e tërheq në fantazin'e tija. Naimi nuk shtrembron po ndreq, nuk bastardhon por shpjegon në mënyrën më t'imtë.

Naimin si poet epik na e tregojnë dy vepra të gjalla të tija **Histori e Skënderbeut,** dhe **Qerbelêja**, në të cilat me aqë hollësi, saktësi dhe harmoni për-shkruan jetën e Skënderbeut dhe vuejtjet e mjerimet e Bektashinjvet në fushën e Qerbelâsë.

Por Naimi u dallua mê fort si poet lirik.

Si e dijmë, poezija lirike shpreh jetën e brëndëshme. Ajo pikturon shpirtin e njeriut, shpirtin e një populli, ku poeti bëhet interpret i ndjenjave të tyre, ose i ndjenjave të personave të tjerë. Objektet kryesore të lirizmit janë: shprehjet fetare, ndjenjat patriotike, çqetësimet metafizike, aspiratat morale, ndjenjat familjare, gëzimet e vuajtjet e dashurisë, përshtypjet e natyrës, gjithë trishtimet, hidhërimet, urrejtjet dhe shpresat njerëzore, me fjalë të tjera ndjesinat e zembrës së njeriut.

Naimi, në poezinë lirike kishte një talent të veçantë, dyke pasur qysh në vogëli një adhurim të math për gjuhën persjane për ëmbëlsirën e saj; këtë gjuhë e kish studjuar shumë hollë dhe e dinte shumë mirë, ashtu si dinte edhe gjuhën arabe, po edhe gjuhën klasike greke, dyke pasur mbaruar gjimnazin e dëgjuar grek të Zosimêjve në Janinë. Kështu Naimi kish një kulturë të gjërë mjaft në këto gjuhë si edhè në gjuhën frënge akoma, dhe s' kish lënë poet e prozator pa i kënduar në këto gjuhë, prandaj ishte në gjëndje mê tepër se ç'do tjetër të shkruante e sidomos të vjershonte në gjuhën shqipe. Sikurse në ep[1] ishte i inspiruar prej Homerit, Virgjilit e Firdefsiut ashtu edhè në lirizmë ishte inspiruar prej poetëve grekë klasikë modernë, prej **Pindarit, Anakreo-**

[1] ep = poezi epike (shif artikullin "Një vështrim mbi poezinë")

ntit, Sapfosë, Theokritit, Vallaoritit, Sutsos prej llatinit **Horatius** si dhe prej **Virgjilit**, nga poezija e tij bukolike, ashtu edhè prej poetëve persjanë **Rumi**, **Niazi Sadi, Omer Kajam**, etj. etj.

Në poezinë lirike Naimi dallohet mjaft me veprat e tija të bukura"**Lulet e verës**","**Parajsa dhe fjala fluturake**","**Fjalët e qiririt**","**Vjersha**" dhe sidomos me vjershën bujk-blektorare të pavdekur: "**Bagëti e Bujqësija**", që është zenithi i poezisë lirike pastorale, ku çquhet atdhetarizmi i tij i pashe-mbëllt. Mjafton të parashtrojmë disa vargje të kësaj vepre, që të kemi një ku-ptim të lartër se qysh e krahason Naimi dashurin' e tij për atdhenë:

Kur dëgjon zëthin e s' ëmës qysh e lè qengji kopenë,
Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,
Edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë
E ta trembin, ay s' kthehet, po shkon në mes si shigjetë,
Ashtu edhe zembra ime, më lè këtu tek jam, mua,
Vjen me vrap e me dëshirë aty ndër viset e tua,
Tek mburron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,
Tek mbin lulja me gas shumë e me bukuri me erë,
Ku i fryn bariu xhurâsë, tek kullosin bagëtija,
Ku mërzen cjapi me zile, atjè i kam mënt e mija....
. . . . . .
Tek këndon thëllëza me gas edhè zogu me dëshirë,
Dhe qyqeja dyke qeshur, bilbili me ëmbëlsirë,
Tek hapetë trëndafili, atjè m' a ka ënda të jem,
Bashkë me shpesht edhe unë t' i ja thëres këngës e t' ja them,
Të shoh kedhërit e shqerat, desht, cjeptë, dhëntë, dhitë,
Dhe Qjellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me dritë,

dhe më poshtë kur bën fjalë për malet e fushat e Shqipërisë, thotë:

Zembrën e varfërë t' ime aty ndër ju e kam mbluar
Tek mburron nga gjithi[1] juaj uj' i ftohtë i kulluar,
Jam lark jush i dëshëruar edh s' e duronj dot mallë,
Por s'e di, si dua unë, do t' ju shoh ndo një herë vallë ?

[1] Gjithi = gji, gjiri

Kush e ka paragonuar[1] në këtë mënyrë dashurinë e nostalgjinë e Atdheut nga poetët Shqiptarë ? Askush.

Arti lirik i Naimit çquhet edhe nga disa vjersha të tjera, sidomos ato esopiket, ku mund t'a krahasojme me **La Fontai-ne**,si p.sh. **Korbi e dhelpra, Dhelpra e dragoj, Breshka dhe shkaba, Qeni dhe hija e tij**, etj, etj. Po nuk kanë më pak lirizmë e bukuri edhè disa vjersha të tija, që janë botuar në "**Dituritë**" e në "**Mësimet**", si p.sh. zënja midis "**Verës edhè Dimbrit**", etj., etj.

Por Naimi ishte edhè profet për ringjalljen e Shqipërisë, ashtu si ishte edhè parabredhësi i sajë. Këtë e shohim mjaft të kjartë në vjershën e tij të lartë e plot shpirt që e shkroj aqë bukur greqisht: O alithis pothos ton Sqipetaron (Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve përkthyer prej meje Shqip në vjershë) ku, duke kujtuar veprat e mbëdha të fatosit t'onë Kombëtar Skënderbeut thotë :

Kur do të vinjë ajo dit' e shejtë e bekuar
Që të ringjallet kjo Shqipëri e lirë, e gëzuar,
Të shohim nè Statuin t' ënt të ngrehur, të lartsuar,
Më gjunjë të të lusim ty, o burr' i shenjtëruar
Por fli, fatos, se kjo Shqipri një dit do të lirohet
Dhe embri yt, o Skënderbè do rroj' e do nderohet,
Vdiqe, n' a lè në një mjerim, po prap' eshtrat e tua
Do prehen qetas n' atë varr, o burrë, o dragua !

Që pra, kjo ëndr'e Naimit u realizua edhè statua madhështore u pregatit e u ekspozua në Firencë dhe për së shpejti do ngrihet madhështore në kthizën e Tiranës, ashtu si ay i bërë nga Odhisè Paskali që ngrihet madhështor në Kosovë.

Profetija tjetër e Naimit çfaqet në vjershën e tij të bukur e kuptim-plotë: **Shkëndij'e Djellit,manushaqeza** ku mbassi e ngushullon Shqipërinë të krahasuar me manushqen që "Shpendra, hithra, ferra, përsipër i kanë rënë dhe dritën ja kanë zënë me fletë shumë të gjëra, etj., etj." i jep nji kurajo të madhe:

[1] paragonuar = krahasuar

Po mos u trëmp, bëhu trime edhe kij durim e shpresë
Edhe silli Zotit besë edhe kësaj fjalësë s' ime,
Se dheu ishte dikur i shkretë, gjë të gjallë nuku kishte
Dhe fare i rrijepur ishte, pa fill bar e pa një fletë;
Atjè gjë s' përpëriste, po brenda në atë brumë,
Ishte një shpirt i math shumë, që priti kohë të buçiste, etj.

Dhe më së fundi çfaqet si një pejgamber qjellor:

Tani më kanë dërguar
Nga fron' i lart' i Perëndisë
Si Engjellin e Marisë,
Me frymë të shentëruar,
Më s' më mban as gjëmp, as fletë,
Se kam ardhur me shum mall,
Në gjithin t' ënt dua të ngjall
Zotn' e Math e të vërtetë !

Cili shkrimtar Shqiptar profetizoj në këtë mënyrë ? Cili poet Shqiptar ja tha kombit gjithë këto fjalë të nalta e t'arta e i dha një kurajo e një shpresë të këtillë ? Askush, përveç Naimit.

Prandaj Naimi do mbetet i pa-vdekur si vjershëtor Shqiptar, se me të vërtet ky ka qenë **pijoneri** e **baba** i poezisë Shqiptare.

DR.KRISTO FLOQI

KUSHTIM

mikut të dashtun e vjershtorit komtar
në zâ Atë Gjergj Fishtës

(Botuar në revistën "Zani i Shna Ndout"
viti 1919, Nr. 2 f. 36-39,
si dhe në librin e botuar nga Êtnit françeskan më 1941
kushtuar Ât Gjergj Fishtës në përvjetorin
e parë të vdekjes së tij)

Quod si me Lyricis vatibus inseres
Sublimi feriam sidera vertice.[1]
H o r a t i u s. – Ode I.

Kthillet Qiella e me harmën vrulûe[2] Appoloni[3]
Vrik pershkon t' agimit mjergullin e lehtë,
Dielli shkelzen me rezat të flakta, jetike
E që, po lên e kândshme nji ditë Prilli.
Midis qetsies, që shekuj tash mbretnote
Të jetës s' mnershme, të gjumit t' randë të dekës,
Nji zâ i kthellët sa edh' i kjartë pritèj
Se do shungllote, pushimin m' e tundûe.
Kâ shkrefë nj' atëhere nji rez' e po si sgjettë[4]
Vrap nget këndej kah megjet[5] arbënore,
E si krongjillat[6], aklli i Pranverës shduket
Tui lâ mbi qiell e kaltërt të Shqypnis s' ngratë,
Me shndritë nji hyll i zjartë qi vettote.

---

[1] Po të numurohesha unë si poet Lirik do të ndjehesha sikur kam prekur qiellin me dorë (përkthyer në shqip nga Prof. Filip Fishta e Prof. Henrik Lacaj në fjalorin Latinisht-Shqip hartuar prej tyre bashkarisht)

[2] harma vruluese = arma sulmuese

[3] Apolloni = Perëndia e bukurisë, e poesisë e të arteve të bukura

[4] sgjettë = shigjetë

[5] megje = kufij

[6] krongjill = Hell akulli.

Befas nji shpirt t' rii, nji frym' merr remeti[1]
Q' i ngathët në plogsi ish i denûe
E pîjtas shmangun pranë nji cepit rrijte[2]
Prej kush din ç' farë mekatesh katragjyshe.
Fishkllèn nër rrembat nji gjak i nxehtë,
Vlon nji gjallnì me nji her' e përftyrohet,
I âmbli flad vallzon me nji gëzim e hîrë
E çel gjithkah nji tjetër jetë, nji naturë.
O r f e u[3] kur kishte hupë të bukrën Euridihe[4]
E po e lypte nat' e ditt në Ferr pa shpnesë
Me lyren e tij të andshme, harmonike
Q e v e r i n sbuti. D a n t e, të dashtnën Beatriçe
Pa prajë e kerkon e mbas aqe potera
Kâ mujtë te e mramja m' e gjetë e m' u gzue.
Në zâ e bûjë ka kenë M i t e l e n a
Sa do qi njifej prej Elinve barbare,
Se pati fat me nxjerë aqe vjershtorë,
Sa edhè sot, kujtoj, i ndihet zani
Lyrës, barbare, B a r b e t o s L e s b i a n e.
Thonë se A r i o n i, aj Lesbjân i vjetër
Dikuër prej Perandorit, avânit[5] të Korinthës
Në Siqelî qe çue me një çmim muziket,
E se, t' anijes detarët e lakmushëm
Qi dojshin vleftet m' zhdeshë kangtarin
Në det t'a qesin nji-ment u mundûne;
Të ndiimen bolbën me zâ qiellore

[1] rrëmet = turmë njerzish, gjindje
[2] Ât Gjergj Fishta ishte fizikisht i bëshëm (i shëndoshë)
[3] Orfeu është një muzikant legjendar, poet e profet në fenë dhe mitet e lashta greke. Luante me veglën muzikore lyrën. (Nga Wikipedia)
[4] Euridika = grua e re që Orfeu e dashuronte. Ajo, duke mbledhur lule, shkeli gjarprin helmues e vdiq. Nga dashuria Orfeu zbriti në botën nën-toksore dhe i kërkoi Euridikën Hadit, zotit të botës nëntoksore
[5] avân = despot, tyran

Hutoj dhe peshkët, sa me vrap ja mrrini
E e shelbeu nji alamet – delfini,
Që t' gjall' e nxjer mbi skâjë t' T e n a r i t !
Kshtû statû' e bardhë prej mermerit
Shkëlzote m' Arionin, hippun mbi delfinin
Pêr mbi T e n â r e mal' e H e l i k o n i t.
T e r p a n d r i[1], gjith' ashtu Lesbjan prej fisit
Lâ nji kujtim të math e t' amshuem
Se ish i zoti me kendû me ândje
Kangët e veta e vjershat e H o m e r i t,
Sa dhe të Spartës t' egrit luftëtarë
Nji adhurim për tê të gjith' e ndjejshin.
Kush ka harûe jon'[2] e tingëllimit
Të A e n e a d ë s aq të kandëshm të V i r g i l i t
Të odeve shlleuore[3] të H o r a t i t,
L a u r ë n e përmallshëm të P e t r a r c h i t
E të T o r q u a t t o s[4] J e r u s a l e m i n ?
Mburret sot plaknesha A l b i o n a,
Për B y r o n e M i l t o n e S h a k e s p e a r i n
Mburren Teutonët per nji G o e t' e S c h i l l e r
Edhe Gallatët për C o r n e i l l e e R a c i n i n,
Për nji C e r v a n t e s Spanja Ibirike
E Portogali me C a m o ë n s për L u s i a d a t,
Por se kujtonj nj' ashtû dhe Arbenia
Ka psè të mburret me ty, o At-Fishtë,
Qi me L a h u t ë n e M a l c i i s e aq të tjera
Vjersha lyrike e gjith farë zânit,

---

[1] **Τέρπανδρος** = Ishte baba i muzikës Greke dhe nëpërmjet saj i poezisë lirike
[2] jon = shkurtim poetik i fjalës "jehonë"
[3] shllim = Ide, përfytyrim
[4] Torquatto Tasso = poet, shkrimtar, filozof italian. Vepra e tij më e rëndësishme është"Jeruzalemi i liruar",e njohur dhe e përkthyer në shumë gjuhë të botës (1581) ku i thuren këngë luftave midis kristianëve e musulmanëve gjatë kryqëzatës së parë me marrjen e Jerusalemit nga ana e kristianëve (Wikipedia)

Atdheut nji shpirt të rii i fal' e dritë.
Me lyrën e X a n o n i t e harpen e N a i m i t
Me të K a m a r d ë s luttën e lahutën t' ande
Kumoj dhe nj' hera Zana Arbnore.
– Qi sllig' e namun vllaget[1] ja kish shterrë –
E deri lamsh' i Dheut t' kthehet rrotull boshtit,
E të vettojnë hŷllet nen të Qiellës kûbë
Ka me gumxhitë e kjartë, madhshtore,
Mest shekujve, saa dit' e Ruzullimit.
A thue kishte m' u gjetë nji M a e c e n ë[2],
Ose një tjetër P e r i k l è s, si i G r e q i s ë,
A nji L o u i s i F r a n c ë s i dhet-e katërt[3]
Qi veprës shejtë frymore e jetike
Zot me i dalë e m' e perkrahë si duhet ?
Hè ! po shpresoj dhe mbaj uzdajë Zotit
Se kâ me shkrepë dikur e bardha ditë
Kû luftëtarët e lodhët të Kastriotit
Prehje do të gjejin nën çinar' e dijës;
Ahere oh, ahere, âsht e dijtun
Se kena m' ja mrrijtë së bukres B a b y l o n ë
E fâri i dijës gjithkahë do shndritë
Mbi lulëzim të blert e veshillûer.
Por si Horati kur percjell Virgilin,
Nj' atehera kur ajy u nis me shkûe
Për në qytet të famshëm të P a l l a d ë s
M' e plottsû nj' atê q' i kish mungûe
E me tiktim të zembrës e me frikë

[1] vlag = njomësi
[2] Gaio Clinio Mecenate = ishte një mbrojtës i rëndësishëm i një gjenerate të re poetësh madhorë midis të cilëve Orazio, Vario Rufo e Virgili sepse ishte kështilltar me influencë dhe aleat i Imperatorit August. Po këtë rol protektor ka luajtur Perikliu i Greqisë e Luigji XIV i Francës (Wikipedia).
[3] Luigji i 14-të

Hŷjit i falet Perndive save
Shndosh t' a çotte lundra përtej bregut
E prap shndosh n' atê Romë t' ja kthette,
Nj' ashtû dhe vet' i lutem Perendisë
Në të vështirën lundrën e vjershimit
N' anijen prirse të fantasiis hyjnore
Durrim të math, fuqî e një dëshirë
E gjith ç' ka të lypet ty t' i faltë !
Ti mos u loth, mos u mërzit, hej burrë
Mos pshaj psè s' çmohet pun' e rândë,
Se kâ m' i ardhë gjith se cillës dita
E gjithsecilla çmimin kâ m' e gjetë,
Mundohet bredhsi qi nget n' pik të vrapit,
Prej M a r a t h o n ë s rrugën tui fillûe
E per me ardhë n' S t a d i u m t' Athinës
E din sa fort' e fshtir' â rrug' e gjattë,
Por se, tui derdhë djersët rkâe, lumë,
Nji gzim të madh në zemêr ndijn i ngrati,
Trupin nji ethe ja përshkon si têja
Deri t' fitojë kunorën Olymbike.
Nji kshtû dhe nè për fije do t' i vemë
Veprat dijetare, vjershën, ose prozën
Qetas fillojmë lettrsiën t' onë
Fort tui durûe, por tui shkûe përpara.
Qè, për kujtim të vlefshëm, t' ditës argtore
Të meshtarîs t' ande n j i – z e t e p ê s e v j e t s h e
T' a kushtoj këtë vjershë.
Deh, sa dishirojsha
Qi n' at vallen t' uej, t' andëshm' e lyrike
T' mujsha m' u afritë, vallen me këcye,
Fyll nji gêm ullinit kish me më vleftë aqe
Sa gjith pasuniët, gjithë farë dhuratet.

Dr. Kristo Floqi

Shënim i redaksisë së revistës "Zani i Shna Ndout": Si mundet me u pá prej diftojsit, per kto pêsë fletët e mrame na patem gatue landë tjera per të perkohshmen t'onë, por me gzim të madh t'onin para se kto fletë të hijshin në makinë, u duk në drejtim t'onë i vlerti e i permenduni dijetar Dr. Kristo Floqi, i cilli, shty prej bindjet ndaj vjershtarit t'onë A. Gjergj Fishten, tuej pasë marrë vesht se ky do të kremtote me 25 Fruer të njizet e pestën vjetë të meshtaris, kishte pasë gatue nji vjerrshë e na lutej me i bâ vend në të perkohshmen t'onë. Të kënaqun kah zêmra, na ket vend ja lshueme ktij shkrimtari ta palodhshem, tuej lânë landët e tjera per nji tjeter numer e ket pûnë e bâme së parit per nderim e çmim me të cillin na i percjellim veprimin e Dr. Kristo Floqit e së dytit pse të perkohshmes s'onë ishte tuej i ra rasa, per mâ të parën herë, me hijeshue fletët e veta me shkrime të nji pinjuellit të ndritshëm të Toskënisë, tuej u bashkue kshtû dy degët e mdhá të nji lisit të vetëm të Shqypnis, per me madhnue veprimin e njati qi nder shkrime të veta, si edhe në zêmer t'vet nuk diejt me njoftë kurrnji ndyshim ndermjet të Toskvet e të Gegvet, por i desht vllaznisht, si Shqyptarë.

MIKUT TË VLERTË D. NDRÉ MJEDES

MBI SHTATËDHETË VJETSHORIN E TIJ
(Poezi e Kristo Floqit kushtuar Dom Ndré Mjedës,
botuar në revistën "LEKA" Nr.12,viti 1936 faqe, 532)

Pegasit krenuer,si Belerefondi[1],
I hypun përsipri, kalorës kreshnik,
Himêrën[2] e shkele, të mnershmin anmik,
Që mbytte Shqipninë;

[1] Bellerofonte ishte një hero i mitologjisë Greke, që vrau kimerën. Esiodi dhe autorë të tjerë tragjikë e përfytyrojnë atë sikur të ishte i ulur mbi kalin e Pegasos.
[2] chimera =monstër legjendare sipas mitologjisë greke, romane e etruske me kokën e një luani, kurse pjesët e tjera të trupit janë të kafshëve të ndryshme. Është e kjartë se K.Floqi me "Himera" quan Turqinë

Fryu era e lehtë, u çel horizondi,
Atdheu mori frymë,filloj jet' e ré,
Shkreptiu Djell' i flaktë, shpërndau mjergull, ré,
E ngjalle Djelmninë !

Prej thundrash t' Pegasit dy ambuj[1] mburruen
Mbi trûllin e shêjtë, mbi mal' Elikôn[2],
I Zânave tingulli hynuer kumbon,
Kur ti ju avrite,

Rreth tejet u mblodhën, me gzim të shtërnguen,
Dhe ti ju dhé dorën, ju bane një shok,
Prej sijsh nuk u shmange, gjithmon' ishit tok,
M' ato bash' u rrite.

Me hapa vigani Atdheut i shërbeve,
Talenti jot ndezi të flakten kumì[3],
Punove, vrapove me afsh' e zjarmì
Në lâmën vjerrshtare;

Pjoner i palodhun kurrgjâ nuk kurseve,
Djelmnìs i tregove detyrën e saj,
Ashtu, pra, perpjetë flamûrin e mbaj
Në fushën letrare !

S' ka gjâ se po plakesh, se vjetat randojnë
Mbi shpînën djaloshe, qi moti orvat,
Ti ecën si flutur, cok si nji kal' ât
Qi shkel curra[4] e gurë,

[1] ambull = pus, pellg uji
[2] mali Elikon ndodhet në Greqi
[3] kumì = furrë për të pjekur tulla ose tjegulla.
[4] curr = shkëmb i lartë me anë të thepisura

Prandaj një mirnjoftje të thellë të çojnë,
Djelmnija e gjallë, gjith ky brez' i rì,
Të kqyrin si shëmbull për Nanën Shqiprì,
NDRÉ MJEDA s' vdes kurrë !

KRISTO FLOQI

———

DY LOTTË MBI VARRIN E KOSTANTIN KRISTOFORIDHIT

(Kjo poezi e Kristo Floqit është botuar
në vitin 1923 tek "VALËT E VJOSËS"
me botues Nazif O.Mamaqi)

Në një kohë të vështirë,
Nënë xgjedhën tyranike,
Kur Atdheu tepër i mpirë,
Ish në breng' e në rrezike.
Shkrepi befas e shëndriti,
Hyll' i dritës i agimit,
Dhe Atdheut të mjer' i zbriti
Dritën e qytetërimit.
Ç' ish ajy luân luâni,
Që u derth prej Elbasani,
Që aq fort i jehoj zâni,
E s' ju unj as një tirani.
Ç' ish ajy i rrallë burrë
Që rrezikut s' ju shmang kurrë,
Që për kombin u bë urë,
Me shërbimet q' i pat prurë ?
Elbasanas ty të lumtë,
Se punove gjithë jetën
Nami kurrë mos të humptë,
Nxore në shesh të vërtetën,

Me atë vokabullarin,
Themelove gjuhën t' onë,
Ti e ndrite Shqipëtarin,
Mos t' harrofshin për gjithmonë.
Vepra jote nuk harrohet,
Ndrit për hera si shkëndija,
Bres pas brezi do kujtohet,
Në parajsën e vërtetë,
Me dëshmorët atdhetarë
Zot' i math ju prijtë vetë,
Ju, o burra Shqipëtarë

Kristo Floqi

MBI NEVOJËN E NJË FJALORI SHQIP
(Artikull i Kristo Floqit, botuar në gazetën "Besa" dt. 2 Tetor 1931)

Z. Drejtor
i fletores B E S A,

Në fletoren t'uaj të ndershme me datë 24 Shtatorit, në faqen e II, nënë titullin TË NA DËGJONTE MINISTRI, pashë një artikull mjaft interesant, i cili më intereson edhe mua, si gjithë Shqiptarët intelektualë e atdhedashës.

Aty bëhet fjalë për fjalorin shqip të të ndyerit Kostantin Kristoforidhit, botuar greqisht tash sa vjet, i cili përmban me të vërtet një thesar të gjallë për gjuhën t'onë, po mbassi është shkruar me shkronja greke që nuk di ç'do Shqiptar t'i këndonjë, çfaqni nevojën që të botohej ky diksioner në gjuhën Shqipe, dhe për këtë e kujtoni Ministrin e Arësimit që të bëhet mukajet. Bukur fort! Këjo është një çështje me shumë rëndësi,prandaj do kini mirësinë të botoni sa shkruanj këtu mbi këtë pikë.

Thoni se nuk i ka ardhur radha gjer në sot të përkthehet në gjuhën Shqipe ky thesar gjuhor kaq i vlefshëm,dhe unë po ju thom se me sa di unë ndodhen dy Shqiptarë që e kanë përkthyer këtë në gjuhën Shqipe, prej të cilëvet njëri ka qënë z. Sotir Peci dhe tjetri unë. Z. Peci si e kam marrë vesht, nuk e ka mbaruar akoma dhe do kohë që ta mbarojë, kur se unë e kam filluar qysh prej Marsit 1922 dhe e kam mbaruar vitin që kaloj, dhe jo vetëm përkthimin e këtij fjalori, por tuke dëshiruar të trajtonj një vokabullar mê të plottë për gjuhën Shqipe, një vokabullar që t'u përgjigjet gjithë nevojave të sotmë linguistike të gjuhës dhe nevojave të tjera të fjalimit privat e zyrtar, kam shkruar një fjalor më të mbaruar.

Fjalori im, z. drejtor, përmban jo vetëm të 8.000 e sa fjalët e fjalorit të Kristoforidhit, po edhe fjalë të tjera, të përmbledhura me shumë kujdes prej gojës së popullit, fjalët e derivasjonet e tyre të adoptuara në gjuhën t'onë prej gjuhëve të huaja, greqishtes së vjetër, latinishtes, turqishtes, slavishtes etj. etj. simbas nevojave që i janë paraqitur gjuhës s'onë qysh se pa dritën fjalori i Kristoforidhit e deri më sot.

Ky fjalor, i cili është trajtuar prej meje me shumë mundime e sakrificje, tuke u plotësuar dita-ditës, duke u ndrequr e duke u rregulluar mirë e më mirë, përmban një visar prej 20.000 e sa fjalë, dhe në qoftë se shtypet në formën e diksjonarit LAROUSSE, besonj të afronjë 1.400 faqet. Kujtonj se është një ndihmë e mjaftë kjo për ata që merren me gjuhën Shqipe sa për kohën e sotme, e cila munt të shtohet e të plotësohet akoma më tepër në kohën e arthme.

Fjalori i Kristoforidhit si kur se dihet, është një fjalor shqip –greqisht, në shumë vende i mangut dhe në disa të tjera i pakuptuar, kur se fjalori im i ka plotësuar gjithë këto mungesa, tuke ndjekur një system mê të drejtë e mê të përshtatur në gjuhën t'onë e në nevojat e saj, një methodhë moderne, në bazë të së cilës janë trajtuar diksioneret më të mbaruara e mê të njohura që kanë sot gjuhët e huaja mê të përmendura.

Në përpillim e në rreshtimin e fjalëve alfabetikisht janë marrë parasysh të dy dialektet t'ona një krahësim midis tyre dhe

një mënyrë, sa ka qenë e mundur, mê korrekte për lehtësinë e këndonjësit dhe për përdorimin mê udob si të Gegës, ashtu edhe të Toskës. Veçanërisht janë mbajtur shënime dhe mbi qytetet e ndryshme të Shqipërisë ku përdoret secila fjalë prej atyre që nuk janë për-gjithësisht në përdorim, si dhe disa idioma të gjuhës nga ato që janë mê tepër në zê.

Kështu tuke qënë posa që e mbarova këtë vepër Ju solla pikësëparit N.M. së Tij, Mbretit t'onë August, Protektorit të naltë të letrave e të msimit kombëtar, tuke i çfaqur mbarimin e veprës e tuke lypur urdhrin epror ku ishte nevoja për botimin e këtij libri mbassi financat e mija nuk munt t'i përgjigjeshin shpenzimeve kolosale të shtypit të një vepre kësodore, trajtuar si thamë mbi bazë të fjalorit të Kristoforidhit, po tuke u marrë si ndihmë sekondare dhe gjithë diksionarët e tjerë të gjuhës Shqipe qysh në kohën e vjetër të Bozukut e të Matarangës, që filloj të shkruhet me shkronja latine gjuha jonë, e deri në ditët e mbrame.

N.M. e Tij lumërisht tuke e pritur me gëzim, si mora vesht, këtë lajmë urdhroj me një herë Ministrin e Arësimit të merret vesht me mua dhe Ministri, ndonse pak von, më kërkoj shpjegime mbi këtë veprë, të cilën edhe ja dhashë.Më tha të caktoj çmimin e fundit me të cilin munt ta blinte Ministria e Msimit, por mbassi çmimi që i lypa ju duk i eksagjeruar, z. e tij më ofroj vetëm një shumë deri më 250 napolona arit, gjë që e refuzova e kështu diksioneri në fjalë po rri akoma në raftet e bibliotekës s'ime[1].

Mê von, z. Tutulani që u ndodh ad interim[2] Ministri i Arësimit, me urdhrin prapë të N.M.T. Mbretit, më bëri fjalë për së dyti, po edhe z. së tij ju përgjigja si edhe z. Hil Mosit. Këjo me pak fjalë është arësyeja që "pse gjer më sot s' ka parë dritën në

[1] Ky fjalor në korrik 1947 u grabit nga biblioteka e K. Floqit prej regji-mit komunist dhe sot ndodhet në Arkivin Qëndror Shtetror në Tiranë Fondi 429 Dok. 8. Ky fjalor është me shkrim dore (materjali i dktilo-grafuar dhe i përmirsuar nuk gjindet) dhe ka rreth 2.000 faqe. Fatkeq-sisht edhe sot e kësaj dite Shteti Shqiptar e mban të "grabitur", sepse origjinalin jo e jo nuk ja kthen trashëgimtarëve të Kristo Floqit, por edhe fotokopjen e tij Arkiva e ka nxjerrë në shitje me 10 lekë të reja faqen

[2] ad interim = i emëruar provizorisht

gjuhën Shqipe fjalori i Kristoforidhit", ose një fjalor më i plotë. Me fjalë të tjera nuk është faji t'onë në se Ministria e Arësimit s'munt t'i përgjigjet auktorit e ta kënaqë si duhet për me dalë në dritë një vepër e këtillë, mbasi një vepër mëndjeje, me aqë sakrificje e lodhje dhe në aqë vjet punimi si këjo vepër, nuk munt të shitet për një kafshatë buket, se duhet të merren parasysh dhe djersa e nettët e gjatta që ka sakrifikuar auktori.

Ministri i Arësimit, miku im i dashur e shoku veteran z. Hil Mosi më kërkoj t'ja paraqit këtë fjalor komisisë së posaçme për shqyrtim, dhe nuk do t'ja prishnja qefin. Po, për Zotin, kur kujtonj se dhe tjetër herë i kam paraqitur dy vepra të këtilla një tjetri komision arësimuer sot e 9 vjet, një *Historí të Greqisë* prej gati 300 faqesh për Gjymnazet e Shtetit, si dhe një tjetër *Historí të Romë*s, po për këtë qëllim dhe gati me 300 faqe edhe këjo, e para vërtet u pëlqye me disa vërejtje skollastike (që nuk më pëlqen mua, se duhej ndryshe konsideruar e examinuar mendimi e qëllimi i auktorit, të cilin s'e mori vesht mirë komisioni i ahershëm), po vojta 6 muaj gjer mezi e shtira në dorë (dhe në një mënyrë që nuk e rekomandonte aspak rojtësin e këtyre dorëshkrimeve pranë Ministrisë së Arësimit), dhe në pyeçi për të dytën, për *Historinë Romane*, ajo humbi, humbi, humbi, dhe nuk di se ku fluturoj, kështu që vanë kott gjith'ato mundime që bëra për atë dhe s'kam edhe qef të ndjek edhe unë shembëllen e profesor Vokshit, tuke ju sjellë gjyqit. Preferova më mirë të mos bënja fjalë, si kur se nuk bëra. Pra, kur digjet plaka nga qulli a s'i lipset t'i frynjë edhe kosit?

Këtë, z. Drejtor, sa për të vërtetën e për të zgjidhur problemin t'uaj për mos botimin gjer më sot shqip të fjalorit të Kristoforidhit.

Kristo Floqi

AQIF PASHË ELBASANIT

(Dorshkrim që ndodhet në AQSH
F.429-3-322.1 e vijues)

Prej oxhakve të Shqypnisë
Ti n'a dolle patriot,
Ndritte për mes Bujarisë
Dhe Shqypnis' i ardhe zot.
Sa do që jishe i rrethuar,
Me të huaj e anmiq,
Ç'do intrig' e kè larguar
Pa peshû' as një rrezik !
Si Ministr' i Mbretit t'onë
U përpoqe për Atdhè,
Shqipëtarët gjith' e thonë,
Se veç ti Ministër që!
Që Ministër i vërtetë,
Që punonje me gjith zel,
Me një shpirt e gjak të nxehtë
Për nj' idèe e një themel.

Propaganda nuk dëgjove,
As që deshe m'u përzìi,
Vërtet' hoqe, ike, shkove
Po nuk dolle faqe–zìi !
Dhe sa do q'Eli-kiami
Ty të doq, të përvëloj
Po shyhreti yt e nami
Përmes flagëve shpëtoj !
Ti e njohe bukur mirë
Që Shqypnia s'â çifliq,
Për të ngrën' e për të pirë
Arrankatë e anmiq,
E Dhespotë e Tyranë
Që n'a mbajtnë në Robnìe
Duhet t' iqen krejt mê nj' anë
Qoft se duan një Shqipnìe !

Mbi këtë princip të bukur
E të drejt' e kombëtar,
Aqif Pashë, ti jè dukur
Mâ i madhi atdhetar.
Si një hyll në mes të Qjellit
N' errësirë një shkëndì
Por si rez' e kjart' e Djellit
Jè një shëmbëll për Shqypni.

Ah, duro o plak i rallë
Por si mali – plak Tomor,
Mbahu trim e burr' i gjallë,
Kije shpresën në krahnor,
Se kjo barrë do kalonjë,
Hylli nuku perëndoj,
Shqipëria do të rronjë
Zoti vet' e tha, urdhroj !

Do të vinjë nj' ajo ditë
Që Ministër prap do jesh
Edhè emni yt do të ndritë
Dhe nderimet do t'i gjesh.
Përsëritu pra dhe nj' herë
Sa do plak i motshëm jè
Aqif Pash' o burr' i ndjerë
Djelmt' e Kombit pas i kè !

Kristo Floqi

MBI KËSHTJELLËN ROZAFAT[1]

(Kjo poezi e Kristo Floqit është botuar në të përmuajshmen "AGIMI" Nr. 8 Dhetuer 1919)

Shndrit ti, o hyll' i bukur i Lirisë
O Diell' i flaktë rezet i lsho
Per mbi kështjellat mbarë të Shqypnisë
An' e kant ndritso
Edhe ti Flamur i shêjt' i Arbnisë
Mal' e fushë e ç'do pullas mbulo
Ngjalli, o ngjalli shpnesat e djelmnisë
Kuq' e zi valo !
Asht Bajram i math a Pashk' e Zotit
Dita e lume, qi n' a shkrepi sot,
Kû të bijt' e Lekës[2], Burrit[3] e Kastriotit
Rkajë derdhin lott ?
Jo, s' â Bajram, as Pashk' as Panaire,
Kjo ditë fatbardhë qi leu në Shqypni
Q'u kputne hekra, hallka[4] e sinxhire
Q' u shtyp nji robni !
Zêmr' e Shqyptarit sot â tui flakrue
Nji zjarm në gjì po ndijn e nji gazmend
E mizorit' e mdhâ qi kà durue
Tash i sjell nder mend.
Zoqt' e mjerë të Shkabës arbnore
T' arratisun kah Dielli lén e prendon,
Çerdhen e gjejnë të shembun, mizore
Dhe Shkaba i mblon

[1] Kalaja e Shkodrês
[2] Leka = Aleksandri i Madh
[3] Burri = Pirro i Epirit
[4] Hallka = pranga.

O Rozafat, kështjell i Shkodrës plakë
Qi i pa-tutun si gjigant qindron,
Kape të lutem ket flamur si flakë,
Kombi t'a dhuron,
Edhe n' a prîj në rrugen e lumnisë
N'a ço prej gjumit t' rând e n'a ngushllo,
Detyren n'a trego të Shqyptarnisë
N' a mso, na kshillo.
Prâjni muzika, kângë e lahuta
Prâjni britme, klithm' e brohorì
Ulni poshtë arm' e pushka e huta
Shtîja[1] e zantrî[2].
Oh, prej kah vjen ky zâ, kjo gjâm e mnershme
Nji kjo stuhî e rrebët si rëmor
Qi po më bjen ner mend kohët e hershme
Në shpirt, në krahnor ?
Mos â tallas, apo shperthŷne rêtë
A Qielli mos u çil e bumullon
Dhe si shgjeta kndej lëshon rëfetë
Dhen' e shungullon ?
Oh ! Zânë ti, goj' artë e qiellore
Zân' e Shqypnisë, qi të ka ardh keq
Ligjrona trimin m' atë zâ madhshtore
Shqypënija heq !
O ! qenka vetë Skanderbeu i gjallë
Ky qi buçet kështû e po ligjron,
Edhe sa do që s' ka as shpat' as pallë
Zân' i tij tmeron.
Prejtje nuk ka në vorr as ka pushue

[1] Shtija = shtiza
[2] Zantri = lloj arme

Eshtnat e vorfna edhe s' janë shkrî
Deri sa kjo tokë të jetë librue
Qetë nuk po rî.
Çoji shternipat të Gençit, t' Agronit
Të Teutës, të Bardhylit, burrit të dheut
E djelmt' e Ballçejt t' gjith mbas zakonit
Bijt' e Skanderbeut,
E lidhni gjithë besën e Shqyptarit
Por si vllazen qi jeni shok-me shok
Ket dhé të trashigueme prej së parit
T'a gëzoni tok.
Â marre per burrnî q' u fali Zoti
Të ngelni si të dekun në plogsi
Ju, q' u ka njoftë Shekulli[1] e Moti
Fusha e Malsi,
Sot qi per popujt ka ague dita
E lyp gjith cili njatë shtegn' e vet
Çilni sytë, avrituni kah drita
Koha nuk u pret.
Pshtym' e flak, mjergull, tym e shkndija
Tomori prej Tosknije po flakron
Dhe zân' e tij e çon tu Perendija
Mshirën i kërkon.
"Shkodra Shqyptare ky qytet i vjetër
"Kerthiz' e Kombit që s' u çduk kaq vjet
"Kjo seli' e bukur qi s' ka shoq tjeter
"Shqypes i perket !
"Burra Shkodranë, Shkodren mos e lini"
Thret, sa shungllon Liqê e Tarabosh
E ndijn dhe Kiri, Bûna e Drini
Burrë, plak, djalosh !

[1] Shekull = në dialektin shkodran i thonë jetës reale

Përpara, burra, bekim paçi Zotin
Doren njani tjetrit jepni me të shpejt
Rueji mos çnderoni Topejt[1], Kastriotin
Shkodra prej jush pret !
Le t' i nderojmë atà prindët t' onë
Qi nji ket vend n'a lanë si trashgim
Qi me burrnî' e nder kan rà gjithmonë,
Per nder e shelbim.
Atà me shpata edhe na me penda
Atdhenë t' a pështojmë si përket
Të gjith na Shqyptarët jasht' e mbrenda
Ket Atdheu po pret !

KRISTO FLOQI

FLAMURIT

(Poezi e Kristo Floqit botuar në gazetën
"Përlindja e Shqipniës" Nr. 26.
Vjeshta e III 1913, faqe 5)

Flamur ! ti që me shkabën po valon
E hapesh palë-palë i gëzuar,
O trashëgim i prindve pa-haruar,
Vallë ç' na ëndron ?

Sôt po valon i mburur në Shqipnî
Dhe ëndra e pa pritur po na çfaqet;
Në djemt' e tu dëshira po përhapet,
Po vleftën kush t' a di ?

Të shof flamur i kuq i Skënder–beut,
Burrat e Dheut për ty ranë therorë

[1] Topejt = familja "Karl Topija"

Je ti, flamur, q' u thure kaq kurorë
Dëshmorëve t' Atdheut !

Tmer i armikut ! Të di cili je
Honet e gërxhet edhé po gjëmojnë,
Një komp i ngratë që po e shkelmojnë,
Mos pandeh se flé ?

Jo, jo, s' fle kurrë !! Fare mos dysho,
Po eja e m' u thuaj printve t' onë
Q' u xgjuha Kombi edhé do të rronjë
Thuaj, mos harro !
Shko dhe nga Leshi[1], ndehu e qëndro
Xgjohe nga gjum' i rënd' e i pa-prerë
Âtën e Kombit, Skënder-ben' e vlerë
Pak e qetëso.

Flamur i shenjtë, atje ku të vesh
U thuaj që Shqiptarët nuk harrojnë
Gjakun e thjesht, vetijat s'i mohojnë
O ! lark qoftë nesh !

Qofsh i bekuar dhe lâ e më lâ !
Kujtonj se nuk do na mohosh bekimet
Për të mbaruar e, a më shpejt qellimet
Ëndrat e mëdhâ[2] !

Gjik Palla[3]

Vlorë, 15/28 Nëntuar 1913

---

[1] Leshi = qyteti i Lezhës
[2] Kjo vjershë e përpunuar dhe e përmirësuar nga vetë Kristo Floqi është botuar më 1923, në faqen e parë të librit të tij SHKËNDIJA OSE ANTHOLOGJI SHKOLLARE
[3] Gjik Palla = një nga pseudonimet e Kristo Floqit

FLAMURI YNË

(Poezi e Kr. Floqi botuar në gazetën "Perlindja e Shqipëniës Vjesht e III Nr. 26 f. 9)

Valo, valo si të ka hije
Shkrep, po si Djelli vetëtì,
Flamur ! O shënjë trimërije
Valona sot në Shqipërì !

....

Pas kaqve kohë tyranie
Pesë qint vjet në robëri,
Flamur ! O shënjë trimërie,
Valona sot në Shqipëri !

....

Shpresa, dëshira atdhesie,
Ndjenja të larta, dashuri,
Flamur ! O shënjë trimërie,
Valona sot në Shqipëri !

....

Çeli, o djemt' e Shqipërisë,
Çlodhi dëshmorët e Atdheut,
Se valon flamur' i Lirisë,
Flamur i kuq i Skënderbeut !

....

Valo mbi malet të bekuar,
Brigje dhe fusha ti mbulo;
Valo i mburrur, i lëvduar
Valo flamur ! Valo, valo !

....

Ti që hoqe Skënderbenë
Në luftra, në mundësi,
Flamur që mbronje, ti, Atdhenë
Ngulu dhe sot në Shqipërië !

Unjim më gjunj e t' adhurojmë
Shpresa dhe fat mvarim mi ty
Dhe **besa-besën** betojmë
Flamur ! të vdesim ne për ty !

....

Rrofsh, o flamur i Shqipërisë
Me nder, gëzim e dashurië,
Flamur ! i bukur i Lirisë
Valona sot në Shqipërië !

Kr. Floqi

D. ALIGHIERI

KONT UGOLINI

(Botuar në revistën "LEKA" Nr. 4,
prill 1937 faqe 162)

Kokën[1] lëshoj dhëmbësh, si e breu, e xhvati,
Buzët e përgjakta pas flokëvet fshiu,
Sŷt' i zgurdullovi, por si sŷ lugati,
Tepër ashpër foli mëkatar-fatziu:
"Ç'kam me këtë kokë, që s'po ngjinjem kurrë,
Doni që ta msoni, çashtjen t' ju tregonj ?
He, dëgjoni mirë, kjo ku më ka prurë,
Të keqen e madhe që sot ju zbulonj !
Vjete tash e ruanj brenda zembrës s' ime
Plagën e majisur, kobin që më gjet,
Që më coptoj eshtrat me aqe pikllime,
Bolbën e poterën që shpirtin ma vret !
Ç'më punoj i poshtri s'kanë të rëfyer,

[1] sipas wikipedisë koka është e arqipeshkvit Ruggieri degli Ubaldini, i cili e gënjeu dhe e futi Kontin Ugolino në një kurth për ta arrestuar

Më mundoj, më treti, më dogji, më shoj,
Kjo s' ka ngjarë kurrë, tepër më ka thyer
Ky qên, ky gjakpirës që më përvëloj !
S' pati frigë Zoti, s' pat as një mëshirë,
Shpirtin ky ma fiku, krejt ma shkatëroj,
Lotët që kam derdhur n' atë burg[1] të pështirë
Kjo bish' e mallkuar, kjo mi shkakëtoj !
Mizoritë q' hoqmë Zoti ja shpërbleftë,
Se s' mjaftojnë mshimet për këtë xhelat,
Ah, vujtjet e mija Zoti trish ja ktheftë,
Si na ka munduar voftë[2] ky lugat" !

"Cilli jé zotrote[3] s'dua ta msonj kurrë,
Si e qysh u ndodhe brenda në kët Ferr,
Veç dëgjo dhe mbahu, mbahu në jé burrë,
Edhe n' e paç zëmbrën gur, ose mermer !
Fjalët që dëgjova, fjalë Fjorentini
Më duket se janë, s' kam as një dyshim,
Mso, pra, kush jam un....KONTE UGOLINI,
Qytetar' i mjerë, që vdiq në dëshprim !
Koka që po shifni, q'e brenj i tërbuar
Është koka vetë e njeriut të keq,
E atij RUGJERIT, ipeshkvit mallkuar,
Që prej sijsh nuk ndahem, as dorë nuk heq !
I besova shpirtin këtij arrakati,
Këtij klyshit t'Ferrit, nieriut rrencak,
Gjer sa e psova dhe flî rash' i ngrati,
Në një llom të thellë, në muzg' e batak !
Psè kërkon t' hap gojën, psè më lëndon plagën,

[1] sipas wikipedisë bëhet fjalë për burgun Torre della Muda në Pisa, që më vonë u quajt Torre della Fame
[2] voftë = le të vuaj
[3] sipas wikipedisë është vetë Dante Alighieri

Plagën e tulitur për se ma skëlfit[1],
Që më shtyp krahnorët e që kërkon shpagën,
Pse s' më lé ta shqyhenj, kokën ta zgërmit ?

Më gënjeu të mjerin ras'[2] e tij priftnore,
Ras' e tij shêjtë ajo më mashtroj,
Dhe më vrau me vdekjen, vdekjen, mê mizore,
Ah, rasën e shkretë kurrë s'e harronj !

Nalt n'atë kështjellë t'errët ç'kam pësuar,
Askush s'e kuptovi, mbet si një problem
Por se ju tanithi kini për ta mësuar,
Atë që më gjeti sot do t' ju a them.
Tani do dëgjoni si ky na ka vrarë,
Si na shoj urijet, gjall' si na mbuloj,
Djemt e mij dhe unë si e gjetmë varrë,
Më dëgjoni pakë se ç'do t' ju zbuloj.

Në atë kështjellë, – që "*kështjell' urije*"
U qojt qysh ahere – ky na pati ndrŷ,
Ku, nga vrim' e vogël një reze shkëndije
Dikur hynte brenda, na binte ndër sŷ.
Prej asaj birruce shumë herë pashë
Hënëzën e zbetë mbushur plot me ré
Dhe kur më zû gjumi dhe në ëndër rashë
Një tmerr më topiti, më ra një rrufé !
Një brengë të keqe shpirti m' ëndriti,
Dhe më çfaqi fatin, atë fat të zì,
Që ky i mallkuar né na pregatiti
Pa pikë mëshire, pa një dhemshurì !
Pashë nj' ulk që ikte me klyshat e trembur[3],
Që ky tradhtor ndiqte me një shpejtësì,

[1] skërfit = lëndoj
[2] rasë = Rroba e zezë e gjatë e me mëngë të gjera e të gjata që vesh prifti
[3] sipas wikipedisë, ujqërit ndodheshin në malin San Giuliano.

Dhe mundohej tepër si një bish' e çmendur
Ti shtinte të gjith brenda në pusì ;
Me qenj e langorë shumë të drobitur
Brithte ! Pas i vijnin do shoq të këqinj,
GUALAND, LANFRANGË, SISMUND[1] të mërzitur,
Gjakpirës të gjithë pleq edhe të rinj.
Ujqtë mjaft u trembën dhe qent' e dopsuar
Mbi 'ta si të marrë turren me furrì,
Copë cop' i bënë ujqit e friksuar
Që s' kishin si mbrohen brenda n' atë vrî[2] !

U zgjuash me nj'herë, – ishte me të gdhirë
Djelmt' e mij të ngratët që i kisha shoq,
Bukë më kërkonin, qanin ishin shtrirë,
Mu fik shpirt e zembër, mu zhurrit, mu doq !
Do të jesh prej guri, granit' a mermeri[3],
Në mos derthsh çurk lotte, në mos qafsh tanì,
Në s' të gufon vaji, brima edhe tmeri
Ah, mendoje mirë ketë tiranì !

Kish kaluar ora, që – si kur se qenvet –
Bukën na e hodhë me të keq qellim
Dhe një sŷ ngashrimi u drejtova djemvet
Që më kqyrnin gjithë me lott' e pikllim !
Oh, ç' të shoh përpara ! ....Ah qyqari unë,
Një krizm' u degjua dhe dera u mbyll,
U mbyll të mos hapej, në nji varr na vunë,

---

[1] sipas wikipedisë ishin tre familje ghibelline. Ghibellinët ishin mbë-shtetësit e familjes fisnike gjermane Hohenstaufen, që ishin në luftë për pushtet pas vdekjes së perandorit Henrik V më 1125 me Guelfët që mbështesnin bavarezët e saksonët. Shih "Divina Commedia" e D.Ali-ghieri,Canto VI, Parajsa,f. 100-108

[2] vrì = bjeshkë, vent malsor i veshun me shelgjë, plok

[3] sipas wikipedisë Konti Ugolino akuzon Danten që është shumë mizor që nuk qan nga ky tregim

Mbetmë të pisklluar[1] si thika në myll[2] !
Çelsat e kështjellës përtej i flakruan,
Tej, në lumin ARNO për mê sigurì,
Dhe kështu, si minjtë, gjalltas na varruan,
Na u pré çdo shpresë, gjaku na pat ngrî !
Në fyt më ngel fjala, lotët mu shteruan,
Asht[3]' e mish mu ngjethnë,s'dinja nga t'ja mbanj
Djelmt'e mij të ngratët gjith'u dëshpëruan,
Dhe vet' u ngurosa, s'mundja as të qanj !

Javo[4] ANSELMINI hap gojën e thotë :
"Babë, pse mendohesh ? Thueja ç' na gjet ?"
Por, mjerisht, përgjigjen e priste të kottë,
Mu klyç goja, heshta, gjë për nè nuk mbet !
E gjith'ajo natë shkoj me psherëtime,
Gjer sa zbardhi Qielli, gjer sa dita agoj,
Dhe kur Dielli shkrepi, gjëma, ulërimi
Burgun e tronditne, vaj i math gjëmoj !

Vezhgëllonj të katër djelmt' e mij të dashur
Edhe një shigjetë zembrën ma përshkoj,
Djersët më mbuluan dhe me shpirtin plasur
Duart po kafshonja, pika më pikoj !
Djelmt' e mij aherë: "Thona, babë, thona",
Më bërtisnin gjithë "babë, mos pshertì,
Ç' pret ? Therna të gjithë, haj nga trupat tona,
Jetën që na fale merre prapë ti !
Jemi mê të lumtur, kur ti të jesh mirë,
Jeta nuk na duhet, s'na dhimbet as pak,
Dëshrojmë vdekjen sa të t'shofim shtrirë,

[1] pisk = në gjëndje të vështirë e pa rrugdalje
[2] myll = këllëfi i shpatës, thikës, etj.
[3] asht = kockë.
[4] Javo = menjëherë, pa pritë e pa kujtue (K.Floqi)

Të zbet' e të ftohtë, pa një pikë gjak !"
Vehten e përmbajta mos ti dëshpëronja,
Gojën e klyçita, nuku fola gjë,
Ç'do hidhrim gëlltita, ç'do ankth e duronja,
Heshta, u nemita, nuku nxora zë !
Po ditën e katërt ?...Zot ç' panë sŷtë !....
Në gjunjët e mija mu shtrî djal i rì,
Djal' i vyer, GADDUA, djali jem i dytë,
Rëzohet i vdekur, u tret si qirì !
Dhe ditët e tjera gjith ata që mbetnë
Një pas tjetrit ranë, ah, më shkuan kot
Vdekjen aq' mizore prej këtij e gjetnë,
Ngela un' i shkreti në vaj e në lot !
Mbet i shurdhë burgu !...Djelmt'e mij kërkonja
Zëth' i i ëmbl' i tyne për mua pushoj,
Qanja e s'pushonja, kufomat lëmonja,
Ç' e deshnja më jetën kur shpresa përndoj ?....
....Mbaroj mëkatari dhe i zgurdulluar
Kokën rëmben prapë, me tërbim e xhvat,
Dhëmbët ja ngul thellë si qên i tërbuar
Dhe s' nginjet së ngrëni, ha si një lugat !

KR. FLOQI

SHËNIM NGA HENRIK KAÇULINI : Nuk e di në se këtë poezi Kristo Floqi e përktheu nga origjinali, apo është një krijim i tij bazuar tek "Divina commedia" të Dante Alighierit. ("Ferri", Canto XXXIII).

NË TË NGRYSURIT E JETËS

(Poezi e Kristo Floqit botuar në gazetën
"Drita", 1937, Nr. 52, 31 janar faqe 4)

Ikim dal–nga dale, po e ngrysim jetën,
Ah, si shkojnë vjetet, moti si kaloj,
Tani sŷt' e mija shohin të vërtetën,
Ëndrat që u zhduknë, fundin që afroj !

Vërtet kalon moti, apo né vrapojmë ?
Si rrodhi kjo jetë e s'kuptuam psé ?
Lindmë që të vdesim e me kaq mbarojmë,
Nesër të mos jemi, veç pluhûr e dhé ?

Oh, sa të gabuar qënkemi të mjerët,
Shtymë dita-ditën, kohën që na lé,
Mbshtillet lëmsh' i shkretë, mbetemi më terrët,
Na korr kos' e vdekjes, ah, të ngratët né !
Në vlugun e moshës qeshnim e dëfrenim,
Koha ishte mjaltë, jeta një blerim,
Gjë s'mendonim mbrapa, vehten e gënjenim,
Pleqëri s'kujtonim, vujtje, a mjerim !

Shkuan këng' e valle, lodra dashurije,
Gjith'ato dëfrime, ato bukurí,
Lule, trëndafile, ëndra djalërije,
Shkuan e mê s' vinë, shkoj ajo lumrí !

Flytyruan, iknë, që të gjitha vanë,
Né n'a lanë prapa, nuk i shohim mê,
U tretnë si vesa, si lulet u thanë,
U ngrys, arriu nata, jeta s' qënka gjê !

Oh, për sê të ndodhen netë plot mystere,
Nettë magjistare, mbushur me lumrí,

Vajza bukuroshe, burbuqe Pranvere,
Që të dehnin shpirtin, kur jé djal i ri ?

Jemi plënk i tepërt, jemi rëndësirë,
N'a u mërzit jêta, rrojtja s'na pëlqen,
Po dhe që të vdesim, prapë s'na vjen mirë,
As në torbë s'hyjmë, as në thes s'n'a gjen !

Në dëshprim e sipër vdekjen e kujtojmë,
Si kur do na çlothte nga ky kob' i zî,
Por se prapë mëndje qint për qint ndryshojmë,
Sa dhe né s'e dijmë, s'kemi terezí !

Psé na tmeron vdekja ? Psé kemi dyshime ?
Psé njeriu t'i trembet ? Plaku psé e dron ?
Nuk ka jetë tjetër, të tjera gëzime ?
Kjo ish rrojtja jonë ? Gjer këtu mbaron ?

Sikur të fillonim të rronim dhe nj'herë,
Do t'ja dijim vleftën asaj jetë s'ré ?
E themi, po prapë do t'ishim të mjerë,
Jeta s'ka të ngjinjur, prapë né se né !

Kështu qënka jeta, s'paska funt e krye,
Një mashtrim, një rrenë, gjithë sa kaloj,
Dhe kush mbet kënaqur, e kush u dëfrye
S'ka se psé të mburret, se as gjë s'fitoj !

Kot rrî e mendohem, nuk e gjenj dot kurrë,
Për sé, vall' u lindmë ? A ka një qellim ?
Rritesh, bëhesh djalë edhé pastaj burrë
Edhe në funt mplakesh e vdes me pikllim ?

Psé të rrosh me shpresë mos nesër mê mirë,
Ditë mê të lume do shkrepin për ty,

Dhe në shtrat të vdekjes, ku ndodhesh i shtrirë,
Edh' atjé ké shpresë, gjer të mbyllësh sŷ ?

Ç'ësht' edhé ky moti që ngryset e gdhihet,
Vera plot me lule, dimri dbor' e shî ! ....
Që kur ka filluar ? Fundi a i dihet ?
Ku ishim ? Ku jemi ? Ku shkojmë tashi ?

Jo, jo ! Moti s'ndahet, gjithë kështu ka qënë,
Né e kemi ndarë në stina, në dit,
Ajy me né tallet, né s' ja ndjejmë zënë
Lodrën s'e kuptojmë, që na lot për vit !

Né i shkojmë sipër motit kurdoherë,
Uj'i tij i valë, trupin na përvlon,
Rrudhesh, tretesh, thahesh edhé vdes i mjerë,
Dhe një dit' harrohesh, balta të mbulon !

Kush vdiq e u kthye që të na shpjegonte
Në ka jetë tjetër, Parais' a Ferr,
Ku kullosin shpirtrat të na siguronte,
Të paktën t' a dijnim, mos rrijnim në terr ?

Jeta qënka nj'ëndër, gjer sa njeriu zgjohet,
Dhe kur vdes ahere e merr vesht që rron,
Po dhe në mos qëntë duhet të pranohet,
Ndryshe kjo problemë s' ka se qysh mbaron !

K. FLOQI

ANKIM I QIPARIZIT[1]

(Poezi nga Kristo Floqi, botuar në
revistën "Njeriu" Nr. 11 viti 1943,f.6)

Te Buda i math u qah një dit krenari qiparisi,
Për se s'ka fatin edhe ky, sikur se pati lisi,
Pse e dënoj që shoqëri të vdekurve t'u jetë,
Pse lisn' e mbolli për mbi mal, këtë e la të qetë ?
Lisit për se i dha liri dhe erë kaq të mirë
Dhe qiparisin e dënoj të rrojë në shkrettirë ?
Ajy të ndjejë nat' e ditë bilbila e ligjrime,
Ky të dëgjojë gjithënjë vaj, lotte e pikllime ?
Dhe Buda qeshi e i tha : S' më thua i begatë,
Kush do t'u mbajë hijeshim të vdekurve të ngratë ?
Gjethet e lisit nuk i sheh si fishken e rëzohen,
E flett e tu gjelbrojnë krejt gjithnjë çelin, krekohen ?
Lisin shigjetat e rrufês' e djegin e dërmojnë,
Por ty s'të nget as er' as gjë, qetsinë s'ta trazojnë !
Lisit të mjerë një tufan ja shtron për dhè ç'do fletë,
E ty s' të tremp as një stuhì, kryet e kè përpjetë !
Qahesh për lisin, që e sheh sè po qëndron i dlirë,
Dhe nuk mejton se fati yt është prej tij më i mirë ?
Apo nuk sheh me ç'bukurì ty shtatin ta stolisa ?
Të kesh pak turp kur flet ashtu, kur lisin s'e pajisa !
Kështu tha Buda dhe një sy i hodhi qiparisit,
Dhe ky u tremp, kryet e ul, u mek përpara prîjsit !
Heshti, pushoj, mbet për gjithnjë i varreve rojtari,
Dhe qysh ahere, kur sheh lis e vret cmiri, nakari !

DR. KR. FLOQI

———

[1] Kjo është poezija e fundit që kam gjetur të botuar nga Kristo Floqi. Morali i kësaj poezije (sipas mendimit tim) është : "Respektoni për-herë të vdekurin" (H.Kaçulini)

DY SHPIRTRA ZIHEN

(Poezi nga Kristo Floqi botuar në gazetën "Njeriu" 1943, Nr.9, faqe 5)

Të zhytura mu në skëterë
Dy shpirtra ziheshin një ditë,
Shamatë bënin e poterë
Puna u zgjat, u kacambit !
Njëri nga shpirtrat ish i pasur
Tjetri i varfër, një harbut[1],
Që rinte pîjtas, buzë-plasur,
Kur se i pari qe nj' hajdut !
Harbuti i shkretë ish i urtë,
Kusari fort harbutn' e nget,
Pse ish i ashpërt, zemër-gurtë,
Harbutit shumë rënd' i flet:
Ti s'je si mua, s'munt të mburresh,
Unë kam qënë pasanik,
Ti s'kishe as një morr të kruhesh,
Në xhep s'të gjen as metalik !
Kur vdiqa unë më mbuluan
Me një shkëlqim, salltanet
Po ty pa hoxhë të varruan,
Si një evgjit, si një l a n e t !
Kujton se do vesh në parajsë,
Kështu me raqe si zhelan,
Ti, që nga paret ishe drasë,
Hiqu të mbytesh, mor h a j v a n.
Po dhe harbuti nuk ja mbajti,
Kusarit t' qelbur ju vërtit,
I foli djathtas e së majti

[1] harbut = njeri i pagdhendur (njëri nga kuptimet e kësaj fjale)

Hajdutit që po llomotit:
"Ti syt' e Zotit s'i sheh kurrë,
"Ditë të bardha s'do ngjerosh,
"Këtu kusar, shpirt-zi e urrë,
"Do dergjesh brenda sa të rrosh!
"Të rrofshin paret që fitove,
"Duke i vjedhur si kusar,
"More gjë pas ? A i gëzove ?
"S'të kam zili, s'të kam nakar !
"Unë vërtet jam i vobektë,
"Por jam i ndershm' jo faqe-zi
"Mëkati ty gjithmonë të ndjektë,
"S'le gjë pa bër' faqe-zi !
"Këtu ku jemi s'ke ç'të thuash,
"Nxir sa të muntsh gëlbaza, vrer,
"Ato që bëre do t'i vuash,
"Se ty as djalli nuk të merr !"

Dr. Kr. Floqi

ËSHTË I PAVDEKUR SHPIRTI ?

(Poezi e Kristo Floqit botuar në revistën "Njeriu", 1943, Nr. 10, f. 4)

Platôn, thua të drejtën, kur bën për shpirtin fjalë,
Se Perëndija vetë, me shpirtin t'onë flet,
Se shpirti kur nesh ndahet, nga trupi kur të dalë,
Prap' i pavdekur mbetet ? Kështu është vërtet ?
Filozofija jote, e nalt' e pasuruar
Rreth shekujve t' pafundtë si një magnit me heq
Dhe fantazinë t' ime, që ësht' e paduruar,
Në Qiejtë nalt përpjetë ma çon e ma tërheq !
Vargonjtë që më lidhin në jetën e përkohshme
Dua ti thyenj gjithë, ç'do sent që më vjegon,

Dhe pranë Perëndisë me krahë të palodhshme
Dua të shkonj t' afrohem, zembra fort ma dishron!
Në jetën e pasosur, që s'ka as funt as krye,
Aty dua të gjendem, të çlodhem, të dëfrenj,
Të shoh madhnit' e Zotit krijesat që ka krye
Një jetë krejt të ndryshme brenda n' ato të gjenj !
O Dritë, o Djell' i zjartë, o Qiej, o Hapsirë,
O Naltësi pa anë, që syri im s't'harrin,
O Natë, o Hën' e zbetë, o Hyj, o Erësirë,
Që kur vall' u krijuat ? Kush ju përmban, ju prîn?
Po ç' them ? Për se habitem, ku jam e ku kam qënë,
Ku shkonj, ç' rrugë kam marrë, ku jam tani, ku rrî,
Ku vete, nga kam ardhun, këtu kush më ka lënë,
Ku nesër do të gjendem a ma tregon njeri?
Që nga jam i tërhequr ? Në Botën si u gjinda ?
Ku do më çojë vdekja, në ç' gjî po më lëshon ?
Për ç' qëllim u krijova e për çqëllim u linda,
Kjo diturî, kjo mëndje më tutje a vazhdon ?
Ç' më pregatitet nesër dua ta di dhe vetë,
Ta flê, të paktën, mëndjen, dyshimin ta largonj,
Mos rronj gjithnjë në frikë, i trembur, i paqettë,
Të drejtën vlla është për se të mos e msonj ?
Platôn ! Në jè i bindur se shpirti rron për jetë,
N'e kè kuptuar hollë se ka një Perëndî,
Një jetë t'amshuar si posht' edhe përpjetë,
Pse s'e shpjegove mirë me shëmblla që ta di ?
Në ka, pas mëndjes s'ate, një Zot në Botën mbarë,
Krijuës e sunduës dhe prijës, kujdestar,
Ky Zot duhet të jetë i urt' e jo i marrë,
I drejtë e i dhemshur dhe për ç'do mëkatar !
Në qoftë se e Zotit e vogël një krijesë,
Platôn, jam edhe unë, për se më lè të heq,
Të dergjem e të vuanj, i mjerë e pa shpresë,

Të duket kjo e drejtë ? Vërejtjen s'ta tërheq ?
Njëri të hajë mirë dhe në mëndafsh të flerë,
Të rrojë fort i lumtur me kamj' e pasuri,
Dhe tjetri një kashatë në gojë të mos shtjerë,
Të vdesë prej urije, pa strehë, pa njerì ?
Platôn, a jè i drejtë ? E kè gjykuar mirë
Ky Zoti të këqinjtë për se nuk i dënon ?
Të drejtët e të mirët psè s'gjejnë' as një mëshirë ?
Këto në cilën Bot' Perëndija i gjykon ?
O e vërtetë q' humbe, që s'kè shpresë shpëtimi,
Dritën ta zu gënjeshtra, ti s'kè një vleftë sot,
Se vleftën e ka rrena, e keqja e mashtrimi,
Ku jè o moj e ngratë, që nuk po të gjenj dot ?
Mê mirë lè të dalim nga kjo qelì e shkretë,
Prej ktij burgu të ngushtë, ku shpirti po rënkon,
Të flutrojmë lirë e të shetisim lehtë,
Në jetën e pasosur, ku gjë nuk na mungon,
Atjè ku s'ka vent cmiri, ahmarrja e e keqja,
Ku mbretëron e drejta, ku nuk dëgjon ankim,
Ku nuk ka duk lakmija, ku nuk të tremp as vdekja
Atjè flutrò e ikë dhe ti, o shpirti im[1] !

Dr. KR. FLOQI

---

[1] Kjo është poezija e parafundit që unë kam gjetur të botuar nga Kristo Floqi. Kjo poezi është botuar kur autori i saj ishte në moshën 71 vjeçare. Ai ndjen se po i afrohej vdekja dhe shpreh dëshirën dhe lumturinë që shpirti i tij do shkojë në Mbretërinë e të Barabartëve dhe të të drejtëve (8 vargjet e fundit), por është shumë i dëshpëruar për Shqipërinë, që ai e donte aqë shumë, e cila kishte marrë rrugën e së keqes. Ashtu si Krishti Biblik, edhe Kristo Floqi në këtë vjershë ia dorëzon shpirtin e tij Perëndisë.

POETI DYKE VDEKUR

(Botuar në revistën e përmuajshme shpirtnore kulturore "NJERIU" Nr. 2, Gusht 1943, f. 10)

Përpara një kandili poeti po vajtonte
Jetën e tij mizore me një të vajshëm zë,
Kandili po klejitte, iskrat[1] e tij lëshonte,
Drita nga dal po shuhej, se vaj nuk kishte mê !...
"Lulet, ah, m'u venitnë, m'u fishknë e m'u thanë,
"Njëra pas tjetrës bijen, fletë as një nuk mbet,
"Të ritë t'em, kjo jetë u zhduknë edhé vanë,
"Ah, si e ngrysa kohën, të mjerin se ç' më gjet !
"Arrivi nat' e shkretë dhe gjumi më afrohet,
"Gjumi i rënd' i vdekjes në portë më trokllet,
"Të vojturat mbarojnë, ky shpirt do të qetsohet,
"Kush e di se ku do gdhihem dhe nesër kush më pret !
"Thyju ti, o moj lyrë, lyra ime zanore,
"Që kaqe të kam dashur e nuk të ndanja dot,
"Se zëthin tënt të ëmbël, o lyra tingëllore
"Nuk e dëgjonj mê kurrë, ah do ta qanj me lot !
"Në varrin t' em të ftohtë të gjitha do mbulohen,
"Me mua do të vdesë dhe shpirti poetik,
"Të gjitha do humbasin, të gjitha do harrohen,
"E shkreta jetë ikën me vrap e me vërtik !
"Vraponi ju, o shokë, t'ju shoh edhé një herë,
"Brenda në kto krahrorë dhe nj'herë t' ju shtërngonj,
"Dhe mëmën e përzishme, që po e lé të mjerë,
"Ta ngushëlloni, shokë ju lutem, ju përgjronj !
....Kështu foli vjershtori, pushoj mê s'u dëgjua,
U shtri mbi shtratn'e vdekjes, ju prè fuqi e zê,

[1] iskra = shkëndija

Kandili me një herë u fik, drita ju shua,
Dhe lyr' e tij fatkeqe u thye, cop' u bë !...

Dr. Kristo Floqi

VALA DHE HIJA
(VIKTOR HYGO, "LES MISERABLES")
(Poezi nga Kristo Floqi botuar
në revistën "Njeriu" viti 1943 nr. 8, f. 6)

Një njeri shkau, râ në det,
Por anija ecën, s'ndalet,
Lundron, ikën, ngutet, s'pret
I çan valët vark si malet;
Se psè râ njeriu në det
Do të ndaleshe anija ?
Ajo mban rrugën e vet,
S' i prish punë, nuk râ zija !

Breth anija, po udhton,
Ikën shduket dal-nga dalë,
Dhe i mbyturi lufton,
Me tallaze e me valë !
Thret, bërtet po kush dëgjon ?
Kërkon ndihmë, ah i ngrati,
Zembr' e tij vuan, rënkon,
Oh, i mjeri se ç'fat pati !

Herë zhytet, herë del
Mbi tallazin e harbuar,
Herë vala e përkdhel,
Her' e kryth të deshpëruar !
Duart lart në Qjell i ngreh,
Po mjerisht kush ja vè veshin,

Shoqt'e shohin, ky i sheh,
Po për të njeri s'jep peshin[1]

Mjerë mjer' i ziu njeri,
Kryet mezi q' i dallohet,
S'ka fuqi, as ka trimri,
Kot përpiqet, kot mundohet !
Tash anija s'duket mê,
As katart[2], as vel' i shihet,
Nata vjen, s'dëgjohet zè,
Veç se val' e egër ndihet !

* * *

Si një fandazmë shduket anija,
Gjithë largohet, vijën s'e ndron,
Dhe kapitani, tajfa[3], njerzija,
S'e çajnë kryet psè njeriu shkon !
Mos nuku ishte dhe ky i gjori
Me ata bashkë, të gjithë tok,
Psè tani fati ndër këmb'e mori,
Psè e ndau syresh, nuk ishte shok ?

Pakëz mê parë dhe ky fjalonte,
M'ata ish bashkë për mbi aní
M'ata shetitte, lirí ngjeronte,
Po ah të shkretin ç'e gjet tanì !
Tani me valët lufton i mjeri,
Ju prenë krahët, ç'do shpres' e lâ,
E kapi frika, e zuri tmerri,
Për gjithëmonë shokësh u ndâ !

[1] s'jep peshin = nuk i jep rëndësi
[2] Katart = direk anije
[3] tajfa = ekuipazhi

Humbi i gjori, humbi ç'do shpresë,
S'ka ku të mbshtetet, deti s'ka funt,
U loth e s'mbahet, s'munt as të thresë,
Perndoj gjith shpresa, s'e sheh gjëkunt !
Këmbët e tija mbshtetje nuk gjejnë,
Noton, po valët s'i lenë shtek,
Njëra pas tjetrës e rëkëllejnë,
Nuk sheh mê toke, as zall, as brek !

Poshtë po shtrihet një natë sterrë,
Një napë e zezë, një errësí,
Ku të qëndrojë ? Ç'drasë të zerë,
Që e përfshiu vala dhe deti i zí ?
Kërkon të mbrohet, por s'ka ku mbahet,
Ju prè fuqija, mê s'qendron dot,
I ngrivi gjaku, goja i thahet,
Duart s'i bëjnë, këmbët s' i lot !

Orën e fundit i ziu bërtiti,
Shpirtin ta japë është gatì,
Valës, hapêsirës ju lut e thiri,
Zoti ku është ? A ka Perndì ?
E lshon zembra, vdekja ja mbrini,
Zhytet, fundoset, thellë po shkon,
Varr' i tij deti, Qjelli qefini,
Jeta mizore kështu mbaron !

O ti, që quhesh SHOQRI NJERZORE,
Ti s'kè mëshirë për një që heq,
E lè të mjerë, e lè të gjorë,
E ndan prej gjirit, qysh s'të vjen keq ?
Sa njerës vallë prej teje presin,
Por ti u shmangesh, nuk i vè rè,

I lè të shuhen, i lè të vdesin,
Shtrigë, kulçedër, llamje[1] jè ?

Dr. Kr. FLOQI

S'IME BIJE TEFTËS
(Vdiq në Salt-Lake City t'Amerikës
më 20 Oktobrit 1910)
(Ndodhet në AQSH F.429-3-242
me shkrim dore)

Moj dallëndyshe,
Teftë moj bijë,
Prit pak të të nis,
Moj sý larushe
Moj dudîë,[2]
Qëndro të të stolis,
Të t'kreh leshkat e t'ua,
Të shndritshme, po si ârr,
O Ëngjell, o pallûa,
Pastaj të shkosh në varr.
Moj faqe-kuqe,
Që s' pushonje,
Si zogë, si bilbil,
Ah, moj burbuqe,
Qysh fjalonje,
O Teft' o trandafil !
A munden të harrohen
Moj lul' ajy kuvënt

[1] llamje = bish e egër, kuçedër
[2] dudië = Vajzë a grua shumë e bukur e tërheqëse.

Dhe fjalët mos kujtohen,
I ëmbli zëthi tënt ?

I shkret' i mjerë
Të çaj dete
Të vinj n' Ameriqië
Në vent të gjerrë
Në ca stepe
Der në Kallifornië
Edhè pa çlodhur mirë,
Befas e më një ças,
Prej fruthit të pështirë
O Teftë të t' humbas !

Mbi hidhërimet
Të pa-anë,
Ti që një ngushëllim
Dhe në trishtimet
Kur që pranë,
Ti ishe përdëllim !
Me nënëqeshjen t'ënde,
Harronja ç'do mjerim,
Dhe me ato kuvënde
M'a zbutnje shpirtin t'im !

Sôt po të ndahem,
Tefta ime,
Ah, më s'të shohim mê,
Lottët s' na mbahen
Zemrat thime[1]
Jot' ëmë qân me zê !

[1] thime = të thyera

O Sumbull[1], o zëmbake,
Hap krahët flutro,
O Teft', o fluturake,
Iq në Parajsë shko !!!

———

S' IME BIJE SHPRESËS
(Vdiq në Vlorë 18 Oktober 1914)
(Ndodhet në AQSH F. 429-3-244 me shkrim dore)

Edhè ti, o bij', o Shpresë
Si një lulezë me vesë,
Bij' e vogël e e mitur,
Në pekûle tepër ritur
Merr dhuratë një kurorë
Në Parajs' atje ku shkon,
Edhè hap krahët e lehtë
E flutrò në Qjej përpjetë
Shko, avritu atjè pranë,
Ku kè motrën e vëllanë
Dhe të trè si Engjellorë
Prehi, losni për gjithmonë.
Nè, sado vetëm na latë,
Si t'ët ëmë, si t'ët atë,
Sa do q'iktë e u ndatë
Paçi bekim e uratë,
Kurrë, kurrë s'u harrojmë.

Mendja, shpirti me ju tok,
Sa fatbardh' o bijë jini
Atjè tok të trè ku rrijni,
Dhe sa keq nè po n'a lini '

[1] Sumbull = Syth i bimës, që çel gjethe; bulë.

Po s'e shihni, ah, s'e dini !
Eh ! Durim !....Kështu do rrojmë
Shpres' o lule, bozilok !

SHPIRTIT S' IM' ËJE

(Poezi nga Kristo Floqi, botuar tek Kalendari "Korça", 1913, f. 185-187)

Në mes të kopshtit mbushur me lule,
Me manushaqe e me burbuqe,
Ish një shpatore[1] e bardh' e kuqe,
Rritur me lajka e me pekule.

Një djal' i mitur vinte për hera,
Në kopshn' e bukur dhe e vaditte,
Era e shpatës i përsëritte,
Shpirtin e tija sikur çel vera.

Kur zbardhëllohej e linte drita,
Dhe lulet ishin mbushur me vesë,
Djali lëshohej edhe plot shpresë,
Vij ne shpatorja t' i thom "mir dita".

Shpator' e bardhë, e but' e qetë,
Ndjente gas shumë kur i vij pranë,
Gezim i tyre nuk kishte anë,
Se qenë dashur me të vertetë.

Ishin të lumur shkonin mirë,
Njëri për jatrin jetënë linin,
Tok kuvendonin, tok, hanin, pinin,
Tok rrinin, flinin, plot me deshirë.

---

[1]shpatore = Familje bimësh barishtore shumëvjeçare si shpatorja, shpatëza etj., që i kanë gjethet si shpatë dhe lulet të mëdha, të bukura e zakonisht të mbledhura në vastakë, në kallinj a në vile.Në këtë poezi "djali" është vetë autori Kristo Floqi dhe "shpatore" është e ëma e tij Angjelina.

Se qysh ra puna që djal'i gjorë,
U ndah prej shpatës e u largua,
Në dhé të huaj keq u mërgua,
E la të vetëm edhe pa dorë

Shpator'e varfër s'duronte mallë,
Që kish në zembër për bir' e dashur,
Ish e vrerosur edhe shpirt plasur,
Dhe e mejtuar ! Do t' a shij[1] vallë ?

Djali për hera i ipte shpresën,
I thosh që pritmë, o shpata ime,
Se do vinj prapë, s'të le jetime,
Të dhashë fjalën me "besa-besën".

Po shpat'e gjorë zuri po thahej,
Fletët i binin si koqe thrime,
Ju zhurit zembra në psherëtime,
E zu venitej s' qendronte, s' mbahej.

Po kur një ditë të Vjeshtës dytë,
Një re e zez del n' Hapësirë,
Një tufan fryri keq i vështirë,
Shpatores gjorë i mbylli sytë.

Ju përzhit palca, fletët i ranë,
I iku era që kundërmonte,
Ju thanë rrënjët, râ, më s' qendronte,
I dolli shpirti ! .... Pa djalën pranë ?!

O ! Det i pa anë, Det' i rëpirë,
Fuqi ! Naturë. Gjithësi, Jetë !

[1] shij = shihte

Që ngjall Remetnë[1] pa gjë të metë,
Si për një lule s' pate mëshirë ?

O lul' e bukur o shpata ime,
Q' keq të desha, keq të pëlqenja,
Që pranë teje bridhnja, dëfrenja,
Pse sot m' bëre zemrenë thrime ?

Ti vërtet ike nga kopsht' i vlerë,
Dhe flytyrove me lehtësirë,
Po s' t' arthi keq, s' t' arthi meshirë,
Për bir' e dashur q' e le të mjerë !

Me helm në zembër qanj dit' e natë
E s' ngushëllohet, s' gjen prejtje kurrë
Rri i përzishmë e i sëmurë
S' i pushon shpirti për ty, o shpatë !!!

K. FLOQI

Salt Lake City, 28 Novembr, 1909.

Shpirt ndrituna nana jeme Angjelina
kâ dekë më 2 Octobër 1909
(Ndodhet edhe në AQSH. 429-3- rreth faqes 250)

Z-ës MARGË POZIO

(Mbaj flamurin përpjetë)
(*fortuna adjuvat audaces*)
(Poezi me shkrim dore nga Kristo Floqi.
Ndodhet në AQSH F.429-3-224)

Si thëllëza kur del duke qeshur,
E me gas për mëngjes belbëron

[1] remet = grumbull njerëzish

Si bilbili kur zê ligjëron
E nuk prànë dit' e natë,
Më ke dalë me llërë përveshur,
E me shpres' e guxim po vrapon,
E pa–lodhur lëçit predikon
M' atë zê por si shpatë !
Si një mburrim që mburron kurdoherë
Si një ambull që kurrë nuk pran,
Ndjenjat t'ënde të nalta përndan
E nuk shmangesh kurrë.
Si një lule që çel dimbër-verë,
Po përhap kombësin' më ç'do vent
Është zjarm' është flak ç'do kuvent
Që e flet por si burrë !
Shqiptarë ka mjaft Shqipërija,
Që t'i mbajnë kudo krahënor,
E t'a mprojnë me gjak e theror,
Sa të jenë gjallë.
Po kujtonj se dhe ty Perëndija
Të krijoj si një shpres' e kuxim,
Si një vegël të fortë për xgjim
T'i dalç veprës në ballë.
Mbaje flamurin e shejtë përpjetë,
Mos pushoh kudo je e qëndron,
Se kjo vepër ty mjaft të nderon,
Në ç'do shpirt e ç'do zemër,
Mos u loth po vrapo me të shpejtë,
Mos u hiq prej të naltit qellim,
Shqiptarkat i xgjoh dhe fitim
Për ty mjaft â një embër.
Dora d'Istria ish Shqipëtare
Që shëndrit si një hyll n' historì,

Kam uzdajë praa kshtu edhe ti
Do shkëlqesh no një ditë.
Mos u drasht po qendro kordhëtare,
Xgjohi shoqet me fjalë, me msim,
Që t'i bijen Atdheut përparim
Lulëzim, mirësitë.

SALIH NIVICËS[1]

(Satyrë)
(Dorshkrimi ndodhet në AQSH
F.429-3-345.1)

I.

N'atë Shkodër, at qytèt,
Ç'n'a ka ndodhun, ç'n'a ka gjèt
N'a pat ardhun nji dajì[2]
Një esmèr, mustaqe-zii
Q'e ka kryet si baxhi[3]
Sy e hûndë çinezii[4]
Trup të derdhun okllagì
Ecën si kapodajì
E e quajnë Salih.
Âsht i dijshëm e i matun,
Mendje-hollë, i begatun,
E n'a arth si inspektor

[1]Salih Nivica dhe Kristo Floqi kanë patur miqsi e cila lindi në Shkodër ku shkuan që të dy nga Vlora më 1914. S.Nivica ishte gazetar atdhetar që ka shkruar shumë artikuj me pseudonimin **Godo Duda**. Në ceremoninë mortore të S.Nivica, në emër të Shoqërisë "Vllaznija" Dr. Kristo Floqi i uroi me pak fjalë, paq e qetsi në jetë të âmshueme (Shih revistën "Agimi", viti 1920, Fruer Nr. 10).

[2] daì = Burrë trim e bujar

[3] baxhi = Përdorej për të thirrur me nderim një grua të moshuar

[4] çinezi = si kinez

Mjaft i rand' e madhështor,
Arësimin me ç'do mjeti
E kërkovi, po e gjeti,
Gurr' e dhè e baltë tundi
Sa e prûni më së fundi,
E vjen n' Shkodër Salih-âj
Gjithë shpresë e uzdaj
E shetit rruga e truall
E heq vedin por si buall,
Ndonse ashtë një bretkoc
Mendje-vocër, torroloc.
Por s'e njeh kërkush Salinë,
S'i sheh mendjen por japinë[1],
E kuximi po i shtohet,
Dita-ditën po smadhohet,
Din e hiqet si stoik
Fjal' e tij sa një shinik,
Flet nga pak' e nuku ngutet,
Jo prej dijes, po prej tutet[2],
Se ka frikë mos gabojë,
E i del e shkreta bojë;
Asht i msuar fort erifi[3],
Kush e mburri, veç se çpifi,
Por se hallku e nderon,
Edhe aj s' di psè e dron,
Nuk se trembet, a gjâ tjetër,
Por se s' pa sijsh no i vepër.
Po Salikua mendje-gjati,
Popullin me kut e mati,
Edhè tash don m'u kallzûe,
Gjan' e gjatë m'u tregûe,
Që t'a shohin djelm' e burra

[1] japi = Trupi i njeriut, shtati
[2] prej tutet = prej frikës
[3] erifi = (turqisht) studjues ?

Sa parà i ban lëkura
E t' a dijn' i vogël' i math
Se dhe pleshtin ky e mbath.

II.

Deh, moj Zanë, pa n'a thûe
Ç' ka Saliu q'â trubullûe
E shetit posht' e përpjetë
Edhè duket i pa-qetë ?
Mos dikush n'a e zhigati[1]
E ju prish të ziut rehati,
A mos keq i eci fati
Ose dishkâ tjetër pati ?
Ç' ka i shkreti professor
Edhè sillet kshtû terthôr ?
Ahì, aj, Sali-agaj
Duket se nuk râ më skaj,
Se këtij ju vû për barrë
Për m'e bamun sa mâ parë,
Një gazettë popullore
E të gjall' e tingëllore;
Këtë Saliu kërkon t'a nxjerrë,
Me kalû shokët e tjerë,
Nep e merr edhè premtohet,
E maraz' i tij po shtohet,
Sot me nesër hê të dalë,
Zembr' e tij tallâs e valë,
Edhè mbarset mal' i zii;
Bûj' e madhe ! Ç' leu ? ....Një mii !
Po Saliu nuku hutohet,
Psè e shajnë nuk zembrohet,
Mjeshtërinë gazettare
Ky e kâ të ndryshme fare,
Se me shkrûe bejta e pralla

[1] zhigat = tundoj

E me prèe bishta, kopalla
Kjo â një mënyr' e rèe,
E jo thash' e them e thè !
"Populli"[1] di ç'ka një vlerë
Sa shkruajn në 'të të tjerë,
Pa kur mbetet mbi Salinë,
Qâje Hanko Met-Alinë,
Thua se kè Halimanë
A këndon Dervish-aganë.
Po, Saliu si burrë trim,
S'ndjen as hîr as përdëllim,
Po vazhdon thell' e më thellë,
Tui u tall' e tui u sjellë,
Fut turinë më ç'do gjellë,
Pralla, dokra duke pjellë,
Sa dhemb barku, ka të mshtjellë
Edhè zgrofi zë të vjellë !
Po Saliu nuk i merr vesh,
I duket se hâ përshesh.
Hè ! Po si i bahet halli
A mos â fletë bakalli ?
I çuditshmi ka guxim
Don Qichoti' ndaj ish trim !
Robert School[2]-i psè e pati
Professor (se i ndiu fati).
Mos kujton se ky i ngrati
Dinte ç' ka âshtë zanati ?
Ashtë cok si një Kines,
Që shet lule për mëngjèes
E psè din këndim e shkrim
E merr Shkolla për këthough msim,

[1] Gazeta "Populli" ka qenë botuar në Vlorë nga gazetari Mustafa Qulli, por pas rebelimit të vitit 1914, ai e transferoi këtë gazetë në Shkodër ku ishte bashkpuntor edhe Sali Nivica.

[2] Robert college = shkollë amerikane në Stamboll që frekuentohej nga shumë studenta shqiptarë.

Kshtû dhe Salua shkoj si msûes,
Jo se ishte meritûes.
La-Fontaine-i aq' i ndjerë
Kallzon se bretkosi nj' herë
Doli ûjit, pa një buall
Që po shtrihej për mbi truall,
E i pat lakmi japinë.
Tui e pamun në lëndinë,
E e kapi një dëshirë,
E filloj me të pa-hirë
Por si bualli të bahej
Edhè fryhej edhè âhej[1],
E s'e len as pak marasi
Deri sa u shkrii e ...plasi !
Pra merr shëmbëll, o Salì,
Se dijen s' e kèe mjeshtrì,
Mos të t' gjejë e bretkosit.
Masandej i fryn dhe kopsit.

III.

Po të thras dhe nj'her' o Zanë
Kaliopi[2], qasmu pranë
Në Parnâs a n' Elikôn[3]
Ku do jè e n'a digjon,
Eja shpejt e dridhe vallen,
Se me ty zun' e po tallen,
Shife professor Salinë,
Se u kap me poezinë,
E do fenë me t'a lujtë
Po veç Zoti ty të rujtë;
Hè ! moj Zan' a kèe mërzì

[1] âhej = ënjtej
[2] Kaliopi = sipas mitologjisë greke Kaliopi ishte gruaja e Apollonit dhe nëna e Orfeut, këngëtar i famshëm i Greqisë së lashtë.
[3] Parnâs e Elikôn = dy male në Greqi ku, sipas mitologjisë Greke qëndronin muzat (Zanat)

Se po flas për poezì ?
A din ti kush â poêt,
A po kott bërtet e thret ?
Msoje praa dhe dije mirë
Vjersha â një sent e fshtirë
Se vjershtori do të ketë
Një moral me vjershën vetë !
Edhè po nuk âsht' i zoti
Të të ndezin si baroti,
Ose lehtas edhè butë
Edhè âmbl' e pa u ngutë
Të t' shetit' e të të shkojë
Kû atij qefi t'i dojë
Në për kopshtet ândërore
Me do lule mësimore,
Ajy s' quhet vjershëtor,
Me përdhûnë s' hâ laknor !
E kështu, ju raftë pika
Kush të bajin satyrika,
Kush të merret me elegjì[1],
Ose me nekrologji,
Kush ban hymne edhè drama
Ose luan m' epigrama,
Ase thur një komedì
Dithyramb'[2] e tragedì !
Kshtû të kritikon Saliu,
Se e tha dhe Firdefsiu,
E përmendi Nizamiu
E ka shkrûe dhe Sadiu[3]
E kush din se sa vjershtorë
Të Persisë këngëtorë,
Që Saliu veç i nuhati,

[1] Këngët elegjake ishin këngë melankolike, këngë vajtimi
[2] Dhithyramb = (**Διθίραμβοι**), këngë për nder të perëndisë së verës *Dionisit,* ose *Bakhusit*,
[3] Firdefsiu = Homeri i Persianëve,

Se fitim tjetër nuk pati;
E Homeri – aj i ngati –
E Virgjili e Horati
Tassua[1], Dante Aligjeri,
E Rakina[2] e Volteri
Për professor Saliânë
Terra incognita janë.
Libra t'hueja Saliu
Ka, po s'i këndon i ziu,
Por i mban për bukurì,
Mbasi t'i këndojë s' di.
Hè, morè, Sali Nivica,
Mos kujton se janë gorica
Vjershat e shkreta, q'u ngute
Me mënyrë aq' harbute
T'i gjykosh si t'a preu gllava[3]
A po thè se hâ bakllava,
Muhalebì, hallv' Stambolli
A po mendja kshtû t'a polli,
A të shtyri cmira, nakari
A të hodhë trû gomari ?
Hiqu, morè Salo, hiqu,
Kû s' kè punë mos përpiqu,
Mos u ngatërro o i mjerë
Gozhdë kâmbës mos i verë.
Një këshillë t'ap më së fundi
Shko u bëj msuës gjëkundi
Se ti s'jè për kësij punë
Këtë shkurt po t'a them unë.

Kristo Floqi

---

1 Torquato Tasso = poet, shkrimtar, dramaturg italian i shek.XVI
[2] Jean-Baptiste Racine ishte një dramaturg francez i shek.XVII
[3] gllava = koka

PONTA DEL GADA

(Azores-Portugal)
(Poezi me shkrim dore nga Kristo Floqi)
(Ndodhet në AQSH F.429-3-249.1)

Tri ditt e tri nett lundronj mbi Oqeân,
Desh Zoti sôt në tokë shkela,
M' u duk një jet' e tërë, një zamân[1]
Kjo koh', e thashë se po, ngela !

Azores! o oâz në ket shkretie
PONTA DELGADA, SAN MIGUELLO
Nisi[2] të bukra e shtegje për shtektie
Që me tallas bëni duello.

Ju shof e marr prej jush një ngushëllim,
Një shpresë, si Kollomb' i mjerë
Që mbas kaq det'e valë e thëllim,
Dikur do të shofim dhen'e gjerë.

Kollomb' i gjorë ishte një fatzi,
Nër ato lundra q'i çoj fati,
Se udhëtoj me muaj dhe mezì,
Mbrini në Amerik'i ngrati !

Të isha si Kollombi kisha dek
Andaj s'them gjë e ngushëllohem,
Sod me vapor, kabina e dyshek
Nuk është turp të qanj e të ankohem ?

Po, prap mejtonj se kam dhe pêsë ditt,
Der sa t'harrinj atjè kû dûa,
Kjo më tmeron, më vret e më topit,
Edhe më ngjethet mish e thûa.

---

[1] zamân = epokë, kohë e kaluar
[2] nisi = ishull, ujdhesë

Ah, o e shkreta Amerikë ti,
Sa lark që qënke s'të mejtonja,
Tash po të shof, e kupëtonj, e di
Ty as n'ëndër s'të ëndërova.

I shkret', i ndarë, vetëm, pâ njeri,
Këtë të gjattë rrugë mora,
Ç'kishte me bâa njeriu i shkretë,
Shpresa më mban dhe mû, e jam gatì
T'heq ç'do rrezik në këtë jetë.

Për ty, o Shqypnie mërgohem sôt,
Për ty po shkoj tallaze-male,
Kush din se si e bën embër ajy Zot
E kthehem prapë dal–nga–dal.

———

NË MEST T' OQEANIT[1]

(Ndodhet AQSH F.429-3-249.1)

Fryn e gjëmon me brîtmë ky tufani,
Valët ngrihen si male si stihi[2],
Buçet më t' katër anët Oqeani,
Tallaz i math, poterë e stuhi.

Qjell nuk shëkon se e përfshijnë retë,
Mjergull kudo e dendur rreth e qark,
Ec tuj lëkundun ky vapor i shkretë,
Lufton me valët me krahnor, me bark.

[1] Këtë vjershë e bëra mbasi lâmë "Azores". Tallaz i math, valët ngrihen por si male, vapor kërcet si kur do çahet, një drithmë e tmerr na ka kapë të gjithë passaxherve (Shënim i Kristo Floqit)

[2] Stihi = hije, llamje, kulçedër (K.Floqi)

Tjetër s'dëgjon përveç tallaz' e marrë,
Që ç'do që gjen e fshin e çkatëron,
Kujton gjithkush se kâ përpara varrë,
Kjo frikë kap gjithkënt e e tmeron

O sa mjerim i math i pa–treguar,
Zembra e shkretë friget, të lëshon,
Lodrë nuk ësht' Oqeani i tërbuar
Që po buçet i egër e s' pushon !

Tufan i rrebt, çpërthyes e çkatrûes
Rëmben ç'të gjejë, e përplas, e flak,
Lundër e ç't'jetë gjithënjë gadhnues,
Fuqin' e madhe s'e ndalon as pak.

Shtektarët e vaporit buzë–plasur,
Avriten shoq me shoq me një dëshprim,
Në thelp të shpirtit tmerin duke pasur,
Shtërngojnë njëri-tjetrin me përdllim.
Ah, jam një dhe unë një prej shtekëtarve
Që fati më largoj prej Atdheut t'im,
Që jena kruspull ktu si sogj' e t' marrve
E n'a rref zembra me të math tiktim[1].

Kû di shtëpia jeme ç'po heq unë,
Të dashurit e mij s'i kam, s'i shoh,
Ah ky tallaz nuk ësht'e vogël pûnë,
Sa vjen rreziku shtohet, po e njoh.

Ah, kur do dukesh o tok' e urûar,
Le të të shoh dhe nj'herë pa të vdes,
Le të shpëtonj prej valëve t' harbuar,
Pra tjetër pasuni' as dua, as pres.

O,o! po tundet ky vapor i shkretë,

[1] tiktim = n'a bën tik-tik (K.Floqi)

Çohet e ûlet s'di deri kû,
Truall i tij përpjet e tatëpjetë
Po ikën prej këmve mija... u bû bû !...

S' na është mjaft tallazi e potera,
Po që, dhe kapitani po bërtet,
Me zë të ashpër që të çpon si grera,
Alarmë, Alarmë popullit i thret.

Fishllen duduku[1] i vaporit t'ngratë,
Dhe sokëllin tallas e er' e rêe,
Dhe një tjetër vapor i gjerr' i gjatë
Tfaqet mest mjergullit po si rrufêe !

S'po shofin njani-tjetrin nga t'ja mbanjë,
Lundrimin seicili e ndalon,
Prorin e njani-tjetrin s' munt t' ja ndanjë
Se mjergulli nuk hiqet, as kalon.
Trishtim i math n'a kap i pa-rëfyer,
Një drithmë funt e krejt n'a depërton,
Të gjithë syt' atjè i kemi kthyer,
Edhè një djers' e ftohtë n'a kullon.

Desh Zoti dhe mbas pakë nee shpëtuam,
Vapori mori ûdhë edhe shkoj,
Vërtet rezikn' e math ne e kaluam.
Por atë çasht të mnershëm s'e harroj[2].

———

[1] duduk = Pipëz a zamare e bërë me lëvore shelgu (këtu "sirena")
[2]Kjo ish e para herë që e shkoja Oqeanin për me shkûe n' Amerikë, pse mbas ksaj heret edhe 3 herë të tjera e kapërxeva Oqeanin Atllantik (K. Floqi)

NJË VËSHTRIM MBI POEZINË

EPI – DRAMA – POEZIJA LYRIKE

Prej **Dr. KRISTO FLOQIT**

(Artikull i botuar në Revistën "Hylli i Dritës
Nr.11 Nëndor 1936 f.528,Nr. 12 dhjetor 1936
f.602, Nr. 5, Maj 1937 f. 240, Nr. 6 qershor 1937
f. 299)

Fjala **Poezi** vjen nga fjala greke **ποίησις** që derivon nga verbi **ποιω** = bënj, krionj, godit dhe në pikpamjen letrare tregon mjeshtërinë për krijimin e një vepre letrare në vargje të matura e rithmike.Ajy që merret me kësij veprash quhet **Poet**, që në Shqiptarët e quajm me fjalën **vjershëtor**, ose **vjershëtar** prej fjalës frënge **vers**, që d.m.thënë **varg.**

Poezija është një nga hartet e bukura letrare.Poeti me anën e vargjeve të tija metrike, ose syllabike zhvillon ndjenjat, ândjet dhe dëshirat njerëzore, tuke i mveshur me fuqinë e mendjes dhe me zjarmin e fantasis të tija. Dhe, sikurse drita çquan ngjyrat e ndryshme tuke u dhënë dallimet e tyre karakteristike, ashtu edhe mendja ose fantasija poetike ndritshon brenda në ndërgjegje njoftimet dhe kuptimet e ndryshme të njeriut, tuke i ngrehur këto në kulmin e tyre. Gjithashtu vepron poeti dhe për natyrën e stolit e saja.

Poezija është e vjetër sa edhe fjala e njeriut. Ka lindur me njerinë bashkë dhe nuk i është ndarë kurrë. Me hovin e zhvillimin që ka marrë harriu të bëhet një mjeshtri e hollë e e naltë, një mjeshtri hyjnore, si e kanë quajtur shekujt. Po për këtë qëllim poezija ka pasur edhè mystët e saj, domethënë bashkëpunëtorë të zgjedhur e të zotë, të pregatitur ose të lindur poetë, sipas proverbit latin **Poeta nascitur**, d.m.th. poeti lindet prej natyret, të cilët këtë mjeshtri e kan pajuar si duhet dhe e kanë ngritur gjer në kubën e Qiellit, me brillandet monumentale të paçmuarshme që krijuan vetë e që na lanë si trashëgim.

Shumë vepra që kanë bërë fjalë mbi poezinë e mjeshtërinë e saj janë konsideruar kohë mbas kohet, si vepra authentike ose

si simbolla vjershimi, sepsè këto mundemi t'a themi, kanë udhëhequr poetët e kanë llamburitur ndjenjat dhe esthetikën e njeriut. Mê të përmendurat nga këto vepra janë **Ήποητική** e filosofit Aristotelis, vepra *De arte poetica* e Oratit, *Arti poetik* i *Vidas* në tri këngë (fillimi i shekullit XV) dhe *L'Art poetique* e frëngut Boileau në katër këngë.

Poezija si kur se dihet, përbën një nga llojet mê kryesore të llogotehnisë, ose të mjeshtrisë fjalore, kur se lloji tjetër është e quajtura prozë dhe ndryshimi midis këtyre është ky, që poezija formohet në masë e në rythmë, por se proza është e lirë krejt. Nga ana tjetër poezija i drejtohet fantasis e ndjenjes shpirtnore, kur se proza i sillet aftësis mendore të njeriut.

Vjerrsha natyrisht është mê e vjetër se proza, për arsye se këjo është formuar edhe para se të jetë nevoja të shkruhet, ose të burojë nga ndo një farë qytetrimi, se mjafton që është marrë e ka qarkulluar gojë më gojë, prandaj edhe quhet *vjerrshë gojore* dhe është e pandarë nga muzika e nga vallja, të cilat edhe këto bazohen në masë e në rythmë.

Llojet e Poezis janë pikërisht trì : **Epi**, **drama** dhe **poezija lyrike.**

Letraturat e reja dallojnë 6 lloje poezije: *Poezinë epike*, *poezinë dramatike, poezinë lyrike*, *poezinë didaktike*, *poezinë pastorale*, ose blegtorale dhe *poezinë fugjitive* (greqisht **Φευγαλέα ποίησις).** Prej këtyre, poezija epike nënë-ndahet në *Epopenë heroike*, në *poemën heroike*, në *epopenë badine*, ose lodrore, në *epopenë heroiko-komike* dhe në *epopenë burleske*,që është epopè shumë komike, ose tepër për të qeshur.

Poezija dramatike dallohet në *Tragjedinë* e në *Komedinë*. Poezija lyrike përmban *Odën*,(**ωδή**) *Elegjinë*, *Kantatën* (që është një farë vjerrshe për muzikë),dhe *Këngën*, që janë këngët popullore. Poezija didaktike ka parasysh *poemin didaktik*, *epitrën* (**έπιστολή**), *satyrën* edhe *prallën*. Poezija pastorale përmban *idyllin* dhe *ekllogën* (**Είδύλλιον**, **Έκλογή**) prej të cillavet të parën e shkëlqeu poeti grek *Theokritos* dhe të dytën poeti latin *Virgilius*. Sa për poezinë fugjitive, këjo përmbleth *soneton*, *trioletin*, *balladën*, *epigramën* (**έπίγραμμα**), *epithallamin* (**Έπίθαλαμιον**),edhe

madrigalin, që formohet prej këngëve dashurije. Nè do bëjmë fjalë këtu për të trè llojet kryesore të poezisë, si thamë edhe mê sipër, d.m. thënë për *Epin*, *Dramën* dhe *Poezinë lyrike.*

Para se të fillojmë studimin t'onë vërrejmë përgjithsisht, se vjerrsha mburron prej popujve vetë, të cilët janë faktorët e vërtetë të saj e sidomos të Epopesë, dhe poetët s'janë tjetër përveç se interpretët, ose dragomanët e tyre. Sidomos mbi gjithë llojet e vjershës e sido shohim mê poshtë mbi vjershën epike, shënojmë se Grekët e vjetër kanë thurur një epopè t'atillë, që ka shërbyer si model mbi gjithë poezit e tjera të popujve të Oksidentit që zbresin nga raca Aryane, prandaj është edhè për të vënë rè e për të studijuar mê thellë e mê imtë.

Poezija greke e ka djepin e saj në Thrakë, atdhènë e vërtetë të *Musavet*, ose si i quajm nè të *Zanavet.* Prej Thraqit u përhap në Greqinë tjetër e sidomos ndaj[1] populli i Jonëvet të Asisë së Vogël dhe në ishullat e tjera greke, kështu që shohim se me atë gjuhë, ose dialekt Ionik u shkruan veprat e pavdekura të Homerit në exametrin daktylik.

Piksëpari do merremi me **Epin**, dhe epopènë dhe me zhvillimin e ktyre në kombet mê të përmendur të Botës.

I.

EPI dhe **POEZIJA EPIKE** (Epopéja).

Epos është një fjalë greke dhe sinjifikon *thënjen*, ose *fjalën*, po ka edhè një kuptim tjetër letrar që symbolizon *vjershën heroike* dhè ahere vjersha merr embrin *Epopè* (**ἑποποῦα**). Në këtë embër përmblidhet shumica e vjershave epike të një populli.

E para poezì lyrike që lindi përpara poezis epike ishte një hymën përpara Zotit, e mê von hymën për prîsat e një orte, ose e një kombi, për fatosat e për luftëtarët kombëtar. Këjo farë poezije përmblidhej sidomos në këngë të ndryshme, me të cilat lavdëroheshin Perënditë, ose veprat e disa fatosave kombëtarë dhe për bazë kishin prallën, ose gojëdhënjet. Po shpesh herë edhè vepra

[1] ndaj =nga (jo vetëm Kristo Floqi, por edhe autorë të tjerë,sidomos nga Jugu i Shqipërisë,në atë kohë përdornin "ndaj", në kuptimin e sotshëm "nga").

të gjalla trimërije e të vërteta përmbanin këto këngë, të cilat ishin të thurrura prej elementeve të tjera, të marruna nga lufta të rrebta dhe nga triumfe të mbëdha, me të cilat inspiroheshe populli dhe krenoheshe për origjinën e tij kombëtare. Për këtë arësye epi e sidomos epi lyrik ishte kurdoherë një karakter thjesht luftëtar.

Filosofi *Aristotelis* e quante epin si "një imitim të bukuris me anën e tregimit" po filologu frënk *Gaston Paris* thotë se "epi s'është tjetër veçse poezija kombëtare e një populli e zhvilluar, e plotësuar dhe e përmbledhur". Epi bazohet më fort mbi këngët popullore dhe kështu ngreh mbi ato një ndërtesë të vërtetë e madhë-shtore.

Epi në këtë pikpamje është një krijesë spontane, që përfaqson shpirtin kombëtar dhe kështu munt të jetë *naturor*, ose *teknik*. Epi natyror është cok ajo poezija popullore e pastrukur[1] dhe e paplotësuar. Me anën e këtij epi vjershëtori tregon ç'do gjë që shpëtoj e mbet në gojën e popullit prej kohëve të kaluara, prallë qoftë, ose histori e vërtetë dhe përpiqet t'i japë kësaj vjershe një ngjyrë më të forta e më impresionuëse. Të epopesë së vjetër kemi dy monumenta klasike ILIADHEN dhe ODHYSENË e Homerit, si dhe epopetë hindase NÂHABHÂRA, ose MÂHABHARATA dhe RAMAYÂNA. Të Epopes së rè kemi epopenë gjermane, (*Niebelungenlied*),epopetë skandinave (*Saga* dhe *Edda*), epopetë frênge, sllave, epopetë ivirike[2] (spanjolle e portugeze) epopetë boheme, italike, këngët armatolike greke e disa të tjera.

Epi teknik ose artificial, ka një karakter të qëndruarshëm edhe është produkt i një qytetërimi të zhvilluar. Lânda dhe heroët e këtij janë marrë zakonisht nga poetët në mënyrë konvencjonale ose symbolike, prandaj ky lloj epi, pajosur edhe me shpirtin poetik, ose me fantasin'e poetit, ka mundur të harrinjë kulmin e ndjenjave e të mendimeve, si kur se ngjet në *Eneadën* e Virgilit e në *Lusiadat* e portugezit Camoens.

[1] pastrukur – këtë fjalë e përdor Kristo Floqi, por edhe autorë të tjerë të kohës së tij në kuptimin "pastrukturuar", "jo e lëmuar"
[2] ivirike=iberike.

Historija e epit është e gjatë shum. Po thua se ç'do popull ka lavdëruar fatosat e tij me këngë më fort, që kanë mbetur tradita për brezat e tjera. Në popujt e Asis p.sh. shohim se *Konfuki* në monumentin e tij *Si-King* ka përmbledhur gjithë këngët e vjetra heroike të Kinezëvet. Assyriani *Ixhubar* për-shkroj epopenë babyloniane. *Pentavri* la epopenë e pavdekur të mbretit Ramsy të II të Egjyptit mbi luftat që veproj ky kundra Hetejvet (Hitti, Kitti, ose Hatta). Libri i Jobit, hymni i Deborrës na tregojnë gjithashtu existencën e epit Judajik. Por ato që kanë një rëndësi të posaçme poetike e që meritojnë të zihen gojet janë, si thamë të dy epopetë hindase Mâhabhârata edhe Râmayâna. Ndër këto permblidhet historija mbarë e hindasvet dhe traditat nacionale të tyre. Mâhabhârata ka 220.000 strofa exametrike dhe tregon zihjet midis dy familjeve të Hënës *Kurrû* dhe *Pantû*, si dhe triumfet e *Krikna e Ardjûna* në shekujt XV e XVI para Kr. Është një epopè sanskrite e *Vyassa-s* shumë e naltë e madhështore.Râmayhâna, poezi epike edhe religjoze bashkë, është një epopè sanskrite prapë e *Valmikit*, ka 96.000 strofa exametrike dhe përshkruan me shumë mjeshtri luftat e fatosit kombëtar hindas *Râma* kundra *Ravâna*-s, prîsit të shpirtënve të mallkuar. Që të dy këto vjersha të mbëdha frymëzohen prej një fantasije të naltë sa edhe pasurore poetike.

Epi grek, qysh se filloj (1.000 vjet para Kr.) edhè gjer në ditët t'ona u mbajt i gjallë. Filloj prej Homerit me veprat e tij të mrekullueshme *Iliadhën* e *Odhysenë*, si dhe me disa hymne të tjerë fetarë dhe dallohet në *epin heroik* e në *epin didaktik*.

Periudha e parë e epit hellenik fillon nga Mythologjija me anën e Homerit. Këtë e pasuan *Qarku epik* (**έπικός κύκλος**), që përbëheshe prej tri epopève të mbëdha *Tsebais, Epigonoi, Oedipodhia* (**Θηβαϊς**, **Έπίγονοι, Οίδιπόδεια**). Pas këtyre vijnë me radhë *Epet Kypriake* (**Κύπρια έπη**), *Iliou Allosis* (**Ίλιου Άλωσις**) *Nostoi*, (**Νόστοι**) *Telegonia* (**Τηλεγόνεια**) etj. Pas këtyre pason vjerrshëtori tjetër epik *Hesiodhi*, i cili la trashëgim dy vepra madhështore epike, *Theogoninë* (**Θεογονια**) dhe *Erga kai Ímerai* (**Έργα καί Ήμέραι**).Që të dy veprat e Hesiodhit janë ep didaktik. Kombi grek ka vepra epike më shumë se ç'do komb tjetër, të

pasuruara e të frymëzuara prej një fantazije tepër të pasur, të naltë e të jashtazakonshme.

Latinët nuk mundnë të formojnë një epopè origjinale të tyren, sepsè poetët romakë nuk kanë mundur të largohen nga influenca e poezis epike greke, kështu që poezit e tyre epike e lyrike s'janë tjetër veç se një imitim i poezis hellenike.

I pari poet epik romak *Livius Andronicus* ishte nga origjini grek. Ky përktheu lirisht Odhysseian e Homerit. Të tjerë, po jo me ndo një rëndësi të çquar janë *Navius, Ennius, Hostius* edhè *Furius*.Oratori filosof *Ciceroni*,(Marcus Tulius Cicero) përshkroj në masë exametrike aventurat e tija në internim. Poeti *Varro* (Terentius Varro Atacinus) përshkroj luftat e Cesarit kundra Sekanëve. Por ajy që mesqelloj në epopenë latine ishte *Virgjili* (Virgilius Marro), që la veprën mê të shkëlqyeshme të epopesë latine Eneadën e cila, me gjithë se është një epopè teknike që imiton Iliadhën e Homerit, është një vepër madhështore e tepër e naltë dhe e çmuëshme.

Eneada ndahet në 12 libra,prej të cilave gjysmat përngjasin me Odhyseian të Homerit dhe gjysmat e tjera me Iliadhën e atij. Eneada, si në pikpamje punimi e thurrje, si dhe në figurat e në përfytyrimet e saj munt të quhet si një vepër origjinale, nji kryevepër sepse është hartuar shumë bukur e me një mjeshtëri të rallë.

Poetë epikë nuk përment të tjerë historija romake, porse *Ovidi, Tibuli e Orati* n'a kanë lënë një numur të math poemash epike, për të cilët flasin mê fort me ironi për qinse talentin e tyre të poetit epik, të cilin nuk e kanë.

Persët janë një komp ku këngët heroike stërditen[1] shpesh e dendur. Luftat e popujve të Iranit kundra çetave nomadhike të Turanit si dhe luftat e Mbretit të Persis Kyrus të madhit trashëguan shumë këngë heroike, të cilat gojë pas goje nuk u shduknë për shumë shekuj. Këto përmbajnë epopenë kombëtare persane dhe do kishin humbur, si kur të mos i kish përmbledhur mbreti *Nusrevan* në shekullin e VI. Këto i kanë shërbyer si bazë poetit të math

[1] stërditen = takohen, hasen. (K. Floqi)

persan Firdefsiut, që quhet Homeri i Persisë (916-1020 pas Kr.)[1]. *Firdefsiu* ka trajtuar epopenë e famëshme persane *Shahname* (librin e mbretëvet), epopè fort të bukur, të këndëshme, e të naltë, që përmban 120.000 strofa dhe përmbleth historin e gjithë mbretëve e heroëve të Persis.

Arabët, të cilët përpara kohës proislamike[2], po edhè në vazhdimin e saj, kanë pasur një poezi mjaft të gjërë, mjerisht nuk patnë edhè një epopè kombëtare. Poezija e tyre, lyrike më fort, është një poezi morali, mësimi e dashurije.Po tuke qënë një popull luftëtar, nuk mund të mbeteshin edhe pa një epopè, prandaj në fillim të kohëve të krishtërimit duall në dritë shumë këngë, me të cilat celebroheshin veprat heroike të fatosave arabë, porse këto nuk mundnin të formonin një epopè të njëshme, sepsè mbetnë si këngë të veçanta në gojën e popullit. Me gjith atë shërbyen si bazë për veprën e madhe, që quhet *Antar*, prej luftëtarit e poetit *Antar*, që vlugoj[3] në shekullin e VI pas Kr., i cili është edhè auktori vetë i kësaj vepre dhe poeti kombëtar i Arabëvet. Këjo është e vetëmja vepër që munt të konsiderohet si ep arabik. Mirë po këtë mungesë Arabët e plotësuan me anën e prozës, me të cilën përmblodhë të gjitha traditat e tyre e sidomos me veprën e dëgjuar romantike *Një mijë e një natë.*

Në poezinë gallate, ose frënge epi fillon qysh me shkatrimin e qytetërimit romak, ahere kur frangët zaptuan Gallatinë (Francën). Epi frënk u zhvillue pas Karlit të math (Charlemagne), personi i të cilit u muer prej frëngjëve si bazë për poezinë epike të tyre dhe këngët që u thurrë mbi trimëritë e veprat e tija e të shokëve të tij janë të njohtura nënë titullin *Qarku Karolian*, ose *Karlo-vingjiân*. Krijonjësit e këtyre këngëve ishin disa këngëtorë popullorë, që i dallonin nënë embrat *joncleurs, menestrels* e më vonë *trouvères* (trobadurë, ose trovatorë).

Letratura frënge përmban një thesar të mjaftë epopesh të çmuarshme. *Kënga e Rolandit* (La chanson de Roland) është një

[1] Sipas internetit Firdusi (Ferdowsi) ka lindur në vitin 940 e ka vdekur në moshën 90 vjeç në vitin 1020. Pra edhe interneti ka llogaritur gabim dt.lindjen e Firdefsiut.
[2] proislamike = paraislamike
[3] vlugoj = lulzoj

kryevepër dhe pikërisht epi naturor frënk, kur se epopet'e tjera frënge zenë vendin e dytë. Të këtilla janë *Berthe aux grans piès, Renaud et Montauban, Fier à bras, Voyages à Jerusalem et à Constantinople, Le pelérinage de Charlemagne, Geste de Doon de Mayance* etj. etj.

Epopèja e vjetër frënge ndahet në dy pjesë, në *Epopenë mbretnore* (Epopée royale) dhe në *Epopenë feudale* (Epopée feodale).

Prej vjerrshavet epike frënge, që patnë marrë për bazë tradita Anglo-normane më të përmendurat janë *Parsifal, Merlin, Tristan et Isolde* dhe *Giron le Cortois*. Kjo e fundit u përkthye edhè greqisht prej Byzantinëvet. Më e mbramja nga veprat epike frënge është vepra e *Voltaire-it L'Henriade*. Të gjitha këto përbëjnë epin teknik frënk, kurse Kënga e Rolandit është ep i kjartë natural.

Gjermanët për ep natyral kanë këngët *Nibelungen*. Këto këngë u bënë nga fundi i shekullit XII, tuke pasur për bazë tradita të vjetra të karakterit heroik, të shekujve IV e V pas Kr. Nibelungen, si edhè këngët epike *Gudrun*, epopét e *Qarkut Dietrich* (Dietrich von Bern) formojnë epopenë gjermane kombëtare.

Nibelungen përbëhet prej 38 këngësh dhe ndahet në dy pjesë, prej të cilave 19 bëjnë fjalë mbi trimërit e veprat e fatosit kombëtar *Sigfrid* (Siegfried) dhe mbi martesën e vrasjen e tij dhe pjesa tjetër prej 19 këngësh të tjera tregojnë gjakmarrjen e gruas së tij *Krimhildës* kundra vrasësvet *Gunther* e *Hagen*. Ipotheza[1] e Nibelungen-it është tepër dramatike, sa nuk i gjindet shoqja nër epopét e tjera të popujve tjerë, me dy fjalë këjo epopé është kaqe e naltë e hartistike sa nuk bëhet më.

Prej epopeve të tjera gjermane më të përmendurat janë *Messiada e Frederik Klopshtock-ut* dhe *Hermann und Dorothèe* e poetit të math *Wolfgang Goethe*.

Për Englezët epopéja e tyre filloj nga shekulli i VI pas Kr. dhe për shkak pati luftat midis të dy popujve të mbëdhej që banonin Anglinë d.m.th. Kimbërve dhe Saksonëve, të cilat lufta i

[1] Ipotheza = shtjellimi,trama,ngjarjet që ndodhin në një komedi, tragjedi

patnë kënduar poetët luftëtarë e fetarë të Kimbërve që quheshin *vardhë*. Këto këngë më von u pasuruan me këngë të tjera dhe formuan disa qarqe epikë. Më të vjetrat e këtyre i shfrytëzoj poeti Engles *Makferson* në shekullin e XVIII, i cili paraqiti nji vark të gjatë vjerrshash epike, që përbëjnë epopénë kombëtare engleze.

Në Angli nuk përparoj aqe shumë epi naturor sa sa përparoj epi teknik.Ky përfaqësohet bukur prej një vepre të naltë e serioze, një vepre madhështore që është *Parajsa e humbur* e poetit *Milton*, në shekullin e XVII. Gjithashtu poezi epike lâ edhe *Byron*-i (*Zara, Manfried, Child Herold etj.).*

Në Spanjë epi natyror përmblidhet në epopenë *Romancero* (Romanthero),e cila është një përmbledhje këngësh popullore që formojnë të dy qarqet e mbëdhenj të vjerrshavet heroike spanjolle, që përmbajnë të gjitha traditat e kombit spanjoll. Qarku i parë përfshin këngët heroike të fatosit kombëtar *Campeador*, të cilat bëjnë fjalë për mbi luftat spanjolle kundra Mauretanëvet. Qarku i dytë numuron këngët që janë thurrur rrotull fatosit *Bernardo del Carpio* dhe tregon betejat e mundjet e mbëdha të spanjollëvet kundra invadorëve të huaj.

Poezija portugeze, sa do që gjindet në ndërlikim (confusion) me poezinë spanjolle për shkak të gjuhës, që është gati një me atë të Spanjës, me gjith atë Portugalija mundi të paraqitë një epopé teknike nga më të bukurat e botës, dhe këjo është vjersha epike e gjatë dhe e naltë *Lusiadat* (Os Lusiadas) e poetit të math portugez *Camoens.* Në ket epopé poeti ligjëron trimërit e bashkatdhetarëve të tij, tuke marrë shkak luftat e tyre dhe gadhnimet në Hind. Për bukurinë që ka këjo vjerrshë dhe për fantasin e fortë me të drejtë Camoensi u qujt *Virgili i Portogalit.*

Italjanët nuk kanë një ep naturor. *Dante Alighieri* me trilogjinë e tij *Divina Commedia*, vepër e pavdekur e shëmbëllore, ka trajtuar një ep të math e të njëshmë teknik. Në këtë ka përmbledhur një shumicë traditash kombëtare,parime fetare dhe fëllqinja[1] politike të Italisë, dhe me këtë mënyrë ka formuar edhè gjuhën letrare italjane.

[1] Fëllqinjë = mundim, përpjekje (K.Floqi)

Poezija epike italjane mori një zhvillim të math pas Rilindjes d.m.thënë prej shekullit XV e gjer në funt të shekullit XVI. Më të përmëndurat vjersha epike të këtij shekulli janë *Il Morgante* e *L.Pulzit, L' Orlando amoroso* e *M. Begiardo-s, L'Orlando furioso* e *Ariosto-s, Il Girone* e *L. Alamanni-t, L' Amadigi* e *Bernardo Tasso-s, Il Primaleone* e *Il Palmerone* të *Ludovico Dolces* me ipotheza të marruna nga tradita spanjolle, Il *Rinaldo* e *Torquato Tasso-s* dhe më së fundi vepra më e bukur dhe e këndëshme prapë e Torquatos,*Gerusalemme liberata* (1530 pas Kr.). Me këtë të fundit mbyllet edhè periudha e vlugut të poesis epike teknike italjane, sepsè u shkruan shumë vjerrsha të tjera epike, po pa një rëndësi të çquarshme.

Vjerrsha epike italjane kanë shkruar edhè Petrarca, Boccacio, Metastasio, Silvio Pellico, Manzoni, Leopardi etj. etj.

Sa për epopét e popujve tjerë shënojmë në vija gjenerike këto: Sllavët, sa do që kanë treguar një dëshirë të madhe për trajtim epopesh, por as Serbët me vjerrshat e tyre heroike që kanë për bazë fatosin e tyre *Markon*, as Russët me gjithë traditat e tyre, nuk mundnë të formojnë një epopé të njënjëshme kombëtare. Çekët kanë një duzinë vjershash të gjata epike, po edhe këto nuk përbëjnë një epopé të njënjëshme kombëtare të tyre. Amerikanët, me anën e poetit kombëtar të tyre *Longfellow* mundnë të përfitojnë një epopé kombëtare *Evangjelinë*. Danemarka epopénë me embrin *Stoerkodder* të **Pramit**, Skandinavët (Suedì e Norvegjì) kanë dy epopè të bukura teknike: *Eddas* që është një përmbledhje poezish mythologjike e legjendare të popujve të vjetër shkandinavas të shekullit XI dhe *Sagas* që është gjithashtu një përmbledhje traditash historike, të përmbledhura prej skalldëve prej shekullit XI e deri XIII. Hungarezët kanë poezinë epike të *Peteffit, Janos Huniadis*, Hollandasit vjershën epike të *Monzit, Wilhelmi i I*, etj. etj. Në gjuhën t'onë si epopé kombëtare kemi disa vjersha heroike të përmbledhura në Bletën Shqiptare (**Άλβνανική Μέλισσα**) të gjyshit t' em *Efthim Mitkos, Historin e Skënderbeut* në vjersha prej *Naim Frashërit, Lahutën e Malësisë* të *Åt Gjergj*

Fishtës dhe *Dëshmorët e Rilindjes*, ose *Epopenë e Korçës* prej *Kr. Floqit*[1].

II.
POEZIJA LYRIKE

Kështu u qojt kjo lloj vjershe prej Grekëve, sepsè këndohej me anën e një vegle që quheshe **Lyra**, instrument i Grekëve të vjetër, që shoqëronte këngën, dhe përbëhej prej 4–8 kordave zorësh, të ngrehura mbi një kafkë breshke që viheshe në veprim me anën e gishtave, si kur se kithara e sotme. Zëri i lyrës ish i thellë e madhështor, i thatë e burrnor, përkundrazi kitharës që e kish zërin të ëmbël e harmonik.

Si mjeshtrit më të aftë të lyrës tregoheshin *Apolloni, Orfeu, Arioni dhe Sapfoja* si dhe më von shumë muziktarë të tjerë.

Definicjoni **lyrik** u pranua edhè prej gjithë popujve të tjerë të qytetërueme, me gjithë që ata të parakohës hellenike kishin instrumenta të tjera, që kishin embra të ndryshme.

Poezija lyrike, e cila është krejt e ndryshme nga poezija epike, formohet prej vjershash të shkurtra, të matura e rythmike që kanë një karakter popullor të lehtë, kurse poezija epike është një poemë e gjatë me një karakter luftëtar, një farë heroismi me ose pa episode dhe përmban një histori të tërë ose shumë tregime historike së bashku.

Përgjithsisht poezija lyrike quhet ajo që shprehon ndjenja individuale, ndjenja subjektive të ç'farëdo kategorije, gëzimi për shembull, hidhërimi etj. e me qenë se këto ndjenja lidhen edhè me përfytyrimet e elementave të tjera shpirtnore, prandaj në këtë farë poezije thelbi është kurdoherë *ndjenja shpirtnore*. Nga ana tjetër, ç'do vjershë që mburron nga një ndjenjë kësodoret çfaq dhe një fuqi subjektive shpirti, me gjithë që ka existue dikur edhè një shkollë poezije lyrike, *Shkolla Parnassiake*, ideali e qellimi i

[1] Dy vjet pas botimit të këtij artikulli, Kristo Floqi përfundoi së shkruari njërën nga kryeveprat e tij "EPOPEJA E SKËNDERBEUT", e cila u botua për herë të parë më 2024,d.m.th. 74 vjet pas vdekjes së poetit. Ajo për-bëhet nga 20 këngë dhe ka gjithsejt 350 faqe në original, por janë gjetur vetëm 13 këngët e para me gjithsejt rreth 8400 vargje të shkruara me mjeshtri të rrallë.

së cilës ishte jo ndjenja shpirtnore, po çfaqja pllastike e botës së përmbrendëshme e së përjashtme.

Shenjat karakteristike të kësaj poezije janë pikërisht *shkurtësija* dhe *llojsija* (varietè) e rythmikës e e masave dhe *varjasjoni* i kompozimit të vjershës. Po edhè këto nuk janë të domosdoshme e apsolute në poezinë lyrike, sepsè ndodhen edhe vjersha lyrike që janë shumë të gjata me strofa të ndryshme, ose të njëjta, ose me strofa që ndryshojnë njëra nga tjetra si në rythmë ashtu edhe në masë.

Poezija lyrike u çfaq mbas poezisë epike, për arsye se poezija epike është zhvilluar në një kohë qytetërimi gjysmë barbar ku njeriu, i përzjerë me ambjente njerëzore e shoqërore, nuk ka pasur ndërgjegjen e një vetqënjeje, kur se lyrismi është pêma e një stine të përparuar, e një jete të zhdrivilluar, ku njeriu ka dalë krejt nga sfera e tërësis dhe ka formuar një personalitet të veçantë.

Hapat e para të poezisë lyrike janë çfaqur bashkë me ndezjen e dëshirës së shpirtit të njeriut për të kënduar e për të dëfryer. Kështu në kohët shumë të vjetra, për sh. në kohët e Kinezëve (1500 para Kr.) çfaqen disa vjersha (këngë) gjujtije, familjare e dashurije. Këto kanë qenë nga të parat vjersha lyrike (me gjithë që asokohet nuk njihej akoma emri i lyrës greke). Këto vjersha janë kënduar me zê, ose me ndihmën e do veglave muzikore. Shumë prej këtyre, tuke kaluar koha, kanë marrë një trajtë didaktike, ose një karakter tjetër.

Në Japoninë e motshme lyrismi u çfaq në shekullin e IX para Kr.dhe gjithë këngët e shkurtra e të ndryshme që existonin deri në atë kohë, të mbetura në gojën e popullit prej legjendash të ndryshme, u përmblodhë e u systematizuan. Këto më fort i referoheshin natyrës, jetës familjare dhe nga ndonjë herë edhe fatosave kombëtarë legjendarë.

Egjyptasit kishin një poezi lyrike mjaft të pasuruar. Ajo u çfaq sidomos me hymnet e shumëllojshme adhurimi dhe me vaj-

timet që i drejtoheshin perëndeshës së madhe *Isis*[1] për burrin e vëllanë e saj perëndi *Osiris*. Një-pjesë tjetër e poezis lyrike egjyptase përmbleth një thesar të mjaftë këngësh melodike popullore, dashurije e alegorike.

Interesant mjaft është poezija lyrike e Judhejve. Populli i Israelit kënaqej fort prej historis së tij fetare, prej së cilës mburron dëshira e tij për lyrismë. Fantasija e tij vrulet prej figurave e fytyrave të llojshme të profetëve të Jehovajt dhe kërcen prej njërit skaj te tjetri me një ândje e zjarmi të jashtazakonshme sipas kuptimit e rëndësis së pikturës, ose figurës së çfaqur.

Qëllimi dhe stohu[2] i lyrizmit ibranik[3] është Zoti i Israelit, *Jehovaj* i math e i pushtetshëm, *Sabaothi*, ashtu dhe mbarshtrimi e rregullimi i botës së krijuar prej dorës së tij, prandaj poezija lyrike israelite shtrihet në psallme të profetëve të ndryshmë dhe formon poezinë lyrike fetare të tyre. Paralelisht me këto është zhvilluar edhè *didaktika kosmike*, që përfytyrohet me fjalët e urta e proverbat e dijetarëve ebraikë, si do mos të *Salomonit*. Poezija lyrike dashurore e këtij, që çfaqet me anën e këngëve, është më të vërtet një poezi sublime, kulmi i të cilavet është kënga famoze që quhet *kënga e këngëvet*, si dhe poezija lyrike luftarake që përmban një visar këngësh epike të fatosave të Israelit, *Davidit* e tjerëvet. Për t'u shënuar janë *Psalmet e Davidit*, ode plot mystikismë i Moisiut passi kapërxeu me popullin e zgjedhur të Israelit Detin e Kuq si dhe psallmet plot kuptim të profetëve të tjerë *Jeremiah, Isajia*, etj. etj.

Në popujt më të vjetër të Hindit poezija lyrike jep krye me anën e hymnëve fetarë hindase, të njohur nënë titullin *Hymnet e Rig Vedas*[4]. Më von vjershat lyrike hindase muern një tjetër

---

[1] *Izis* ishte perëndesha e madhe e Egjyptasvet, vajza e Sebit (Dheut) dhe e Nutit (Diellit), e motra dhe e shoqja e Perëndisë Osiris, që ish më i madhi nga perëndit e Egjyptit. (K. Floqi)

[2] Stohu = esenca, thelbi

[3] Ibranik = hebraik

[4] *Rigveda* (Rig-Veda) është libri më i vjetër i hindasve *Vedat*, që sajoheshin (renditeshin) si më të vjetrat libra hindase (1500-1600 para Kr.) ishin të shumta dhe u përhapnë tuke u systematizuar prej dijetarit e poetit hindas *Vyassa* në

drejtim me karakter didaktik. Të këtilla janë këngët e ditura nënë emnin *Bartrihari*. Në kohët e mëpasme dhe gjatë viseve ku shtrihet lumi i shejtë hindas Gangi, u çvillua një lloj poezije lyrike sentimentale, një poezi dashurije që ishte ajo e qojtura *Gitagavinda* e *Jayadevas* dhe *Meghaduta* e *Kalidasas*. Prej këtyre u përhap m'andej dhe lyrismi fetar hindû që u shtrî an'e kant Hindit.

Persët kanë patur një poezi lyrike shumë të ëmbël e harmonike, si e ëmbël e harmonike është edhe gjuha ariane e tyre. Vjershat lyrike të këtyre janë pikërisht ato të *Zend-Avestas*[1] të cilat i përshtateshin jetës e edukimit të Persëve dhe kishin një karakter thjesht didaktik, një karakter fetar. Padyshim munt të thohet se poezija lyrike persane është nga poezitë më të nalta të Orientit. Po, poezija lyrike me rëndësi që vlugoj mbas shekullit të X pas Kr. ishte ajo që u zhvillua prej poetëve të qojtur *Sufî*, më i madhi i të cilëve ka qënë *Rumiu*, poet mistik, auktori i *Methlevisë* prej afro 5.000 vargjesh. Një tjetër veprë lyrike e këtij është *Divanija* me 3.000 e sa vargje.

Poezinë lyrike persane e pasuroj poeti i famshëm *Sadiu* në shekullin e XII pas Kr. me veprat e tija të çuditshme *Gjylistân dhe Bustân*, ku flet mbi zakonet e jetën e mbretëve të Persis, mbi dashurin e rinisë, mbi edukatën shoqnore, mbi Zotin e mbi lumninë e pendesën e njeriut. Këto dy vepra të Sadiut janë përkthyer edhe në disa gjuhë europjane.

Në shekullin XI e XII u çqua një poet tjetër i naltë persan *Omeri Khajami*, poet mystik e skeptik, poet i thellë e psykollog i math. Vepra e tij *Rubâjat* shënoj një stinë të paharrueshme. Omer Khajami na thotë aty se enigmat e botës s'ka se si zgjidhen, dhe tuke bërë fjalë mbi enigmat më me rëndësi të jetës e të vdekjes, këshillon gjithënjë zbavitjen e lezetin e ç'do gjeje të kandëshme e të hijeshme që mund të kenë të gjallit.

---

katër volume (Shif: *Max Muller, History of ancient Sanskrit Literature,* 1860 dhe *Kägi Der Rigveda* 1881). (K. Floqi)

[1] *Zend* ishte gjuha e vjetër Ariane e shkrojtur, gjuha persane e vjetër. *Zend-Avesta* janë librat e shêjta që përmbajnë doktrinat e Zoroaestrit (Zarathrusta) ose Zardushj,themeluësit të fesë persane(Shif. *A. Williams Packson, The Prophete of Ancient Iran*, New York, 1899). (K. Floqi)

Mê i madhi ndër poetët persanë është padyshim *Shiraziu* që vlugoj në shekullin XIV pas Kr. Këngët e tij lyrike përmblidhen në Engjëjt e Parajsës, në jetën, në dashurinë, në djelmënin e paqetë etj. etj.

Ndaj[1] Grekët poezija lyrike u zhvillua paralelisht me zhvillimin e muzikës hellenike. Kështu u zhvillua poezija melodhike (**Μελική ποίησις**), ku këngët shoqëroheshin me anën e muzi-kës. Këjo poezi nëndahej në dy degë: në *degën Eolike* (ku për-fshihen edhe këngët ionike) dhe në *degën dorike*. Këngët eolike e jonjane kishin një trajtë strofike dhe përmbanin një ton mono-dhik (të një zëri), kur se këngët dorike exekutoheshin me anën e strofës e të antistrofës, tuke u kënduar prej një kori, do me thënë ishin këngë korale, në mënyrë që një palë këngëtorësh këndonin dhe pala tjetër pas asaj përsëritte po atë këngë, ose këngës së parë i përgjigjeshe me anën e një tjetre këngë korale. Këjo ngjan edhè sot ndër nè Shqiptarët, ku një palë këndojnë edhè pala tjetër përsërit këngën e të parëve në aheng në qoftë, ose në valle[2].

Në tri kategori të dallushme çfaqej poezija lyrike greke: *në elegjin* në *jambet* dhe në *odhet*. Këngët elegjake ishin këngë melankolike, këngë vajtimi. Poetët elegjakë grekë ishin pikërisht *Kallynos* dhe *Tyrtaios* në shekullin e VII para Kr. Prej këtyre Tyrteu ishte më i naltë e më inspiruës. Me këngët e tija enthusiasmonte aqe shumë masën e rè, sa derdheshin si të verbër në luftat pa u tundur nga vendi.

Jambi ishte një poezi e shpejtë dhe e gjallë dhe përdorej më fort për të kritikuar dobësitë e të metat e dokujt dhe për të tallur. Në këtë metrë, që ish e përberë prej një rrokeje të shkurtër të shoqruar prej një tjetre të gjatë ka shkruar *Arqilohu* 600 e sa vjet para Kr.

---

[1] ndaj Grekët = nga Grekët, prej Grekëve

[2] Këjo e ka origjinën në dhithyrambet e vjetra hellenike (**Διθίραμβοι**), ku dy herë në vit këndoheshin në grumbuj këngë për nder të perëndisë së **verës** *Dionisojt,* ose *Bakhusit*, një herë në fillim të Pranverës edhe një herë në fillim të Vjeshtës prej grupesh djelmsh e vajzash që rreshtoheshin andej e këtej tuke formuar dy farë dyersh, prandej edhe këngët muarn emnin e dhithyrambe = dydyershe. (K. Floqi).

Odet ishin këngë të ndryshme melodhike që këndoheshin me anën e lyrës, ose të kitharës. Me këto çfaqeshin gëzimet, dëfrimet,mëritë,hidhnimet,si dhe ndjenja të ndryshme shpirtnore. Odet pikërisht ishin këngë lyrike që këndoheshin me anën e veglave muzikale, ose edhe të recitoheshin vetëm.

Në lyrikën eolike këngëtorët mê të përmendur kanë qenë Alqeu, Sapfô dhe Anakreondi. Nga Alqeu e Sapfoja që ishin kontemporanë nuk kan mbetur perveç disa fragmenta, gjithashtu edhe nga Anakreondi, që shkroj në dialektin ionik. Në poezinë lyrike dorìjane kënduan *Alkamani*, *Ariôni, Stesihori, Iliku, Hiponaxi, Simonidhi, Bakhylidhi* edhe mê i madhi e mè i nalti nga të gjithë këta *Pindhari*, i cili këndoj me aqe bukuri e elegancë në gjithë llojet e lyrikës eoliane si për shembull ode triumfale, vajtime, këngë luftëtare (**παιάναϛ**) dhithiambe, hymne fetare dhe ode festimesh (**έπινίϰια**). Nga këto kanë mbetur vetëm 44 ode disa fragmenta nga poezit e tjera. Pindharin nuk e harriu asnjë poet lyrik grek.

Në Italì nuk u zhvillue si kur se në Greqi poezija lyrike, e cila çfaqet nga fundi i Republikës, po edhè poetët lyrikë latinë që u dalluan në at kohë nuk mundnë të formojnë një poezì lyrike, si me thënë krejt origjinale. *Katuli, Horati, Tibuli, Propersi, Ovidi*, me gjithë që shkruan aqe vepra të bukura lyrike të paharruara, por prapë nuk u larguan nga styli e fantasija e Grekëve lyrikë, të cilët i imituan aqe hollë. Romakët kanë pasur edhe një pakicë tjetër vjershash lyrike venduese, por nuk i patnë çvilluar në një trajtë të naltë, sepsè në Italì këndoheshin mê fort këngët greke, që patnë një influencë aqe të madhe e të përhapur mbi gjithë këngët latine.

Nga poetët romakë që përmendmë Katuli ka shkruar elegji e kangë e vjerrsha të tjera shumë të bukura e delikate. Horati, që ka qënë edhè më i madhi i gjithë poetëve latinë lyrikë, ka shkruar shumë poezi lyrike të thella e të ëmbla me një styl të bukur e të naltë. Librat e tija janë gjithsej pêsë. Horati sado që ka imituar shumë Alqenë, Anakreondin e Pindharin, po prapë ka trajtuar edhè vjersha të tjera origjinale e plot bukurì.

Tibuli shkroj elegjì në të cilat tregon një dashuri të dalluarshme, si dhe gëzimet e hidhërimet e tij, që prekin zembrën e njeriut, me gjithë që disa vjersha të tijat nuk kanë hollësinë e naltësinë e duhun, pse janë të cekta e banale. Propersi ka shkruar katër libra gjithashtu me elegjì, por nuk ka stylin e naltësin e Tibulit.

Ovidi ka lënë shumë vepra elegjiake e dashurore, të cilat dallojnë për fantasin e gjallë e fuqin e madhe shpirtnore si dhe për mjeshtërinë e vargjevet. Sikurse prej poetit elegjak Mimnerit ashtu edhè prej Ovidit elegjija mori karakterin e saj melankolik që e shohim edhè sot në vjershat elegjake të reja. Një lloj lyrismi roman kishin edhe këngët e Euquilit, që mê von Ovidi dhe Iuvenali i hartuan në formë satyre.

Në kohën mes–shekullore[1] filluan edhè popujt islamikë të kenë poezin e tyre lyrike.Arabët e kufizonin lyrismin në një vark këngësh që u drejtoheshin të vdekurve të tyre si edhè në një shumicë këngësh dashurije dhe mê von, tuke u influencuar prej doktrinave fetare të Kuranit, filluan një rrugë tjetër lyrismi fetar me disa psallmodhì e këngë melankolike me një harmonì orientale të përvajshme e të këndëshme.

Qeltët, Gjermanët e Sllavët, sa do që vazhduan këngët e tyre lyrike të trashëguara qysh në kohën e paganismit, krijuan edhe një farë poezije të rè fetare, e cila zuri rënjë në qytetërimin e Evropës së krishterë.

Prej përzjerjes të këngëve të Orientit të kohës së kroassadave[2] që hymnizonin disa mbretëresha anadollake, me këngë kavalereske të luftëtarëve kryqëzorë u trajtua një lloj poezije lyrike dashurore që këngët e zjarta t'asaj i këndonin trobadurët. Këto këngë njiheshin nënë embrin gjerman Minnesang. Këjo poezì vlugoj më parë në Provingjì[3] dhe s'andejmi u përhap në gjithë Europën e krishterë.

Mbas shdukjes së kalorësis dhe tuke imituar këngët *Minnesang*, duall në Gjermanì këngë të tjera, që muar titullin të *kryekë-*

[1] Koha mes–shekullore = mesjetë
[2] kroassadave = kryqëzatave
[3] Provingji = Provence–Alpes-Côte d'Azur Francë (**Προβηγκία**)

ngëtorëve (Meistersang). Po poezija lyrike gjermane afroj zenithin e saj me vjershat e pavdekura të poetëve të mbëdhenj gjermanë *Goethe* e *Sciller* gjithashtu edhe me poetët e tjerë gjermanë që vijnë në rangun e dytë, *Heine, Arnd, Kerner, Senkendorf* etj.

Në Francë poezija lyrike shënoj periudha të ndryshme e të shkëlqyeshme. Prîjsit e saj ishin *Ronsar, Boileau,Voltaire, Andrè Chenier, Lamartine, V. Hugo, Alfred de Musset, Alfred de Vigny, Berenger, Soully, Prudhomme, Baudelaire, Rispain, Malarmè, Paul-Verlaine, Vatery* etj.

Në Italì, mbas Rilindjes prîjsit e lyrismit u bënë *Petrarca, Michel-Angeli, Lorenzo de Medici, Poliziano, Marini, Torquato Tasso* e m'andej *Metastasio, Monti, Foscolo, Pindemonte, Leopardi, Carducci, Pascoli, Manzoni, Adda Negri* dhe i mbrami poeti me nam i Italisë së rè *Gabriele d'Annunzio.*

Në Spanjë si poetë lyrikë u dalluan *Garthilalazo de Vega*, *Boscan, Almogaber, Errera*. Në shekullin e XIX u duknë poetët romantikë *Becuero, Campoamor, Ruben dhe Dario,* të cilët shënuan një stinë të çuditshme në logotehninë mondiale.

Poezija lyrike engleze filloj me elegjin e vjetër të Englezëvet, dhe harriu kulmin e saj nga fundi i shekullit XVIII. Poezija e tyre ja mbrîn shumë herë mystiqismit lyrik. Mâ të dallueshmit poetë lyrikë të Anglisë kanë qenë *Edgard Young, Walter Scott, Byron*, *Tennysson, Hardy* dhe në Shtetet e Bashkuara *Edgard Poe, Longfellow, Emmerson, Witman, Dikinson* etj. etj.

Danemarkasit kanë pasur poetë lyrikë *Ailenscleiger, Ingermann e Erachmann*. Skandinavët kishin *Bellman, Tagner, Alterborn, Fraiding, Heiden, Stam, Karfeld,* etj.Hollandasit kishin poetët *Geselle, Verbey, Closs*, Rusët kishin *Puskin, Lermontoff, Tinceff, Fet, Blok*, etj. *Polonezët Michievitz, Krasinski*, *Kasprovitz, Vyspiansky*, etj. Çekosllovakët, *Tzelakofsky, Kollar, Maha-Vrlikn, Brzezna* dhe Magjarët vetëm *Petaiffin*.

Ne në Shqipërì kemi një thesar të mjaftë vjerrshash lyrike popullore e të varguara prej poetëve t'onë të rinj. Zâna Shqiptare është e begatshme. Prej këngëve popullore ato që meritojnë të zihen në gojë janë disa të Shqipnìs së sipërme dhe nga Shqipnija Jugore vlejnë sidomos ato të Labërisë, të Myzeqesë, të Dangllis

e të Devollit që kanë një karakter lyrik-elegjak si dhe balladat e madrigalet me një karakter thjeshtë nacional; por ato që janë më pikante e inspiruëse janë këngët e famshme të këngëtorit Korçar Muços[1], trobadurit të Ali Pashë Tepelenës, që me aqe shije e lezet i këndon edhe sot populli Shqiptar. Këngët e Labris, të Dangllis e ato të Muços munt të shërbejnë një ditë si baza e muzikës s'onë kombëtare.

III.
POEZIJA DRAMATIKE

Tani na mbetet të flasim pak edhè mbi pjesën e tretë të poezisë, d.m.th. mbi **Poezinë dramatike.**

Fjala greke **δράμα** derivon nga verbi **δράω,** që do me thënë vepëronj, punonj, pra fjala dramë **(δράμα)** sinjifikon punën, veprën, ose çfaqjen e një vepre. Në pikpamjen teknike **drama** është një vepër theatrale, në të cilën auktori, ose vjershëtori çfaq me anën e personave të tretë një ngjarje, ku tregohet një gzim,ose një hidhërim,një dëfrim, ose një pikëllim në një mënyrë si kur se t'ishte ngjarja e vërtetë,ose si kur të ngjiste në kohën që e shohim. Kjo ngjarje kuptohet se duhet të çfaqet në sqenë për t'a parë publiku e për t'u impresionuar prej saj.

Në dramën poeti, ose auktori përpiqet të çfaqë ndjenjat e mendimet e tij, tuke i shtjelluar në një mënyrë të këndëshme e inspiruëse dhe tuke ju dhënë një farë përfundimi gëzimi, ose trishtimi.

Në këtë pikpamje drama ndryshon prej tragjedisë, sepsè në dramë munt të marrin pjesë edhe persona komikë, kur ahere drama ka formën e komedisë, kurse përkundrazi në tragjedinë nuk munt të pjestojnë persona komikë. Prandaj në dramën munt të çfaqet ç'do vepër serioze me anën e dialogëve që shkëmbejnë personat çfaqëse, si edhè në komedinë gjithashtu munt të çfaqet ç'do vepër që ka një karakter komik, ose satyrik. Pra, si pas karakterit që të ketë drama, ose komedija merr edhè embrin përka-

[1]personazhin "Muço" Kristo Floqi e ka përshkruar diçka më shumë tek "Autobiografia ime"

tës, që kështu kemi **dramë historike**, **dramë fetare**, dramë **morale**, **psykologjike**, lyrike etj. si ngjet edhè me komeditë. Por tragjedija ka një rëndësi tjetër, se në këtë dominon sidomos trishtimi, melankolija, pikllimi, në një mënyrë të dhimshme e të thekshme.

Drama e ka origjinën e saj qysh në kohët e vjetra greke dhe mori dukje prej kremtimeve që bëheshin për nderin e Perëndisë së verës e dehjes **Bakhus**, ose **Dhionyssos.** Sikur se kemi përmendun edhè më parë mbi poezinë lyrike, këto kremtime bëheshin dy herë, ose katër herë në vit, në fillim të pranverës e të vjeshtës, ose në fillim të ç'do stine të motit. Në këto kremtime populli çfaqte gzimin e tij p.sh. se afrohej pranvera e lulëzonte natyra dhe dëfreheshin të gjithë, ose pikëllimin sepsè vinte dimbri e thaheshin lulet e gjethet e toka, e psè vinte mjerimi. Prandaj edhè këngët që këndoheshin kishin një karakter gazmor, ose pikëllor. Këto këngë quheshin edhè **dhithyrambe** (**διθίραμβος**) e këndoheshin në valle rythmike, do me th. këndonjësit, tuke i kënduar këto këngë, njëkohësisht edhè kërcenjin. Prej këtyre dhithyrambeve pra, dolli në shesh drama, e cilla, kohë pas kohet, mori edhè përfytyrime të ndryshme deri sa u formua tragjedija, e cila është perfeksionimi, ose kulmi i dramës. Dhe u qojt **tragjedi** ajo farë drame, sepsè ata që merrnin pjesë e që këndonin visheshin me petka që përfundonin në këmbë sqapi, i cili sqap greqisht quhet **tragos** (**τράγος**), prandaj edhè kënga e tij u qojt **tragodhija** (**τραγωδία**) d.m. thënë **kënga e sqapit**.

Tuke qënë se rolistët e dramës, ose e tragjedisë ishte nevoja të visheshin edhè me petka të ndryshme, si mbas çfaqimit që deshnin të bënin, ishte nevoja të vishnin edhè petkat analloge, dhe mbassi vendi ku do këndonin, ose do çfaqnin ngjarje duhet të ishte i lartër që të shihej prej popullit, u pa nevoja që të kishte përpara një farë perdheje, që të mos dukeshin auktorët kur visheshin herë pas heret. Që këtej pra, mburroj sqena theatrale. Fjala theatro (**θέατρον**) është vendi i pamjes, sepsè fjala vjen nga verbi grek (**θεάομαι**), që do me.thën shof, kqyr, dhe **theatron** (**θέαττρον)** d.m.th. vëndi i pamjes. Tuke qenë se njerzit që dëgjonin e shihnin auktorët nuk mund të rrinin gjithënjë më këmbë si më

parë, u pa nevoja të storaseshin[1] edhè frona pra, që këtej burojnë parteri dhe lozhet e theatrit. Më von theatri u stabilizua në ndërtesa të posaçme me gjërësi të mjaftë për publikun.

Mbas sa folmë më sipër, drama munt të çfaqej në dialogë që shkëmbeheshin midis aktorëve, ose në këngë që këndonin këta bashkarisht ose veçanërisht secili. Po kur këngët ardhi t'i shoqëronjë edhè muzika, ahere drama mori një fytyrë tjetër, prandaj ato drama që çfaqeshin vetëm me diallogë quheshin drama diallogore, ose vetëm me fjalët *dramë*, *tragjedi, komedi* dhe ato që shoqëroheshin edhè me këngë quheshin *melodhike*, të cilat arti dramatik i ri i quhan *melodrama,* ose *opera*, ose *opereta*, ose *kantata*. Drama, tragjedija, kur çfaqen në proza quhen *drama në prozë*, ose tragjedi, ose komedi në prozë dhe ato që çfaqen me vjersha quhen *drama epike*, në qoftë se përmbajnë èpe, ose *lyrike* në qoftë se kanë lyrismë gjithashtu edhè tragjeditë e komeditë.

Tani të shohim si u shvillua drama dhe pikërisht do marrim parasysh dramaturgët e tragjedijanët grekë, të cilët e trajtuan dramën në një mënyrë të dukshme e klasike. Ajy që i dha trajtën e parë dramës në tragjedi ishte tragjedijani grek **Thespis**, i cili çpiku aktorin e parë me një të folun të rëndë e theksore e sidomos në vjershë. Pas atij u duk dramaturgu tjetër **Frynihu** (**Φρύνιχος**), i cili përdorte po një aktor që çfaqte jo vetëm rrolin e burrit, po edhè të gruas. Pas këtyre u çfaqnë edhè dy dramaturgë të tjerë **Kirilli** (**Κοίριλος**) dhe **Pratina**, por ata që mesqëlluan në sqenën theatrale dramatike helenike ishin tragjedijanët e mbëdhenj **Aeshyli[2], Sofokliu** dhe **Euripidi** (**Αεσχύλος, Σοφοκλής, Εύρυπίδης**). Aeshyli lindi në Elefsinën e Greqisë më 525 para Kr. dhe quhet baba i tragjedisë greke. Ky trajtoj 92 vepra të mbëdha, prej të cilave 69 ishin tragjedi dhe të tjerat drama. Sot kanë mbetur vetëm 7, të cilat janë **Προμηθεύς δεσμώτης**, **Πέρσαι, Οϊ έπτά έπί Θήβας, Ίκέτιδες, Άγαμέμνων, Χονφόρα, Εύμενίδες.**Të trì tragjedit e fundit përbëjnë **triologjin**'e tij që quhet **Όρέστεια.** Sofokliu lindi në Kolonô, katund afër Athinës më 468 para Kr.

[1] storaseshin = vendoseshin, uleshin

[2] Aeshyli = Eskili

dhe prej të 120 e sa tragjedive që trajtoj sot kanë mbetur vetëm 7 prapë, që janë **Mbreti Oedipus** (**Οίδίπους Τύρανος**), **Antigon**i (**Άντιγόνη**) **Elektra** (**Ήλέκτρα**) **Ajazi Telamoni** (**Άϊας ό μαστιγοφόρος**) **Oedipi në Kolonô** (**Οίδίπους έπί Κολυνω**) **Trahiniai** (**Τραχίνιαι**) dhe **Filokteti** (**Φιλοκτήτης**).Sofokliu quhet perfeksionuesi i tragjedisë greke.I treti Euripidi lindi në Salaminë më 480 para Kr. Ky quhet më tragjiku i të gjithë tragjedijanëve grekë dhe prej të 94 tragjedive që përpilloj sot rrojnë vetëm 18. Prej këtyne Aeshyli na e çfaq njerinë si nuk munt të jetë kurrë, kur se Sofokliu e kërkon në perfeksionimin e tij. Përkundrazi Euripidi e çfaq nj'ashtu si është me gjithë veset e këqija e shpirtligësinë e tij, dhe këto i çfaq me hollësi të madhe e me një mjeshtrì të thellë tragjike.

Si thamë, Thespi e Frynihu kishin në sqenë vetëm një aktor por tragjedijanët e mbëdhenj këta i shtuan deri më katër, përveç korit që merte pjesë dhe i shoqëronte me këngë.

Tragjeditë greke e mernin hypothezën prej prallave të vjetra heroike, ose prej traditave prehistorike. Prandaj poezit epike të Homerit dhe gjithë vjershat e tjera kyklike, për të cilat bëmë fjalë në titullin e Poezisë epike përbënin një thesar të madh lëndësh dramatike prej të cilave mernin subjektet e nevojshëm tragjedi-janët grekë.

Theatri grek u transferua në Romë me gjithë përmbajtjet e maskat e tij. Në një kohë që komedijani latin Naevius admetonte[1] në Romë komedinë greke Livius Andronicus mundohej me trajta latine të kombëtarizonte tragjeditë e kohës së Perikliut. Gjithashtu Ennius, Pacuvius, Aetius adoptuan copat greke në zakonet romake.Ovidi vetë trajtoj Medênë, marrë nga Medêja e Euripidit. Por gjith'ato vepra sot janë shdukur. Romakët nuk kishin lezetin e shijen delikate të grekëve, sepse ata preferonin më fort dëfrimet groteske, si kur se ishin ato të cirqeve, të luftimeve e mundjeve, të qerreve, të ekatombeve[2] që bëheshin me anën e luanëve, të ele-

[1] ammettere = pranoj, duke njohur superioritetin e një tjetri

[2] ecatomb (**ἑκατόμβη**) = sakrifikim i shumë viktimave, masakër.

fandëve e të pantherëve, brihjet me buajt, dyluftimet me gladiatorët etj. etj.

Drama në Romë ardhi në dekadencë dhe nuk ishin as invadimet e Barbarëve që shkaktuan këtë dekadencë, as mallkimet e priftëve të Kishës që shduknë theatrin klasik t'Antiqitetit. Theatri klasik u shlye me anën e korrupsjoneve të gustit publik. Arenat, baletot, pantomimat dhe çfaqimet e tjera trashanike që i shijonte më fort populli romak, të gjitha falimentuan artin fisnik theatral grek, artin delikat të tragjedisë helenike dhe diskredituan dramat e dijetarëve të mbëdhenj,sepsè zhenija romake rivalizonte brillandat e çmuar të artit grek. Cilat tragjedi kanë mbetur në Romë prej asaj stine të dekadencës qysh në kohën e Imperatoris romake e deri në shkatërimin e Perandoris Okcidentale? As një! Pak rëndësi kanë pasë dramat **Oedipus Rex** e Jul Cezarit dhe **Medêja** e Ovidit, që kishin një subjekt grek, si edhè 10 pjesët dramatike të Senekës në kohën e Neronit. Gjithashtu edhè muzi-ka romake ishte banale e jo e lartër si ajo e grekëve klasikë.

Tuke përshkuar historin e popujve të vjetër shohim se në Hind, drama zhvillohet në fazën e dytë të zhdrivillimit të poezis sanskrite, duke marrë embrin Natâka, prej fjalës hindase nata, që sinjifikon vallëtorin. Kjo fjalë na tregon se arti dramatik hindû e ka mburimin prej valles, e cila valle ishte reservuar për festat e Perëndive të Hindit.

Drama hindase e merr lëndën nga traditat e vjetra, nga zakonet e nga disa fatosa kombëtarë hindas, po e merr edhe nga mythologjija e sajë. Më e famshmja dramë hindase përmendet **Sakuntala** e poetit **Kalidassa**. Për të kuptuar mirë dramën hindase duhet të dijmë mirë Mythologjinë Brahmanike.

Më të përmendunit dramatistë hindas janë, si thamë, **Kalidassa** dhe një tjetër akoma **Bravabhuti**, auktori i dramës "Gjerdhani i Mbretit të Kashmirit, **Shrî Hasha Dêva**".

Theatri hindû është pema e një qytetërimi mjaft të rafinuar. Kompozimet dramatike janë tepër moralë e të dalluar për mendjen e hollë e të naltë që përmbajnë, për stilin e bukur e elegant edhe për kjartësinë. Por edhè muzika hindase, si edhè vallja lozin një rol mjaft me rëndësi.

Historija dramatike, ose e artit dramatik sa për Kinezët përment të pakta pjesë të dramatollogjisë kineze të kohëve të vjetra, sepsè, si merret vesht, drama kineze e ka origjinën qysh prej shekullit XVII para Kr.

Si pjesë dramatike kineze me rëndësi përmenden 100 e sa pjesë të kompozuara gjatë dynastis së madhe **Youjenëve**. Karakteri i këtyre ka qenë moral. Në këto drama, ose pjesë dramash (se psè vetëm fragmenta kanë mbetur), mëkati është kurdoherë i dënuar dhe virtuti i pëlqyer.

Një nga më të mbëdhatë e mâ të bukurat dramë kineze është "Bonjaku i Kinës" ose **Bonjaku i familjes Çao**, të cilën e defiguroj keq Volteri me dramën e tij **L'Orphelin de la Chine.** Gjithashtu është edhe drama tjetër kineze **Mjerimet e Hanit**, si dhe drama **Pi -paki** e poetit dramaturg kinez **Kaotong–kija.**

Muzika lot një rol të math në theatrin kinez, sepsè muzika e Kinezëve nj'ashtû si muzika klasike e grekëve përbën pjesë të pandame të ligjeve fetare e civile kineze.

Farën e parë të dramës moderne e gjejmë nga Mes–shekulli, në të qojturat **Mystere** e **Mrekullina**, të cilat ishin drama fetare, dhe urën që bashkon dramën mes–shekullore fetare me dramën kosmike, ose dramën e rè e stërditim për të parën herë nga sheku-lli i XVI pas Kr. në Spanjë ku, i qojturi **Juan de la Encina** trajtoj disa drama blegtorale, që i qojti **Eglogas**. Pas atij përmendet **Bartolomeo de Torrès Naharo**, poeti komëtar i Spanjës, i cili konsiderohet si themeluësi i komedis spanjolle. Vjen mandej poeti i dëgjuar **Lope de Vega**, i cili ka trajtuar aqe vepra theatrale, sa as një tjetër po thua. Thonë se ka shkruar për mbi 1.000 vepra, drama e komedi, në gjuhën spanjolle. Ky e ka titulluar mjeshtrin e tij poetike si **Arte nuevo de haver comedias.**

Me dukjen e **Cervantes** fillon shekulli i artë për dramën spanjole i cili, kontemporan tuke qënë i **Lope de Vega-s**, e konsideron këtë të dytin si "patriarkun e dramës". Pak kohë mbas këtyre u duk mbi Qiellin e Spanjës mê i madhi i poetëve dramatikë spanjollë, i famshmi **Calderon**, i cili famën e tij të madhe e fitoj prej dramave të tij romantike, me të cilat u njoht edhe jashta Spanjës, sepsè shumë prej këtyre u përkthyen në gjuhë të huaja.

Shpirtin e tij poetik të naltë dhe fantasin e zjartë nuk ja kalon asnji poet tjetër. Dramat e tija kanë lënë përshtypjen më të madhe që munt të bëhet dhe kan influencuar, si kur se edhè dramat me famë të englezit **Shakespeare**, gadi gjithë dramat e tjera të Botës, gjithë sqenat theatrale të Europës.

Vendi ku u lint më i madhi dramatist i Botës pas Antikitetit, ësht' Anglija ku theatri laik i vjetër engles pati pregatitur fushën për dukjen monumentale të më të madhit dramaturg mondial, *Shakespeare*-it. Ky trajtoj 10 drama historike, 13 tragjedi të nalta dhe 14 komedi. Këti' i detyrojmë dramën në kuptimin e vërtetë e të kufizuar të saj. Drama në këtë pikpamje është *pasjoni folës, pasjoni ëndërruës, pasjoni lëvizës e vruluës përpara dëgjuesve*. Shakespear-i të bën âqe shpejt me kja sa edhe me qeshë. Të impresionon thellë, të çudit fort, të thek shpirt e zembër, të mallngjen, të bën mellankolik, të bën gazmor e dëfryës, me fjalë të tjera e ka në dorë e e dominon spektatorin me anën e auktorëve që interpretojnë veprat e tija. Munt të themi pa exagjerim se Shakespeare-i dhe Calderoni janë të vetmit që i kanë hyrë në shpirt dramës e që e kanë kuptuar. I pari i jep dramës një karakter spiritualist, tjetri i inspiron një karakter fataliteti krejt specjal.

Anglija ka pasur edhè të tjerë dramatistë me nam, sikurse janë **Poele**, **Loly** dhe **Aeshyli** i Anglisë **Marlow**. Posë këtyre duhet të përmendet i dëgjuari engles poet **Bernard Shaw**, kontemporani i jonë,veprat e të cilit janë imponuar në gjithë Botën. Përveç këtyre numrohen si poetë dramatistë englesë dhe **Ben Jonson**, **Fletzer**, **Dreyden** dhe **Woolswuorth**.

Në Francë, sado që theatri frenk ishte influencuar mjaft prej veprave theatrale të Calderonit e të spanjollëve të tjerë dramaturgë, u preferuan mê fort veprat klasike theatrore, kështu që dramatistët më në zê të Francës **Corneli e Racina** u influencuan në veprat e tyre më fort prej tragjedis së vjetër, dhe veprat e këtyre konsiderohen si vepra të mbëdha të shekullit të artë frënk.

Zhvillimi i dramës nuk pati edhè aq sukses në Francë deri në shekullin XVIII. Deri nga mbarimi i atij shekulli kishte vleftë e qojtura **Comedie larmoyante e Bourgeois et d' Ennery**, prin-

cëve të tragjedisë laike. Rrugën e tyre e ndoqi edhe dramatisti frënk **Victorien Sardou** me një sukses theatral të madh. Gjith'-ashtu një sukses të meritushëm i dhanë komedis frënge dhe **Dumas fils**, **Rispain**, **Lavedan** e **Coppè**.

Pikërisht si tragjedijanë Franca ka pasur katër, *Corneille*, *Racine*, *Voltaire* e *Victor Hugo*, dhe veprat më të përmendura të këtyre janë, *Cid*, *Horace, Polyeucte e Pompée* të Cornelit, *Britanicus*, *Germanicus*, *Andromaque e Iphigenie* të Racinës, *Brutus*, *Zaire*, *Merope*, *Semiramis* dhe *Oedipe* të Voltairit dhe *Ernani*, *Marion Delorme* e *Tribulet* të Victor Hugojt.

Në Itali drama zhvillohet nga shekulli i XVI me anën e dramës pastorale të *Beccharit* dhe më von prej *Tassos*, *Ongarios*, *Loglios* e *Guarinit*. Por ato tragjedi që mund të kenë një vleftë teknike e klasike për Italinë janë tragjeditë e Alfierit, i cilli quhet edhè mê i madhi tragjedijan i Italisë. Ky kishte marrë parasysh më fort tragjeditë frënge të Cornelit e të Racinës dhe prandaj tragjedit e tij frymëzohen prej një ndjenje të naltë patriotike me të cilën përpiqet të inspirohen patriotët italianë për mos me durue kurrë zgjedhën e huej. Nga tragjeditë më të bukra e më të nalta të Alfierit janë:*Maria Stuart*, *Agamemnone*, *Cleopatra*, *Filippo II* e sidomos kryevepra e tij *Saul*. Pas Alfierit shkruen tragjedi edhè *Monti*, *Ugo Foscolo* dhe *Manzoni*, si edhe në kohët t'ona *Gabrielle d' Anunzio*.

Në Gjermanì drama e rè u zhvillua në një trajtë shumë të naltë. Dramaturgët gjermanë tuke e lënë më nj'anë influencën frënge që pati për kaqe vjet drama frënge, muar si shëmblla dramat klasike, si edhe ato të Shakespear-it dhe mbi këto formuan dramën e rè gjermane. Pionierët më të mdhaj të dramës gjermane kanë qënë të dy poetët e mbëdhenj të Gjermanisë **Goethe** e **Sciller**. Me këta bashkë munt të merret parasysh edhe **Lessing** – u. Veprat më të përmendura të këtyre kanë qënë **Faust**, **Egmon** dhe **Iphigenie auf Tawris** të Goethes**, Die Rawuber** dhe **Walensteins Tod** të **Schillerit** dhe **Nathan der Weise** i Lessing-ut.

Gjenerata e romantikëve gjermanë mbas Göthes nuk mundi t'i shtojë gjë dramës gjermane, por me dukjen e kompozitorit të math gjerman Wagner drama gjermane mori një fazë të duk-

shme e me shumë sukses. Dramat e tija *Lohengrin*, *Tanhauzer*, *Parcifal*, *Tristan und Isolde*, *Siegfried*, *Walkerie* etj. etj. mbetnë të pavdekura.

Në shtetet Skandinave drama mori rëndësi me anën e norvegezëve **Ibsen** dhe **Biernson** (Bjørnson) dhe të suedesit **Strindberg.**

Tanithi do bëjmë pak fjalë edhe mbi dramat fetare, të cilat dramatologjija i quan *Mystere* e *Mrekuj*, dhe për të cilat folmë edhè më lart.

Nga shekulli i X në Oksident, si edhe në Orient u trajtuan disa drama fetare, tuke pasur për subjekte ceremonitë kishtare me sqena të marruna prej historis së krishterë e sidomos prej pësimeve të Jezu Krishtit. Disa êtën të doktrinës së krishterë, si **Gregor Nazianzinoj**, **Jan Gojëarti** dhe **Vasili i math**, trajtuan disa drama religjoze si mbas systemit klasik të tragjedijanëve grekë, si kur se panë dritën tragjedija e qojtur **Gsija e të dhetë virgineshave**, **Krishti vuajtës**, etj. etj.

Në Oksident prapë kleri katolik kontriboj në trajtimin e disa dramave fetare, tue çfaqur në kohën e kremtimeve do çfaqime të pjesëve mê me randë-si të Ungjillit. Kështu për sa ditët e kremtimeve, e sidomos ditën e ngjitjes së Krishtit në Qiejtë, priftnat hipnin në vendin mê të naltë të tempullit dhe lëshonin s'andejmi tufa pullumbash. Këto çfaqime patnë kurdoherë për bazë tregimin evangjelik, të trajtuar në prozë në gjuhën latine. Këto drama, që u përhapnë an'e kant të Oksidentit, muarn embrin e **Mysterevet** . Një nga këto drama edhe ajo mê e mira është drama e pësimeve të Krishtit, e njohur nënë embrin **Oberammergau**. Në këto drama munt të sajohen edhe kompozimet muzi-kore të marruna nga Testamentet, ose nga ceremonitë fetare, si për sh. **Oratori i Krishtlindjevet** e **Bach**-ut,**Messiah** e **Händelit**,**Shën–Pali i Mendelsonit**, **Ave Maria** e **Gounojt**, **Virgjinesha** e **Massenet**–it etj. etj.

Sa për nè Shqyptarët, letërsija jonë dramatike numuron një pakicë veprash që nderojnë sidomos dramatollogjinë t'onë të varfër. Kësish veprash kemi dramën e të ndyerit Sami bè Frashërit **Besa**, disa drama të englezit Shakespeare-it të përkthyera prej

Fan Nolit,si kur se **Hamleti**, **Othellua** dhe **Jul Cezari**, disa prapë të Ât Gjergj Fishtës, si **Ifgjenija në Aulidë** etj. etj. si dhe do drama të tjera origjinale,ose të përkthyera të Foqion Postolit, Hil Mosit, Hayhiazmit etj. etj. Sa për vehten t'ime, me qenë se jam marrë prej vjetësh në këtë pjesë të letërsis, me fuqin t'ime të paktën që pata kam mundur t'i shtonj dramatollogjis s'onë 16 gjithsej drama e tragjedi prej të cilave 8 origjinale, që janë **Fè e Kombësi**,**Karl Topija,Pirro Neoptolemi**,**Fatzeza**, **Skënderbeu në Italì**, **Qypërlinjtë**, **Meço Qafëzezi**, **Ymer–agë Ulqini**, 8 të përkthyera prej gjuhëve të hueja, prej të cilave 4 klasike **Mbreti Oedipus**, **Antigoni**, **Elektra** e **Medêja** të tragjedijanëve grekë, dhe 4 të tjera prej frëngjishtes, si **Fedora** e **Atdheu** i V. Sardo-it**, të dy Rashterët** dhe një komedi **L' Avare** të Molierit.

Të gjitha janë lujtë shpesh më suksese. Sa për komedi gjithashtu kam mundur t'i shtonj letrësisë Shqiptare 22 komedi origjinale[1] Dhëntë Zoti u pasuroftë mirë e më mirë dramatollogjija jonë prej dramaturgëve të brezit të ri Shqiptar nj' ashtu si meriton një komb me histori të gjallë.

———

VDEKJA E SOKRATIT

(Poezi e Kristo Floqit, botuar në revistën
"Leka" Shkodër, Nr. 1 viti 1937, f.34
dhe revistën "Njeriu", 1942 Nr. 1-2 f.10)

Sokrati u dënua !....Po pse? Se predikonte
Që duhet me besue vetëm një Perëndi,
Se vetëm një Zot është, njashtu djelmninë e msonte
Ky filozof i naltë, që ishte një çudi !
Dhe kush e akuzovi ? Mjerisht nj' a dy tre veta,
Që nxënës i kish pasur e u pat dhënë msim,
Që pa mëshirë e msyne, ju turrë si shigjeta,
Gjer sa në gjyq e çuan, gjersa i dhanë dnim !

[1] Mbas botimit të këtij artikulli, Kristo Floqi ka shkruar edhe komedi të tjera që përfshihen në listën e veprave të tija, në fund të këtij libri.

Sokrati u dënua, por gjakun nuk e prishi,
As pak s'u turbullua dënimin kur dëgjoj,
As mni njeriut s'i mbajti, s'u tremp, as ju ngjeth mishi,
Zembrim s' tregoj askushit, as mshovi, as mallkoj!

N' atë qelin' e shkretë ku ishte i burgosur
Në moshën e pleqrisë, i ndarë, pa njeri,
I mjerë, i përbuzur, i dergjur, i brengosur,
Ku vetëm vdekjen priste, me helm e mizori,
Sokrati s'e bjerr shpresën, uzdajën s'e hump kurrë,
Doktrinës tij të naltë gjithmon' i rrí krenar.
Idhêt s'i hedh poshtë, qëndron besnik e burrë,
Dhe ligjeve të vendit s'u del aspak tradhtar !
Jo ! Vdekja nuk e trembi këtë njerin' e rallë,
Që shëmbëll desh të ishte për Botën, Brez' e ri,
Si shtetas i një vëndi, si patriot i gjallë
Që për Atdhen' e dashur s' peshoj asnjë njeri !....

Atje ku qetas rinte ky dijetar i ngratë,
Ku jetën po mendonte, problemin, çdo qëllim,
U ngrys e u err moti, harriu e zeza natë,
Dhe gjumi e merr ngadalë, i vetmi ngushllim.
Po flè, po flè i mjeri, si ëngjëll, fort i qetë,
Kush di sa e sa ëndra fatkeqi tash po sheh,
Në ftyrën e kulluar e t' ëmbël e të zbetë
Ajy q'e vezhgëllonte kush e di sa shenja njeh !
Por gjumin s' ja tunt kushi, i shkretë është burgu
Dhe vetëm fill rrojtari përjashta sillet, vren,
Deri të mbrinjë dita, deri të çohet murgu
Të shkretin helm të pijë, që vdekjen n' atë gjen !....

Tek pijtazi[1] po flinte, tek çlodhej pak Sokrati,
Befas u çilte dera, një nxënës brenda vjen,

[1] pijtazi = anash

Miku i tij Kritoni, që fort e desh i ngrati,
Me dhimbj' e sheh, avritet, të zbetë fort e gjen.
Kritoni s'ka dëshirë qetsinë ti trazonjë,
Gjumin e tij t'ja prishë, që aq' i lumur flé;
Dy lote sysh i derdhen. Ka ardhur ta shpëtonjë…
Rrojtarin e të tjerët me pare i ka blé;
Kritoni ësht' i pasur; Kritoni â shpirtë-mirë,
Që për njerin' e naltë s'i dhimbet gjë e mall,
Çdo flî bën ta lironjë. Ka mbrîjt aty pa gdhirë,
Prej burgut ta tërheqë edhé ta marrë gjall.

Sokrati dikur çohet dhe sytë tue fërkue,
Kritonin sheh përpara…i duket mrekulli,
"Qysh herët paske ardhur, pa prit' e pa kujtue….
"O miku im, i thotë, qysh nuk të pa njeri ?
"Qysh hyre ti ktu brenda, kush ty të ka lejue ?
"Rojtari nuk të ndali ? Njeri nuk të vezhglloj ?
"Qysh pragun e ktij burgu ké mundur me kalue….
"A mos ndo një sent tjetër na shkrepi, na takoj ?
"Më folë, pra, më thuaj, a mos ka mbrijt' anija
"Prej ishullës së DHELOS[1] " U duk ? A shihet kunt ?
"Mos popullit t' Athinës i është shtuar mnija
"Dhe ngutet jetës s'ime ti japë sot një funt" ?
Edhè ja pret Kritoni: "O mjeshtri im, qetsohu,
"Se cok për ty kam ardhur…rrojtari më lejoj,
E kam paguar mirë, askush s'më pa, s'më njohu,
"Veç ngutu shpejt të shkojmë, qé qé, dita agoj !
"Me miqt' e mij kam folur këndej me të largue,
"Të gjitha gati janë, do jesh në siguri.

[1] *Dhêlos* (**Λήλος**) është një ishull i detit Egjé (**Αϊγαϊονπέλαγος**). Me qenë se aty bêheshin për mot festime e deri sa mbaronin këtu nuk bëhej as nji exekutim, prandaj pyet Sokrati "a mos ka mbrîjt' anija" sepse kur mbrînte anija prej Dhêlos-it në Piré ishte shêji kjo se exekutimet munt të bëheshin (K. Floqi).

“Por eja, mos bjerr kohën, mos rij tue u mendue,
“Të ikim sa më parë tani që s’ka njeri.
“Për né dhe për të gjithë ti duhesh me jetue,
“S’ durojmë të të shohim të vuash në pleqri,
“O prîjës, goj-artë që kurrë s’ ké përtue
“Me prediku’ të drejtën gjithmonë per djelmrí !
“Ç’ po flet ashtu, i dashur ? Si s’ u mendove mirë” ?
Ja pret me vrap Sokrati – “un’ t’ ikinj, të shpëtonj !
“Më duket se bjerr kohën që ardhe sot pa gdhirë,
“Këtë nuk e bënj kurrë dhe kurrë s’ të dëgjonj.
“Si do të thonë Bota dhe populli grek mbarë,
“Qe vet’ ajy Sokrati gjith ligjet i shkelmoj ?
“Kriton, kështu mos folë, Sokrati s’ ësht’ i marrë,
“Ajy ju shtrohet ligjve, dënimin e pranon.
“Qysh do të flasin nesër, që fshehtas pata hikë,
“Që vdekja më pat trembur, mohova ç’do parim ?
“Për me shpëtue vehten Sokrati nuk ka frikë,
“Një njollë nuk lé kurrë, duhet të kem qendrim !
“Jo, jo, Kriton, të lutem, kot më ké këshilluar,
“Duhen nderuar ligjët, zakonet e ç’do sent,
“*Atdheu është m’ i dashur e më i adhuruar,*
“Nga prindër e fëmijë Atdheu është m’ i shent’[1],
“Themelet e një Shteti nuk munden m’u tronditë
“Për shkak të një personi, dënuar me gabim,
“Duhet të japim shëmbëll, duhet të japim dritë,
“Djelmnija, Bota mbarë duhet me pas’ guxim.
“Në qoftë se né shkelim zakonet katragjyshe
“Si pret të vepërojnë të tjerët paskëtaj ?
“Në qoftë se Sokrati shkel ligjet, sillet ndryshe,
“Si do qëndrojë Shteti, kur ne bijem në faj” !....

Kështu mbaroi Sokrati…Kritoni s’bëri fjalë,

[1] m’i shent’ = më i shênjtë

Dy lott ju derdhë sŷvet, ul kryet, s' kundrështon.
Dera e burgut hapet, xhelati hyn nga dalë,
Dhe helmin tue ja sjellë, Sokratit ja drejton,
Sokrati fort i qetë, e merr, e pî me nj' herë:
Kritoni e sheh, dridhet, një tmerr e depërton,
I vjen ti zhgulë fytin xhelatit e ti bjerë,
Por një bisht syr' i mjeshtrit Kritonin e ndalon.
Nuk shkoj një koh'e gjatë që piu helmin e shkretë,
Sokrati zé ndjen dhimbje, por nuk nxjer zë, duron,
I ra zalí të ngratit, ulet përmbys i zbetë,
Fjala në goj' i pritet, thua se po mbaron !

Çohet me vrap Kritoni për supesh pak e ngriti,
"Mjeshtër, - i thotë - ndalu, ku shkon, né ku na lé ?
"Pa ty nuk munt të rrojmë !...." Kritoni fort bërtiti
Po filosof' i qetë prapë në vent e vé.
I sillet me nga dalë me gjak e trup të ftohtë,
Këshillat mê të fundit nxënësit tij i dha.
E mson se qysh të sillet, ç'do porosi i thotë,
Dhe për të mbramen herë Kritonit kto i tha:
"Tash, mik, ja mbrîni ora të ndahemi të qetë,
"Unë që ta lé jetën dhe ti që ta vazhdosh,
"Po ç' rrug' është m' e mirë e di veç Zoti vetë,
"Lumrinë e vërtetë prej sijsh do ta ngjerosh[1] !

Kështu tha filozofi dhe râ e mbylli sŷtë,
Shpirti i tij i qetë la trupin e flutroj,
Sokrati ndrovi jetën. Bota nuk sheh të dytë,
Perndoj hŷll' i mesqjelltë, Sokrati vdiq !...Mbaroj !!!
Por ideal' i naltë që mbolli nj' ajy burrë
Zû rrënja fort të thella, gjithkundi përparoj,
Doktrin' e tij e vlertë nuk pati vdekje kurrë,
U hap mbi gjithë popujt për jetë lul

[1] ngjeroj = gëzoj, shijoj

VDEKJA E SOKRATIT

(botuar në revistën "NJERIU", shtator 1944
nr. 3, f.14 firmosur me inicialet V.Xh)

Vdekja e Sokratit, që ndodhi nën rrethana q'e bënë pastaj të pavdekshëm sepse, me gjithë që e dinte se ish dënuar padrejtësisht, nuk tregoi mos–bindje në ligjet e atdheut të tij. Ai u ka dhënë themë të parshtatshme si letrarëve e studjozëve, ashtu edhe artistëve për vepra të bukura dhe t'admirueshme.

Sokrati, më i famëshmi nga të gjithë filosofët e botës, ish nga Alopekia e qarkut të Athinës dhe u lind më 470 para Krishtit. Ish i bir'i mermer-gdhëndësit Sofroniskut dhe në rini u dha edhe ky pas mjeshtrisë së t' et, por mbasi s'kish prirje për atë mjeshtri, u hoq dhe studjoi filosofinë pranë Anaksagorës dhe Arkelaut, i ndihmuar financjarisht prej pasanikut Kritonit. E kështu u bë filosof i math dhe donte ndreqjen e të metave të shoqërisë. Sokrati u predikonte bashkëqytetarëve të tij gjithnjë të vërtetën dhe virtutin.

Sokrati nuk jepte mësime në nonjë shkollë të caktuar, as në orë të caktuara, por mësonte që në mëngjes e gjer në mbrëmje, pa ndo një shpërblim të gjith'ata që takonte dyke shetitur, mbi detyrat që kish njëri për tjetrin. Me kohë u shtuan nxënësit e tij, midis të cilëvet kish edhe burra të shquar, si Alqiviadhi, Kritoni, Ksenofoni, Antistheni, Aristippi, Fedhoni, Heskini, Platoni etj.

Sokrati predikonte se ka një Qënie eprore, të cilën e quante Demonion, me dituri e mirësi të pakufishme. Doktrina e tij bazohej në qënien e Perëndis dhe të Shpirtit. Proverb të pëlqyer kish këtë: "Të jesh i drejtë (i virtutshëm) që të bëhesh i lumtur".

Filosofia e Sokratit kufizohej krejt në moral. Të gjitha, sipas Sokratit, duhet të kenë qëllim moralin, të ndihmojnë për moralin dhe t'i binden moralit si qëllim.

Dyke predikuar qënien e Perëndis Sokrati nuk e kundërshtonte drejt për drejt fen'e atdheut të tij, por me gjith'atë dëshironte, në vend të Perëndis së korruptuar të Helenëve Zeus-it, një

tjetër Perëndi të përsosur, që të kish para sysh përsosmërinë dhe lumtërin'e njerëzimit. Mirë po një doktrinë e këtillë munt t'a rrëzonte dal nga dal polytheizmin dhe t'a zëvëndësonte me monotheismin. Ligjet e Athinës ishin të rreptë në çështjen e besimit dhe në rast të këtillë caktonin dënimin me vdekje për çdo qytetar që cënonte perëndit' e qëna.

Por,përveç predikimit të qënies së epërme,Sokrati qortonte dhe regjimin e Athinës, e prandaj bëri shumë armiq, siç ndodh edhe me çdo udhëheqës idealist dhe të drejtë edhe në ditët e sotme. Demagogët kanë qënë edhe janë kurdoherë njerës të rrezikshëm. N'atë kohë regjimi oligarkik ish zëvëndësuar nga ay demokratik, që nuk ish i ndryshmë nga ay ohlokratik[1]. Filosofi Sokrat, dyke shëkuar se qyteti drejtohesh nga njerës të poshtër dhe demagogë, i përqeshte ata në çdo rast dhe theksonte se donin t'a drejtojnë demokratinë pa patur nonjë ide për shtet dhe qeveri. Mirë-po këto tallje i zemruan demagogët e tre nga ata u betuan t'a çdukin Sokratin; këta ishin një pasanik regjës lëkurësh, Anyti, një poet diletant, Meliti dhe një orator, Lykoni.

Këta e paditën Sokratin në Shtetin dhe formuluan kundër tij këtë akuzë trifishe:

1) Se nën titullin "Demonion" do të nxjerrë Perëndi të reja.
2) Se me një predikim t' atillë e korrupton rininë e Athinës.
3) Se predikon parime që i përmbysin ligjet e atdheut.

Këto akuza ishin të rënda dhe e dinte Sokrati, por me gjithatë filosofi nuk vuri as një mprojtës, sepse e dinte se ish i pafajshëm dhe, nga ana tjatër, se s'kish frikë nga vdekja, kur kish për të mprojtur të drejtën dhe të vërtetën. Oratori i math i asaj kohe Lysia shkrojti një mprojtje të mirë nga ana e tij për Sokratin, por filosofi nuk e pranoj, dyke thënë se do të mprohej vetë. Edhe kur e shpunë përpara gjyqit, ay nuk la të ndodhen atje e shoqja dhe fëmija, sipas zakonit, për të tërhequr mëshirën dhe simpathin' e gjykatësve me anën e lotëve për t'akuzuarin.

[1]ohlokratia ose oklokracia, ose mobokracia = Sundimi i turmës, është një term poshtërues që përshkruan një formë shtypëse mazhoritare të qeverisjes të kontrolluar nga njerëzit e thjeshtë përmes frikësimit të autoriteteve legjitime.

Gjykatorja që gjykoi Sokratin përbëhej prej afër 500 gjyqtarësh që ishin nga shtresat më t'ulta të popullit. Dhe kur filloi gjykimi dhe u këndua pretenca kundër Sokratit, ay me një fuqi fjale t'admiruarshme i rrëzoi një nga një të tri akuzat.

Për të parën tha:

"S'kam pushuar kurrë t'i nderoj perëndit'e prindërve të mij dhe t'u bëj kurbane. Dhe e dini mirë se i kam këshilluar kurdoherë miqt e mij që të marrin këshilla nga Orakujt".

Për akuzën e dytë tha:

"Mjaftojnë sjelljet e mija dhe karakteri im. E lutem të paraqiten këtu prindërit e të rinjve, për të cilët thonë se ua paskam prishur zakonet, dhe të dëshmojnë përpara jush dhe meje".

Edhe për akuzën e tretë tha:

"Kam qënë kurdoherë besnik dhe i bindur në ligjet e atdheut, për të cilën edhe luftova kundër armiqve të tij".

Passi u krye gjykimi, 283 gjykatës votuan kundër tij dhe 278 në favor të tij. Kështu u gjend fajtor e duhej të tregohej edhe lloji i dënimit që do të kish.

Meliti propozoi atëhere që të dënohet me vdekje. Por me qënë se ligji i jepte të drejtë atëhere të dënuarit që të kërkonte këthimin e atij dënimi në internim ose gjobë, e pyetën për këtë Sokratin.

Por filosofi, passi mejtoi se, po të kërkonte këthimin e dënimit, do pranonte se ishte fajtor, u përgjegj me një ironi të bukur, si vijon:

"O Athinej, me qënë se tërë jetën t'ime ia kushtova shërbimit t'atdheut t'em, dhe me qënë se, dyke punuar kështu e lashë mbas dore edhe familjen t'ime e nuk pranova kurrë pozita dhe tituj, prandaj i vetmi dënim i em duhet të jetë që sa të rronj t'ushqehem Prytanion[1] me shpenzimet e republikës".

Këjo përgjigje kalorëse natyrisht i zemroi shumë gjykatësit e tetëdhjetë nga ata që kishin votuar më parë në favor të tij, tani u bënë kundër tij. E kështu dënimi i Sokratit me vdekje u vendos

[1] Prytanion=në greqishten e vjetër **πρυτανεῖον**, *prytaneion*, "presidencë".

tani me shumicë votash të madhe, por ay s'u trondit as pak, se e dinte pafajsin'e tij.

Kur e shpunë Sokratin në burg, nxënësit e tij u hidhëruan pa masë. Me gjith'atë ndenji në burg tridhjet dit, sepse anija e shenjtë Salaminia kish vajtur në ishullin Dhilo, për të shpënë kurbane në tempullin e atjeshmë të Apollonit dhe si mbas ligjit nuk bëheshin ekzekutime dënimesh me vdekje deri sa ajo gjendeshe në lundrim.

Gjatë kohës së burgimit të Sokratit vinin dhe dëgjonin predikimin e tij nxënësit e tij, të cilët mundoheshin më shumë mënyra për t'a shpëtuar. Kështu, një ditë para se të kthehesh "Salaminia" nxënësi i tij Kritoni, i cili u kish dhënë mirë rojave të burgut, e këshilloi Sokratin që të ikte natën dhe të vejë në pro-nat që kish ay në Thesali. Mirë-po Sokrati nuk e pranoi propozimin e pastaj i dha Kritonit një mësim të lartë për bindjen ndaj ligjit e atdheut. "Qoftë me të drejtë ose pa të drejtë, por sa më dënuan ligjet e atdheut duhet t'u bindem atyreve", tha filosofi.

Dhe me një frymëzim shumë të lartë Sokrati theksoi:

"Nga nëna e nga baba dhe nga të gjithë stërgjyshërit e tjerë atdheu është më i nderuarshëm e më i hirshëm e më i shenjtë dhe më i përfillshëm edhe ndër perënditë edhe ndër njerëzit që kanë mënd. Ato që urdhëron ay duhen bërë e kështu është e drejta e jo të tërhiqemi, as të ikim, as të largohemi nga radha; por edhe në luftë edhe në gjyq e kudo të bëjmë ato që urdhëron qyteti dhe atdheu".

Ditën e fundit të jetës së tij e vizituan Sokratin në burg e shoqja Ksanthippi, me fëmijën e saj të vogël më krahë, dhe nxënësit e tij. E me qënë se Ksanthippi qante shumë, urdhëroi dhe e larguan nga burgu e pastaj Sokrati u foli atyre që ndodheshin atje për pavdeksin' e shpirtit, siç e përmënd Platoni në Faidhon-in.

Mbrëmanet hyri shërbëtori i burgut, i cili, me lot në sy, e lajmëroi se ardhi ora. Sokrati pa u trembur fare e mori kupën dhe e piu pa trazim helmin që kish brenda. Ay helm bëri efektin dal nga dal e Sokrati dyke e ndjerë se i ardhi fundi, u shtri në shtratin dhe dha shpirt në vitin 400 para Krishtit, në moshë 70 vjeç.

Sokrati nuk la të shkrojtura e ato që janë botuar për ‘të i shkrojti nxënësi i tij Platoni, me inspiratën e lartë të dhënë nga mësuesi i tij.

V.Xh.

Për librezën e të I-it Kuvent Kombëtar Kullturor

DRINIT TË ZÎ

(Ndodhet në AQSH Fondi 429-7-001, materjal i daktilografuar)

A ka vënt më të bukur e t’hijshëm,
Se nj’aj vënt ku ti del e mburron,
A ka kënt më të ëndshëm e të hijshëm
Se nj’aj kënt që të mbron ?

N’atë prehrin e bregut plot hije,
Q’e rrethojnë shelgjishta për qark,
Ku mezi rezet Djelli i shtije,
Ti na çfaq cok një park !

Uji jyt, aq’ i ftoht’ i kulluar,
Shkon me vrul, si një trim kordhëtar,
Ngjyrë-blertë, llagar[1], i praruar,
Si kristall, qehlibar,

Ku përfundi leshteriket[2] dallohen,
Që lëvizin me një bukuri,
Si qilima që ndehen e shtrohen
Plot me art e mjeshtri.

Dhe formon dy të vegjël liqenë
Që të k’ënda ti kqyrsh e t’i shohsh,

[1] llagar = i kulluar, i qartë, i filtruar (K.Floqi)
[2] leshterikë quhen ato bimët që mbijnë në funt të liqenit (K. Floqi)

Si dy sterna[1], të thellë legenë
Që me lundra ti shkosh.
Kull' e nalt' e atij Shënt-Naumi,
Dit' e natë të sheh, të përgjon,
Kur ti shtrin rrotull tij vala-lumi,
Që prej gjirit lëshon.
N'ato sheshe të këndshme, magjike,
Do të shtrihem, do rri, do qendronj,
N' atë heshtje prallor' e mystike
Do të thres, do këndonj.
Do këndonj bukuritë hyjnore,
Do ligjronj panoramën që kè,
Vrit[2]' e hijet e kodrat gjelbrrore
Që mbi 'to tjetër s' vè !
Rrugën t'ënde të gjatë pa marrë,
Ti përbën afër teje një vrell[3],
Po ç'farë vrelli, që kurrë s' kam parë,
Që shkreptin e të kndjell
Kur sheh lekat[4] për fundi që shndritin
Që shtektarët të falin, o Drîn,
Si brillande shkëndija të qitin,
Kjo më ngjall, më përtrin.
Pranë teje i gjat' e i gjerë
Shtrihet qetas liqen' i Ohrìs,
Q'i sheh fundin të thell' e plot rërë
Ktij liqenit Shqipris !
Vetëm ti ja trazon, po, qetsinë
M' atë hov që mbi të e lëshon,

[1]sternë=Depo e gërmuar në tokë për të mbledhur dhe ruajtur ujin e shiut.
[2] vri = pyll i dëndur e i mprojtur prej malesh. (K. Floqi)
[3] vrell = burim uji, pus, ujnajë (K.Floqi)
[4] lekën = lloj peshku, femra e koranit

Q’e përçan si tufân, shakullinë,
Kur shbërthen e gjëmon !

E kalon me rëmbim nj’ atë rrugë,
Pa u ndalur, pa bër’ as një bryll,
Gjer sa prek nj’ atë të bukurën Strugë
Si një nuse, një hyll !

O Perndeshë, o Muza goj-artë,
Që po ndehesh si flutur kur shkon,
Më ligjro m’ atë zërin e zjartë
Këtë Drîn q’e shëkon,

Nënë Hënën e plott’ e të zbetë,
Në kanalin ku breth e kalon,
Që Parajsë përbën të vërtetë
Kur belbron e valon !

Në pushimin e natës të thellë,
Ah, ç’ dëfrim e zbavitje që ndjenj,
Të shetit, të shoh Hyjet e Qjellë
Që në jetë s’i gjenj !

Ç’do të thot’ ajo ecje nga dalë,
Pëshpëritjet që rrjedhja tregon,
Që s’ përshkruhet me pên’ as fjalë
Ky myster që vazhdon ?
Edhè ecën në shtratin e bukur,
Dyke lagur Veleshin Shqiptar,
Vala jote, kaskadet e dukur
Shkumbëzojnë si ar !

Shko e piqu me Dibrën luâne
O symbol i vërtet’ i Arbris,
Që bashkon këta vende vigâne
Të Toskris e Gegris,

Dhe me Drinin e bardhë takuar,
Derdhi tutje ku Buna valon,
Tok me 'të si dy shoq të vllazruar
Det' i kalltërt ju fton.

Drin, o Drin, ti o lumi i rallë,
Sa kujtime të ëmbla na jep,
Se fatosin e math e të gjallë
Ti e pè kur s'u ep.

Kur luftonte me trimat Shqyptarë
Bishat t' egra, Çagatët armiq,
Kur krastitte nj' ata pashallarë
Ata turqit e liq !

Sa betêja që pa kjo luginë
Që u lye me gjakun armik
Që shpëtoj an' e kant Shqipërinë,
Q'i largoj ç'do rrezik !

Ty, stërgjyshët e t'onët të parë
T'adhuruan me droj' e me nder
Gjithë Lekët[1] e burrat Shqiptarë
Q' ishin flagë e tmerr.

Po të falem, O Drîn i bekuar,
Shpres' e Kombit, e gjithë Atdheut,
Qofsh për jetë symbol i shêjtruar
I atij Skënderbeut.

DR. KRISTO FLOQI

Tiranë me 11-VII-1942-XX

[1] Lekët = malësorë sidomos të Shqipërisë së Veriut

SHËNT – NAUMI
(Ndodhet në AQSH F.429-11-001 e vijues)

Jemi në majën e Qafës së Thanës, në këtë naltësi panoramike, ku s'ngjinjet syri së pari bukuritë natyrore që ka rreth e qark. Përpara shtrihet liqeni magjik i Ohrisë, si një pasqyrë e gjat'e e gjërë, që reflekton Qiellin e kalltërt dhe malet e mveshura me lisa e me bungje që e rrotullojnë. Syri bije pikë së parit mbi bregun madhështor të qytetit të Ohrisë (Lyhnidhôsi i vjetër), ku përposh e mprapa shtrihet qyteti omonym, Atdheu i Perandorit Roman,Illyrianit Justinian,(Flavius Justinianus) i cili përmblodhi e systematizoj të drejtën Romake (Corpus iuris Civilis), të njohur nën titullin Kodi Iustinian (Codex Iustinianus), që shërben edhe sot si baza e Drejtësisë Romake. Nga an'e djathtë shihet Pogradeci i bukur,cok si një qytet Sviceran buzë liqenit, i cili i përngjan liqeneve të famshëm të Svicrës. Nga ana e mëngjër dallon qyteti zografik i Strugës Shqiptare midis kopshteve e gradinave të dendura me pemë e me lule. Nënë këmbët, në pëqinjt' e një kodrine bukuroshe sheh katundin peshkatar e piktoresk të Linit. Drejt për drejt një tjetër katund madhështor Pèshtani, qendrën e koraneve të shijshëm të këtij liqeni. Për mprapa Qafës së Thanës shëkon fushën e këndëshme e pjellore të Prrenjzës e të Godeleshit, ku tjetër herë legjonet e Pompeit, të mundura prej rivalit të tij Jul Cezarit hiknin me vrap, dyke kaluar nga mali i Zvezdës e për mes Sajigonës (Cangonjit të sotmë) në luginën e fushës së Devollit (Eordheut të vjetër) e dyke dalë m'andej nga an'e Pisoderit për në fushat e gjëra të Thesalisë, ku më së fundi u muntnë prej Jul Cezarit afër qytetit të Farsallës.

Por ajo që të heq vërejtjen e të bën përshtypjen më të madhe është Monastiri i famshëm i Shënt-Naumit, vëndi më i bukur e më piktoresk që munt të ketë Shqipërija jonë.I ngrehur në juglindje të liqenit të Ohrisë, ose të Shënt–Naumit, si kanë zakon t'a quajnë Korçarët, dhe pranë mburimeve të Drinit historik, ose të Drinit të Zî, si e quajnë në Gegërì për të dalluar nga lumi tjetër Drini, që quhet Drini i Bardhë e që mburon afër Pejës së Kosovës,që bashkohet më së fundi me Drinin e Zi dhe që të dy bashkë

formojnë Drinin e math, që edhe ky bashkohet me lumenjtë Kirin e Bunën afër Shkodrës dhe derdhen tok në detin Adriatik.

Monastiri i Shënt–Naumit me ndërtesat e tij të vjetra, përpara të cilave paradel si një gjigant Kulla e naltë e e bardhë e monastirit, shëndrit për së largu madhështor, dyke reflektuar mbi liqenin e qetë e të lëmueshëm, si një idhull symbolik të kohëve legjendare e të tërheq me një herë vërejtjen për bukurinë e madhështinë që ka, me një përshtypje të paharruar. Duket si një shkëmp i mermertë që qëndron për mbi ujrat e liqenit, ose si një fortesë prallore e magjistare e Renit, ku zhvillohen kaqe legjenda të bukura, që i përkasin më fort historisë mythike gjermane.

Është koha më të ngrysur. Koh'e ëmbël e e qetë që paralajmon një natë të këndëshme e dëfrimtare. Atjè tej nga majat e malit të Prespës një hyll i zjartë posa ka filluar të japë krye. Është Hëna e argjentë, Hëna lozonjare, protektoresha e ngushllimtarja e dashuronjësve të rinj, që del e bukur e madhështore, sikur se të na përshëndetë e të na thotë "mirë se na arthtë" në këtë vënt kaqe të hijëshëm, panoramik.

Me një herë Qjelli merr tjetër fytyrë. Malet rrotull bjerrin ngjyrën lilâ që kishin pak më parë prej rezeve të Djellit, që ishte në perëndim, për të marrë një ngjyrë tjetër edhè më të bukur, ngjyrën e sërmit të Hënës, të kësaj Perëndeshës së vjetër, që Grekët e motshëm e quanin Artemis dhe latinët Diana (Dies Ianei), që është gjithë ajo fjala Shqyptare illyre Hëna, ose Hana, që lot rol në Mythologjinë Shqiptare.

Hyjet kanë filluar të xhixhëllojnë si kandila porsa ndezur mbi Qiellin e qartë,ose si shkëndija të zjarta, që bashkë me Hënën e zbetë po reflektojnë e shndritin mbi liqenin majestik. Natyra merr një tjetër pamje fantasmagorike[1].Kudo qetësì s'lëvis as një fletë; s'ndjehet as një zhurmë ere, ose një belbërim shpeshi. Atjè përtej një motoskaf i vogël po përçan ujët e qetë e të kulluar të liqenit, dyke e shpërndarë me krahërorët e tij në vala shkumbëzonjëse e të bardha; është i ngarkuar plot me njerës, që s'janë

[1] Fantasmagorike = efekte që shkaktohen nga një shumicë elementesh që pasojnë njëra tjetrën me shpejtësi

tjetër veç se pelegrinë, që venë të bëjnë pelegrinazhin e tyre në monastirin historik,përpara Shënt–Naumit, dyke bujtur atjè, sipas zakonit e dyke i sjellë Shënjtit thaumaturg[1] kanisqe e dhurata të çmuarshme.

Tani më bije ndër mënt se nesër është dita argëtore e 3 Korrikut, dita e përvjetorit të vdekjes së këtij shënjti që mot e për mot festohet prej popullit besnik orthodhoks me aqe shkëlqim.

Sa nat'e bukur, natë e magjepsur e mysterioze, natë poetike e dëfrimtare nga ato që s' harrohen kurrë !

Zbresim poshtë, dyke marrë rrugën e gjatë më të djathtë të brek-liqenit, dyke ju drejtuar Pogradecit. Aty stërditim grumbuj të pasosur që destinohen për në Shënt–Naum. Shumicën më të madhe e bëjnë Korçarët e Korçarkat me një sasi 3-400 qintsh burrash e grash, të rinj e pleq, e sidomos djelm e vajza, që venë për të dëfryer, pa harruar të sjellin nga Korça dhe disa palë saze për të kënduar e për të kërcyer valle. Midis vullgut[2] dallojmë shumë grâ plaka katundare që, me droje të madhe vijnë t'i falen shënjtit, dyke prurë me vehte edhè disa të sëmurë, sidomos mendarisht për t'u shëruar nga shënjti mrekullor, sepsè janë të bindura se shënjti pa fjalë do bënjë mrekullin' e tij dyke i shëruar këta të mjerë.

Një gjë më bëri përshtypje, se disa prej atyre ishin të zbathura, pa çorape. Pyeta, i kureshtuar psè këjo, a po ndofta s'kanë të blenë çorapë, ose ju mungonte leshi, po përkundrazi më dhanë të kuptonj se këjo ngjiste për respekt të shënjtit, sipas zakonit katragjysh të fetakëve Shqiptarë. Këjo më solli ndër mënt me një herë, se një gjë të këtillë e përmendin edhè vjershëtorët kllasikë Grekë Omeri e Esiodhi, si dhe historianët Grekë Herodoti, Polivi e Plutarku. Omeri për shëmbëll në një përshëndetje që fatosi i math i Trojës Akileusi, i drejton Zotit Dodonas Pellasgjik, protektorit të vëndit të tij, i thotë midis të tjeravet:

[1]Shënjti thaumaturg = Shënjti që bën mrekullira

[2] vullg = grumbull njerezish

Amfì dhe Selloì sy nèusin
Ypofìtai anytòpodhes hameêvnai.

Do me thënë :"Pranë teje, i Zot Pellasgjik i Dodonës flenë shërbëtorët e tu Sellijtë të zbathur e këmbë-palarë."

Dhe këjo ishte për respektin e math që kishin pelegrinët e motshëm për Jupiterin Pellasgjik,gjë që si duket, është trashëguar edhè ka mbetur edhè në kohët t'ona, që gratë, për nderin e drojen e Shënjtit të venë gjer atjè të zbathura edhè bilè, si edhè sot bëjnë kështu, si u informova mirë, edhè për të përfituar mê mirë nga mrekullit'e shënjtit për të sëmurët që sjellin pas.

Të nesërmen drejtohemi për në Shënt–Naum që mbahet vetëm 8 kilometra lark Pogradecit. Kur ju afruam monastirit pamë aqë mizëri njerzish, sa s'kishe ku të rinje, edhè me shumë vështirësi munt t'i përçanje ata grumbuj aqe të dendur.

Monastiri i vjetër i Shënt-Naumit, i ngrehur mbi një bregore të ultë e të kandshëme për bri liqenit, e sidomos në afërsitë ku mburon Drini i Zì, ka një pikë pamjeje aqe të bukur, sa nuk përshkruhet dot me pêndë. Monastiri i pasuruar në Kisha e në qelì[1],ka mjaft oda, ose konaqe për të bujtur shtektarët. Rrotull e qarkojnë liqenët e vegjël që formojnë mburimet e shumta të Drinit, gati të mbuluar me gjethe shelgjesh gjithfarësh që, bashkë me sheshet e bukura, nënë pyllishtet e dendura, formojnë vëndet më të bukur hijeshore, ku munt të hanë e të pijnë e të këndojnë e të kërcejnë shtektarët.

Besonj të mos ketë vënt më të bukur, se vëndi ku është ngrehur monastiri i Shënt–Naumit. Mjafton të përmendim këtu që, dyke lënë monastirin e dyke shetitur me lundrë liqenin e vogël që formojnë mburimet e lumit, e që është mjaft i thellë, vëndevënde 3 e mê tepër metrash me një ujë të blertë e të kulluar si qehlibar, që i shihet kudo fundi e që është brisk i ftohtë, arrin në funt, ku me një herë sheh mburimin kryesor të Drinit. Uji del me rrëmbim dyke gurgulluar e para se të formohet në liqen, përbën një pellg të vogël e të thellë nja 3-4 pëllëmbë, ku grumbullohet

[1] qelì = dhoma të vogla ku banojnë murgjit e murgeshat për t'u autoizoluar

uji, dhe ku gjëndet një mur i vogël me një Konizmë[1] të Shënt-Naumit. Një prift qëndron atjè e e bekon popullin fetak, që vjen aty të pijë ujë e t'i falë diçka Shënjtit, të cillin e spërkat me ujë të bekuar, me anën e një tufe boziloku. Populli heth aty në atë pellk leka me grushte – tjetër herë hithte çereçka e mexhite të argjënta – prej të cilavet mbushet pellgu për llogari të shënjtit, ose më mirë të themi të monastirit edhè diku–diku të kallogjerëve që i shërbejnë monastirit, kështu që, nënë ujën e kristalltë e të blertë shkreptijnë lekat sikur se janë argjënde, ose brillande.

Në të hyrë të monastirit në portën kryesore shohim një Konizmë të vjetër me Shënt–Naumin në ballë, dhe nën atë një bujk që ka mbërthyer qetë e po lëvron tokën. Po, për çudì, në vënt të shohim dy që, pamë vetëm një; i dyti ishte një arì i math, që i mbërthyer edhè ky nënë zgjedhën e drunjtë, po shoqëronte kaun, dyke lëvruar tokën me atë bashkë ! Çudì ! – Pyesim ç'ngjet këtu? Përgjigjen na e dhà me një buzëqeshje të lehtë një nga kallogjerët që na shoqëronte: Shënt – Naumi, na thotë kallogjeri, kishte një çift qèshë që lëvronte tokën. Një ditë, një arì ju hoth njërit kâ edhe e xhvati, e bëri copë-copë. Shënt–Naumi, i paçim uratën, vazhdoj kallogjeri, u zembrua fort edhè me një herë ju faneks në ëndër ariut. Ti, i tha, që më bëre këtë të keqe e që më lè me një kâ vetëm, shkò tani e shoqëroje kaun tjetër dhe lëvromëni tokën bashkë me atë. Edhè mrekullija u bë me një herë. Ariu uli kryet dhe i bindur shkoj e e shoqëroj kaun e vetëm dhe vazhdoj të lëvrojë së bashku tokën, si edhè tokët e tjerë të Shënt-Naumit !

Shënti Naumi vlugoj nga shekulli i IX. Ishte nxënësi i apostujve – më vonë shëntorë – Kyrillit e Methodhit. Gjithë jeta e tij kaloj në përkujdesje e bamirësi për popullin. Besnikërija e tij ne Zoti ishte shëmbëllore, prandaj edhè mori hirin e naltë të thaumaturgjisë, dyke shëruar sidomos të çmendurit e epileptikët.

Shënt-Naumi shkroj edhè një sinaksar[2] të math në gjuhën greke, pse e dinte mirë greqishten. Ky sinaksar u shtyp për të pa-

[1]Konizmë = ikonë

[2]Synaxarium = përmbledhje hagjiografish (biografi e një shenjtori) që korrespondojnë afërsisht me martirologjinë e Kishës Romake.

rën herë në shtypshkronjën e famshme të Voskopojës më 1740, e cilla Voskopojë vlugonte aso-kohet me një popullsi të madhe banorësh.

Monastiri i vjetër – thonë – se u ndërtua prej vetë Shëntit–Naumit. Këtu vdiq edhè Shënti e gjendët akoma varri i tij. Ky monastir ka qenë një qendrë me rëndësi spirituale. Sllavë e Grekë shekuj me radhë janë grirë në mes të tyre kush e kush të munt të përfitonjë e t'a ketë për vehten monastirin e shenjtë.

Ky monastir, përveç mbeturinave e kushtimeve të tjerë të pelegrinëve të ndryshëm që ka, përmban edhè shumë kushtime të tjerë të disà njerëzve me rëndësi,si edhè shkrime,ose dorëshkrime të vjetra historike sidomos në gjuhën sllave.Ka qenë vënt verimi e zbavitje i shumë mbretërve serbë. Aty Aleksandri I Karagjorgjeviç, mbreti i ish-Jugosllavisë, vinte mot e për mot e qendronte gjatë stinës së verës bashkë me të shoqen e tij mbretëreshën. Edhè sot akoma ndodhet në monastir oda e fjetjes së tyre me krevatet e tyre e orendit' e tjera.

Monastiri i Shënt–Naumit ka qënë e është akoma një vilegjaturë[1] e Korçarëve. S'ka Korçar e Korçare të mos ketë vajtur në Shënt–Naum, kaqe sa Korçarët e konsiderojnë si monastirin e tyre, sa edhè liqenin e Ohrisë e quajnë "Gjol' i Shënt–Naumit".

Monastiri i Shënt–Naumit me anën e Konferencës së Londrës i ishte shtuar Mbretërisë Shqiptare, qyshë më 1913. Kështu vazhdoj deri më 1925 kur, në rastin e ratifikimit të kufijve Shqiptaro-Jugosllave ju aneksua Jugosllavisë. Kam qenë deputet aso kohet kur, në Parlament, një ditë pas dreke nga goja e zotit Mehdi Frashërit, që ishte një nga anëtarët e Komisjonit për caktimin e kufijve Shqiptaro–Jugosllave, dëgjuam çkëputjen e këtij monastiri prej tokës Shqiptare për t'ja falur Jugosllavisë, kundrejt Linit me 14 katunde të tjerë me popullsi bullgare që na u dhanë neve. Lajmi i hidhur na pikëlloj të gjithëve. Të gjithë ulmë kryet, me gjithë protestimet që u bënë nga ana e disà prej deputetëvet.Të gjithë e kuptuam se ishim tradhëtuar. Por ç'munt të bënim ?

[1] villeggiatura = pushime verore apo dimrore të përkohëshme në fshat

Por Zoti dikur bën mrekullina, dhe këtë radhë mrekullija ardhi nga bajonetat e ushtrive ngadhnimtare të Boshtit. Monastiri i Shënt-Naumit me interllandin e tij, si dhe gjithë Kontinenti me Pèshtanin e gjer afër Ohrisë, edhè m'andej prej Strugës e gjer në Dibër ju dhanë përsërì Shqipërisë për të mos i lëshuar më nga duart e saja.

DR. KRISTO FLOQI

Tiranë, më 2-VII-1942-XX

HYMN' I ZOTIT



(Ndodhet në AQSH F.429-3-350.
Dorëshkrim)

O Zot' i math i jetës,
Shpëton' Atdhenë t'on,
O drit' e së vërtetës
Mburona nè gjithmon.

Prej tejet Shqypënia
Pret drit' e lulëzim
Prej tejet vjen lumnija
Ti jè për nè gëzim.

Flamurin ti bekona
Të shêjtin arbënor
Fatbardhësin' urona
Ngroh zemrën në krahnor.

Një shpirt të rii Shqypnisë
O Perëndi i fal,
Prej gjumit të robnisë
E ço në jet' e ngjall.
Ti jè e Kombit shpresa
Shqyptari me ty rron,
E fisit t' tija jè "besa"
Me ty gjith kush e dron

O Zot, të qofshim falë,
Ti doret mos n' a lshô
Për ty s' mjaftojnë fjalë
N' a shih e n'a peshô

Ne ty kemi uzdajë
Të rrojmë në këtë dhè
Dhe dorën ti pa-prajë
O Zot e ngjit mbi nè.

Kristo Floqi

KONTRIBUTET E KRISTO FLOQIT
PËR ARSIMIMIN DHE KULTURIMIN E SHQIPTARËVE

A. Kontributi në themelimin e Bibliotekës Kombëtare Shqiptare Tiranë
(Revista "AGIMI" Nr.1
viti 1919 f.1 e vijues)

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë e ka zanafillën e saj në bibliotekën e shoqërisë "Vllaznija" në Shkodër. Shoqnija "Vllaznija" u formua më 16 Fror 1919 nga bashkimi i antarëve të shoqnisë "Mustafa Pasha" me antarët e shoqnisë "Vaso Pasha". Qëllimi i saj ka qenë: "Duem të zgjojmë kombin shqyptar në zhdrivillimin e gjuhës së tij letrare e në kulturën qi ka me vijue mbas tashit, tuej mos u përzi në politikë, por se vetëm në histori,

ethnografi, arqeollogji, gjuhësi e zakone e tradicione kombtare, tuej begatue të dy veglat e përparimit letrar, vjershën e prozën"

Shoqnija "Vllaznija" kishte 4 degë vepruese: degën letrare, degën theatrore, degën muzikore dhe degën gjimnastikore. Kryetar i shoqërisë u zgjodh Hil Mosi dhe Nënkryetar Hys Draçini, kryetar i degës letrare u zgjodh Kristo Floqi, të cilit iu ngarkua detyra e botimit të një reviste të përkohëshme me emrin "AGIMI", të çeljes së një shkolle nate, për mbajtjen e konferencave dhe botimin e librave të nevojshëm, mbajtjen e një libërtores (biblioteke). Në këtë detyrën e fundit ai zëvëndësoi Luigj Naraçin. Pas 1-2 muajve nga data e formimit të Shoqnisë "Vllaznija", Kristo Floqi arrin të botojë më 01 Maj 1919 numurin e parë të revistës "AGIMI" me 13 artikuj prej të cilave 4 janë shkruar nga vetë K.Floqi. Që në numurin e parë të kësaj reviste ai nxjerr këtë lajmërim:

Shoqënija "Vëllaznija"
DEGA LETRARE
(Njoftim në revistën "AGIMI" Nr.1 Maj 1919 faqja e fundit)

Mbasi nji prej qëllimeve të kësaj Shoqnije asht edhe zhdrivillimi i djelmnis në letraturë e mbasi shoqnija ka ngrehë në salon të saj nji bibliotekë, ju heqi vrejtjen patriotike ç'do atdhetarit të ndershëm, të ketë mirsinë me e pajue me gjith farë librash Shqip, ose të gjuhëve të huja qi bajin fjalë per Shqipnì e Shqyptarë, se tuj i ndihmue kështû shoqnìs i ndihmon popullit Shqiptarë edhe Shqipnisë marë.Ç'do dhurtì ka me kenë e mirë pritun me mirë njoftje. Drejtohì në Zyren t'eme ase në Zyrë të Kryetarit të Shoqnìs Z. Hil Mosit në Parrucë.

Drejtuesi i degës letrare
Kr. FLOQI

Brënda pak javëve kësaj thirrjeje i përgjigjen qytetarët shkodranë duke shtuar librat e bibliotekës së shoqërisë "Vllaznija" që kishin dhuruar më parë shtypshkronja "Nikaj" dhe shtypshkronja "Zoja e Paperlyeme" të qytetit të Shkodrës. Edhe vetë K. Floqi dhuron 3 libra.

Në vitin 1920 Ministri i Arsimit Sotir Peci urdhron transferimin e kësaj biblioteke në Tiranë. M 10 korrik të atij viti Prof. Karl Gurakuqi i transferon këto libra në një dhomë të Ministrisë së Arsimit. Që në atë kohë kjo bibliotekë mori emrin "Biblioteka e Shtetit" dhe Prof. Karl Gurakuqi emërohet drejtor i saj. Në vitin 1922 me rasë të kremtimit të flamurit kombtar bahet shugurimi i Bibliotekës kombëtare[1].(28 Nëndor 1922)

Pra, një kontribut, në dukje të vogël, në grumbullimin e ruajtjen e librave të parë të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë e kanë Hil Mosi, Luigj Naraçi, Kristo Floqi, të cilët ishin njëri pas tjetrit 3 kujdestarët e parë të librave të kësaj Biblioteke nga viti 1917 deri 1920 Edhe kur K.Floqi u bë Ministër i Arsimit më 1921 ai i ruajti të paprekura librat që ndodheshin në një dhomë të asaj Ministrije.

Nga njoftimi i mëposhtëm kuptojmë se edhe detyrën e çeljes së një shkolle nate Kristo Floqi e zgjidhi brenda një kohe të shkurtër :

Shoqnija "Vëllaznija"
DEGA LETRARE
(Njoftim në revistën "AGIMI" Nr.1 Maj 1919 faqja e fundit)

Prap i bahet me dijtë popullit të Shkodrës se kena ngrehë Shkollë të Natës për me msue, me këndue e me shkrue gjuhën amtare, ata qi kanë nevojë e dishrojnë me xanë:

Shkolla ka dy rendë ksi sojit :

Rendi i parë. Qi asht për ata qi s'dinë as a, be, c, në (për anallfabetet), e dahet dyshë:

a) Per ata qi janë 12 deri 16 vjetsh.
b) Per ata qi janë 16 vjetsh e perpjetë

Rendi i dytë. Qi asht per ata, qi janë pak'a shumë të perparuem me gjuhë.

Mësime janë tash per tash shkrim, lexim e numratore. Mâ vonë kan m'u shtue mësimet si mbas nevojet.

[1] Shuguroj = I vë vulën e shenjtërimit diçkaje. Shif "Fletore Zyrtare" dt. 10 Dhjetor 1922, faqe 3 (BKSH)

Mësimet nepen nga nji orë per ç'do natë, pêsë herë në javë si mbas programit të posatshëm, prej orës 12 deri më 1 alla turka, në Shkollë të Parrucës,

Mësimet nepen gratis (pa pare),

Pra djelm e burra Shqiptarë, mos bjerrni kohen, as mos keni marre pse mësoni gjuhen tuej.

Shkodër me 1 Maj 1919.

Drejtuesi i degës letrare
Kr. FLOQI

B. Kontributi në lëvrimin e gjuhës e kulturës Shqiptare

Në zbatim të programit të Shoqnisë "Vllaznija", Kristo Floqi shkruan artikullin e mëposhtëm :

Rândsi e gjuhës për një komb
(Artikull i botuar në të përmuajshmen "AGIMI"
Nr. 1 në Maj 1919)

Gjuha âsht shpirti, zembra, mendja e gjaku i një populli. Gjuha e çquan prej fqinjëve të tjerë, gjuha e rrjeshton në familjen e madhe kombtare; pra gjuha âsht kombsija vetë, vegla e veprimeve të tij, organi i marrëdhanjeve të tij.

Kuer popujt ishin në nji shkallë të ulët,domethânja e gjuhës ish nji sent i pa–kuptueshëm. Çashtjet e shtetit ishin monopol i mâ të fortve. Popullit s'i duhej gjuha për veç se me e perdorue në familje të vet, ose me bisedue me shokun e tij, a me diftue pralla. Kufit'e gjuhës ishin të ngushta se organ i Qeverisë ish *kërbaçi,* i cili e kishte gjuhën të shkurtë e kuptimin lakonik e aqe bukur e lehtë kuptohej sa s'kish nevojë gramatike e vokabulari! Shkolla nuk ishin; para gjyqit s'mundej të çilte gojën qytetasi e të paraqitte ankimet e veta; shteti s'e bâte kabull me çilë veshin e me ndii hallet e popullit, aqë sa edhe kisha s'i nepte të drejtë lauzit[1] besnik me komunikue në gjuhë të vetë me Zotin!

[1] Llauz = Gjindje, popull

Sot kaloj ajo kohë e njeriu rrnon në nji shekull qytetnimi, ku sa do i dobët e i ulët qoftë ka të drejtë me shkapercye ç'do pengim per me e çue zanin e tij perpjetë qoftë para gjyqtarit, qoftë para sunduesit të tij. Në shkollë, në ushtri, ner mbledhje e kudo njeti flet gjuhën e vet; edhe kisha te e mramja u shtërngue me i çilë dyert e gjuhës së popullit,me të cilën ky munt t'u merke vesht me Perendin e vet, mâ mirë se me nji gjuhë të huej. Në ç'do rasje msimi i gjuhës amtare u njoft si nji nevojë. Gjuha kshtû u kuptue se âsht ushqimi e jeta e popullit e vegla e fuqishme e kulturës së tij.

Njashtû si nuk mundesh me i nalë rrugën nji luanit të rrebtë që me û[1] e britme perçan shkretinat per me gjetë gjojen që kërkon, njashtû si nuk mundesh me mbajtë tufanin fishkllues qi shkon tuej rëzue lisa e plepa, ose valen e harbueme qi me tallas lshohet kundra shkambijve e zalleve, njashtû s'mundesh me ndalë gjuhen e nji kombi, e cila âsht kah turret gjigandisht për me u shdrivijue e me mrijtë në qëllimin e tij !

Ç'farë rândsijet ka gjuha për nji komb s'mundet t'a marrë vesht mirë aj qi nuk duli jashta prakut të shtëpisë së vet, njashtû si nuk mundet me marrë vesht dhimjen e mnershme të tjeter kujt aj qi nuk ka pasë dhimje në trup të vet. E ndjen aj qi jeton jasht' atdheut të vet, e ndjen aj qi shef se n'atdhé nuk përdoret gjuha e tij si gjuhë zyrtare e shtetit.

Sa lotte të pikllimta nuk ka derdhë nen sundimin shekullor ottoman njaj Shqyptar qi verevertet ka dashtë gjuhen e kombin e vet, atbotë kuer në gjykatoret e zyrat e tjera civile e ushtarake në vent të gjuhës shqype digjonin turqishten ! Ajy mundet me folë per rândsin e gjuhës, i cilli, tuej kenë brenda në shtet të tij sheh vedin qi u çdesh prej së gjithash të drejtave primitive qi pat e u shterngue me ulë kryet perpara nji rodit të huej. Sa pare bân me pasë duer e kâmbë të lidhun kur ké gjuhen e lidhun ? Të jesh orator e mos kuxosh me folë ! Të ndijsh se mundesh me bâ me shungllue fusha e male sa me u bint dreqi e mos kesh kuxim me nxjerë

[1] û = uri

zânin ! Kshtû njeriu e shef vedin të bjerrun, ta hupun e te denuem per dekë qysh per se gjallit ! Ka mâ keq ?

Fëllqinia[1] e gjuhës pra âsht fellqinjë jete, kur s'ké gjuhë s'mundesh me jetue. Don me bâ me dekë nji popull ? Merri ose ndalja gjuhen. At herë ky ka dekë prej vedit. Kshtû për me jetue duhet me pasë gjuhën, pra gjuha âsht jeta e popullit.

Na jemi Shqyptarë se flasim shqyp. Sa do e vorfen qi âsht gjuha jonë duhet t'a flasim, t'a duam, t'a përkrahim. Kur nderojmë gjuhën, nderojmë vendin t' onë.

N'âsht nji visar dija e gjuhëve të hueja, dija e gjuhës s'ate âsht nji detyrë për ty. Pa gjuhen s'ké as nder, as rândsi. Pra, kjo vegël e artë, kjo arm' e shêjtë, ky shpirt, kjo fuqi e kombit a duhet me u lânë mbas doret ? Ktu a çâshtja.

Kr. Floqi

Kulturë

(Artikull i shkruar nga Kristo Floqi me pseudonimin "Eordensis"[2] në të përmuajshmen "AGIMI" Nr. 1 Maj1919)

Fjala "*kulturë*" âsht nji fjalë latine (*cultura*) qi vjen prej verbit "colere" frangjisht "*cultiver*" qi don me thânë "veprim' i të punuemit", i të "livruemit", si bjen fjala, të livruemit e tokës, të punuemit të kallamit të sheqerit etj. etj. – Por ka edhe nji tjetër kuptim, e ky âsht përkujdesimi për me bâ të dobishëm çdo tjetër proth[3] për posë prodheve të tokës; si fjala vjen perkujdesimi për mbletët e për mjaltën qi bajin kto, si edhe dyllin e për qirat qi bâhen prej dyllit; edhe kjo âsht nji punim, nji kulturë. Por kuptimi qi ka fjala "kulturë" sidomos në ket shekull të dritave e të qytetnimit qi po jetojmë âsht mâ fort moral edhe perdorohet për vepra të mendjes, për perparimin e arteve e të shqencave (sciences) e per të tjera vepra kso doret.

---

[1] Fëllqinj = Mundim, përpjekje

[2] Eordensis = Korçari pellasgjik. Banor i krahinës Eordêa (krahina e Devollit ose e Korçës, mbassi edhè në kohët e lashta këjo krahinë quhej "Eordêa" dhe lumi i Devollit "Eordêos"), Njëri nga pseudonimet e Kristo Floqit

[3] Proth =prodhim

Në zhdrivillimin e qytetnimit të nji kombi, ose të një shteti, fjala "kulturë" ka nji kuptim fare të naltë, se me ket merret vesh nji mënyrë veprimit moral, i cili në qoftë se pëlqehet e birsohet edhe prej ndo nji a mâ shumë kombeve të tjerë, at-herë aj komb, ose shtet qi e ka qitë në dritë edhe e ka vue për fije ket kulturë ka pse lavdrohet e mahet krye-naltë për ket menyrë përparimi moral. Kshtû merren vesh disa menyra kulturet të shteteve mâ në zâ, si fjala vjen "kultura frange", "kultura anglosaksone", "kultura italjane", "gjermane", etj. etj.

Kultura hin në ç'do veprim moral të nji kombi, edhe mâ fort në ç'do pikpamje qytetnimi.Nji popull per me mujtë me jetue moralisht ner vedi e faqe me kombet e tjerë, ka nevojë të ketë nji kulturë, për mbi bazë të së cilës ngrehë jetën e tij morale. Me ket zgjohet, me ket mendohet e me ket vepron. Kultura âsht nji rrugë morale me principe të shndoshta e me nji frymë e shpirt të naltë, prej së cilve nuk largohet populli qi don me perparue e m'u qytetnue.

Na shqyptarët a kena nji farë kulturet? Me taman me folë, s'kena nj'ashtû si e lyp kuptimi i fjalës kulturë.S'kena, për shkajk se kulturë të vertetë ka nj'aj komb, nj'aj shtet i cili i ka duert të lira për me veprûe. Na Shqyptarët a i kena pasë duert edhe gojen të lirë për veprim qysh se Turqia vuni kâmben në ket dhé? Mjerisht jo.Në qoftë se në ket kohë brenda s'mujtme me marrë nji kulturë prej shkakut të robnisë, në kohët mâ të para të sundimit të Romanve,Gothve, Venecjanve, Byzantinve, e Harvarve[1] prapë se prapë s'mujtme, se pse as na s'ishim të zottët per kulturë, as qytetnimi s'ishte avritë m'atë shkallë sa me kuptûe ç'ka don me thânë kulturë. Kultur'e asaj kohe ishte shigjeta e shpata.

Por mas tashit a mundena me pasë nji kulturë ? Njiment mundena në qoftë se me të vërtet duem. Por se për nji të tillë kulturë duhet me kenë të gjithë nji mendjet. Duhet me kenë puntorë e jo harankatë (tembelë); duhet me marrë vesht hollë ç'ka do me thânë kombsì e atdhé edhe si kto të dyja munden me shkue perpara, duhet me studijue historin'e kombeve të tjerë që janë

[1] Harvar = Kroat

pasqyra për çdrivillimin t'onë moral, politik e ekonomik e ma fort me studijue thellë gjendjen t'onë, vetijat e doket e parimet t'ona, me nji fjalë shpirtin e mendjen e kombit t'onë. Mandej rrugen e kulturës e gjejmë vetë.

Eordensis

Bibliografi

Albania The master key to the near east

(Shqypnija çilsi i parë i Lindjes s'afërme)
(Artikull i shkruar nga Kristo Floqi, botuar
në të përmuajshmen "AGIMI"
Nr. 10 Fruer 1920 f.165)

Nen ket titull na ra në dorë nji liber i bukur anglisht, shkruem prej z. Dr. Kristo Dakos, kryetarit të partis politike shqyptare në Boston.

Libri i shtypun bukur e kjartas përbahet gadi prej 300 faqesh, e ka dalë në Boston-Mass e shitet prej auktorit. Âsht tepër interesant, pse bân fjalë për Shqypnì e Shqyptarë në pikpamje historije, ethnologije, gllosologije, statistike e politike me dokumenta e me fakta. Fillon me nji parathânje të Mr. *Richard Gotheil* profesuer n'Universitetet "Columbia" N.Y. Ndahet në 12 kapituj, të cilët përgjithrisht bâjnë fjalë për posicjonin geografik e popullsin e Shqypnis, për originen e gjuhen e shqyptarëve, zakonet e tradicjonet e tyne, për peripetin e Shqypnis midis shekujve, edhe mâ fort për kongresin e Berlinit, Lidhjen e Prisrendit, luften ballkanike e pasimet mizore të saj për Shqypni, Konferencën e Londonit, luftën Europjane e peripetit e deritashme të Shqypnis, për shdrivillimin komtar, edukacionin national etj. etj. Libri bân fjalë edhe per burrat e grât mâ të shkelqyeshëm të Shqypnis, disave prej të cilvet shifen edhe pikturat e shtypuna. Me nji fjalë auktori analyzon hollësisht e me mjeshtrì, me të drejtë edhe me arsye ç'do gjâ që i përket Shqypnis e popullit Shqyptar. Bashkë me kto

ka edhe shum topografi të bukura të Shqypnis si edhe zografi[1] klasike të luftave të Skanderbegut, etj. edhe nji indeks hollësuër të lândës. Ket libër të cilin e kemi këndue me verejtje i u a porosisim lexuesavet t' onë, por edhe gjith Shqyptarvet.

Auktori i ktij libri zotni Dr. Kristo Dako prej Korçe âsht nji nga veteranët intelektualë Shqyptarë i njoftun në fushën komtare si nji nga mâ të nxehtit e mâ aktivët atdhetarë.Ka mbarue fakultetin mathematik t'Universitetit të Bukureshtit të Rumanis.Përveç propagandës së madhe që ka bâmun për shqyptarismin në Rumani, Bulgari, Turqi e n'Amerikë, ka shkrue edhe disa libra mathematike shqyp per shkollat e mesme të Shqypnis, si edhe librin e vogël, po të çmueshëm, "Cilët janë Shqyptarët", të përkthyem edhe anglisht. Din bukur greqishten, turqishten, rumanishten, frangishten edhe anglishten. Ka qenë drejtues i "Diellit".Si nëpunës, mis i këshillit qeveritar, i ka shërbyem Atdheut energjikisht në rasa kritike. Në këshillin e gjyqit ushtarak, qi u ngreh në Korçë për shkak të kryengritjes së Prillit, z. Kr. Dako ka bashkpunue me shkruesin e ktyne radhëve[2] bashkë me misët tjerë z. Pandeli Vangjelin, Abdyl beg Ypin edhe komandantin ollandes të Korçës, major Shnellen. U martue me të shkelqyeshmen z. *Sevasti Kirjas,* të parën direktoreshë të Shkollës shqype e vajzave në Korçë, shkrimtaren e pa-lodhun, për të cilën kena bâmun fjalë tjetër herë nê ket të përkohëshme nen titullin "Grat shqyptare në fushën e literaturës". Z. Dako shum i ka shërbye Shqypnis si delegat i kongresit të komeve të pa-liruem në Philadelfia, po edhe si përfaqësues i "Vatrës" në Washington, D,C. bashkë me mikun tjetër t'onin z. K. Çekrezin.

Tue i dhânë fund ktij artikulli po pergzohena me auktorin e ktij libri e mikun t' onë z. Kr. Dakon, të cilit i çojmë falënderjet t'ona per ket liber të çmueshëm e për veprimet e mundimet e tija qi âsht tue bâmun për shpëtim e mbrothsi të komi

---

[1] Zografi = piktura

[2]Kristo Floqi në Prillin e 1914 kur ndodhi kryengritja në Korçë ka qenë prokuror dhe ka hetue kryengritësit që ishin arrestuar. (Shih "Autobiografia ime" të Kristo Floqit botuar më 2022 f. 135 e vijues ose dorëshkrimin në AQSH F.429-1-416.1 e vijues)

C. Kontributi në promuovimin e Shqiptarëve të çquar në fushën e arteve

Gratë Shqyptare në fushën e literatures

1.DORA D' ISTRIA[1]

(Artikull i Kristo Floqit botuar në Nr. 2,7 e 8 të muajit Qershor, Nânduer e Dhjetuer 1919 në të përmuajshmen "AGIMI")

Kombi shqyptar sàdo i lânun në harresë e i përbuzun, por prapë se prapë âsht i zoti me i kallzue botës së qytetnueme se në gji t'tij ka ushqye njerës të mëdhej të shkëlqyeshëm e të famshëm jo vetëm burra po edhe gra në ç'do pikpamje, si burnije ashtû edhè dije e qytetnimi.

Prej racës shqyptare ka lemun nji zojë qi sot jo vetëm mbahet në kujtim si nji shkëndi e zjartë drite e kulture për Shqypni por edhè si nji shembllë e rallë ditunije, si nji hyll i rendit të parë qi ka shndritë në kubë të qiellës për mes të literaturës shekllit. Kjo âsht *Elena Gjika* e titulluemja *Dora d' Istria* prej dijetarve të huej.

Ka lemun në Bukuresht më 1828 e ish e bij'e Mihal Gjikës, princit të Vllahis, i cili rrâjen e tij e kishte prej qytetit të Përmetit të Tosknis. Studimet i mbaroj në Bukuresht e i plotsoj në universitetet të Berlinit e të Venedikut. Flitte e shkruante bukur rumanisht, rusisht, frangjisht, gjermanisht e italisht për posë shqypes t'cilën me nji hir e flitte si gjuhën e saj. U martue me princin rus *Kolhtzof Malanski*e mbasi i diq i shoqi u dha krejt mbas literaturet.

Ka shkrue libra të pa-njehuna në gjith gjuhët e naltpërmenduna, t'cilat bânë fort të madhe përshtypje nër gjithë dijetarët e

[1] Për biografinë e Elena Gjikës (Dora D' Istria) ka shkruar një artikull mjaft të gjatë edhe Prof. Filip Fishta në Revistën "Shkëndija" Nr.7-8 Kallnuer–Fruer 1942,faqe 243, i cili thotë se disa nga biografët e saj kanë qenë E. Deschanel-i, Paolo Mantegazza etj. Prof.F.Fishta e shkroi biografinë e Dora D'Istria 23 vjet më vonë se e kishte shkruar Kristo Floqi. (Biblioteka "Marin Barleti" Shkodër).

moralistët e ndhej t'Europës. Zân' i saj shungllote[1] an'e kant edhe se cili filozof a profesor prej mâ të dukshmit vrapojshin në Fire-ncë t'Italisë, ku ksaj grue filozofe i pëlqente me ndêjë, për me e pa e me e njoftë së afërmi e kshtû shtëpi'e saj u bâ nji qendrë e madhe letrare, cok nji akademi. Mbreti i Italis' Umberti, i topitun prej artikujve të botuem italisht prej Dorës, më nji zel të madh gadi si nji adhurim vijte aty në Firencë e me habì e mrekull flitte me të e digjonte gjith'ato brillante të çmushëm, qi si breshën lshoheshin prej gojës s'saj. Njikaqë ish habija e mahnitja e atyne qi folnë me të sa jo vetëm i dhanë mbiêmnin *Dora d' Istria* , por edhe "Regina delle donne" ose "La reine des femmes" (Mbretnesha e grave) e quejten mâ von ! Mâ të shumtat akademi e shoqni të Francës, Italis, Gjermanis, Amerikës e Greqis e emnuen *anëtare nderi.*

*Jam Shqyptare,*thesh e leçitte gjithnji e e kish për nder e lavdi të quhej me ket emen, se në ket komb shifte nji karakter të kthellët e nji fisnikri qi s'i shifte njeti. Pênda e saj ish kaq'e mprehtë e e bindushme sa tërhoqi verejtjen e disa arqeologve e histori-shkrusve, të cilët fort pak e njifshin kombin t'onë. Nji prej sijsh Luis Benloew professor'i gjuhëve greke e latine në universitet të Parisit e akademik i Francës kaqë fort u bint prej shkrimeve të saj e aqe shumë u tërhoq prej shqyptares s'onë, sa vetë erth në Itali e e njofti edhe nji dishir i gjallë e kapi per kombin shqyptar sa u shtërngue e nxuni edhe gjuhen shqype e shkroj disa volume të çmushëm për mbi Shqypni e shqyptarë[2].

---

[1] Shungullon = ushton, gjëmon

[2] Ksij librash të Benloewit janë kto mâ të çmueshmit:

I. *La Gréce avant les Grecs*, ku shpjegon hollësisht e me dokumenta të forta se banorët e parë të Greqis sotshme ishin Shqyptarët.

II. *La nationalité des Troyens,*ku merret me fisin e rrâjen e Troasve, t'cilët i çprovon se janë shtërnipat e pelasgve e gjuh' e tyne ish pelasgjishtja qi i përngjet tepër ksaj shqypes së sotshme.

III. *Du rhytme et de la rime dans la poesie epique des Albanais,* ku shiqohet deri ku ka mrrijtë durimi e zeli i ktij burri sa

Dora d'Istria ish ajo qi bâni me u dijtë në Europë karakterin e kângët popullore të Shqypnis. Kjo u bâ shkajk qi u zgjunë shqyptarët e Italis e filloj gjith ajo lëvizije e kjo ish ajo qi i dha nji shtyrje përparimi letrësisë shqype, prej së cilës dulne veprat e gjalla të shqyptarve *Kamarda, Dorsa, Girolamo de Rada*, Shpata e kaqë shkrimtarve të tjerë.[1]

Librat qi ka shkrue Dora d' Istria janë të pa numurta, por ato mâ të vlefshmit kanë qenë kta :

La vie des moins (jeta e mungarve) ku me fakta të arsyeshme çprovon se mungarët e manastirve (kuvendeve) të kishës ortodokse, janë bâmun shkak ndalimi i qytetnimit n'Europen lindore e jugore.

La Suisse Allemande, (Svicera Gjermane), ku kallzon se idheat e filosofëve të Gjermanis i dhanë nji ndihmë të madhe përparimit të popujvet.

Les femmes àl' Orient (Gratë në Lindje) ku shpjegon të metat e gravet të Lindjes, si edhe tregon mjetet e shërimit të pozicionit të tyne e të konditave, në të cilat gjindet gruja në të Lemë (orient).

Shqyptarët e Rumanis, ku bân fjalë shumë për kombin shqyptar, si edhe për historin e shtëpis të *Gjikej*[2]*,* fisit të saj, e të sundimit të tyne bres mas brezit si princat e Rumanis.

---

me kthellue e me rëmue aqë fort mbi vjershimin shqyptar.(K. Floqi)

[1] Ky shkas u dha me anë të nji librit të saj të çmueshëm nen titullin "*La nationalité albanaise suivant les chansons populaires "*(Kombsija Shqyptare mbas kângve të popullit). Ky libër u përkthye në shumë gjuhë. (K. Floqi)

[2] Familja *Gjika*, e cila origjinen (rrâjen) e ka prej Përmetit ndonse gojdhânja thotë se âsht prej katundit "Vithkuq" të Korçës, ka mbretnue per disa vjete në Rumani. Breznija e ksaj familje shqyptare âsht kjo: I pari princ ish *Gjergj Gjika,* mbas ktij mretnoj *Gregor Gjika i I*, mbas atij *Gregor Gjika i II,* mandej *Aleksander Matheo Gjika,* mbas ktij *Karol Gjika*, mbrapa *Matheo Gjika i II,* mbas tij *Aleksander Gjika i VI, Gregor Gjika i III, Gregor Gjika i IV, Aleksander Gjika i X,* e i mbrami ishte *Gregor Aleksander Gjika i I.*

I jati i Dora d' Istris Michael Gjika, ish minister i Aleksander Gjikës të X, të cilin e kishte nip.(K.Floqi)

Excursion en Roumelie, Paris – Zurich 1863 (Shetitje në Rumeli), ku refen per zakonet e jetën të popujve të Rumelis.

La nationalité Albanaise (Kombsija shqyptare) për t'cilen bâme fjalë mâ syper. Përveç ktyne, Dora d' Istria ka shkrue edhe shumë të tjerë studime e artikuj për Shqyptarët ner shumë gazeta e të përkohëshme të Francës, Belgjit, Italis, Svicerës e Greqis.

Volume të tânë janë shkrue mbi jetën e ditunin e Dora d' Istriës, e cila ka lânë stinë të pa-harruem në literaturë e në sektin e saj. As nji grue nuk e kaloj në mendje e në dituni. Titulli "Mbetnesha e grave" e meritonte me të vërtet ksaj grue bujare, ksaj dijetare të rallë. Por kjo grue ish Shqyptare. A ka pra gzim mâ i math per nji komb, i cili mrrijn të nxjerrë ksijsh grash prej gjinit të vet ? A mundet kombi shqyptar të përbuzet e të mos çmohet ?

Dora d'Istria, ky hyll i rendit të parë perëndoj, mbaroj jetën në Firencë më 1888 në moshën e 60 vjetve !

Për mbi jetshkrimin e Dora d' Istriës disa dijetare e poetë të huej kan kushtue dorëshkrime të plota e vjersha. Por na, si shqyptarë do të përmendim ktu vetëm nji vjershë të bukur shqyp qi ja ka kushtue nji i shkretë dijetar e poet shkodran, Zefi i Ndokë Illìs prej Jubanit, dritë pastë, i cili e kishte njoftë per s'afermi Dora D' Istrin e qi tue kenë në Venedik kishte kndue me verejtje gjithë dorëshkrimet e sajë e kishte ndì me veshë të vet gjith shka të huejt flitshin per té. Qe edhe vjersha:

Ti jé nji hŷll e n' a shndrit Arbnìn,
Me dije, me t' mira e me bukurì,
Me dashtnì t' ânde jé tui n' a pertrìn
Nji gazmend të math e nji lumnì.

Ndér hyj ti prà jé regjinesha,
Qi *"Dora d' Istria"* t' emnojnë,
Per Shqypni ti je begtaresha,
Qi gjithkund e ktu të nderojnë.

Po ! shpnesa e âmbel jé per né,
Pse zemra e jote âsht fort e mirë,
Sjelli sŷt e t' u e mos harro ket dhé
Të késh edhe për né mall e dishir !

Nji tjetër dorshkrim të vlefshëm kishte pasë kushtue Dora d' Istrìas shpirt ndrituni gjyshi jem Efthim Mitkua në librin klasik të tij "Bleta Shqyptare" shtypun në Skenderije[1] më 1878. Ky, mbasi e njifte hollë dijetaren e naltë shqyptare e kish edhe shkëmbim letrash me até, e kuptote bukur vleften e saj, andej edhe në studjimin e tij për mbi jeten e shkrimet e saj kishte shkrue sende me shumë rândsì. Kursimi i shtyllave të ksaj përkohëshme nuk na permeton[2] m'u zgjatë në ket pikpamje, tue analyzue dorëshkri-min e naltpërmendun.

Si thamë edhe mâ nalt prej shkakut të Dora d'Istrìs dulne veprat e bukura të vjershtarve italo shqyptarë *Kamardës,Dorsës, De Radës, etj.* Prej ktyne veprave tue u shtyemun ka mujtë me dalë për dobì të madhe të literatyrës s'onë edhe nji dijetare tjeter e vlefshime prej shqyptarve t'Italis, zoja Kristina Sqiro, e cila vdiq tash vòn, me 28 Frorit 1919; për ket të shkëlqyshmen zojë, e cila shërbime të mdhâ i ka prue letresìs s'onë, n'a kândet me bamun pak fjalë.

2.KRISTINA SQIRO

Zoja Kristina Sqiro ka lé në katundin Hora e Arbreshvet në Kalabri t'Italis së poshtme. Ishte fort e mirë e shpirt-madhe e nji atdhetare nga mâ të flaktat. E pajuar me ndjenja të kthellta për atdhé e me cilësi e virtyte të tjera të ralla, u bâ me kohë shembulli i grave shqyptare t' Italis. Gjith jeta e saj kaloj tue këndue gjith shkrimtarët e njohun shqyptarë e tue bâ studjime mi origjinen e Kombit shqyptar e gjuhën shqype. Pat durimin me mbledhë prej gojës së popullit të pa-njehuna kangë, pralla e gojë–dhânje. Vjershtori kombtar *Girolamo de Rada* kishte për até nji miratim të posatshëm e ushqente për shkrimet e saja nji adhurim të math e shpesh herë fliste e shkruente për tê.

Vajzë edhè e pa rritun kishte fillue me shkrue me nji kujdesje fetare gjithshka mundej të msojë prej gojës së pleqve e qi munt të kishte ndollë. Shkrimet e *Demetrio Kamardës* e kishin enthusiasun së teprit. Shumë kishte punue e kishte hjekë per ket

[1] Skenderije = Aleksandria e Egjyptit
[2] Permeton = nga italishtja "lejon"

popullin t'onë, tue u mundue me ç'farë do mënyre për mos me marrë vesht të huejt të metat e kombit shqyptar. Ket e shofim përftyrue dhe në nji vjershë që i kushton ksaj nipi e poeti shqyptar Zef Sqiroj:

Sa m' e lartë e sa m' e kryerë,
Aqe mê nuk pate fat
Zembra jote po kje e thyerë
Vuajte shumë e kjajte gjat !
Po të butin gas s' e bore,
Kurr nder lote edhe në shesh
Brengat t' ande kurr s' i nxorre
Mos t' i merrte i hueji vesh.

Qi prej ksaj shkrimtare âsht xehë edhe profesor Sqiro; e ka shkrue gjith ato vepra për Shqypni, merret vesht prej nji strofe të vjershës së ktij vjershtori mbi ket dijetare:

E nga tatëzat e parë
Nxune heret se kush janë
Të pa-mundurit shqyptarë,
Çë me né nji gjak po kanë
E të rijvet ju dhae pjesë
Prej të nxanavet te tua,
Sa t' u shtonej ajo besë
Çë, prej ty më ndezi mua,
Çë më ndezi e do t' qindrojë
E pa-shuar mote e vjetë
E t' pastajmit do t' i ndritojë,
Si të vendit per shëndetë.

Mënyrën me të cilën z. Kristinë i mblidhte prallat e legendat e vjetra shqyptare si bleta mjaltën prej lulesh edhe flîtë qi bânte n'a i kallzon prapë z. Sqiro në kto strofa :

Afër votrave n' e mbrëma,
Kur mâ i keqi dimr' i zii
Gjyshe të bardha e të reja mëma,
Të shëndoshtes vogjeli

Do t' të thom me fjalë të gjalla
E të thjeshta çë ti xgjodhe
Ato fort të bukra pralla
Që prej plakave i mblodhe.

Nder Shqyptarët e Italis s'ka kush qi të mos t' a njofin ket shkrimtare të rallë, e cila jo vetëm ndër kta ish e permendun por edhe në shqyptarët e tjerë të Shqypnis, shumë prej të cilve mbajshin edhe korespondenca mjaft të nxehta me të. Jet'e saj ka qenë nji luft'e gjatë për me qite sheshit vleftën e vërtetë të Shqyptarit e me bâ me tingllue emni i vendit të vjetër të saj, i Arbnis. Ish fort e butë, e urtë, e begenisun dhe e mentshme. Këtë përftyrim e shohim gjith ashtu në strofet e mbrame të vjershës së z. Sqiro :

Ish e hijeshme, e but' e mirë,
Pati shpirt aqe sa ment
E me zembërë të dlirë
Deshi shumë të vjetrin vent.

3.SEVASTI DAKO

S'duhet harrue nji zojë tjetër, e cila ka qenë e para direktoreshë e së parës shkollës së vajzave qi u çil për të paren herë në Korçë më 1886, zoja Sevasti Qirjasi edhe sot Sevasti Dako, e motra e të pa– harruemvet atdhetarë Gjeras e Gjerq Qirjazit. Ka lemun në Monastir në vjetin 1875 e masi mbaroj msimet enkyklopedike në Monastir shkoj e i plotsoj në Robert College të Stambollit. Prindët e saj ishin prej katundit "Vithkuq" i Korçës, katunt qi s'ka sot veç se 3 lagje kurse tjetër herë, më 1790–1820 ka pasë për mbi 70.000 banorë.

Z.Sevasti Qiriasi ose Dako (grue sot e atdhetarit të njoftun zotni Kristo Dako prej Korçet) ka ardhë për të paren herë në Korçë e dërguemun prej misionit amerikan i cili, tue dashtë me u dukë bâmirës i kombit shqyptar lypë me anë të bajlozit[1] amerikan të Stambollit prej Qeveris turke të çilet nji shkollë shqyp e femna-

[1] Bajloz = ambasador

vet në Korçë. Me gjith përbuzjet e pa-hijeshme e ndjekjet e rrepta e të dame të popullit fanatik atëhere të Korçës, i cili ishte rritë e nunosë[1] me ideat greke, z.Sevasti nuk u tut as pak, as prej mallkimeve të metropolitëve grekë të Korçës, as prej nâmëve të priftnave të lagjeve as prej boykotit të tregtarve fedakë[2], por vijonte gjithnji në detyrën e saj, apostulle besnike e dërgatës së saj dritëpruese e qytetnore.

Në ket mënyrë e me kta konditione z. Sevasti Dako e administroj ket shkollë mâ shumë se 18 vjet, jo si grue por si nji burrë, tue ja dalë në skaj secilit do rrezik sa do i math qi ishte ose prej popullit, ose nga ana e Qeveris lokale të Turqis, e cila jo nji herë e dy ja mbylli shkollen e e hoqi edhe në gjyq.

Në ket shkollë nxunë gjuhën âmtare e muernë të parat drita jo vetëm vajzat e Korçës e të rethinave, por edhe sa e sa të tjera varza prej tjerë qyteteve e katundeve të Shqypnisë, mâ e shuma prej të cilave muerne diplomë e duelne msuese të vlefshëme, tue shpërndà an'e kant të Shqypnisë dritat e ditunis.

Shkolla e zojës Sevasti Qiriasi ase Dako nuk ishte vetëm nji shkollë msimesh por edhe morali e edukacioni, se zoja Sevasti ishte rritun në kondicione tepër serioze si prej anës të prindve si prej anës së shkollës, andej edhe sa varza paten fatin me dalë prej ksaj shkolle dijshin ç'ka don me thânë drojë e respekt e nder e detyrë. Kjo shkollë me shkollat e tjera greke të Korçës kishte nji ferk[3] si dita me natën. Nji i huej qi vinte e inspektonte ket shkollë merrte mbas vedit ato mâ të mirat e mâ të bukrat përshtypje. Me kohë kjo shkollë u bâ jo vetëm qendra intelektuale e grave të Korçës por edhe e burrave, se aty bisedimet baheshin përgjithnji mbi gjuhë e histori shqype gjan'e gjatë e rriheshin çâshtje me rândsi për shdrivillimin e qytetnimin kombtar.

Në kohët e mrame kjo shkollë u plotësue edhe me nji pension ku fmijë të vobektë vijshin e nxijshin shqyp e hajshin e visheshin pa të holla.

---

[1] Nunosem = brumosem

[2] Fedakar = fetar i devotshëm.

[3] Ferk = ndryshim, dallim

Z.Sevasti ish e âsht nji shkrimtare e fortë e nji oratore e rrallë. Din bukur, përveç gjuhës së saj âmtare shqypes, edhe greqishten, turqishten, rumanishten, bullgarishten edhe anglishten, po mâ teper anglishten, të cilen e shkruen pa asnji gabim e flet me nji shije të rrallë e me nji eloquencë të bindueshme.

Dy herë u thir në Shtetet e Bashkueme të Amerikës kû shkoj për disa kohë e vizitoj disa qytete e katunde të kolonizueme prej shqyptarësh. Mbajti Konferenca të pa njehuna për mbi Shqypni e Shqyptarë. Edhe sot atje gjindet bashkë me të shoqin e saj z. Kristo Dako e dy djemt e saj, tuj tërhjekë gjithmonë adhrimin e respektin e gjith shqyptarve për vleften e saj !

4.PARASHQEVI QIRIASI

Kjo zojushë âsht motra mâ e vogël e zojës Sevasti Dako. Gjithçka folmë për z. Sevasti Dako mundena me folë edhe per zojushen Parashqevi Qirias. Shkollat i mbaroj edhe kjo atje ku edhe motra e saj. Din edhe kjo aqë gjuhë sa edhe e motr'e saj.

Mbassi u martua zoja Sevasti, direktoresh'e shkollës së famshime të Korçës u njoft zojusha Parashqevi,e cila tue vazhdue mbi gjurmët e së motrës drejtoj për disa vjet rreshtas edhe shkollën edhe pensjonin, ku jo vetëm varza por edhe gjith farë fëmijësh vijshin. Edhe kjo ashtu si e motra nuk peshoj kurrsesi ndalimet e pa-shpirtshëm edhe rreziqet e shpeshtë qi i takojshin përpara; vijoj gjithmonë krenare në detyrën e saj e u duk nji zojë e dêjshme e tepër e lavdurueshme.

Në Korçë, mbassi u njoft mirë me disa zoja shqyptare ngrehi nji shoqni grash nen titullin *Hyll'i Mëngjezit*, e cila shoqni numrote shumë grà edhe përparonte mjaft, tue pasë edhe nji fond mjaft të respektushem.

Gjith'ashtu si Z.Sevasti Dako ashtu edhe zojusha Parashqevi Qiriasi ka shkue dy herësh n'Amerikë të Verit ku edhe sot gjindet (në qytetin Boston, ku gjindet mâ e madhja koloni shqyptare si edhe shoqnija mâ e madhja e mâ e famshimja kombtare Federata Panshqyptare "Vatra").

Në Shtetet e Bashkueme gjith ashtu edhe zojusha Parashqevi ka mbajtë shum konferenca mâ tepër anglisht përpara disa

dijetarëve amerikaj e popujve të ndryshëm, të cilvet ju shpjegoj hollsisht e me nji ligjerim të pashoqtë origjinen e karakterin e kombit shqyptar, vojtjet e vleftën e tij.

Aty botoj edhe nji të bukur të përkohshme shqyp-anglisht prej 33 faqesh me artikuj e *klishe* të bukura gjith me at titullin e shoqnis "Hyll' i Mëngjezit" e cila vepron edhe në Amerikë,dhe e së cilës kjo âsht kryetarja.

Shqyptarët e Amerikës, tue çmue veset e talentin e saj, e zgjodhen si delegate në Konferences e pagjes në Versailles, ku vojt edhe ndej per disa muej bashkë me delegatët e tjerë shqyptarë, tue veprue krahas me ta me gjith aktivitetin e pa-lodhshem, qi i përket nji politikani e jo nji gruje !

Deshtëm me përmendë edhe sa e sa zoja e zojusha tjera shqyptare, qi janë dà ne shej në fushën e letresis kombtare, porse vendi i ngusht i ksaj të përkohëshme nuk na permeton m'u zgjatë mâ tepër e kshtu u a lamë rendin shkrimtarve të tjerë për me vijue ket kapitull, edhe mâ fort vllazenve dijetarë Shqyptarë t'Italis, të cilët i njofin mâ mirë dijetaret grà e varza të shenjueme si të zonjat e pendës e të gojës, qi kanë midis tyne.

Ç.-Artistë të tjerë Shqiptarë

5.ARTET NË SHQYPNI

(Artikull i shkruar nga Kristo Floqi e botuar në të përmuajshmen "AGIMI"
Nr. 1 Maj 1919)

Në kanë pse mburren kombet e kulturës për vepra artistike, ka edhe kombi i jonë për se me u mburrë në ket pikpamje. Në qoftë se *Zenxis* e *Parasios* i lanë nji stinë t' amshueshëm Greqisë për gjallshkrimet e tyne, në qoftë se *Rafaeli e Michel Angjeli* e banë Italinë të famshme për mjeshtrin'e tyne fytyrore, mundem me thânë, se ka edhe Shqypnia artistin e vet, nji artist që shpik nji tjetër mënyrë artit, të pa-njoftun deri më tash. Ky artist âsht *Dr. Durro Guri*, avokat prej Gjinokastret.Mjeshtrija e tij nuk âsht mjeshtrì njyrash, vojit ose lapset, âsht nji mjeshtrì e rè, *mjeshtrì mndashit*. Fraza, qi artisti "lindet e jo bahet" âsht e vërtetë. Edhe z. Durro Guri nuk u msue, por leu artist. Në Francë e Itali e njeti

punohen disa piktura të bukura nër avlimente, ose gjergjef porse mjeshtrija e Durro Gurit qëndron në gjylpânën e në mndashin. Për pa dijtë symmetrin e vizat e lakueme të nji pikture, për pa ja msue kushi mjeshtrin e kalitehnisë[1], din vetë mysterin e armonisë e të ândsisë. Edhe kjo âsht pika e çuditshëme për mjeshtrin' e tij.

Kur ish i vogël, shkollën s'ja kish kânde. Prindët e tij e qortonin për ditë tui e paa se kalonte kohën me gjith farë piturash të bâme nëpër murret me thëngjilla. Nji dit mjeshtri i shkollës po e qortote se s'kish mendjen në librin, po kur ju afrit pavi për çudë, ftyren e vet, të cillën me aqe mjeshtrì e kishte goditë Durroja. Qeshi atbotë e i tha: "biro, ti s'je për libra je për arte". Zelli i ktij arrite deri atje sa i ndalte disa të vobektë rrugave, të cilët me perdhuni i pitturote ! Si u rrit e ju shtue zelli u dha në qendisjen e pitturave me mndash. E para piturë që punoj ish pitura e Ali Pashë Tepelenës. Në Stamboll si student punoj shumë pitura të tjera. Kur ka ardhë në Shqypni bani piturat e princ Wiedit e të princesës Sofija, të cilës ja doroj[2]. Nji mjeshtri fort e pelqyeme. Ktu në Shkodër punoj ftyren e mbretneshës s'Italis Elenës, të cilën ja çoj në Romë. Mandej të Franz Jozefit, të Arqidukës Franc Ferdinand, të mretit Karl, të Krajl Nikollës, të monsinjor Sereqit, të Abatit Mirditës etj. etj. Kto dit ka mbarue edhe nji pikturë tepër të bukur e me mjeshtri, të Wilsonit, të cilën don me ja dorzue vetë në Washington, ku e thret "Kryqi i Kuq" amerikan me punue, i bindun prej mjeshtrisë të rallë të tij, të çpikun per të paren herë në Shqypni.

Do episode mastojnë me na diftue hollsin e naltsin e ksaj mjeshtrie prototype. Në sallë të vet, kur ish në Stamboll kish pitirue nji grue. Miqtë qi e vizitojshin për të paren herë, të pamen pikturen shmangeshin prej turpit se shifnin papritun nji grue! – Në nji shtypje tjetër, kur ish student,në funt t'odës kishte pikturue nji karike me nji micë.Ata qi hijshin,per pa njoftë mashtrimin turreshin me largue micen e me marrë karigen qi ju duhej per me ndejë ! – Në nji kafehane, mbasi piu nji kafe i thret garçonit me

[1] Kalitehnia = artet e bukura (**καλιτεχνία**)
[2] Doroj = dhuroj

marrë paret, tui ja pikturue mbi tavolinë. Garçoni avritet e fillon me marrë metaliket prej tavolinës,po mjerisht metelikë aty s'kish, posë piturave të metelikëve, prej të cilave u rrejt garçoni ! – Në Rodos, kur ish syrgjyn nji zojushë inglize pikturonte kalanë e Rodosit.Ky afritet e pituron piktureshën me aqe mjeshtrì, sa kjo kur e pa u habit ! –

Z. Durro Guri me mjeshtrin e tij nderon kombin e vet si Shqyptar e atdheu jonë s' mundet mos me ken i lumun prej ksij artistësh qi ka qitë prej gjiut t'vet.

Kr. Floqi

6.ANASTAS KULLURJOTI

(Artikull i shkruar nga Kristo Floqi, botuar në të përmuajshmen "AGIMI" Nr.7 Nânduer 1919)

Midis burrave të shkelqyem të historis s'onë Kombtare në pikpamje literature thom se duhet përmendun edhe nji shqyptar i shkretë i cili sa do lemun e rritun në Greqi ka punue aqë shumë për kombim shqyptar, sa të pakë Shqyptarë kan veprue. Pse ky ka qenë prej atyne të pakve Shqyptarë të Greqisë qi u mundue për Shqypni, kujtoj se detyra e jonë âsht për mos me e qitë në harresë. Ky âsht pra, patrijoti i math shqyptar i shndritshmi *Anastas Kullurjoti*.

Ky Shqyptar i math e i pa–shembëllt ka pasë lemun më 1722 mbas Kr. në nji lagje t'Athinës në emnin "*Plaka*" e cila edhe sot në Athinë e sjell ket emen, se âsht mâ e motshmja mëhall'e Athinës, mëhalla plakë, e cila edhe sot banohet prej Shqyptarësh, qi flasin e bisedojnë gjithmonë shqyp me shoqi-shoqin, sa edhe me dashtë me folë mâ hollë, gratë shqyptare të ksaj lagje nuk dijnë me folë greqisht sa do qi gjinden në kryeqytetin e Greqis.

I at'i tij, nji luân i gjall, fatos nga mâ të permendunit, e dha jetën e tij për indipendencën greke,nën termalet e kodrës "Akropolis" tue luftue kundra urdive turke.

Anastas Kullurjoti studimet e tij encyklopedike i mbaroi n'Athinë; mandej për me i plotsue ka shkue në Amerikë të Verit

mbas nji misjonit amerikan. Atje tue u vaditun me ajrin e lirë e me principe të nalta ideale të kombsis, ka muejtë me njoftë edhe mâ mirë e me çmue kombin e vet të vërtetë për të cilën thirej me veprue. Kur ka kthye në Greqi ka mujtë me dijtë 6 gjuhë.

N'atë kohë kuer fanatizmi i grekve për kombsi ish tepër i math, Kullurjoti kish guximin me ngrehë flamurin kombtar të Shqypnis midis të Athinës, tue çpallë andej e kndej nepër bashk-atdhetarët e tij ndjenja kombtare e dashtni për Atdhenë. Leçitte e predikonte për ç'do të dielë për mbi çâshtjen e gjuhës shqype, për nji ide nacionale e për nji bashkim të gjithmarshëm të shqyptarve të Greqis me ata të Shqypnis. Mendimet e nalta të tij i çfaqte me anë të nji gazetës së tij nën emnin "*Zân'i Shqypnis*"[1] të cilën e botonte greqisht brënda në atê Athinen! I guxueshëm, i papritue-shëm edhe pa ju shmangë as nji rrezikut, çili shkollë të natës n'Athinë për me msue bahkatdhetarët e vet, shqyptarët e Greqis gjuhën amtare shqype; krijoi nji shoqni shqyptarësh, e cila për pak kohë numrote shumë anetarë,edhe qellimi i së cilës ishte marrëveshja për nji lidhni e bashkim të ktyne me Shqyptarët e tjerë të Shqypnisë e të Greqis; ka shtypë at-herë e ka qitë në dritë abetarin e gjuhës shqype e disa libra të tjera shqyp.

Aso kohet kur i pa-harruemi, i famshmi udhëheqës Abdyl beg Frashri luftonte për të drejtat shqyptare e kuer bâhej fjalë për me i dhânë Greqis Shqypnin e poshtme Epirin, i madhi Kullurjot, *justus et tenax*[2] si thotë edhe z. Louis Benloew, çoj zânin e ashpër deri në kubën e Qiellës, edhe kaqe i kundrështoi ktij vendimi sa-tanik t'Europës për ket coptim të Shqypnis të pa drejtë me anë të ditores së tij, sa zân' i ktij burri u ndigjue shumë lark e bâni me shungullue e me u trondit gjith shtypi i Greqis; ky ish shkaku qi heroji ynë ra nën mnijën e në urrejtjen e qeveris greke edhe popu-lli i Greqis e njojti si për trathtar të kombit ! Te e mramja u përbuz e u neverit tepër sa e zunë edhe me gurë e psoj mâ shum se aj apostulli Pavli, por i pa-drashtun e bujar gjithmonë

[1] Foni tis Allvanias.(K. Floqi)
[2] Justus et tenax = "I drejtë dhe këmbëngulës".

ato ndjekje e të mshame të kqija i duroj e pa u dishprue as pakë pasoj i pa-tundun veprën e tij të madhnueshme patriotike.

Mâ në funt niset për Shqypni për mâ u marrë vesht me shqyptarët e tjerë për çlirimin e sigurimin e Shqypnis por mjerisht, kur ja mrijni në Gjinokastrë s'e lanë as prej kalit me sdrypë. Konsulli i Greqis i atij qyteti ja zbuloj mendimet e tij sundimtarit të vendit e kshtu me urdhën të rebtë e kthyne shpejt në Sarandë e e çuene të lidhun në Piré të Greqis kû e burgosne! Kur doli prej burgut botoj nji libër fort të vlefshim e interesant nën titullin "*Ankimet Shqyptare*"[1], ku me nji dishprim të math, por edhe me nji hollsi e mjeshtri kallzonte neveritjet e grekve kundra Shqyptarve e ndjekjet e ktyne kundra gjuhës e shdrivillimit t'onë kombtar, edhe mbi gjith rreziqet qi e gjetnë mâ von ky nuk prani kurrsesi me ndjellë popullin shqyptar në detyrën e tij të shejtë kombtare, gjith ashtû s'pushoj së botuemi gazetën e tij Zân' i Shqypnis tui shkri gjith mall e pasunin e tij për kombin shqyptar. Ksi patrioti ish Anastas Kullurjoti, që kurrë s'ka për t'u harruar prej nevej Shqyptarvet !

Kr. Floqi

7.PANAJOT KUPITORI

(Ky artikull i Kristo Floqit është botuar në të përmuajshmen "AGIMI" Nr. 8 Dhetuer 1919)

Mbas të pa-harrueshmit Anastas Kullurjotit, nji Shqyptar prej atyne të Greqis, po i u paraqesim lexuesavet nji tjetër atdhetar të shndritshëm e të shkëlqyshëm për literatyren shqyptare e për historin e kombit t'onë; ky *âsht Panajot Kupitori.*

Panajot Kupitori ka lemun në ishullin *"Hydra"* të Greqis. Si mbaroj studimet encyklopedike në vend të vet erdh e i plotsoj n'Universitet t'Athinës ku u shkrue si student në degën e filosofisë edhe mbas 5 vjet shkollë u dà në shej prej gjithve bashkëstudentët e tij tue marrë titullin e doktorit të filosofis.

[1] Allvanika parapona (K. Floqi)

Me gjith qi hyni si nënpunës në Drejtori t'Arsimit n'Athinë, me gjith qi ish nenshtetas grek e nënpunës i qeveris, ky atdhetar i rrallë ndîte tepër nji dishir për sgjimin e bashkatdhetarve të tij, Shqyptarët e Greqis, për të cilët fshahtas përpiqej me muejt me i msue me shkrue e me këndue shqyp, me i sjellë në marrveshje e lidhni me atdhetarët e tjerë të Shqypnis e me i ngutë në çvillimin e perparimin e tyne kombtar.

Më 1876 u emnue profesor në Gymnasion e I t'Athinës të *Varvaqit*[1]. Këtu detyrat e tij i kreu pa mungesë, gjith ashtu edhe mâ von kur u bâ drejtuer i Gymnasit (Gymnasiarchis) la nji stinë të pa-harrueshme në letërsin greke midis shokve të tij e të botës letrare. Por mbi të gjith detyrat e tija nuk prajte tue çpallë mendimet e tija për mbi përmirsimin e fatit të Shqypnis e për ndritsimin e Shqyptarve. Veçanrisht kishte nji shkollë të natës, ku i u a msonte gjuhën shqype, me shkronja greqishte[2] shqyptarve t'Athinës e të rretheve t'Athinës, të cilat rrethe kan qenë e janë të gjitha Shqyptare.

Qysh i vogel ndîte nji dishir për gjuhën shqype edhe i vinte shum keq kah e shifte se përbuzej e përçmohej prej Grekvet. Jo nji herë e dy ishte zânë e ishte shà me Grekët për çâshtje të gjuhës shqype e të shqyptarvet! Dikur, dikur ka takue me i ra n'erë qeveris greke për propaganden shqyptare qi ish tue e bâ, gjâ për të cilën edhe u gjygjue e ka shkue në burg për nji kohë të mjaftë.

Shpesh herë në "Hydrë", në "Poro", në "Spetsë", në "Kranith",në"Kullur"edhe disa herë në "Plakë" t'Athinës mbante fjalë per Shqypni e Shqyptarë; kallzonte sa të mira i kishin bâmun Shqyptarët Grekve, sa te e mbramja edhe lirin kta i a u kanë falë, kur se Grekët jo vetëm s'u dukne mirnjoftës para Shqyptarve po edhe mâ në funt i shanë e i poshtnuene !

Kupitori ish nji njeri tepër liberal e dijetar nga mâ të rrallët. Për veç librave greqisht qi kish qitë në dritë, kishte botue edhe shqyp disa libra, mâ të çmueshmit ndër të cilat kanë qenë "*Studim*

[1] Varvaqi ase Barbaçi, ish nji shqyptar pasanik prej Athinet, i cili u fali grekve mâ të bukrin e mâ të plotin Gymnasium të gjith Greqis (K. Floqi)

[2]Se aso kohe më 1876–1877 s'kishin dalë edhé shkrojet latine (K. Floqi)

historik e filologjik për gjuhën e kombin e Shqyptarve, 1879, si edhe *Shënime gramatikale mbi djalektin e shqyptarve të Greqis, 1870, alfabetarja e gjuhes shqype 1879* etj. etj.

Ligen e Prisrendit më 1878 kur e ndigjoj e përshndeti me nji enthusiasim të math. Kupitori edhe tue u marrun vesht edhe me mikun e shokun e tij *Anastas Kullurjotin* don me i çilun nji shtek të math Shqyptarve të Greqis për bashkim me Shqyptarët e tjerë, por se ra në mnì e në vërejtje të qeveris greke, e cila e hoqi prej pune e e shtini në burg. Mbas disa vjetsh qi doli, punoj me rrogë andej e kndej deri sa vdiq në nji dishprim të math ky i math patriot se nuk pau të realizuem ândren e vet !

Kristo Floqi

Një nga mâ të mbëdhejtë shkrimtarë Shqiptarë t' Italisë.

(Artikull i Kristo Floqit botuar në revistën "Hylli i Dritës, Nr. 3muaji mars 1933,f.117)

Një nga mâ të mbëdhêjtë pionerë të letrësisë s'onë, nga mâ të dukshmit e mâ të palodhshmit shkrimtarë të gjuhës shqipe, ka qenë edhè i paharushmi GJERONIMI,ose GIROLAMO DE RADA, Shqiptar prej vëllezërve t'onë t'Italisë, i cilli ka punue aqe shumë e me aqe durim, sa ka kalue ç'do masë. Veprat e tij, përpjekjet e tij, vujtjet e mjerimet e tij për litratyrën t'onë përbajnë një nga mâ të shkëlqyeshmet faqe të historisë s'onë letrare. Zâni i tij për lirimin e Shqypnisë, që vuante nënë thundrën turke, ishte ndîe shumë lark dhe kishte tronditë e mallngjye gjithë diplomatët e asaj kohe, e sidomos ata të masës së blertë të Kongresit Berlinian në vitin 1878.

Me këtë patriot të math kam pasë fatin të kem një korespondencë për një kohë të shkurtë, të rekomanduem prej gjyshit t'em, të ndjerit Efthim Mitko, auktorit të BLETËS SHQIPTARE, prej Benissuefit t'Egyptës, i cilli m'a kish tregue si mâ të çqushmin e mâ të palodhshmin puntuer të gjuhës amtare, njeri me karakter të naltë, me ndërgjigje të pastër, e me një vleftë tepër të madhe. Gjithashtu, dritë pastë, vjershëtori i jonë Naim Frashëri

më shkruante prej Stambollit për De Radën se ishte mâ i miri ndër patriotët shkrimtarë të njoftun, shëmblla e punëtorëve dhe dekani i shkrimtarëve të gjuhës shqipe si në prozë, ashtu dhe në vjershë.

Girolamo De Rada kishte lemun në katundin e vogël Maqja të Kalabrisë në vitin 1815 prej një familje të vobektë, po të ndershme, dhe studimet e tij i kish krye me shumë vështirsì e vujtje, psè nuk kish as një mik, as një protektor që t'a ndihmonte. Msimet e para i bani në kolegjin e famshëm të San Demetrio–Coronës, kolegjin shqiptar të mirënjohtun, ku kanë studjue sa e sa Shqyptarë të Italisë e të Shqypnis së lirë.

Gjitha jeta e tij ka rrjedhë në punë e në përpjekje për lirìn e përparimin e Atdheut, për të cilin nuk ka kursye kurrgjâ dhe për të cilin ashtë martyrizue, tue mbetë shumë herë pa bukë, me petka zhelane, në mjerime e në lottë, po kurrë nuk â dëshpërue se, si kur se Naim Frashëri, ka qenë edhè ky një apostull i vlefshëm, një profet i vërtetë për arthmënin'e Shqypnisë, në një kohë që askushi nuk kish guxim, por as mâ të paktën uzdajë se do ish e mujtun të shkrepte një dit edhè për Shqypnin'e mjerë Dielli i Lirisë! Girolamo de Rada ishte Tyrteu[1] I i Shqypnisë, ishte Dante Aligjeri i saj që me lyrën e tij të vorfën e hŷjnore e me kangën e tij tingëlluëse ka ndezë zjarmin e patriotismit nër zembrat e drobituna të shqyptarëve të dëshpruem.

Rapsodit'e tija (RAPSODIE ALBANESI) që botoj në Firencë më 1866 dhe fletorja FJAMURI I ARBNIT, që botoj kaqe vite me radhë, kanë qënë dy shkëndija të mbëdhâ që kanë ngjallë prej lithargut Shqyptarët, tue i u tregue rrugën e mbarë e shelbuëse e tue i vaditë me ndjenjat mâ të nalta atdhetare. Vepra e tij gjigande ka nxjerrë në dritë qindra Shqyptarë, të frymzuem me një kurajo burrnore për me vazhdue në gjyrmët e patriotit të math e për me pasue qellimin e tij të shêjt e fisnik për Atdhenë.

Tregojn se ishte aqe i papërtueshëm, sa në moshën e pleqnisë ajy, gati 80 vjetshar, shpesh herë, kur nuk kishte kafshën e

[1] Tyrteu = Tek artikulli "Një vështrim mbi poezinë" Kristo Floqi e përshkruan Tyrteun si më të naltin e më inspiruesin të poetëve elegjakë grekë të lashtësisë

tij për me shkue deri në San Demetrio–Corone me dhanë msime, si msuës që ishte në atë kolegj, shtërngohej e vinte më këmbë, mjafton të mos bjerte as një çast msimi për nxansit e tij, të cilët i kishte tërheqë një sympathi e pashoqtë kundrejt msuësit dhe një dashuri e thellë që gati e adhurojshin plakun e ngratë e të mirë, i cili nuk kursehej për ata, por gjithmonë i këshillonte për të mirën e Atdheut me një bindje të rallë e me një enthusiazmë të pakufijtë.

Një dit gomari i tij, (e vetmja pasuni që kish i shkreti De Rada), e ka përplasë në mes të dborës në një kohë dimni, në një tufan të keq, ku njeri s'guxonte me dalë jashta pragut derës. Girolamua i jonë, pa u ankue aspak e pa u dëshprue, çohet prej dboret kadalë, i ven prapë samarin gomarit të vet e mundohet me i hipë, por nuk i hipte dot se s'kishte fuqì. Do katundarë që taku-an aty, brodhë me një herë në ndihmë të këtij të ngrati, tue i çfaqë habitjen e tyne se qysh një plak njeri në një kohë aqe të keqe pat kurajon me udhtue! Por plaku endarak, ju përgjeq katundarëvet se "detyra ashtë mâ e shêjte se jeta" e cila duhet t'i perûlet e t'i lëshojë rrugën e asaj,se ndryshe nuk mbaron qellimi!

Për mos me shkue kot një thesar i vlefshëm që përmblidhej në kangët e bukura shqyptare të asaj kohe, De Rada nuk pritonte me shkue shtëpì në shtëpì e cep mbë cep për me i mbledhë e me i rreshtue në librin e tij të paharuem "Gjakët ynë i prishun", bashkë me disa tregime e gojdhanje të tjera.

Ahere, kur fuqit'e mbëdhâ nuk deshin me njoftë Shqypnìn në Kongresin e Berlinit, De Rada ishte i pari që protestoj rreptësisht kundra një padrejtësije kësodoret, tue ju adresue Gladstonit të famshëm, e tue e bindë për të drejtat jetike të kombit të tij për një lirì ethnike, deri sa mori përgjigjen e atij burrit për me mbetë qetë, se Shqypnija nuk lijet doret, po ka me përfitue edhè ajo të drejtat e saj civile si gjithë kombet e robnueme.

Kur më 1844 poeti i math frënk Lamartini kishte shkue në Napoli për banja, De Rada e përshendeti, tue i çue dy veprat e tija shqype MILOSAO dhe SERAFINA THOPIA, prej të cilave Lamartini u kënaq tepër tue e falnderue për atë mirsì, tue e inkurajue për qellimin e tij mbi të arthmen e Shqypnisë dhe tue i urue nji lirì të plottë të afërme.

Girolamo de Rada çmohej edhè nga shkrimtarët e dijetarët e huej. Kangët heroike që botonte herë pas heret, kishin tërheqë habitjen e shumë vjershëtorëve të asaj kohe, të cilët e nderojshin për së teprit. Tragjedija e tij SOFONISBA (e bija e gjeneralit ASDRUBAL) shkruar aqe bukur prej Girolamos në gjuhën shqype, kishte tërheqë verejtjen e admirimin e disa dramatistëve në zâ të asaj stine, dhe princesha shqyptare ELENA GJIKA, e njohtuna nënë pseudonymin DORA D'ISTRIA(për të cilën kam pasë shkrue tjetër herë gjân e gjatë në përkohëshmen t'ime AGIMI, që botojsha në Shkodër më 1919) e çmonte aqe fort, sa gati e adhuronte, dhe kishte shkrue shpesh e me enthusiasmë të pa–tregûme për Radën e veprat e tija tue e bâ të njoftun në të gjithë miqt'e saj të çmuem e të panjehun të kombësive të ndryshme, me të cilët kishte marrëdhanje letrare e në bisedime për hera. Gjithashtu mjaft e favorizojshin edhè Mbreti Umberto i pari si dhe mbretne-sha Margarita e Italisë. Dora d'Istria e kishte ndihmue edhè lândërisht në botimin e veprave të tija. Ashtu edhè shkrimtarja e dëgjûme e vjershëtorja e rallë austriake, baronesha *Josephina Knorr* e kish nderue tepër De Radën. Tek e mbramja qeveria Italjane, tue çmue vjershtorin t'onë, e emnoj profesorin e gjuhës Shqipe në Universitetin e Napolit, mbassi e njohi zyrtarisht gjuhën Shqype, por plaku i naltë e modest De Rada nuk e pranoj, për arsye se ishte tepër plak e jo i aftë për atë detyrë.

Girolamo de Rada kish një korespondencë mjaft të gjânë me veteranët e asaj kohe Shqiptarët shkrimtarë, si për sh. Sami e Naim Frashërin, me Jani Vreton, Naum Veqilharxhin, Abidin Dino Pashën, Efthim Mitkon, Nikoll Naçon, Anton Çakon (Çajupin) etj. etj. si dhe shumë djelmosha të thjeshtë atdhetarë të Bukureshtit, të Sofjes, të Misirit e të Stambollit. Gjithashtu një letërshkëmbim të gjattë kish edhè me të ndyerin Orhan bej e me Thimi Markon në Korçë e me disa të tjerë në Kolonjë e në Mona-stir, nga sa di unë.

Veprat mâ në zâ të tija janë sidomos "Rapsoditë Shqyptare","Serafina Thopija", "Milosao", "Nata e Krishtlindjes", "Sofonisba", "Ana Maria","Skënderbeu" e sa e sa të tjera.

De Rada ishte udhëheqsi mâ interesant e mâ i çmuëshëm i idealit të kombit. Aj e sgjoj djelmninë, të cilën e potisi[1] me ndjenjat mâ të kthellta nacionale, aj ndezi zellin e Shqyptarëve të Shqypnisë, shumica e të cilëvet msojshin për të parën herë se kemi edhè vëllazën të tjerë të një zjarmi e të një gjaku përtej Adriatikut, të cilët flitshin po atë gjuhë tingëllore shqype që flitshim edhè nè, edhè të cilët vëllazën kanë qënë shkëndija e parë e gjallnìs së gjuhës s'onë, e cila deri ahere kishte mbetë në dënimin e harresës, si një gjuhë e pa–shkrueme.De Rada pra, ishte një nga flamurtarët e saj.

Janë të pasajuem[2] artikujt e tij të ndryshëm, të botuem nër fletoret e ndryshme italjane mbi çashtjen shqiptare. Ishte një nga protektorët mâ të rrebtë e guximtarë të idhesë kombëtare, dhe kur pâ dikur se historjani në zâ Italjan *Cesare Cantú*, nuk përmendi emnin e Shqypnisë në historin'e tij gjenerale që e pat botue, De Rada u zembrue tepër e i ka shkrue Cantújt me një mënyrë shumë të ashpërt, tue ju ankue për padrejtësinë që i bani atdheut të Skander–begut, kombit Shqyptar. Gjithashtu shumë artikuj të rreptë ka shkrue kundra propagandavet helenike që mundoheshin gjithsesi me e bâ Shqypninë një pjesë të Greqisë.

De Rada pat për ndihmesë në vjershat e tija një zojë të zgjûtë e bujare, *Kristinën Gentile,* vjershëtore edhè kjo nga Piana dei Greci[3], e cila e dijte mirë gjuhën shqype dhe bashkëpunonte me gjithë fuqinë e saj me Girolamin plak. Kësaj i dhimbej tepër

---

[1] Potis = pajis

[2] Të pasajuem = të pallogaritun, të panumurt

[3] **PIANA DEI GRECI**, ose **FUSHA E GREKEVET**, ashtë quejt gabimisht prej vendasvet të Palermos të cilët, tue pá Shqyptarët e parë që e kolonizuan me petkat kombtare veshun e tuj dijtë se janë Grekë, mbassi kishin fenë orthodhokse, kan kujtue se po janë Grekë, e kështu atë fushë të banume prej tyne e kan qujtë **FUSHË GREKE**, mbiemën që edhè sot nuk asht ndryshue (Shënim i Kristo Floqit).

Shënim i Henrik Kaçulinit: Duke u konsultuar me Wikipedia rezulton i saktë ky shënim i Kristo Floqit, por se sot kur unë po e kopjoj këtë artikull (qershor 2022), kjo fushë nuk quhet më **PIANA DEI GRECI**, por **PIANA DEGLI ALBANESI**. Ndryshimi i emrit nga **PIANA DEI GRECI** në **PIANA DEGLI ALBANESI** ka ndodhur në vitin 1941.

De Rada dhe nuk ju ndâ kurrë, sa herë që aj pat nevojë për bashkëpunimin e saj, të cilin ja ofronte pa një shpërblim.

Me pak fjalë Girolamo De Rada ka qënë aj mâ punëtori e mâ i vlefshim midis shkrimtarëve Shqiptarë, sepse jeta e tij, me gjithë travajet e prapshtimet e tjera, ka qenë një jetë veprash, një jetë përpjekjesh, një jetë e destinûme vetëm e vetëm për të mirën e kombit t'onë. Prandaj De Rada do të mbesë i pavdekun e i adhurushëm për nè Shqyptarët, të cilët duhet të jemi shumë mirënjohtës përpara hijes së shêjtë të tija !

I ngrati De Rada mbaroj jetën më 1905, në një moshë 90 vjetshare, tue dhanë shpirtin midis një mjerimi e vorfnije, i lanë e gati i haruem, por se aj ka dekë tue mendue gjithë për Shqypninë, të cilën nuk e harroj deri në minutën e mbrame ! Qoftë i bekuem për gjithë jetën kujtimi i tij si një shêjë frymëzimi për brezat e arthme[1] !

———

[1] Në revistën "Perparimi", Kallnduer 1915, f.4 është një biografi e Jeronim De Rada. Në f. 8 lexojmë se "në kohë më t'mirë të riniës De Rada ka humbur 4 djelmt e tij, të shoqen dhe dy vllazen".Por edhe Kristo Floqi ka humbur 4 fëmijë: Teftën më 1910, Shpresën më 1914 dhe Dritën më 1916, si dhe djalin të cilit nuk ia di emrin dhe moshën kur ka vdekur. Ashtu si Jeronim De Rada, edhe Kristo Floqi vdiq më 1950 në varfëri të plotë, i dëshpëruar se Shqipëria kishte vendosur një regjim despotik të tipit ottoman mesjetar, por krenar se kishte kryer detyrën ndaj Atdheut.

FANATIZMI[1]

(Artikull i botuar në të përmuajshmen "AGIMI",
Nr. 7 muaji Nândor 1919)

Nuk ka nji mjet mâ të poshtëm e të mrapshtë ndë botët, se përdorim' i fesë si veglë për me mashtruem botën tue e shmangun prej kombit e atdheut.

Nuk ka besë[2] ndë botët qi e shtrëngon bestarin mos m'e dashtë e mos me jetuem vëllaznisht me vëllan' e vet të nji gjuhe e të nji gjaku ! Përkundra po thuej se mâ e shumta e besimevet na këshillojnë *të duem edhe anmikun t'onë si vetvehten*.N' ungjill të Shënt Mateut V,VI. âsht e shkrueme: "*Doni anmiqtë tuej, bekoni ata qu ju mallkojnë, bâni mirë atyne qi ju kanë mëni edhe faluni për ata që ju bâjnë dâm e ju ndjekin"!*

Po t'i studjojmë mirë këto fjalë,na e shofim sheshazi, se sa gabushëm janë disa nesh, të cilët tue pandehun se gjoja me fanatizmin fetar po i bâjnë nji sherbim besimit edhe atdheut, përkundra tue mbjellë darje përçarje, i sjellin nji dâm të math besës edhe kombit. Me këto fjalë na nuk duem të diftojme *aspak* nji mëni kundra atyne qi sot duen me anë të besimit të dalin udhëheqës të kombit, por po ja u shtimë në vesh, se rruga qi kanë zânë, me e përdorue besimin si veglë për me mbjellë *fanatizëm* në popull, âsht i dâmshëm edhe shumë i rrezikshëm si për besë ashtu për atdhè. Kujtojmë se ngjarjet e mnerushme të vjetve të kalueme[3] na kanë dhânë nji msim të mjaftueshëm mbi këtë çâshtje, për të cilin, me idhnim të math t'onin po na duhet këtu me shkrue.

Shofim me helm të math se sot, në nji kohë kur të gjitha fuqit'e kombit duhen përmbledhun vetëm rreth nji flamuri, të dalin njerës pa pikën e turpit e të ftojnë njerzit të qarkohen rreth

---

[1] Mendoj se ky artikull, botuar në të përmuajshmen "AGIMI" është shkruar nga Kristo Floqi sepse mban firmën "Drejtimi", dhe K.Floqi ishte drejtuesi i kësj të përmuajshme. Nga ana tjetër këtë temë ai e ka trajtuar shpesh herë edhe në vitet e mëvonshme si gazetar në Tiranë. Unë nuk përjashtoj mundësinë që shkrimi të jetë bërë në bashkëpunim me miqt e tij Hil Mosi dhe Karl Gurakuqi (H. Kaçulini)

[2] Besë = fè, besim fetar

[3] Bëhet fjalë për rebelimin e vitit 1914 të shijakasve kundra princit De Wied.

nji flamuri fetar, qi do të jetë i vetmi shpëtimtar, e jo rreth flamurit të Shqipnisë. Âsht e tepërt të thomi, se ata qi punojnë kso dore, o janë njerëz hypokritë e të çmendun, ose janë veglat e ndonji fuqisë së huej, e cila punon në vend t'onë nen divisen "divide et impèra". Prandaj nuk âsht çudi, në qoftë se me idhnim fort të math, vrehet se qysh sot gjasht muej e sipër ka nisë në popull të ndigjohen fjalë fanatike e të pa-ngjashme, qi nuk i kanë hije aspak nji atdhetari. Ata pakë qi janë bâmë vegla të kti mendimi pandehin se janë mâ të mirët atdhetarë, e nuk e dijnë se nuk janë tjetër veç se rreziku e rrenimâ i Shqipnisë.

Atdhetarët e vërtetë, qi nuk kanë qenë kurr veglat e të huejvet, por qi kanë pasë gjithmonë për qëllim të parë shpëtimin e kombit topiten për këtë udhë të shtrembët qi kanë zânë disa të vetquejtun atdhetarë edhe në fund të zemrës i luten Perëndisë tue thânë : "O Zot fali, se as ata nuk dijnë se ç' bâjnë" ! – Nuk quhet atdhetarì edhe nder kur njeriu ndrron fletë e ngjyrë si kamaleoni sa herë qi e lypë nevoja e interesi ! Nuk âsht fe e besë e vertetë ajo, qi në nji komb si i joni, ku banort mâ se tri të katërta janë musliman, të na këshillojë të dahemi veçmas me gisht, tue vepruem nën nji flamur të posaçëm, kur i vetmi flamur i joni âsht ai i Shqipnisë, i cili nuk âsht as qi mundet me qenë monopol i ndonji besimi të ndryshëm.

Kemi ndigjuem shpesh herë fjalë fanatike, vrastare e të pa gjashme qi përdoroheshin prej ndonji shqiptari, mbas të cilavet çfaqej helmi fetar i tyne, por nuk ja kemi vû veshin, sepse mendojshim se deri atje nuk e mrrijte mâ thellë kuptimi i tyne. Kemi ndigjuem edhe disa fjalë qi janë përhapun ndër ditët e fundshme për trajtimin e shoqnisë, e cila do të mblidhet në rreth të vet vetëm bestarët e nji besimi, por mbassi edhe gjâ faqeza nuk shifshim me sŷ, nuk kemi dashtë me besuem. Numri 10 i "Lajmtarit" të k.v. i drejtuem prej Z.Z.A.A. Jezujtë, tue u kapë me çâshtjen e dramit "Erminja e Vorfën" qi tfaqi shoqënija e jonë "Vëllazënija" me fjalë: Kso doret mundena, si i thonë nji fjalës, me da dhenët dhish: kjo punë ka m'u pa shpejt edhe mâ çiltas, pse *âsht koha mâ që n'njenë anë t'rreshtohen t'krishtenët e mirë e në tjetren ata qi pak a shum ndjekin nji flamur tjetër*" na i provonka fjalët

qi kemi ndigjuem për trajtimin e nji shoqnis, e cila tue i da bestarët prej shoqishoqit, t'i lidhte me i shërbyem atdheut ! Çudija e jonë mâ e madhja âsht kur "Lajmtari" mbassi i ka shkruem ato rreshta plot me fanatizëm, vijon tue thânë se nji punë ksilloj âsht nji fitim i madh për klerin ase për fenë t'onë. – Na po thomi për vehte e për shokë t'onë katholikë, qi na âsht mbushun mendja, se ato fjalë nuk kanë mujt kurrsesi me dalë prej pendes së nji pjestari të klerit, përveç i shkruen penda e ndonji djaloshi, i cili në mende të vet pandeh qi feja katholike për nji mend âsht nji fe e tillë, qi na mëson atdhenë t'a bâjmë monopol besimi; por si do qi t'jetë âsht bâmun nji gabim n'ato rreshta me i botuem ndo nji të përkohëshme, pa u bâmun nji vrejtje të meritueshme.

Na prej anës s'onë nuk jemi aspak kundrështarë qi të trajtohen shoqënina ndë rreth t'antarvet të nji besimi, por nuk âsht mirë qi ktyne shoqëninave me u dhânë nji frymë fanatike aqë të madhe, sa me i sjellë dâm çâshtjes kombëtare, e cila sot ka nevojë për udhëheqës atdhetarë të vërtetë e me sjellje të mira, e jo për asish qi janë të mbushun me helm e me vnerë *fanatizmi*.

Të gjithë e kemi kuptuem se sa rreziqe të mëdha i ka sjellë atdheut besimi, kur âsht përdoruem si veglë fanatizmi, për me krye qellime politike të dâmshme, e ati gabimi lypset qi secili, qi e don pak a shumë Shqipninë t'i ruhet fort, në dashtë mos me fituem nâmët e të gjith kombit.

Drejtimi

AUTOR

SAMUEL SMILES
Publicist e moralist i famshim I n g l i s

Ndihmoji vetvehtes
ose
KARAKTERI
Msim moral e dobiprurës për çdo njeri, burrë ose grua
Përkthyer shkurtazi
Prej veprës së madhe inglishte "*Helpself*"
Prej

KR. FLOQIT

(Botuar në gazetën "Indipendenca Shqiptare[1]"
Nr. 1,3,5,7,etj.1925)

———

KARAKTERI

Kapitulli A
VLEFTA E KARAKTERIT

Karakteri i njeriut është fuqija e tij e vërtetë. Ajy që çquhet, ose nga drejtësia që ka, ose nga naltësia e principeve të tij, ose nga mendimet e tij të patronditura e bën tjetrin që t'a respektojë pa dashur. Gjithë populli, gjithë bota ushqen për këta një besim të plotë dhe një bindje të patundur e kërkon kurdoherë t'i imitojë. Mendja e naltë i habit njerzit, po karakteri i mirë i siguron respektin atij që e ka. Mendja e naltë është fuqi e trurit, po karakteri mburron kurdoherë nga zembra. Prandaj shohim me të vërtetë që mëndje-mbëdhenjtë zenë në mes të shoqërisë njerzore pozita të

[1] Gazeta "Indipendenca Shqiptare" është botuar nga Kristo Floqi. Ai e ka zgjedhur këtë titull gazete. Në krye të çdo numuri të gazetës është deviza: "Përpara së gjithash Atdheu!" Gjërë e gjatë për këtë gazetë, si dhe pse e bëri, K.Floqi ka shkruar tek "Autobiografia ime"

shênuara analloge me dituritë e tyre, po në ndërgjegje të shoqërisë çmohen e nderohen vetëm ata që kanë karakter.

Burrat e mbëdhenj në përmes të shekujve kanë qenë si shënja të jashtazakonshme për njerzinë, se edhé madhështija është një sent që ka marrëdhënje me burrat e çquar e njerzit e mbëdhenj. Njerzit më të shumtën përshmshtillen brenda një orizonti të kufizuar, pse të ngushtë edhé të pakët jan'ata që gjejnë kohë e volí të tregohen njerës të mëdhenj. Ç'do njeri munt të sillet i ndershëm e i drejtë në shoqërinë njerzore; e ka në dorë të jetë i drejtë, i besës, i sinqertë, i ndershëm edhé në ato më të voglat sende me pak fjalë prej atij mvaret të jetë i mirë ose i keq !

Sicilido mundet t'a kuptonjë e t'a msonjë karakterin e vërtetë të tjetër kujt prej të sjellave që sheh midis tij e shokëve të tij që e afrojnë e e shoqërojnë edhé prej mynyrës me të cilën vepëron, ose kryen punët e tij, ose përgjithërisht sillet me punët e të tjerëve.

Detyra është udhëheqësi i domosdoshëm i njeriut ndër gjithë marrëdhënjet e tij të jetës njerëzore edhé kjo është bara e karakterëve më të fisçëm. Njeriu munt të mos ketë të holla, a prona e pasuní, as dijeni të larta e shqensore, as fuqi e influencë, po do të jetë i respektuar e do meritonjë të nderohet në qoftë se ka zembër të duruarshme e fisnikëri shpirti, në qoftë se është i ndershëm e njeri i matur e i sinqertë, e në qoftë se përmbaron me ndërgjegje detyr' e tij.

Mendja e zhvilluar nuk munt të formojë me doemos edhé një karakter të mbaruar e të pastër. Një Engles filosof thoshte: "Një drehem[1] vepra të mira ka vleftë më tepër se një okë[2] shkenzë". Edhe kish të drejtë; nuk e tha këtë se desh të poshtëronte shkenzën, po për të venë ré e për të kuptuar se ajy që ka dijeni të shumta duhet të jetë edhé njeri i mirë. Mundet dikush të rëfehet i aftë për një mjeshtri, një tjetër i zoti në literaturë ose në një shken-

[1] Dërhem = Njësi e vjetër peshe, e barabartë me një të katërqindtën e okës
[2] Okë = Njësi e vjetër peshe rreth një kilogram e një çerek deri një kilogram e gjysmë

zë, po moralisht të mos jetë i zoti të krahësohet as me ata katundarët e vobektë e të paditun.

Pasuria pak ka të bënjë me formimin e karakterit; përkundrazi, shpesh herë bëhet edhé shkaktare e çorroditjes[1] të karakterit, ose i poshtërimit të moralit. Begatí e çorroditjes, e shqim[2] i immoralitetet mjerisht kanë shumë afrim midis tyre.

Karakteri është një pasuri e vërtetë, është pasuria mê fisnike mbi gjithë pasurit'e tjera. Ajy që ka një të tillë pasuní, ajy që ka karakter të vërtetë, ka një farë të drejtë mbi nderin e respektin e gjithë njerëzve. Ata që vetëm me anë të karakterit të tyre kërkojnë të mirën e vërtetë, ndofta do mos e gjejnë kurrë, ndofta nuk do përfitojnë kurrë kamje e begatí të mbëdha, po do gjejnë pa fjalë shpërblim për karakterin që treguan, se bota do t'i çmonjë e do t'i nderonjë një ditë. Një Engles moralist ka thënë se "As një njeri nuk detyrohet të jetë i pasur,ose i ditur, po pa tjetër ka detyrë të jet'i ndershim".

Në jetën e përditëshme karakteri lot një roll mê energjik se sa mendja. Aqe në jetën publike, sa edhé në jetën private, bazën kryesore që përfiton një qëllim e përbën kurdoherë drejtësia e karakterit, e cila drejton dhe e udhëheq *mendjen e zakonshme*, ose si thonë,*mendjen komune*.Mendja e zakonshme,tyke u udhëhequr prej experiencës, e tyke u frymëzuar prej një vullneti të mirë përbën *urtësinë praktike*. Prandaj shumë herë shëkojmë ca njerës që kanë një influencë për mbi të tjerët, ndonse nuk kanë aqë fuqi dijenije. Për këta njerës mundet dikush lehtazi të thotë se : "virtutet e tyre janë fuqia e tyre".

Në brumimin e karakterit marrin pjesë shumë cirkonstansa[3] të vogla, që mvarren pak a shumë prap prej nesh. Nuk takon ditë për pa n'a msuar, e për pa n'a shtyrë të veprojmë një të mirë, ose një të keqe. Ç'do vepër, ç'do mejtim, ç'do ndjenjë influencon formimin e moralit, e zakoneve e të mendjes s'onë. Karakteri i njeriut ndryshohet për ditë ose për të mirë, ose për të keq, edhé

[1] çorroditje = zvetnitje, fëlliqje, përdhosje.Shpesh herë K. Floqi e përdor këtë fjalë me kuptimin e "korrupsionit".
[2] shqim = Shquaj, dalloj
[3] cirkostanca = rrethana

dikûr ûnjet. Englezi shkrimtar i famshëm *Rosckin* thotë se nuk ka një marrí, ose një faj që bëra në jetën t'eme që nuk më prishi e nuk më damtoj aktivitetin t'em, që nuk më shduki buzëqeshjen t'ime. Kur se ç'do gjë e mirë e fisnike që bëra më duket se më ndjek pas e më inkurajon shpirtin.

Karakteri i mirë nuk përfitohet edhé pa përpjekjen t'onë. Duhet një stërvitje e gjith-hershme, një ushtrim i ngaditëshme,sŷ i pafjetur e vullnet i duruarshëm. Në qoftë se gjen përpara vështirësi, pengime edhé humbje të çashta duhet të mundohesh e të luftosh kundra atyre sa t'i mundësh, tyke qenë i armatosur kurdoherë me durim e qëndrim të math. Kurrë s'do falimentosh në qoftë se ké trú të fortë edhe zembër të pastër.

Karakterin e njeriut e tregojnë vetë veprat e tija, të cilat po të frymëzohen edhe me drejtësí, me mendje praktike e me vese të mira, ahere edhé karakteri formohet i drejtë, i mirë e i naltë. Ahere edhé njeriu ecën me hapa të qëndruarshme, me hapa të matura, tyke e vërejtur të kryerit e detyrës si një sent mê të lartër mbi nderin e përgjithëshëm, edhé gëzimin që ndjen në ndërgjegje si një lavdi mê të madhe mbi të gjithë lavdit e tjera të botës.

Sa do që shëmbllat lozin roll të math e influencojnë shumë në formimin e karakterit, po baza e vërtet' e tij është kurdoherë fuqia që ka shpirti. Kjo fuqi shpirtnore e ndihmon njerinë në vështirësit'e jetës së tij e i jep kurajo e vullnet vehtiak. Po të mos muntte njeriu t'i vinte fré vehtes së tij e t'a përmbante, ahere pozita e tij në botë do të ish as gjâsendi. Pa një farë fuqije praktike e aktive të bashkuara dhe me vullnet – i cili është rrênja e karakterit – edhê me urtêsi jeta e njeriut do të ishte pa një qëllim, do të shêmbëllente me ato ujrat e ndejura, që qëndrojnë më një vent gjer sa qelben, ndonse duhet të përngjasë me atë ujët që rrjeth pa pushuar, sepse vetëm ky ujë i jep dobi tokës, dheut.

Kur elementat prej të cilave përbëhet karakteri janë të bashkuara me vullnet të fortë, që e udhëheqin ndjenja të lartra, ahere njeriu hyn në udhën e detyrës edhe qëndron në atë, pa vënë re në se kjo e damtoj apo jo landërisht. Ahere munt të thotë njeriu se harriu në mê të naltën shkallë të njerëzimit. Në qoftë se ka përnjiment karakter energjik, po i mungon integriteti e mirësia,

ahere karakteri bëhet një vegël e së keqes. Midis njerësve kësi natyre numurohet ata kërbaçët mê të këqinj të gjinisë njërëzore, ata çkatërruesit e mbëdhenj të kombeve, të cilët në stina të ndryshme, bënë edhe vepra katastrofale.

Njeriu që ka karakter fisnik është kurdoherë njëri me ndërgjegje të mirë edhê ndërgjegja e tij duket ndër fjalët e ndër veprat e tija. Ësht' i matur e i butë edhe nderon edhe vehten e tij edhe të tjerët. Nderon ç'do të mirë që kushtoj, ose që lanë trashëgim brezat e shkuara, ç'do vepër të madhe, ç'do punë fisnike, ç'do idhê të naltë, nderon njerëzit e mbëdhenj të kohës së kaluar, si dhe të kohës së tanishme. Ky respekt naltëson personat edhe formon bazën e lumërisë edhe të familjeve edhe të kombeve. Atje ku s'ka respekt, nuk ka as besnikëri, as besim te Perëndia edhê te i afërmi, as paqje sociale, as përparim.

Po shpirti i karaktereve të mbëdhenj është vullneti. Atje ku ka vullnet ka edhe jetë e energji; kur s'ka, pason kurdoherë plogësia, pafuqija dhe dëshprimi. Vullneti i fortë është si uji kur ecën e viri[1] që kalon; si ajy e hapin udhën vetë. Ajy që ngrohet prej zjarit të një vullneti të këtillë jo vetëm udhëheq vehten e tij, por edhe tërheq të tjerët pas tij. Ç'do vepërim i tij dëshmon edhe fuqinë që ka, dëshmon indipendencën edhe besimin ne vehtja e tij, inkurajon të tjerët, tyke ju inspiruar respektin, çuditjen edhe përulnjen.

Këto i shohim jo vetëm ndër ata që marin përsipër fëllqinjat[2] e mbëdha të politikës, për shembull, ose të luftave, po edhê ndër ata që rijnë, ose qëndrojnë përbrenda horizondit të ngushtë të jetës së tyre ordinare. Kudo dhe kurdoherë njerëzit e mirë, njerëzit e ndershëm, njerëzit me vullnet të patundur, ata që ndjejn fuqin' e fortë në vullnetin e tyre, bêhen udhëheqësit natyrorë e të tjerëve, të cilët i ndjekin e ju shkojnë pas pa dashur, pa kuptuar, vetëm prej vetiut ! Njerës të këtillë lamburitin edhe naltësojnë ç'do gjë që gjendet mbrenda kufive, ku vepëron energji' e tyre.

---

[1] vir = vijë uji

[2] Fëllqinjë = mundim, përpjekje.(K.Floqi)

Kur një njeri i një karakteri të tillë thritet të marrë përsipër një vent të besuar, ose një autoritet, gjith'ata që ndodhen nën urdhërat e tij ndjejnë fuqin'e tyre të dymëzuar, ose të shtuar dyfish. Detarët mbi krye të të cilëvet ishte admirali Nelson, kishin gjithë po atë heroîzmë që kishte edhe i madhi Inglis. Shpesh herë një influencë e ushtëruar kësodore merr po thua formën e një magjîje dhe duket sikur vjen prej një fuqije jashta-njerëzore, ose fuqije mbinjerëzore. Romani *Pompeius* thoshte "Më mjafton të godit një herë dherin e Italisë me kêmbë, që të japë këjo ushtëri!"

Kujtimi i njerësve të tillë të mbëdhenj qêndron si një përmendore e përjetëshme e vleftës së tyre. Njeriu vdes edhe shduket, po mendja e mendimet e tij edhe veprat e tij rrojnë edhê mbas atij edhe vizatohet e shkruhen për gjithnjë në historin'e kombit të vet. Kështu zgjatet e amëshohet energia e tyre, kurse mendimet e vullneti i tyre vlejnë shumë për formimin e avenirit ose së pritmes, janë far (fanarë) të vërtetë të përparimit njerzor, të cilët ndritin e lamburitin atmosferën morale që i përmshtjell, po edhe pas vdekjes së tyre pasojnë të derdhin e të shpërndajnë dritën e tyre edhe mbi brezat e arthme.

Është gjë naturale të çuditemi me njerëzit e mbëdhenj e t'i nderojmë, sepse shenjtërojnë kombin e tyre, të cilit i përkasin; tregojnë udhën edhe i mësojnë jo vetëm njerëzit e kohës së tyre, po edhe brezat e arthme. Shêmbulla e tyre gloriose, mendimet e tyre bëhen trashëgim i paçmuar i kombit të tyre. Bashkojnë kohën e tanishme me kohën e kaluar edhe pregatitin më të mirë kohën e arthme. Ata ngrehin me një dorë të hekurt flamurin e virtutit edhe tradicjonet edhe kujtimet e mira, e të tre fisnikërojnë e forcojnë shpirtin e atyre që vijnë pas.

Karakteri i çfaqur në këtë mënyrë edhe me fjalë edhe me vepra ka një gjë të pavdekur me vehte. Opinionet e njerësve të mbëdhenj qëndrojnë në kujtimin e brezave të arthme edhe më në funt bëhen një pjesë e pa ndarë e jetës s'onë; zëri i tyre vazhdon të mbrijnë gjer në veshët t'ona tyke ardhur për së largu nga varret e tyre. *Moïsiu,Sollomoni, Platoni, Sokrati, Xhenofoni, Seneka, Ciceroni, Dhemosteni, Epikteti,* etj. duket sikur rrojnë edhe sot midis nesh.

Historia universale, ose e përgjithëshme është pikërisht historia e njerësve të tillë të mbëdhenj. Këta janë *aristokratia njerëzore*[1]. Për atë kohë, në të cilën janë lindur edhê për atë komb në të cilën u duknë, lenë një ndërshtypje të thellë si kur se vulën e mendjes ose e spiritës së tyre. Këta janë lêngu i kombit, të cilit i përkasin;e naltësojnë, e forcojnë, e fisnikërojnë. Embri e kujtimi i njerësve të mbëdhenj të një kombi janë begatia e tyre, një begati që s'munt t'ja marrë, ose t'ja rrëmbenjë asnjë katastrofë, as një njeri. Në ç'do rast kritik që kalon patriotismi, ata fatosat e vdekur rrojnë në kujtimin e stërnipëve të tyre edhe qëndrojnë pranë si kur se dëshmorë të pa dukur të ngjarjevet.Një komp, një vent, që e ndjen se ka me vehte heronj të këtillë të famshëm që i shohim fatin si kur se i ndjehen përsipër tij, ajy komp, ajy vent nuk munt të shduket!! Që të çmojmë mirë e caktimisht virtutet e një kombi, nuk mjafton të marrim parasysh vetëm njerëzit e tij të mbëdhenj. Duhet të hetojmë cili është karakteri dominuës, karakteri i vërtetë i një populli përgjithësisht.

Kur një shkrimtar Amerikan vizitoi një dit në vilën e tij Walter Scott-in, romancjeri i dëgjuar Skoces, për me nderue shtektarin e tij ftoj në një gosti që e bëri për nder të tij, jo vetëm fqinjët e tij pasanikë po edhe bujqit e vobektë. "Dëshiroj i tha, të njohësh katundarët e thjeshtë e të mirë të Skotisë. Nuk do kuptosh, i tha, vleftën e një kombi në qoftë se sheh vetëm klasat e tij fisnike edhe zonjat e zotërinjtë të shoqërisë së naltë, ose të aristokracisë,se pse këta janë kurdoherë e gjithëmonë po thuaj të njëjtë.

Burrat e Shtetit, burrat politikanë, filozofët, shqenzëtarët, dijetarët përbëjnë përnjiment *klasën shpirtnore*,kryet si me thanë, të shoqërisë. Mirpo ata që bëhen themeltarët e industrive të reja, ata që hapin shtegje të reja të punës e të përparimit, sindëkur[2] edhe grumbulli i madh i klasave punëtore – prej të cilave shëndrit shumë herë spirita e vërtetë morale, – këta, po themi, përfaqësojnë *fuqinë reale*, fuqin'e vërtetë edhe formojnë bazën e një kombi.

[1] aristokracia njerzore = njerëz të aftë, të zott.

[2] sindëkur = sikurse

Sikurse njerëzit, ashtu edhe kombet nderohen e naltësohen analogjikisht pas karakterit që kanë. Në shtetet konstitucjonare ku kombet qeverisen e sundohen në bazë të një ligje kushtetore, atje do me thënë ku gjithë klasat sociale pjesëtojnë pak a shumë në qeverimin e vendit, karakteri nacional mvarret më fort nga cilësit' e numurit më të math të nënështetasve, se sa nga pakica e tyre. Ato çilësi që e çquajnë e caktojnë karakterin e njerësve, gjith'ato edhe në atë mënyrë caktojnë edhe karakterin e kombeve.

Ligjët e zakonet e mira nuk mjaftojnë të çfaqin përgjithësisht karakterin nacional.Vlefta morale e nderi i një kombi mvarret prej karakterit të njerësve, ose personave,të cilët e përbëjnë edhe nga principet që kanë ata në mes të tyre; Qeverija përgjithësisht e një vendi nuk mund të jetë më e mirë,ose m'e lartër se ata, të cilët qeverisen prej asaj. **Në qoftë se shumica e popullit mendohet mirë edhe ka ndërgjegje të plottë të detyrës së tij, në qoftë se ka një moral e zakone të mira, ahere edhe kombi do drejtohet e do sundohet me nder e bujarisht; përkundrazi në qoftë se shumica e popullit është e çoroditur e egoiste, pa ndërgjegje e pa ndjenjë të nderit, pa besim, pa ligjë, ahere pa fjalë do të vazhdonjë tyke ja mbrimun[1] shpejt mbretërija e budallenjve e e të liqve.**

Për kombet, si edhe për njerëzit ndjenja që ndodhen në një gjini glorioze është një mshtetje e madhe e një fuqi e pakufizuar, sepse me një herë e kuptojnë se janë trashëgimtarë të madhnisë të të parve të tyre edhé se kanë detyra t'a pasojnë, t'a smadhojnë e t'a përjetësojnë famën e shkëlqimin e tyre.

Ka një domethënje të madhe e me rëndësi për një popull origina e raca e tij e kujtimi glorioz i kohës së kaluar, sepse prej asaj nxjer elementet e jetës së tij; naltësohet e ndritësohet prej tradicjonevet e prej msimevet të shtërgjyshëve të tij, prej kujtimit të veprave të mbëdha të tyre, prej fëllqinjave fisnike dhe prej shprovimeve të hidhura që ata kanë vojtur tyke duruar.

[1] mbrimun = arritur

Kombet, ashtu si edhe njerëzit pastrohen, forcohen e shenjtërohen me anë të shprovave që marrin. Faqet më të shënuara historike të jetës së tyre janë ato që na bijen ndërment mjerimet e cfilitjet përmes të së cilavet karakteri i tyre u përmbajt e nuk u përhunj. Dashuria e lirisë dhe atdhedashsija n'a tërheqin kurdoherë çudinë t'onë faqe atyre, po ca m'i math e për të vënë rè është durimi i një kombi, të cilin nuk e mposhtnë dot mjerimet që hoqi!

Filopatria[1] e vërtetë është kurdoherë e urët e e matur edhe çfaqet me anë të veprave, me anë të përmbarimit e përmbushjes së detyrës, me anë të urtësisë së ligjëshme, më një fjalë më anë të jetës të njerësve të përmbajtur e të ndershëm. Pseudopatriotizmi, përkundrazi tregohet vetëm me fjalë të trasha e të thata. Pseudopatrioti thret e bërtet, tyke u mburur për gjysh–shtërgjyshërit e tij, tyke kënduar hymne e këngë patriotike e tyke shetitur e treguar rrugëve flamure e symbole kombëtare e tyke përtypur pa rreshtur lavdimet e ankimet që vet'ajy i përdoron e i shfrytzon për të harrirë qëllimet e tija.

Kur bije poshtë karakteri i një kombi, ajy komb munt të thohet se afroj në shdukjen e tij; do të humbasë. Kur të pushonjë së çmuari e së ushtëruari virtytat e sinqeritetit, e nderit dhe të drejtësisë, ahere do rëzohet domosdo. Edhe në qoftë se midis shëmtyrave[2] gjenden akoma njerës të mirë, të cilëvet ju lijet për barrë shpëtimi i atdheut, kujdesja e vetëm e tyre duhet të jetë ristorasja[3] e karakterëve individualë, ose vehtijakë. Në qoftë se edhe këjo s'ësht' e mundur ahere shteti ka mbaruar, nuk ka më shpresë shpëtimi !

[1] filopatría = dashuria për Atdheun
[2] shëmtyra = gërmadha, mbetje nga shembja e një ndërtimi
[3] ristorasja = rivendosja

Kapitulli B
FUQIA E FAMILJES

Familja është shkolla e parë e m'e vlefshmja e karakterit të njeriut. Brenda në atë merr njeriu edukatën e tij morale edhe prej kësaj inspirohen principet, të cilat e shoqërojnë në gjithë jetën e tij.

Një fjal'e urtë thotë se "veset e mira bëjnë njerin'e mirë". Një tjetër proverb thotë se "mendja bën njerinë" opinioni më i drejtë është se familja bën njerinë, sepse familja përmban jo vetëm veset e moralin, po edhe karakterin. Në familjen brenda zhdrivillohet zembra e përfitohen veset e mira, ase të këqija, atje gatohet mendja edhe karakteri i njeriut merr formën e së mirës, ose të së keqes. Prej këtij mburrimi të kulluar, ose të pëgërë dalin principet që frymëzojnë klaset njerzore. Edhé ato ligjet e Shtetit s'janë përveç se përfytyrimi i familjes. Ata që mësuan kalamajtë brënda në familjet e tyre, jetën private, gjith ato duken më von në shoqërinë njerzore dhe përbëjnë *opinionin publik.*

Natyrisht, jeta familjare është shkolla e parë e jetës sociale. Shoqëritë (societés) janë, ose shumë ose pak të qytetëruara, analogjikisht, sa më të mirë ose më të keqje rritje, e ç'edukatë kanë marrë që foshnjërije miset e tyre që i formojnë.

Në rritjen e njerësve shumë kanë të bëjnë edhe situatat, ose cirkonstancat morale, të cilat i përmshtuall në të parat vjete të jetës së tyre. Njeriu vjen në këtë botë lakuriq dhe s'ka fuqi as vetë t'i ndihmonjë vehtes së tij, prej të tjerëve pret edhe ushqimin e tij edhe arsyetimin. Pra edukata e tij fillon nga fryma e tij e parë. Një mëmë pyeti një herë një klerik kur, e në cilën kohë duhet të fillojnë edukimin e të birit, që ish ahere katër vjetsh, edhe kleriku (prifti) i tha: "zonjë, në qoftë se nuk kini nisur t'a edukoni djalin t'uaj paskërki humbur katër vjet. Çashti m'i mirë është qysh ahere që kini parë nënqeshjen e parë të shëndritë në buzët e djalit t'uaj."

Djali në fillim msohet prej imitacjonit, do me thënë tyke parë msuesin e tij.I pari është *shëmblla*;prandaj të parat shëmblla, që pa i mituri e me të cilat u brumos e u gatua e shoqërojnë në

gjithë jetën e tij. Karakteri i çunit, ose i gocës, përbën bërthamën e karakterit të burrit, ose të gruas. Ç'do mësim i mbasandajmë është vetëm një shtesë.

Ajo shemblla m'e mirë që gjendet gjithënjë përpara syve të djalit është *nëna*.

Një nënë vlen sa për njëqint msuës. Në familje ajo është magneti i gjithë zembrave dhe hylli pollar i gjithë sŷve. Fëmij'e saj e imitojnë pa rreshtur, edhe shëmblla që ajo jep ka një domethënje mé të madhe se sa ç'do tjetër mësim. Shëmblla është një farë msimi që çfaqet me punë jo vetëm me fjalë. Kundra shëmbllës së keqe nuk bën dobi as një këshillë. Këshillat kur nuk shoqërohen prej shëmbllës së mirë bëjnë mé tepër dëm se sa dobi, se nuk shërbejnë për tjetër gjë, përveç se të msojnë ligësinë mê të dobët që munt të bëhet, do me thënë hypokrisinë. Të vegjlit çquajn shumë mirë ne prindërit e tyre në e mbajnë fjalën e prémtimin që japin apo jo edhe e kuptojnë mirë kur të tjera thonë e të tjera punojnë.

Prej imitimit të veprimeve formohet dal nga dal e pa u ndjerë karakteri; edhe me qenë se nëna influencon të vegjlit e saj **mê tepër se babaj**, merret vesh se edhe shëmblla që jep ajo ka shumë mê të madhe rëndësi brenda në familje. Shtëpia është mbretëria e gruas; e sundon si një monark apsolut. Ajo është shëmblla e yrneku[1], të cilat kanë parasysh për herë fëmija, edhe të cilat imitojnë pa pasur ndërgjegjen se e imitojnë. Dashuria e nënës është kujdesimi i dukshëm i njeriut. Influencimi i imitacjonit është i pasosur, është universal, ose i përbotëshëm e fillon qysh prej çashteve të para të jetës edhe vazhdon pastaj anallogjikisht mas influencimit, të cilin nëna e ka pasur qysh ahere mbi të vegjëlit e saj.

Njeriu në travajet[2] e vështirësit' e jetës së tij, midis mjerimeve e poterave kur e zenë, rend e kërkon këshillat e ngushëllimin e s'ëmës. Principet e kulluara e fisnike, të cilat nëna e mirë mbolli në zembrën e fëmijëve të saj në moshën e djalërisë,

[1] yrnek = model, mostër, shembull
[2] travaj = vuajtje

pasojnë edhè pas vdekjes së saj e qitin pêmë të mira. Edhè ahere kur vdes nëna e s'mbetet përveç se kujtimi i saj vetëm, edhè ahere fëmij'e saj vazhdojnë t'a nderojnë e t'a bekojnë.

Mundet njeriu sigurisht të thotë se lumëria, ose mjerimi, msimi,ose padija qytetërimi, barbarismi i cilit ç'do komp mvarret mê të shumën prej influencës,të cilën ushtron gruaja në mbretërin e saj, domethënë në shtëpi të saj.

Muziktar'i dëgjuar i Francës *Getry* e konsideronte aqe të madhe fuqin'e gruas mbi formimin e karakterit sa thoshte që: "një nënë e mirë është një vepër e madhnushme e natyrës". Edhè kish të drejtë sepsè nënat e mira shumë mê tepër se sa âtët kanë të bëjnë me rritjen e përditëshme të njerëzimit! Ata krijojnë *atmosferën morale* e cila ushqen mendjen, si kur se atmosfera natyrore ushqen trupin.

Shtëpia m'e dobët e m'e vobektë ku mbretëron gruaja vesemirë, gruaja-amvise, e prepsur e buzëqeshur munt të bëhet vatra e lumërisë dhe e fatbardhësisë. Një shtëpi e tillë bëhet qendra e lidhnive të shejta familiare. Atjè e ndjen jetën konjugale (të martesës); atjè zembra e tij çlodhet në orët e fortunave të jetës, si kur se në një liman të sigurtë; atjè gjen qetësi pas mundimeve të ditës; atjè kërkon gëzimin e tij, atjè lumërinë dhe ngushëllimin sa herë që i shkrep ndo një poterë mbi krye.

Një e tillë shtëpi është shkolla mê e mira jo vetëm për moshën e djalërisë, por edhè për atë të burrnisë. Në atë brenda si të rinj, si pleq frymëzohen me gëzim, me ëmbëlsi, me butësi me abnegacion[1] (fedaqarllëk) dhe me një dashuri për të afërmin. Një jetë e atillë e pregatit njerinë të kryenj mirë jo vetëm detyrat e tij vehtijake, po edhè detyrat publike; ajy që do shtëpin' e vet do të dojë do e mos edhe atdhen e vet e do t'i shërbenjë me një papërtesë më tepër se ç'do njeri tjetër.

Mjerisht takon ndo një herë që babaj të jetë i leshtë (budallá) pijanik ose plënkprishës, po me gjith'ato shtëpia nuk prishet, pse ? Se nëna është vesmirë, e urtë e trimreshë, kurse përkundrazi në qoftë se nëna s'i ka këto virtuta, shtëpia shembet e çkatërrohet

[1] abnegacion = vetmohim

edhe fëmija shumë rrallë munt të bëhen të mirë, sado i mir të jetë i at' i tyre.

Brumimi i karakterit mvarret shumë herë prej influencës së gruas, e cila e ushtëron këtë fuqi e e zbaton dal e nga dale e pa bujë nënë pullazin e shtëpisë së saj, kryen detyrën e saj me durim e urti dhe nuk lëvdohet për triumfet e saj, të cilat shumë herë as që përmenden. Mirpo vepra e saj gjen një dit shpërblim, se nxjerr fruta (pemë) të mira, edhè përfundimet e saj duken e vazhdojnë edhè si të vdesë ajo.

Ësht'e vërtetë, thotë një shkrimtar frënk, se gratë nuk kanë shkruar as *Iliadha*, as kanë ngrehur *Parthenone,* as kanë skalisur statua si të *Fidhiasit* as *algjebrën* kanë zbuluar, as *turbinë* kanë çpikur, po as mashinën e avullit, po me gjith'ato ju kemi një detyrë shumë mê të madhe edhè më të bukur së gjithash, sepse mbi gjunjët e saj u ritnë fëmijë të mirë, kreaturat mê të bukura e më të vlefshime të natyrës.

Po brenda në shtëpi, sikundrë edhè në të gjitha ndollinat e jetës, elementi m'i math i stolisë,pastrisë e i qetësis është *rregulli*. Rregulli ndalon konfuzionin ose ngatërrimin. Por për me qenë rregulli duhet me qenë edhè cokësja[1] (exactitude). Shtëpia që ka parregullim e anomali (inconstance) të bën t'a neveritish e të mos e shohsh dot me sŷ. Atë posa e shohim me një herë mendohemi se qenka një grua që e shpenzokërka kohën më kot dhe s'e zënkërka qederi për ata që ka rrotull. Për burrin, thonë Englezët "koha është flori", po për gruan rregulli është diçka mê tepër akoma, është qetësia, shëndeti, kamja e lumëria e familjes së saj.

Prandaj e mira është të msohen gratë në drejtimin e të hollave, ose në ekonominë shtëpiake, në drejtimin e punëve të tjera shtëpijake, të mësohen si e si të sjellin edhè ato një ndihmë e një dobi në shtëpi në punët e burrit e përgjithësisht në punët e ç'do dite. Po, edhè përveç asaj, gruaja që të munt të zbatonjë urtësisht fuqin'e saj brenda në shtëpin'e saj, që të munt të ndjekë zhdrivillimin e fëmijve të saj qysh në kohën e foshnjërisë e që t'i rritë

[1] cokësja = saktësi (cok = saktë, tamam)

mirë është nevoja të ketë arësim mendarak të mjaftë, i cili të hynjë në punë për qëllimet e saj

Qëllimi i gruas është të rronjë jo vetëm për vehte të saj, po edhè për të tjerët. Detyrat që ajo ka për të kryer nuk duan vetëm ndjenjat e zembrës së saj (sensibility) po edhè lëvrimin e mendjes së saj. Nuk mjaftojnë vetëm ato stoli që kanë vajzat përgjithërisht prej një rritje të zakonshme, një rritje ordinere. Këto stoli munt t'i hyjnë në punë të shumën–të shumën sa për të qenë m'e dukëshme e m'e dashur, të rritet bukuria, porse shërbejnë shumë pak në nevojat e jetës praktike.

Romanët e vjetër e konsideronin si mê të madhen lavdi për një grua kur rinte brenda në shtëpi të saj e kur punonte në avliment[1]. Po një kufizim i tillë për një grua do të ishte një gjë e pavent, aqë sa e paventtë është theoria tjetër që gruaja duhet të ritet e mësonjë aqë sa edhè burri, tyke qenë barabar me atë dhe se nuk ka tjetër ndryshim prej atij përveç se ndryshimin e seksit (që është domethënë grua), edhè se duhet të ketë edhè gjith'atë të drejtë votimi që ka edhè burri, tyke shkuar një për një me burrin.

Përgjithësisht rritja e arësimi që i përket e i përshtatet burrit duhet t'i përshtatet edhè gruas. Arësimi moral e mendar që duket i duhur për burrin është i nevojshim edhè për gruan. Po këtu mos harrojmë se zhdrivillimi i mendjes e karakterit të gruas nuk lipset të ketë parasysh vetëm zhdrivillimin vehtijak të saj po duhet të parashënonjë edhè lumërinë e të tjerëve,sepse lumëria e të tjerëve mvarret mê fort prej asaj.

Karakteri moral dhe fuqia mendarake e burrit gjejnë rojtarin e tyre mê të mirë dhe mështetjen e tyre në mirësinë e në naltësinë morale të gruas. Sa më tepër ësht'e zhdrivilluar mendja e njërit dhe e tjetrit, aqë mê tepër do të mbretëronjë rregulli e armonia në shoqërinë njerëzore. Influenca e gruas është gjithënjë ajo.

Në të gjithë vëndet prej asaj merret morali, zakonet, mënyrat e sjelljes e karakteri i kombit. Kur grueja është e pavleftë dhe e çnderuar, atëhere edhè e gjithë societeja s'ka vleftë dhe është e çnderuar, kur gruaja është e ndershme dhe e msuar edhe shoqëra

[1] avliment = tezgjah, makinë fill–punuese

njerzore naltësohet e fisnikërohet. Pra arsyetimi i gruas është edhe arsyetimi i burrit dhe naltësimi i karakterit të saj naltëson edhe karakterin e burrit.

Po sa ësht'e sigurt se zhdrivillimi i mendjes së gruas bëhet për të mirën e një kombi, aqë është e dyshimtë dobija që munt të vijë, në qoftë se duam t'a venë gruan në atë shkallë që të konkurronjë me burrin në fëllqinjat e rënda të punëve të dorës si dhe të politikës. As gratë s'munt të bëjnë punët e veçanta të burravet, as burrat ato të gravet. Sa herë që gruaja dolli nga familj'e saj e nga shtëpi'e saj që të merret me punë të tjera, përfundimisht në pikpamje sociale mbaruan fatkeqe e dëmprurëse.

Më gjith' ato ndodhet një degë e veçantë e punës së gruas, e cila është për t'u vënë rè, po mjerisht nuk është marrë edhe shumë parasysh. Kjo është *pregatitja mê e mirë e mê ekonomike e ushqimit*. Sa shpenzime të kota bëhen më kot, kur gratë nuk dijnë as elementat e para të kuzinës,ose të gatimit të gjellravet! Në qoftë se duam të konsiderojmë mirëbërësin e njerëzimit, atë njeri që prodhon dy kallinj prej asaj are që s'bënte më parë as një, aqë më tepër duhet të nderojmë amvisen e cila merret pa u lodhur me paksimin e shpenzimeve të shtëpisë edhe me më të dobishëm të ushqimeve që bie për dita në shtëpi puna e burrit.

Kapitulli C
SHOQËRIA DHE SHËMBLLA

Influencimi i rritjes familjare zgjatet përtej moshës së djalërisë, munt të thohet se ky as mbaron kurrë, se sa që kalojnë vjetët asaj influence i shtohen edhe të tjera. Rritja brenda në shkollë, shoqërimi i bashkënxënësve e i miqve e formojnë gjithnjë karakterin e të riut me anë të fuqisë tepër të fortë të *shëmbllës*. Njerëzit, të rinj qofshin ose pleq, po mê fort të rinjtë, imitojnë pa dashur ata me të cilët shoqërojnë. S'është e mundur të mos na influencojnë karakterin t'onë ata që kemi rrotull.Njeriu është prej natyre imitonjës; imiton pa e kuptuar qëndrimin, gjestat (lëvizjet e duarve),ekspresjonet dhe mendimet e atyre, me të cilët është në fjalim e marrëdhënje të shpeshtë. Imitacjoni bëhet përgjithërisht

pa ndërgjegjen e imituësit, influenca e tij shkon e pa dukur po përfundimet që lèn mbeten për gjithnjë.

Të tilla influenca që i ndihmojnë formimit të karakterit vepërojnë mê fort në kohën e miturisë, edhe tyke kaluar koha, shëmblla e imitacjoni përfundojnë e bëhen *zakone*, edhe zakonet rrënjosen e bëhen aqe të shëndosha, sa n'a rrokin, n'a zaptojnë shpirtin pa e kupëtuar.

Një vesë, ose zakon i keq kur rrënjoset bëhet kaqe tyranik, sa shohim njerës që nuk munt të presën[1] një zakon të likshëm, njerës që s'kanë fuqinë të çporrin një të metë të tyre, me gjithë që janë mërzitur prej asaj dhe e mallkojnë.

Thonë zakonisht se njerëzit njihen prej atyre me të cilët janë shokë.Këjo është e vërtetë,sepse njerës të matur e të përmbajtur s'munt të jenë shokë me pijanikët e kumarxhinjtë, as ata që kanë sjellje të mira e fisnike me njerës të pafisëshëm e harbutë, as të ndershmit me të çndershmit. Kur ka njeriu marrëdhënje me njerës të unjtur nga karakteri, me njerës të çorroditur e të çndershëm është shenjë këjo që edhe ajy njeri s'ka karakter mê të mirë se ata që i shoqëron. Në qoftë se shoqëron me ata nga herë, karakteri i tij pa fjalë do çorroditet e do prishet. Rrojtja me njerës harbutë e egoistë do t'a thanjë një ditë shpirtin, do kufizonjë mendjen, dhe do neutralizonjë çdo përpjekje e dëshirë e çdo çilësi të mirë e të naltë. Përkundrazi, në qoftë se vemë me njerës mê të mentshim, mê të mirë e mê të praktikuar se nè, do gjejmë në shoqërin'e tyre një mburrim inspiracjoni e fuqije dhe do kemi dobi nga eksperienca, nga dijenit'e nga pësimet e tyre.

Karakteri i atyre që na qarkojnë ka influencë shumë për karakterin t'onë. Një fabrikant i ndershëm i frymëzon me jetë punëtorët e tij e zhdrivillon relacjonet e mira të tyre. Përkundrazi në qoftë *leshko* e në ka rrojtur në ligësi bëhet, pa e kuptuar edhe ajy vetë, shkakëtar i prishjes mê parë i vehtes së tij, pastaj edhe i atyre që ka nënë drejtimin e tij.

Mirësija është një mjetë e tepër fuqishme për me drejtue e udhëheqë inferiorët, ato do me thënë që kemi nën sundimin, ose

[1] presën = pres me gërshërë, heq dorë

vërejtjen t'onë. Me anë të mirësisë tërhiqet dashuria edhe bindja e atyre. Njeriu verevërtet i mirë bëhet një sovrân i vërtetë, tyke tërhequr pas tij të gjitha zembrat. Janë ca njerës që edhe ajo prezenca, ajo dukja vetëm e tyre të duket si kur të mban një erë shëndeti, një erë e cila n'a përsërit e n'a çel mendjen, si kur se era e malevet e rezet e Djellit. Vetëm pamja e një njeriu të dëgjuar, njeriu të math frymëzon shpesh herë të rinjtë të cilët, prej natyre që kanë, çuditen edhe dëshërojnë ç'do kualitet të tillë dhe ç'do gjë të bukur, të lartër dhe të vërtetë.

Shohim një fotografi, ose një korë[1] të bukur të një njeriu të mirë, të math ose të dëgjuar, që është e mvarur në dhomën t'onë, e çuditemi me 'të e n'a pëlqen e n'a duket sikur e kemi shok, sikur e kemi në shtëpi t'onë, sikur duam të flasim me atë e të këshillohemi. Tyke e parë për dita zakonohemi me atë, e quajmë si të shtëpisë edhe padashur kemi një sympathi mbi atë dhe e duam. Tyke parë karakteristikat e tij, n'a duket sikur e njohim më mirë e sikur ky bëhet i afërmi i jynë.

Bëhet kësodoret një farë lidhnije, e cila n'a lith e n'a shtërngon me një natyrë më të lartë se atë t'onën! Dhe sa do që n'a ndan një largësi e madhe ne me até, si në vleftën, si në fuqin shpirtnore qi ka heroji jynë me gjith'atë ndjejmë një inspiratë, një frymëzim prej pikturës së tij, të cilën e kemi për dit përpara syvet t'onë.

Në periudhën e djalërisë s'onë kur karakteri brumohet, është shum'e çvilluar brenda në shpirtin t'onë nevoja e çuditjes. Prandaj duhet t'i kndjellim djelmtë t'onë në çuditjen e karaktereve të mbëdhenj, se natyra e tyre është akoma e njohmë e e butë edhe sa merr përshtypje më të thella. Se në qoftë se kalamanjtë nuk stërviten të çuditen me të mirën e të bukurën e të madhnueshmen qysh në atë moshë që janë, është shum'e vështirë më von stërvitja e përshtypjevet, është rrezik se mos marrin për shëmblla e mos konsiderojnë si për njerës të mbëdhenj ata që s'kanë as madhëni, as moral.

[1] korë = njerëzit e një moshe a me moshë të afërt, që jetojnë në të njëjtën kohë ose që lidhen nga veprimtaria e përbashkët, që kanë qëllime të përbashkëta.Brez

Vetëm ata njerës mendje shkurtër, ata që s'janë inspiruar me ndjenja bujare e të nalta, vetëm ata s'kanë ndjenjë të sinqertë, as që munt të kenë sa të çuditen me të vërtet kur shohin një gjë të mirë. Për fatkeqësinë e tyre, ata s'mundin të njohin edhe ca më pak të nderojnë njerëzit me të vërtetë të mbëdhenj, si edhe veprat e tyre. Një mendje e unjtër s'munt të çuditet kurrë me një naltësi, si një sent të naltë.

Si njerës të këtillë duhet të konsiderojmë edhe ata që shohin me kënaqësi mjerimet e të afërmit e gëzohen për hidhërimet e tyre. Mjerisht ndodhen edhe shumë njerës të këtillë, si kundër ndodhen edhe njerës që kategorisin[1] të tjerë, ose qeshin e tallen me të tjerët. Për këta çdo përfitim i ri, ose lumtëri e fqinjës së tyre, shëkohet si një e fymje personale kundra tyre. Nuk durojnë të dëgjojnë një lavdë, ose një fjalë të mirë për as një njeri edhe më fort kur ajy që lëvdohet takon të ketë një mjeshtëri, ose një profesjon me ata. Në qoftë se ka bërë edhe ndo një faj, ata ja ndjenë, ose ja falin, po nuk ja falin kurrë në qoftë se tregohet m'i lartër nga ata.

Çudija jonë për njerëzit e mbëdhenj n'a lint dëshirën t'i imitojmë. Thonë se *Themistoklinë* e Greqisë nuk e linte të flerë triumfi i gjeneralit *Miltiadhis*, që fitoj në luftën e Marathonës. Po, pas disa vjetësh ay mundi Persjanët në detin e Salaminës edhe atdheu i tij, tyke qenë mirënjohës, deklaroj se e shpëtoj nga rreziku me anë të urtësisë e trimërisë së tij. Historishkronjësi math Grek Thukydhidhis, kur ishte djalë akoma qau një ditë kur dëgjoj babën e historisë Herodhotin të këndonjë historinë e tij, edhe ajo ndërshtypje që ju rrënjos qysh ahere në shpirtin e tij caktoj njerin' e math mê von. Thuqidhidhin s'e harriu as një historishkrues tjetër. Historija na tregon shumë shëmblla të njerësve të mbëdhenj, të cilët u bënë të mbëdhenj tyke imituar shtërgjyshët, ose të parët e tyre.

Shëmbllat e burrave me të vërtetë të mbëdhenj nuk vdesin bashkë me ata, por rrojnë për të msuar e për të udhëhequr edhe

[1] kategorisin = akuzojnë (term që Kristo Floqi e përdor shpesh në vënde të tjera me këtë kuptim)

brezat e arthme, amëshohen m'andej e n'a ndihmojnë në rrugën e jetës t'onë.

Kapitulli D
PUNA

Me anë të punës zhvillohet mê fort e formohet karakteri praktik. Puna është nëna e bindjes,e përmbajtjes e kujdesimit e e durimit. Ajo e bën njerinë të aftë në profesjonin ose zejen që ka edhe me këtë bashkë e mson si të kryenj gjithë sendet e jetës.

Puna është nomi[1] i ekzistencës t'onë është motori që nis përpara njerës e kombe. Shumica e njerësve punojnë që të rrojnë, po të gjithë pa një përjashtim detyrohen kështu ose ashtu të kenë një farë pune, në qoftë se dëshirojnë me të vërtetë të ngjerojnë kënaqësin'e kësaj jete. Puna mbasse është një barrë e rëndë, po me gjith'atë është nder e lavdë. Pa punë nuk mund të bëhet gjë në këtë botë. Ç'do gjë e madhe e për të vënë ré që shohim ne sot është kryer me anën e punës! Edhe qytetërimi s'është tjetër përveç se prodhim i punës.Po të çdukej ose të hiqej puna, gjindjen njerzore do t'a kapte një maras, një vdekje morale. Pra, papunësija e jo puna është një mallkim për njerinë. Breh zembrën e njeriut si kurse zgjyra hekurin.

Plinius, duk'e përshkruar gjendjen shoqnore të Italisë në kohët e lashta, tregon se gjeneralë që patnë triumfuar në luftrat edhe ushtarët që ktheheshin të shëndoshë nëpër vatrat e tyre, vraponin me gëzim të rroknin në dorë plugun e parmëndën. "Dheu – thotë – ahere lëvrohej prej duarsh të gjeneralëve edhe trualli ishte i mburuar[2] se pse vijohesh me plugje të kurorëzuara me dafina". Vetëm që kur bulqësia e degët e tjera të industrisë u lanë në duart'e shërbëtorëve, u qojt puna si një poshtërim, ose si një angari e gjë e dobët. Por se qysh ahere filloj plogësia e lluksi, të cilat çorroditnë klasat e nalta të shoqërisë Romane edhe nuk mënoj të poshtërohet shteti i paanëshmë Roman e më në funt të shëmbet e të shduket.

[1] nom = ligj (nga greqishtja)
[2] mburuar = jepte prodhim

Prej të gjitha pafuqësive (faiblesses) të natyrës njerëzore, ajo të cilën ç'do njeri me mënt duhet t'a çporrë është plogësia, sepse poshtëron e bën të mjerë edhe njerzit edhe kombet.

Plogësia nuk munt të kapërcenjë pengimet as të mposhtë vështirësit'e jetës. Fundi i saj është kudo e kurdoherë çkatërim. Kudo e kurdoherë është rëndësir'e pengim, është mburrim mjerimi e dëshpërimi.

Englezi Richard Burton e quan plogësinë si "mburrimin e melankonisë". Plogësia, thotë, është kamxhiku i trupit e i shpirtit, është nëna e ç'do ligësie në botë, një nga të shtatat mëkate të vdekjes, pragu e jastëku i djallit. Qenin e plogët e zé kroma (zgjebja).

S'munt të mos pësonjë gjë njeriu i plogët. Plogësia e mendjes është shumë m'e keqe se ajo e trupit. Plogësia e mendjes është lima e trupit, është cok një skëterrë! Ashtu sikurse në ujrat e ndenjura shumëzohen krimbat e mikrobet e ndyra, ashtu shtohen edhe mendimet e këqija e të çoroditura në mendjen e njeriut të plogët edhe pëgëjnë e ndyjnë shpirtin e tij.

Tembelët, ata që jetojnë pa punuar ndonjë punë, burra qofshin ose gra, pasanikë ose të vobektë nuk munden kurrë të ndjejnë një lumëri të vërtetë në jetën e tyre. Lumëria e vërtetë nuk është në të ndënjurit pa veprim të fuqive t'ona, po në veprimin e në punën që bëhet me ment e me urtësi. Papunësia e dobëton njeriun, jo puna; puna përkundrazi, na jep jetë, shëndet e lumëri. Puna munt t'a mposhtë e t'a dobësonjë mendjen, po plogësia, ose papunësia sjell përfundime mê të tmeruara.

Që të donjë njeriu të përfitonjë pa mundim atë që dëshëron kjo është një shenjë pafuqësie e dobësije. Fuqi e vërtetë është të kuptonjë njeriu, se në qoftë se dëshërojmë të përfitojmë një gjë, këtë duhet t'a përfitojmë me një mundim. Edhe këjo çlodhja nuk ka as një vleftë, në mos vjen si një shpërblim e si një pêmë e mundimit t'onë. Nuk ka një hirë po nuk u çpagua me punë.

Detyra për të punuar imponohet në gjithë klaset e shoqërisë; i pasur ose i varfër qoftë, gjithsecili në jetën e tij duhet të ketë një punë që të punonjë. Fisniku nga fisi e nga ritja sa do kamës që të jetë ka detyrë të japë një pjesë të punës së tij për hatër të së

mirës së përgjithëshme. Nuk mjafton të rronjë mirë e të mvishet me punën e të tjerëve, pa dhënë edhe ky gjë për shkëmbim. Një njeri i ndershëm e si lipset, nuk do t'a pranonte kurrë të merrte pjesë në një gosti të përgjithëshme e të rinte në sofër, të hante, të pinte e të bënte qef e të shkonte pa paguar pjesën e tij, anallogjin' e tij.

Puna është masa m'e mirë për të n'a mprojtur kundra paqetësisë e travajeve, e acarimeve të kotta që munt të pjellë egoisma jonë. Shumë kujtojnë se tyke u shmangur më nj'anë njeriu largon acarimet e mërzitjet e jetës. Po experienca e shprovoj se nuk ësht'e mundur kurrsesi t'i çporrim këto, se kështu është krijuar njerëzia për të vojtur. Ata që tremben nga hidhërimet e kërkojnë t'ju bëjnë ballë që më përpara, t'a dijnë mirë se edhe para se të mbrinjë mbi kokë të tyre hidhërimi ata janë therorët e tij.

Është e vërtetë se gjenden njerës që vdesin prej punës së madhe e të jashtzakonshme,po më të shumët vdesin nga egoisma, nga dobësia e karakterit të tyre e nga plogësia. Ahere mposhtet njeriu prej pune kur të mos përkujdeset si duhet edhe për shëndetin e trupin e tij.

Stërvitja e parreshtur e e dobishme është si për burrin, si për gruan kusht elementar, jo vetëm për shëndetin e trupit por edhe për shpirtin. Njeriu i plogt nuk i ndjen një shije jetës, po punëtori jo vetëm e ngjeron jetën si lipset, po bëhet edhe një mburrim energjie për ata që ka rrotull. Edhe ajo m'e dobta stërvitje është shumë m'e mirë se plogësia.

Puna edhe ahere akoma kur nuk përfundon mirë, ose nuk sjell pêmë të mira, prapë është shpëtimtare, se ushtron njerinë e e bën të përkujdesohet e të pregatitet për punë të dobijshme. Zakoni i punës n'a mëson methudhën e punimit e n'a shtërngon të çmojmë vleftën e kohës e të mos e harxhojmë më kot.

Puna e ndihmon shumë formimin e karakterit e n'a mëson si të drejtojmë e të rrjeshtojmë çështjet t'ona. Ose një shtëpi kemi për të drejtuar, ose një popull të tërë, methudha ose mënyra e drejtimit n'a lipset pa fjalë.

Kemi thënë se amvisja, ose nikoqireja e mirë e shtëpisë duhet të përfitonjë e të ketë një methudhë të tillë praktike që të

rregullonjë e të drejtonjë hollësit e shtëpisë së saj e që të caktojë vazhdimisht shpenzimet, ose harxhet e shtëpisë sipas mjeteve ekonomike që ka e kështu të administronjë mendërisht ata që ka në rredhin e saj. Që të drejtonjë mirë shtëpinë e saj duhet kujdesìm, duhet rregull, duhet një imponim moral, mendim, urtì, volì praktike, sý i pafjetur, mëndje e kjartë e parashëkuese që të njohë karakteret të atyre që ka rrotull; këto çilësi janë shumë të nevojshme për një grua shtëpijake, por janë edhe shumë të nevojshime për ç'do tjetër që n'a jepet të sundojmë, shtëpi qoftë, popull ose Shtet.

Kujtojnë disa se këtilla stërvitje ndër hollësitë e jetës janë gjërra që nuk puqen me një karakter të lartër, me një mëndje të madhe. Këta gabohen shumë. Burrat mê të mençur të shekullit ishin pa një përjashtim ata punëtorët mê të mbëdhenj që u muarr me kësij punësh të vogla, edhe s'e kishin këtë për turp as pak. As një vepër e madhe e e qëndrueshme s'u krijua fêt e fêt edhe prej vetiu. U munduan shumë njerëzit gjer sa i krijuan; vetëm durimi e mundimi përmbaruan veprat e mëndjes së madhe.

Vetëm dashamirësit e punës kanë fuqinë. Tempelët janë të pafuqishëm. Punëtorët e ata që mundohen sundojnë botën. As njeri s'përfitoj as në politikë, as në degët e tjera të punëtorisë pa u munduar. Gjith'ata njerëzit e shkëlqyer e të mbëdhenj, gjith'ata ishin punëtorë dhe s'i shmangeshin kurrë mundimit.

Përfundimi është se, puna me ment ësht'e nevojshme e e dobishme edhe për mëndjen edhe për trupin. Mendja e njeriut ushqehet e përmahet prej organeve të trupit, të cilat duhet të ushtrohen me anë të punës. Pra, merret vesht, se jo puna, po puna e tepërtë e prish njerinë. Ç'do punë është e mirë kur mshtetet edhe në një shpresë.

Një nga më të mbëdhenjtë mystere në këtë botë është edhe ky, që njeriu duhet të stërvitet me punë udobisht, tyke ushqyer kurdoherë shpresën se nuk do t'i shkonjë mundimi kot.

Kapitulli E
KURAJO E DURIM

Bota përgjithërisht detyron shumë gjërra në njerzit kuximtarë,edhe burra edhe gra. Nuk po flasim këtu për kuximin natyral, të cilin e kanë mê tepër shtazat se sa njerzit. Durimi i atij që përpiqet e që i duron të gjitha pa bërë zê për hatër të detyrës e të së drejtës është me heroike se trimëria trupore, së cilës përfundi-met shpërblehen me nderime e me vleftime po akoma edhe me dafina shumë herë të ngjyera edhe me gjak.

Kuximi moral karakterizon madhnin e vërtetë të burrit si dhe të gruas. Kuximi që të thotë njeriu të vërtetën, vullneti i patundur që të jetë njeriu i drejtë e i ndershim, trimëria që i bën ballë ç'do zhigatje ose tentacjoni e që kryen detyrën e tij, këto janë madhëni; janë kuxime morale të paçmuara. Ajy që s'e ka këtë virtytë, ajy që s'e ka këtë kuxim, burrë qoftë ose grua, është e vështirë të konservonjë edhe sa të tjera virtyta që ka.

Ç'do përparim në historinë njerëzore u bê në mes të vështirësive e të kundrështimeve. U bë e u themelua prej njerëzve kuximtarë e të duruar, të cilët u vûnë në krye të njerësve të kohës së tyre e kështu i udhëhoqnë. Këta burra ishin zbulonjës të mbëdhenj, patriotë të mbëdhenj e punëtorë të palodhur.

As një e vërtetë ndofta, as një doktrin'e re nuk zuri vent pa u brehur e për pa u luftuar bigonitë[1], çpifjet edhe ndjekjet. Athinasit dënuan për vdekje Sokratin, sepse doktrinat e tij ishin të kundërta me mendimet e me besimet e atyre kohëve. U qojt fajtor se çorroditte djemt'e Athinës, tyke i ndërsyer ata kundra Perëndive që ju faleshin asokohet e i adhuronin, ndonse ajo paganismë ish e njohur prej autoriteteve e zakoneve. Po Sokrati kishte kuximin jo vetëm të mos peshonjë përdhunin e ngutsin e gjyqtarëve që e gjykuan, po edhe popullin, i cili s'ja kuptonte msimet e tij. Edhe kur vdiq, vdiq tyke biseduar me nxënësit e tij për pavdeksin'e shpirtit. "Tani, ju tha, ardhi koha të ndahemi, kështu që unë do të vdes edhe ju të rroni; po kush prej nesh do të jetë mê

[1] bigoní = çpifje

mirë atë s'e dijmë veç se Perëndia !" Këto ishin fjalët e tij të fundit. Sa e sa filosofë e dijetarë të mbëdhenj u ndoqnë e u dënuan në embër të fesë e të besimit të gabuar !

Kjo ndjekje e padrejtë kundra martyrëve të së drejtës duhet të n'a mësonjë ne sot të jemi të duruar kundra atyre që kanë një mendim të kundërt me ne, ose të ndryshme, harrin[1] që vërejtjet e tyre, mendimet e opinionet që kanë të bazohen mbi studimin, mbi besimin e mirë e mbi lirinë.

Shumë për t'u çuditur e për të vënë ré është edhe trimëria e martyrëve të fesë, si dhe durimi i tyre e qëndrimi në detyrë, të cilët për atë fé duruan, ose janë gati t'i durojnë të gjitha, nga do një herë tyke qenë edhe vetëm, të ndjekur, të arratisur, pa një zê sympathije nga një i afërm! Qendrimi do kuxim shumë më të lartër se trimëria që rrëfehet në patalokët e sheshet e luftës.

Në jetën e zakonëshme nuk lipset gjithënjë një trimëri heroike. Duhet ajo trimëri e cila n'a forcon që të jemi kurdoherë të ndershim, t'ju bêjmë ballë tentacjoneve (zhigatjeve) të flasim gjithmonë të vërtetën, të mos bëhemi hypokritë dhe të rrojmë me nder me punën t'onë. Një njeri që ka karakter të dobët shqet shumë shpejt në ç'do të keqe. Tyke mos pasur kurajon të thotë "jo", bijen lehtas në të keqen. Po duhet edhe një trimëri morale që mundet njeriu t'i përballnjë çorroditjet sociale. Pothuajse gjithë gratë, nga ndo një herë edhe burrat, bëhen skllevër të klasës sociale në të cilën përkasin. Se cila klasë ka huqet e zakonet e saj, të cilat i poltis[2] me do e mos misi[3] që ndodhet në atë klasë, se për ndryshe neveritet e përbuzet prej miseve të tjerë të klasës e mbetet në turp. Janë shumë veta që syrambyllazi i unjin qafën *modhës*, disa të tjerë janë *robt* e zakoneve ose adeteve të klasit të tyre edhe të pakë jan' ata që përkasin vetëm në vehten e tyre e që munt të mendohen pavarrësisht e të ruajnë lirin'e tyre të plottë. Mvishemi e hamë jo sipas fuqis ekonomike që kemi, po pas shëmbllit të klasit t'onë social edhe ndjekim verbërisht modhën,

[1] harrin = mjafton që
[2] poltis = i ven në jetë, vendos në vendin e vet
[3] mis = anëtar, pjestar i një shoqërie njerzore

tyke rrezikuar shumë herë të bijem e të mbytemi në borxhe, në mjerime e në katastrofë të plotë !

Paburrënia morale duket edhe në jetën private. Janë shumë njerës që të lajn'e të lyejn e presin, ose kanë pa fjalë një interesë prej teje. Dikur *laj-e lyej* quhej edhe *mos kuximi për të thënë njeriu të vërtetën përpara arhondeve*[1], po sot nuk kuxojnë t'a tho-në të vërtetën as përpara njerësve të unjtër.

Tani kur fuqia politike ndalon duart e popullit, ata që kanë nevojë e lëvdojnë, e fërkojnë, e lajn' e lyejn, i shërbejnë unjtërisht, i japin ose i falin virtyta që e dijnë fort mirë se nuk i ka, nuk i rrëfejne kurrë dobësit'e të metat e tija edhe për të fituar favorismin e tij, bëhen sikur i adoptojnë planet që ka qeveria, ndonse janë të bindur se s'munt t'i kryejnë kurrë. Prandaj shpesh herë shohim burra të klasave të nalta që kanë rritje të naltë e janë me këtë bashk pasanikë, të unjen përpara njerësve të dobët e të trashë vetëm e vetëm që të përfitojnë prej atyre votën. Preferojnë të bëjnë ç'do padrejtësi e të mohojnë principet e tyre se sa të humbasin ndjesit'e votuesvet ! Edhe ketë e bëjnë se është më kollaj të lanj'e të lyenj njeriu tjetrin, se sa të rrëfehet burrë, shpirtmath e me karakter të kjartë.

Po duhet fuqi e kuxim që të notojmë duke qëndruar përsipër lumit, se me rrjedhën shkon tatëpjetë edhe njësent i pashpirtë, një kufomë.

Gjith'ajo paburrnì morale shihet si në katet e nalta, ashtu edhè në ato të ultat. Kur hypokrizia edhe unjtësia e klasave të nalta pasohen prej hypokrizis'e çorroditjes të vërtetë të tyre, ç'munt të presim ahere prej të vegjëlvet ?

Kur popullariteti fitohet me anë të të larit e të lyerit të shumicës, me të mosçfaqurit e së vërtetës, kur tyke shkuar dikush, ose tyke folur shërben ato dëshirat më t'ulta të vullgut dhe më fort ahere kur i inspiron neveritjen kundra klasave të tjera sociale, një popullaritet i këtillë bëhet një gjë e ndyjtë për ç'do njeri të

[1] arkond = Titull në hierarkinë feudale, që e mbante një pronar i pasur nga paria e vendit.

ndershëm**. Ata që kanë karakter të kulluar kanë edhe kurajon të flasin të vërtetën dhe ahere kur ajo është antipopullore.**[1]

Të patremburit spiritual është një kusht i domosdoshëm i indipendencës së karakterit. Njeriu duhet të ketë konviksjonin e tija e jo të jetë hije ose jehim[2] i të tjerëvet, duhet te ketë veset e vitytet e tija e mendimet e tija e të çfaqë lirisht ato që mendohet. Duhet të bisedonjë mendimet e tij dhe të formojë konvisjone prej vetiut. Prandaj ësht'e drejt' ajo që thohet se ajy që s'kuxon të ketë opinionin e vet është *tempel*, edhe ajy që s'ësht' i zoti të ketë opinionin e vet është *budallë*.

Shumë njerës aherë kur duhet të rëfejnë një pafrikësi të këtillë, çfaqin mungimin e saj dhe përgënjeshtrojnë shpresat e shokëve të tyre. Këta afrohen gjer ne sheshi i luftës, por se mu n'atje humbasin dhe kurajon e tyre.Numurojnë rreziqet, peshojnë të padukurat e fatit gjer sa të kalonjë, ndofta për gjithnjë okasjoni për të bërë një gjë të bukur e të mirë. Burrat trima e guximtarë drejtojnë gjithë botën edhe e sundojnë. Ata të dobëtit e frikanacët, s'lenë as një gjyrmë prapa tyre, kurse zembër-mirët, mendje drejtit, punëtorët çfaqen si ca vija të shndritshme edhe shemblla e tyre, si edhe mendimi e kuximi e qendrimi i tyre inspirojnë brezat e arthme.

Burri trim,ajy që është me të vërtetë burrë, është kurdoherë i butë e i qetë, është shpirt math po edhe i ëmbël në sjelljet e kalorës edhe përpara armiqëve të tij. Historia përment të tilla shëmblla kalorësije nga an'e gjeneralëve nëpërmes të luftave e të kanareve[3] më të përgjakshme. Po njerëzit e vegjël, paraqendètë[4] nuk kanë burrnì, ose shpirtmadhësì dhe kërkojnë të përfitojnë nga dobësia, ose pafuqësia e të afërmit, po mê të dobët rëfehen ata, të cilët u lartësuan në shkalla e vleftime të mëdha me mjete jo të ndershime.

Prej save kemi folur merret vesh se për formimin e një karakteri moral është nevoj' e madhe të kemi kuxim edhe qën-

[1] Nxirja është e H.Kaçulinit
[2] jehim = jehonë
[3] Kanáre, ose Kanaré = thertore, kasaphânë (K.Floqi)
[4] paraqendè = horr i keq, kopuk

drim. Një babë i urtë theshte se, kur u rrittë djelmt'e tij e vajzat u përpoq t'u mësonjë të mos tremben prej as gjë sendi më tepër se nga ajo frika vetë.

Frika është shumë herë përfundimi i fantazisë. N'a bën të shkojmë nëpërment mjerime e potera që munt të na trembin, e të n'a shtijen në rrezik ndonse këto shumë rrallë munt të n'a gjejnë. Shumë liksht bëjnë sot që nuk e kanë futur në programin e rritjes së gruas edhe ushtërimin e kuximit, i cili është shumë më me rëndësi serioz se mësimi e ushtërimi në muzikë, në gjuhët e huaja edhe në astronomì. Disa kujtojnë dhe pandehin se gruaja duket më e dashur dhe sympathetike kur ka frikë e pafuqësì, kur trembet prej ç'do ndërshtypje të jashtme. Né themi të kundërtën, se edhe gruaja duhet të jetë kuximtare dhe e patrembur, se vetëm kështu do të bëhet më e dobishme e më indipendente.

Frika s'ka asnjë shije me vehte;ç'do pafuqësi ose e shpirtit, ose e trupit është një mungesë. Kuximi n'a jep kurdoherë një hir'e një ëndje, kur se frika, si do që të çfaqet është gjithmonë një gjë e dobët e për të neveritur. Një zograf i math i shkruante dikur së bijës: "E dashura ime bijë, përpiqu të jesh e mirë edhè trimëreshë; këta janë dy virtyte të vërteta për një grua. Ç'do njeri duhet të jetë i gatijshim për mjerimet e hidhrimet. E vetmja mënyrë për të ballësuar fatin e mirë ose të ligështë të presim si të këqijat ashtu edhe të mirat gjithë me atë qetësi shpirti".

Në sëmundjet e në mjerimet as një s'përmbahet me aqë durim të math sa gruaja. Experienca n'a ka shprovuar se gratë durojnë më të mbëdhatë poterat e fatit me aqe durim e qendrim sa edhè burrat. Mirë po nuk përpiqemi t'i rritim edhè vajzat në atë mënyrë sa të mposhtin ç'do të keqe e të largojnë nga sýt frikën foshnjore.

Bukuri e trupit kalon shpejt si edhè vesa e lulevet, kurse bukuria e shpirtit dhe e karakterit përfiton edhè shijime të reja sa më tepër zgjatet mosha. Me të vërtetë trimëria e gruas është shumë herë passive dhe zakonisht kufizohet brenda në qarkun e ngushtë të jetës familjare. U ndodhën gra që u dalluan jo vetëm në pikpamje qendrimi, po edhè në pikpamje heroismi burrnor, të

cilin ia inspiruan ndjenja e detyrës edhe dëshira fisnike për të përmbushur atë detyrë.

Midis shembllave të tilla të panumurta grash, po përmendim këtu të shoqen e Englezit detshetitës të math Franglinit[1], e cila insistoj 12 vjet radhazi tyke kërkuar gjyrmët e të shoqt, i cili humbi në mes të deteve të pa njohur e të Polit Verior !

Sa e sa shemblla të të tjera heroismi të vërtetë granuer munt të gjejmë në historin'e përbotshme të kombeve! Besnikëria e grave me detyrën çfaqet shumë herë në vepra filantropike edhe mbetet pothuaj për hera e pa njojtur, sepse kryhet lark sývet të njerëzisë, pa një bujë, pa një zê. Nga ndo një herë fama i nxjerr në dritë veprat e tyre, po edhè këjo bëhet pa e dashur vetë ato, të cilave s'ju vjen edhè mirë e ju ngel hatri kur dëgjojnë. Burgjet e spitalet si edhè shtëpitë mirëbërëse janë dëshmimtarë të një bâmirësije të tillë të gruas.

Kapitulli F
DETYRA

Detyra është një borç,të cilin ç'do njeri detyrohet t'a lanjë. Mos pagimi i detyrës është cok një falimentë morale. Është një det që ç'do i detyruar me atë, lipset të përkujdesohet e të përpiqet që t'a lanjë.

Detyra është aqë e gjattë sa edhe jeta e jonë. Fillon që nga shtëpia prindore, ku fëmija kanë detyra përpara prindëve edhè prindët përpara fëmijve. Pastaj vijnë detyrat e burrit e të gruas me shoqi shoqin, si edhè detyrat midis zotërinjve e shërbëtorëve. Jashtë qarkut familjar janë detyra midis miqve, midis fqinjëve, midis direktorëve,ose patronëve dhe shërbëtorëve,midis nëpunësve superiorë e nëpunësve inferiorë, midis sundimtarëve e të sunduarve.

Jeta pra, qysh se fillon ndaj nesh e gjer sa mbaron s'është tjetër përveç se një vark i gjatë detyrash, detyrash para njerësve, detyrash para Zotit. Në ç'do veprim të jetës s'onë n'a çfaqet edhè një të kryer të detyrës; se s'jemi tjetër gjë mbi faqe te dheut për-

[1] John Franklin = oficer i marinës luftarake të Mbretërisë së Anglisë

veç se organe që kemi porosinë të përdorim mjetet që n'a janë dhënë për të mirën t'onë e për të mirën e të afërmve.

Ata që inspirojnë me principe të lartra janë të zotët të bëjnë theror ç'do gjë më të ndershme e më të dashur që kanë, se sa të shkelin detyrën e tyre. Edhe në atë fushën e luftës, njeriu që ka karakter fisnik duhet të mundohet me nder e të mos përdoronjë mjete të poshtra, qoftë edhè për jetën e tij në dashtë t'a shpëtonjë.

Të mbeturat e fundit të ushtërisë Spanjolle u therë gjer më një në luftën e Rokroâsë më 1643, mirpo asnjë ushtar s'la vendin e tij. Një regjiment i tërë u gjent në vijën i rreshtuar në sheshin e luftës, por se ishin të tërë të vrarë. Francezi mundës, i famëshmi princ Condè kur pa atë pamje funerale bërtiti : "Si kur të mos i kisha mundur dëshironja të vdes si kurse këta" !

Jet'e vërtetë ësht' ajo jetë që nuk kalon në plogësi. Jeta është një luftë, brihje, ku ç'do njëri prej nesh ka detyra të mundohet e të përpiqet me fuqi, tyke mbetur në atë vent që ju caktua i patundur akoma edhe përpara vdekjes.

Programi i jetës s'onë duhet të jetë *vullnet i fortë, kuxim fisnik edhè qëndrim në përmbushje të detyrës*. Fuqia e vullnetit është një dhuratë Perëndije. Kemi detyrë të mos e dobësojmë tyke mos e përdorur e të mos e poshtërojmë tyke e përdorur në punë e në vepra që s'kanë ndonjë vleftë për nè. Duhet t'a ushtërojmë vullnetin sipas nomit e ndërgjegjës s'onë edhè të mos e robërojmë nër ëndjet e poshtra e naturale t'onat.

Ajy që bashkoj virtytin me vullnetin e lirë të tij, vetëm ajy është me të vërtetë i mirë e burrë. Ajy që e le vullnetin e tij në plogësi, ajy që s'është i zoti t'ju verë frenë orekseve të tija, ajy bëhet skllavi i pasioneve të tij edhe lidhet me zinxhir të hekurt me zakonet e së keqes. Në qoftë se s'shtyhet prej një vullneti të lirë nuk munt të bënjë një vepër të madhe. Që të mundë të qëndronjë më këmbë duhet vet'ajy ta donjë e t'a bënjë, sepse ndihma e të afërmit nuk mjafton t'a qëndronjë në këmbë e t'a mbanjë. Secilido ësht'i zoti i vehtes së tij e veprave të tij. E ka në dorë të urrenjë gënjeshtrën e të jetë i sinqertë, e ka në dorë të jetë i matur, i urtë e i kulluar, të jetë filanthrop e mëshironjës, zembër-gjerrë, i duruar. Të gjitha mvaren nga ajy. Njeriu prej vetiu bëhet i lirë,

i mirë ose i keq, i ndershëm, ose i poshtër. Ndjenja e detyrës është një mshtetje edhe për atë më trimin burrë. E ndihmon e ja mban kryet përpjetë edhe i shton fuqinë.

Miqtë e Pompejt e lutnin, të mos nisej për Romë në një kohë fortune për të mos ekspozatur në rrezik jetën e tij. Po, Pompej ju tha "Është nevoja të shkonj e nuk është nevoja të rronj". Desh me një vullnet të patundur të bënjë detyrën e tij, tyke përbuzur tufanet e rrufetë.

Përmbushja e detyrës ishte përgjithmonë principi themelor i Amerikanit të math e themelonjësit të Shteteve të Bashkuara, Washingtonit. Detyra, ajo i jepte karakterit të tij njësi e fuqi. Posa që shihte ç'kishte detyrë të bënjë ecte me hapa të patundura për të përmbushur detyrën e tij edhe s'desht t'ja dinte prej rreziqeve që stërditte mb'udhë. Nuk kërkonte si e si të refehej, nuk kish për qëllim as famën, as shpërblime, por vetëm ndërmentonte atë që duhej bërë si e si të kryhej më mirë.

Gjith'ajy princip i përmbushjes së detyrës frymëzonte edhe gjeneralin e math Engles Welington, atë që mundi Napolonin e math në luftën e Waterlosë. Këtë ndjenjë ja u inspironte edhe atyre që kish nën urdhrin e tij. Kur kalonte në Waterllo tyke inspektuar rreshtat e ushtrisë këmbësore edhe atë ças kur pa që po vërsulej me tërbim kalorija franceze kundra tyre, ju bërtiti: "Ushtarë mos u tundni prej vendeve! Mendohi ç'do të thonë për ju në Angli"! Edhe ushtarët ju përgjiqnë "Mos kij frikë Mylord, né e dijmë mirë detyrën t' onë".

Edhe për admiralin Englez Nelsonin, detyra ishte i vetmi mendim i tij. Ndjenjën e cila e frymëzonte gjithnjë kur shërbente atdhenë e vet, e çfaqi gloriozisht me anë të një qarkorje përpara se të fillonte lufta navale e Trafallgarit, ku mundi ky fllotën francëze. "Gjithkush – shkruante – do të kryenj detyrën e tij; këtë po pret Anglia" Edhe ahere kur po jepte shpirt, mbassi kishte mundur francezët në bordin e vaporit të tij ku ndodheshe tha: "Mbarova detyrën t'ime, i falem nderit Perëndisë për këtë".

Është shumë e madhe gjë për një komb të jetë i vaditur me frymën e ndjenjës për detyrën. Gjer sa kjo spiritë valon në shpirt të njeriut nuk është frikë për të arthmen. Po në qoftë se çfuqizo-

het, ose humbet, në qoftë se zëvëndëson etja e qefeve e lëvdata e egoizmit, ahere si mjer'ajy komp! Çkatërrimi i tij ësht' i afërmë!

Detyra ka marrëdhënje të ngushtë me sinqeritetin e karakterit. Njeriu i detyrës është kurdo herë i sinqertë edhe në vepra edhe në fjalë;nuk gënjen kurrë.*E vërteta* është lidhnia e Shoqërisë njerëzore. Pa të vërtetën do mos kishte shoqëri (society) edhe anarhia e kaosi do vijnin me një herë dhe as shtëpi, as komp mund të sundohet me gënjeshtrën. U pyet një ditë një Engles i xgjuar në gënjejnë apo jo djajtë. "Jo, tha, se po të gënjejnin nuk do të kishte as skëterrë (Enfer)".As një arsye munt të justifikonjë shkeljen e së drejtës. Kjo duhet të mbretëronjë sovranisht në të gjitha cirkonstancat e jetës.

Prej të gjitha të metave të dobta, gënjeshtra është më e keqja. Është pema e dobësisë e e çnderimit edhe nga-ndo-një herë është pragu i paburrnis morale.

Kapitulli G
GAZMENDI OSE GALLDIMI

Thonë se për të goditur njeriu një qëllim që ka i ndihmon shum edhe temperamenti, aqë sa edhe veset e mira që munt të ketë. Po e vërteta është se lumëria varet më të shumtën herë prej butësisë së moralit që ka njeriu, prej durimit, prej mirësisë edhe prej dashurisë e sjelljes që ka për të afërmin. Po edhè Platoni e ka thënë se tyke kërkuar lumërin'e të tjerëve, gjejmë lumërin t'onë.Ndodhen njerës kaqe të mirë sa e gjejnë kudo të mirën. Edhe në mjerimet më të mëdha ata shohin shenjë ngushëllimi, si edhe në qiellin e vrejtur nga retë shohin e dallojnë reze djelli. Edhe kur dielli nuk duket në horizont ata prapë gjejnë ngushëllim, tyke menduar se, edhe në e fshehin diellin, këjo ngjet prapë për të mirë.

Njerës të këtillë janë me të vërtet për të patur zili. Drita e sŷrit të tyre ka një farë shkëndije gëzimi, kënaqësije e filozofije; zembra e tyre duket si kur është plot me shëndritje djelli; mendja e tyre ngjyron sendet e jashtme me ngjyrat e saja. Kur kanë një hidhërim e durojnë burrërisht pa ankime e pa qarje e pa lottë të

kotta. E durojnë me heshtje e me qendrim edhe përmbledhin me mirënjohje ato të pakta lule që për fat i stërditnë në rrugë.

Edhe s'janë njerës të përciptë këta. Përkundrazi burrat e çquar,ata më të mënçurit janë shpesh herë edhe mê të buzqeshurit edhe mê optimistë. Me gjithë që fytyra e qeshur vjen nga temperamenti i zakonshim i njeriut, mundet të përfitohet e të çvillohet si edhe gjithë zakonet e tjera. Mundemi me anë të mendimit e të vullnetit të msojmë t'i shohim çështjet nga pikpamja e tyre e mirë e jo nga pikpamja e keqe. Jeta e njeriut ka edhe dritë edhe hije. E kemi në dorë të hedhim sŷt në njerën, ose në tjetrën anë, tyke zbatuar vullnetin t'onë mbi dritën ose mbi erësirën e kështu të përfitojmë zakonin të jemi të lumur, ose të mjerë.

Optimisma, do me thënë të paturit kurdoherë një shpresë, që s'është vetëm një mburim kënaqësije e dëfrimi në këtë jetë, po edhe një mburresë kundra mendimeve të këqija. Një shkrimtar, kur u pyet një herë me ç'mënyrë mund të shpëtonjë e të ruhet prej zhigatjeve të këqija tha, se ka për këtë gjë tri mënyra: Mënyr'e parë tha, është alegresa, e dytë mënyrë prapë *alegresa* edhe e treta gjithashtu. Galldimi, ose gazmendi pregatit truallin, mbi të cilin mbijnë mirësija edhe virtyta, ajy çloth zembren èdhe shndrit mendjen. Është bàri mê i mirë i shpirtit; i jep atij gjithënjë fuqi të reja, kur se trishtimi e dëshpërimi e dobësojnë njerinë dhe i shterojnë fuqit'e tij morale.Përse shëkojmë njerës sikurse *Palmerstonin* të punojnë edhe në atë moshën akoma të pleqërisë gjithë me atê nxehtësi? Sepse konservuan, ruajtën gjer në pleqësì të tyre, gjer në funt të jetës së tyre alegresën e gëzimin; u ushtëruan që në vogëlì që të mos trazohen lehtazi, u ushtëruen të gëlltisin shumë gjërra, u mësuan të dëgjojnë me apathy fjalë të ashpërta e të padrejta për pa u helmuar, u msuen të mos rëmbehen a të zembrohen më kot. Një mik i ngushtë i lordit Palmerston, i cili e kish shok dhe e shoqëronte për më tepër se 20 vjet edhe e njohu për së afërmi, tregon se nuk e pa kurrë të zembrohet, për veç se një herë vetëm, ahere kur kabineti i tij u akuzua prej partisë kundërshtare politike qinse falsifikoj shkresa zyrtare edhe qinse mashtroj e shkeli besën.

Historija na tregon se ata mê të çquarit burra ishin mê të shumën buzë-qeshur e të kënaqur e që nuk dëshironin as pasuri, as famë, as pushtet, por të cilët deshnin jetën, tyke ditur si t'i ngjerojnë më mirë të mirat e saja. Këjo ndjenjë duket në veprat e Homerit, të Horatit, të Virgjilit, të Montaignit, të Shakespearit dhe të Thervantit[1]. Një galldim, një alegresë shihet kudo dhe frymëzon qetazi gjith'ato frymë nër ato veprat e madhnuëshme të mendjes së thellë të këtyre prozatorëve e poetëve.

Burrimet e vërteta të alegresës janë dashuria, shpresa dhe durimi. Dashuria kndjell dashurì edhè lint mirësinë. Dashuria inspiron besimin te i afërmi dhe i sheh çështjet gjithë nga pikpamja e mirë. Dashuria jepet si një dhuratë, po me gjith'atë vlefta e saj është'e paçmuar, sepse ndjell bekimin ne ajy që e ka, të cilit i përmbush zembrën me gëzim e shpërndan rrotull saj lumërinë.

I famëshmi penalist *Bet-ham*, thosh se kapitali i lumërisë i ç'do njeriut shumëzohet *analogjisht* pas lumërisë që shpërndan, ose që ju sjell të tjerëvet. Mirësija e tij tërheq mirësinë e të tjerëve. Ësht'aq e lehtë – thosh – të flasë njëri një fjalë të mirë, sa edhe një fjalë të keqe. Mundet që sjellja e mirë të mos i bënjë ndonjë dobi atij që i çfaqet ose i paraqitet, mirë po këtë të mirë që bën gjithënjë ka dobi ai që e jep. Shumë herë takon që bamirësija shpërblehet pa një mirënjohtje, por se mirëbërësi e ndjen kurdoherë të kënaqur vehten e tij dhe këjo është shpërblimi i tij. Bamirësia nuk është gjithmonë e ndihura me të holla, po e sjella mê fort me mirësi e me burrni.

Përdëllimi, ose mëshira me të holla nuk kan'asnjë vjeftë në mos u shoqërofshin prej mirësisë hirëplotte të zembrës. Nga ndonjëherë të ndihmuarit me të holla bën keq se sa mirë. Vetëm mirësija që rrjeth prej një simpathie të vërtetë, si edhe e ndihmuara në kohën që lipset, në kohën e duhur, ato sjellin përfundime të mira.

Njerzit zembër–bardhë janë zakonisht edhè mê energjikë, kur se egoistët edhe ata që duan vetëm vehten e tyre e shkojnë

[1]. Duhet të jetë Servantes, por në origjinal kështu është shkruar. Duket si gabim shtypi

kohën pa ndo një dobi. Francezi Bufon theshte se nuk i tërhiqte kurrë besimin një djalë, i cili e fillonte jetën e tij pa një enthusiasmë. Sa janë për të përdëllyer e për të qarë hallin ata farë njerës që e shkojnë kohën tuke u ankuar kundra fatit, njerës të pakënaqur, që gjithnjë ju duket si kur punët ju shkojnë keq, po të cilët prapë nuk përpiqen si do mos diç'ka të bëjnë që të ndreqin punët e të shkojnë mirë. Shumë herë ata që ankohen më shpesh kundra fatit janë edhè më të papunshmit e më të pazotët, janë njerëz që s'vepërojnë asgjë për shoqërinë njerzore edhe njerës që s'i duhen as pak shoqërisë.

Një fjal'e urtë thotë "rrotat më të këqija janë ato që kërcasin e bëjnë zhurmë". Ajy që ka karakter të vështirë, karakter të paqetë e të dyshimtë, ajy që është i zhytur në skotura e travaje pa ndonjë arsye, ajy gërmon vetë e rrënon lumërin'e tij e qetsin'e shpirtit. Sa e sa burra e gra marrin kundra të tjerëve një pozitë iriqi, aqë sa s'kuxon njeri t'u afrohet nga frika se mos e çpojnë ! Që të durojmë të këqijat të cilat s'kanë ardhur akoma po munt të vijnë, kjo është një marrì, po nuk është edhe mënyra m'e mirë që t'i muntnjë e t'i mposhtë. Në qoftë se s'durojmë një barrë, një ngarkesë, e cila s'n'a është ngarkuar akoma,ahere të jemi të sigurt se do na shtypë më tepër kur të na e ngarkojnë, dhe do mos e durojmë dot. Kur të vinjë mjerimi, ahere detyrohemi t'a presim burrnisht, tuke pasur për ndihmës shpresën. Më e mbramja, po edhè më e madhja e të mirave është shpresa. Shpresa është mbështetja e ndihma e të mjerit; është si kur se me të drejtë e quajnë, "Buka e të vobektit". Po bashkë me këtë është edhe mëma e ç'do punëmarrje, si edhè e ç'do dëshire fisnike. Shpresa është që shtyn përpara gjithë botën e që e mban në lëvizje e sipër. Poeti i math Engles Byron thotë: "Në qoftë se nuk do të ishte shpresa në botë, ku do të ndodheshe e pritmja ? Në Skëterrë" !

Në të gjitha sendet njerëzore baza është *shpresa* dhe prapë *shpresa*, edhe kurdoherë *shpresa*.

Kapitulli H
SJELLJET

Sjelljet e mira janë më të mirat çfaqime të karakterit të mirë, janë stolitë më të bukura të çdo vepërimi. Janë shpesh herë një hirë në përmbarimin edhè të atyre më të voglave detyra. Sjelljet kanë një domethënje shumë më të madhe se sa mundet njeriu të imagjinonjë (t'a shkonjë në për ment), se sheshtojnë ç'do çështje edhe zbutin relacionet njerëzore. Edhe ajo virtyta bëhet e mërzitur, kur shoqërohet me mënyra (sjellje) antipathetike.

Opinioni që formojmë për një njeri mvaret më tepër prej sjelljeve të tija; Nga ndo një herë influencohemi mâ tepër nga sjelljet se sa nga veset e tjera më të mira që ka një njeri. Sjellje gazmore e fisnike kanë të bëjnë shumë për jetën më të mirë të njeriut edhe për të përmbushur më mirë qëllimet e tij. Shumë veta bijen jashtë[1] vetëm e vetëm se nuk kanë sjellje të mira.

Ndërshtypjet e para kanë të bëjnë shumë edhe janë ose të mirëpritura ose jo, si mbas sjelljes së gjithkujt. Përpara harbutësisë e pafisnikërisë mbyllen edhè dyert edhe zembrat, që i hap vetëm sjellja e mirë e butësia e karakterit.

Ka, pa fjalë, njerës të trash'e të pagdhendur, mirë po kanë një zembër të mirë dhe karakter të shkëlqyer, e ca më tepër do të ishin të dashur,të duhur e ndofta edhe të dobishëm,si kur të kishin edhè fisnikërin' e sjelljeve e të moralit, të cilat janë vula e simboli i rritjes të mirë !

Sjellët dëshmojnë gjer më një farë grade karakterin e njeriut, çfaqin natyrën e tij të brendëshme, tregojnë qëllimet e tija dhe ndjenjat, si edhe cilësin e llojin e miqve në të cilët afrohet e reshperon[2]. Sjelljet typike të rritjes së mirë nuk tregojnë edhe shumë sende. Etiketa shumë herë na mësheh ligësinë e gënjeshtrën edhe në atë pikpamjen e saj më të mirë s'është tjetër gjë veç plotësimi i fisnikërisë gjer sa nuk është falcifikimi i saj. Sjelljet me të vërtetë të mira kanë për bazë butësinë, mirësinë dhe sinqeritetin. Sepse ajy që sillet fisnikërisht me të vërtetë duhet të jetë

[1] bien jashtë = falimentojnë

[2] reshperoj = hyj e dal shpesh herë në një shtëpi, derë komunikuese, etj.

edhe i sinqertë. Fisnikëria s'mundet të ndalonjë të vërtetën sa të çfaqet; po për pa fshehur, ose pa ndryshuar karakterin t'onë të kulluar rreth ç'do sjellje të rreptë e të ashpërtë.

Me anë të sjelljes së mirë nuk pushojmë të jemi të sinqertë edhe nuk ndryshojmë karakterin t'onë. Fisnikërija, ka thënë një dijetar frënk, është si kur se uji. Uji më i mirë është ajy i kulluari, ajy që s'ka as një shije. Mendja e madhe nga ndo një herë mbulon shumë mungesa të kësaj natyre,prandaj bëjmë si kur s'i shëkojmë ne njërëzit e mbëdhenj e prototypë. Po të mos ishin këto anomali, të cilat çfaqin edhe nga një typ të veçantë në ç'do njeri, si mbas vleftës që ka, ahere jeta e njeriut nuk do kish aqe lezet e hirë.

Ajy që është me të vërtetë fisnik është edhe njeri i mirë, ndjen një kënaqësi, tuke i shtuar lumërinë të afërmit dhe tuke u larguar prej ç'do sendi që e mërzit të afërmin e tij. Nderon e çmon gjith'ata, me të cilët shoqërohet e që ka marrëdhënje, sepse ajy që do të nderohet prej të tjerëve duhet t'i nderonjë edh'ata me atë masë. Nuk përbuz opinionin e tyre edhe si kur të mos jetë një me opinionin e tij, edhe nuk e gërget mikun për një mê të voglin shaka.

Fisniku e i mënçuri nuk dëshiron kurrë të duket m'i ditur e m'i pasur se i afërmi i tij. Nuk lëvdohet për sojin e tij, as për pozitën e tij sociale dhe nuk përbuz ata që s'kanë një barasim me atë. Nuk mburret për çilësit'e tij, ësht'i matur gjithënjë, s'ka pretensione[1], s'ka krenari (qibra) edhe tregon karakterin e tij të vërtetë me veprat e tij mê tepër se sa me fjalë. Përgjithësisht mund të thotë dikush, se ndryshimi midis njeriut të rritur mirë dhe atij të rritur keq është ky, se i pari bên theror gjithnjë vehten e tij në relacjonet e jetës së përditëshme. Ajy që s'do të sakrifikonjë në asnjë mënyrë vehten e tij për hatër të tjerëve, ajy që nuk respekton zakonet e ndjenjat e atyre që ka rrotull, ajy që sillet me të keq e ashpërisht përpara atyre, bëhet i paduruar. As njeri s'e afron, asnjeri s'do t'a shohë me sŷ, të gjithë mërgohen sijsh se ju jep mërzi e acarim.

[1] pretensione = pretendime

Të mos respektuarit e societesë me atë nder e respekt që lipset, këjo çfaqet më shumë mënyra. Për sh. çfaqet me të mveshurit keq, të ndyjtë, nga të mos veshurit mirë, nga mos pastrimi i trupit, nga raqet e reckat e dobta e të fëlliqura e të arnuara që munt të veshë njeriu. Të këtillë bëhen të mërzitur, të paduruar, se duket se përbuzin e bëjnë për asgjë zakonet e sjelljet që ka e që lyp një rritje e mirë e fisnike.

Sjellja e mirë vetëm ahere mund të quhet e plottë e e mbaruar kur është e padjallëzuar, ose kur s'ka as një farë hypokrizije me vehte. Thohet zakonisht se sjelljet e mira janë shenjë dalluëse për ata që janë prej familjeve të mira e që muarn që voglije një rritje të pëlqyer. Këjo është'e vërtetë gjer në një farë mase vetëm, sepse të këtillë patnë fat t'a shkojnë jetën e tyre qysh në fillim me cirkonstanca të favorshime edhe muar, pa e kuptuar, typin, formën e fisnikërisë së përjashtme, ose të përciptë. Po nuk ka fjalë që edhe njerëzit e klasave më të unjtëra të mos kenë sjellje fisnike si edhe ata të klasave të nalta në marrëdhënjet e përditëshme midis tyre.

Njeriu munt të ketë pak të holla në bursën e tij, por me gjith'atë munt të jetë fisnik në sjelljet si njeri i mirë. Të sjellurit mirë nuk kushton pare, është më e lehta e më e lira nga të gjitha veset e tjera, po është kaqe e vlefshime e e naltë, sa vlen të rrjeshtohet në rrangun e virtytavet.

Motra e mirësjelljes është *eleganza,* ose *shijesa* e sjelljes. Edhe këjo nuk kushton shumë; përfitimet e punës e dëfrimet kanë më tepër shije kur shoqërohen edhè prej "filokalisë"[1]. Eleganza fisnikëron vobeksinë, stolis si ndërtesën ose shtëpin'e pasanikut ashtu edhe kasollen e fukarajt; zbut sjelljet e zakonet e krijon një atmosferë paqje e qetësije. Edhe kur bashkë-ecën me mirësin'e zembrës edhe me lëvrimin e mendjes, naltëson e zbukuron edhe atë ekzistencën më të përvujtur.

E para edhe m'e mira shkollë e sjelljes së mirë, si edhe për brumimin e karakterit është *familja*, brenda në të cilën na jep

[1] philokalia = është një koleksion tekstesh shkruar nga udhëheqës shpirtërorë të Kishës Orthodokse në shekullin XIV-XV, i kompletuar në shek. XVIII.

kurdoherë shembëllin e mirë. Po edhe vetë mundet kush do, tuke kultivuar mendjen edhe sjelljet e tij, të mësonjë prej shembëllave të mira, si munt të sillet mirë e me njerzì.

Po nuk lipset të harrojmë se sjelljet e mira s'janë gjithënjë çfaqja e vërtetë e karakterit të mirë, se shumë herë nën ato fshihet një zembër e çorroditur edhe janë aqe mê të rrezikshme kur s'i marrim vesh e kur n'a dëfrejnë, n'a mashtrojnë, e n'a venë në gjumë.

S'është çudi të ketë njeriu pamje të bukur,dukje të shkëlqyer dhe shpirt i tij të jetë i zi e i poshtër. Më anën tjetër, si kur se thamë përsipër, takon të shohim burra me pamje të mërzitur, të cilët s'kanë as një hije, as një shije, as fisnikëri në sjelljet. Këto ngjasin si ajo pema që ka luspën e fortë dhe brenda ka ushqim shumë të ëmbël.

Por në qoftë e mira në sjellje, fisnikërija, hijeshija dhe gjith'ato që kanë të bëjnë me jetën e njeriut që si e si t'a bëjnë më të këndëshme duhet të lëvrohen, ahere s'duhet të lihen edhe virtytat e tjera që janë mê të duruarshme, sikurse *nderi, sinqeriteti dhe e vërteta*. Mburrimi i së mirës duhet të jetë në zembër mê tepër, se sa nê sytë. Fisnikërija e sjelljeve s'ka edhe aqe vleftë të madhe, në qoftë se nuk shoqërohet edhe me vepra fisnike. Durimi është m'i vlefshim se ç'do hir tjetër, modestia është m'e preferuar se hijeshija, edhe kjartësija e trupit, e mendjes edhe e zembrës është m'e lartër nga ç'do perfeksion i sjelljeve.

Kapitulli I
LIBRAT

Njeriu njihet përgjithsisht nga librat që këndon, sikurse njihet edhe prej njerëzve, me të cilët shoqëron. Libra e mirë është një mik i mirë e besnik; edhe dje ishte ajy që ishte sot edhè nuk do ndryshohet kurrë.Është ajy m'i duruarshmi e m'i qëndruarshmi mik nga të gjithë miqtë t'onë. Nuk na kthen shpinën në kohën e së keqes, po n'a sillet gjithnjë me ât-mirësi, n'a dëfren, n'a mson kur jemi të rinj e n'a ngushllon kur jemi pleq.

"Librat ka thënë një filozof, hyjnë thellë në zembër të njeriut; vjershat e poetit lambikohen në gjakun e rembave t'ona;

i mësojm mëgojë[1] kur jemi të rinj, i sjellim me dashuri ndër ment kur plakemi".

Libra e mirë është monumenti m'i duruarshëmi i shkrimtarit që e shkroj, përmban në gji një lëndë pavdekësije. Njeriu s'munt të krijoj një sent mê të duruarshëm se libra. Tempujt shëmben e shduken, statuat thyhen e coptohen e fashiten, mirë po librat rrojnë.Moti nuk heq me vehte edhe idhet'e nalta. Ato mbeten edhè sot të shndritshme e të gjalla si kur se ishin edhè prej kaqë shekujsh kur shkrimtarët e tyre i shkruanin, ose i ligjëronin. Moti ka vetëm këtë vleftë për librat, se nuk shkojnë nga shosha e tija ato libra që s'kanë asnjë vleftë ose rëndësi. Vetëm librat e mira amëshohen e rrojnë.

Librat n'a futin në mê të mirat shoqëri; n'a njohin me shumë ose me të gjithë mendjet e mëdha që kanë jetuar në këtë shekull[2]. Mendojnë se ç'kanë thënë e ç'kanë punuar edhe shohim sikur se ishim ahere kur ata rronin.

Ndjejmë një sympathy për shkrimtarët, marrim pjesë në gzimin si dhe në helmin e tyre. Msohemi prej experiencës së tyne dhe kujtojmë nga ndonjë herë se edhe ne vetë kemi marrë pjesë në sqenar që ata përshkruajn. Kështu burrat e mbëdhenj e të mirë nuk vdesin kurrë; shpirti i tyre mbetet i gjallë ndër veprat e tyre edhe pason të shëndritë në një horizont që zgjerohet dita ditën. Libri është zëri i tyre, zê që rron, edhe zê që kënaq veshin t'onë.

Mendjet e mbëdha sa që i lavdëruan qysh me kohë (tjetër herë) mbi ata dhe rrojnë edhe sot. Homeri, p.sh. rron gjithënjë edhe sa do që jeta e tij mbetet në terrësinë, poezit' e tij rrojnë akoma të pavenitura në bukurin e tyre të parë.

Platoni n'a mson gjithënjë filosofinë e tij të naltë. *Horati, Virgili, Danti*, po vazhdojnë të ligjërojnë këngët e tyre sikur të rronin. *Shakespear*-i nuk ka vdekur. Trupi i tij u mbullua më 1616 pas Kr, por mendja e tij rron edhe përtej kufive të atdheut të tij.

[1] mëgojë = përmentsh

[2] Shekull = jeta reale (sidomos në dialektin Geg)

Njerzit më të unjtur e më të varfër mundin të shoqërohen me këta njerzit e mëdhenj, edhe kjo me anë të librave. Porta e tyre rri hapur gjithënjë për gjith'ata që dijnë të këndojnë.

Librat shpesh herë janë më të mirë miq për pleqtë, po janë edhè më të mirë msues për të rinjtë. Libri i parë, që bëri përshtypje të thellë në mendjen e një të riut ka influencë mbi gjithë jetën e tij, ngreh zembrën e tij; ngreh enthusiasmin e tij, drejton energjinë e tij e vepëron gjithnjë për brumimin e karakterit të tij. Libri i panjojtur gjer sot, me anë të cilit zemë miqësi me mikun e ri, që është m'i ditur e m'i pjekur se ne, ky libër bëhet shkak i një periudhës së re, në jetën t' onë.

Pra librat e mira janë shokët më të mirë t'onët, naltësojnë mendjen t'onë, n'a fisnikërojnë inklinacjonet t'ona edhe shërbejnë si mjete mprojtëse kundra relacioneve të këqija.

Kapitulli J
JETA KONJUGALE

Në formimin e karakterit të burrave si edhe të grave ka influencë të madhe marrëdhënja e tyre reciproke në të gjithë periudhet e jetës. Kemi parë sa e madhe është influenca e mëmës mbi brumimin e karakterit të fëmijëvet. Është krijesa e saj ajo atmosfera morale, në mes të së cilës rrojnë fëmijt'e saj edhe më anë të së cilës ushqehet edhe mendja edhe zembra e tyre, sikur se ushqehet trupi i tyre prej atmosferës natyrale, e cila i përqarkon.

Natyra ka ndarë më një cokësi të plotë veprat si edhe detyrat reciproke të burrave e të grave në mes të shoqërisë njerzore. Zoti ka krijuar burrin edhe gruan për të përmbushur seicili punën e vet, pa dalë prej qarkut të caktuar për gjithësecilin. Nuk mundin të ndrojnë vent edhe të bëjnë njêri punën e tjetrit.

Gjithsecili ka edhe nga një dërgatë; tjetër është qëllimi i existencës të burrit e tjetër qëllimi i existencës së gruas. Po që të dyve existencat bashkohen e puqen edhe asnjë përparim social s'munt të kryhet pa bashkëveprimin e tyre. Janë shokë edhe të barabartë me njeri-jatrin, mirë po ndryshon masa e çilësive e gjithësecilit. Burri ka fuqi trupore shumë më të madhe se të gruas edhe durimi i tij është m'i gjatë. Gruaja është më mendje-hollë,

mê sensiblë edhe mê nervoze. Burri çquhan për çilësit e mendjes që ka, edhe gruaja prej virtytave të zembrës. Edhe vërtet se kryeja[1] administron, por zembra drejton e komandon. Burrë e grua janë baras si njëri edhe tjetri të pregatitur mirë prej natyrës për vepërimet reciproke që u janë ngarkuar si njërit si tjetrit. Që t'i vemë për barrë burrit punë grash është aqë e vështirë sa edhe t'a ngarkojmë gruan me punë burrit.

Virtytat mê të mbëdha të gruas çfaqen me ndërmjetësinë e ndjenjave të saj. Natyra i ka ngarkuar gruas kujdesin'e njerzimit. Gruaja përpiqet për të mjerët, ka kujdes gjith'ata që duam, ajo është drita e timoni i gjithë familjes. Është prej natyre sensiblë, e ëmbël, e duruar edhe plot besnikëri e therorësi. Pamja e saj sympathike shpërndan kënaqësinë e nënqeshjen rrotull saj, llamps midis mjerimit e e lehtëson, llamps mbi zembërimin e e zbut, mbi ftohtësinë e e ngroh, mbi helmin dhe e ngushëllon. Grueja u qojt "Engjëlli i mjerimeve". Ajo është gati kurdoherë t'ju ndihmonjë të pafuqishmëvet, të ndaltësonjë të rrëzuarit, të ngushëllojnë ata që qajnë. Ku krijesa njerzore vuan e vajton, atje edhe gruaja vjen e ngushëllon, rënkimet e të mjerit kërkojnë gjithënjë ndihmën e gruas.

Me qenë se virtytat mê të mbëdha të gruas çfaqen me anë të sympathisë e të mëshirës, është nevoja, që për lumërin'e saj, të zhvillohet e të forcohet karakteri i saj. Është nevoja të përfitonjë me zakonet e eksperiencën e saj fuqinë që të mvaret vetëm nga vullneti i saj, kështu që me ç'do rasë të jetë e zoja e vehtes së saj. Lumëria e gruas, si edhe ajo e burrit mvaret mê shumë nga përmirësimi i karakterit të tyre. Prandaj gjith'ajy kanun moral lipset të zbatohet si për burrin, si për gruan. Do të tronditeshin themelet e virtytës, po të dominonte opinioni i cili ka mjerisht partizanët e tij që ësht'i lirë burri të shkelë nomet morale pa u ndëshkuar, kurse gruaja, jo vetëm s'ka të drejtë për këtë, po edhe tërheq me vehte çnderimin e katastrofën e saj të përjetëshme !

[1] Kryeja = koka

Për hatër të moralit (society) duhet edhe burri edhe gruaja të jenë të ndershëm, të largojnë ç'do gjë që e kundrështon zembra, karakteri edhe ndërgjegja.

Mbi respektin reciprok edhe me të çmuarit reciprok bazohet lumëria familjare, sepse pa ato s'munt të existoj një njësi idheash e ndjenjash, gjê që është element i domosdoshëm për një dashuri konjugale të qëndruarshme.

Nuk munt të ketë dashuri të vërtetë e të gjattë atje ku s'ka as nder as respekt. Bashkimi i një burri me një grua duhet të ketë për themel karakterin e mirë, i cili imponon nderin në jetën private, si edhe në jetën publike. Po midis burrit e gruas duhet të existonjë edhe një tjetër gjë. Burrin e gruan i lith një ndjenjë më e thellë e më e butë se respekti, edhe është këjo: me anë të martesës njeriu hyn në një sferë të re, në një botë dëfrimesh, sympathinash e interesash edhe këjo bot'e re është vatra e vërtetë e atij që martohet. Këjo vatr'e tij e re, krejt e ndryshme nga vatra e parë e djalërisë së tij, i jep një sërë dëfrimesh po edhe hidhërimesh të panjojtura; se pse në këtë botë gjen nga ndo një herë angushtime e trishtime edhe merr experiencë prej msimeve të tyre. Jeta familjare është plot me gjëmba e me skotura, po të cilat sjellin pemë të mira, kur se gjëmbat e jetës së kalume janë beronja[1].

Karakteri i një burri njihet më fort në shtëpinë e tij. Mënyra me të cilën administron e dëshmon urtësin'e tij më tepër se mënyra me të cilën drejton ato më të vështirat çështje të tija, private qofshin ose publike. Në çështjet e tija munt të kushtonjë gjithë mëndjen e tij, po në dashtë të jetë i lumur duhet të kushtonjë zembrën e tij të tërë në vatrën e tij familjare. Atje më fort njihen e çquhen virtutat e tija, atje rëfen sinqeritetin e tij, dashurin'e tij, sympathinë e tij, respektin e tij për të tjerët, karakterin e tij të drejtë dhe kapacitetin e tij administrativ.

Disa njerës e gjejnë se martesa që bënë nuk u përgjiq në dëshirat e tyre, sepse nuk ju pruri sa lumëri që shpresonin. Po prej këtyre disa e kanë fajin vetë se, në kontratën e martesës që bënë nuk depozituan atë pjesë mirësije që ju takonte, as atë pjesën e

[1] Beronjë = shterpë

alegresës, e durimit edhe të urtisë. Fantasia e përciptë tyke fluturuar nër horizonte ideale e mashtruëse krijoj ndofta kushte lumërije të pa qena në këtë shekull, edhe ahere kur u gjetnë përpara jetës reale, të shoqëruar me trishtimet e kokëçarjet e saj, u xgjuan me një herë dhe panë ëndrat e tyre të shduken si vesë pranvere; ose kishin pretencën të gjejnë perfeksionin të shoqit që zgjodhë kur se përkundrazi zbuluan, po si kofini pas të vjelit se, edhe ata karakteret mê të mbaruar kanë mjerisht të metat e tyre! Midis burrit e gruas rregulli m'i sigurt është *toleranca* dhe *klemenca*. Në jetën konjugale duhet butësi, mos vërejtje dhe durim. Edhe pa mbyllur sytë njëri në të metat që ka tjetri, mundet sidomos t'ja duronjë me mirësi e me të butë. Në jetën martesore, prej të gjithave virtytave mirësia sjell ato mê të mirat pemë.

Kapitulli K.
MSIMI I EXPERIENCËS

Urtësia praktike përfitohet në shkollën e experiencës. Shëmbllat e mësimet janë të dobishme gjer më një farë mase, po doktrina e tyre mbetet vetëm në theori, gjer sa mungon praktika e jetës. Është nevoja t'i bënjë ballë njeriu pjesës positive të jetës së tij se ahere karakteri bëhet i qëndruarshim; vetëm këshillat e mira nuk mjaftojnë t'a ndreqin karakterin po s'u përzjeh njeriu me njerës të tjerë, po s'pati relacione. Që të ketë karakteri një vleftë duhet të vinjë në atë gradë sa të qendronjë e të mos të përunjet në mes të poterave, në mes të tallazeve të mjerimeve e në mes të shprovave të hidhura, me një fjalë të përballonjë të gjitha travajet e jetës së përditshme.

Ata njerës që përpiqen e përkujdesohen vetëm për vehten e tyre edhe për mirë-rrojtjen e tyre, nuk i bëjnë dobi asnjë njeriut. Dëgjojmë shpesh herë të thonë se aksili pasanik vdiq e la aq miliona pasuni, po nuk na thonë në ju ndihmoj ndo një herë të vobektëve sa rronte e në i'u la pas vdekjes. Ka vdekur tani ca vjete në Londër një njeri, një lord tepër zengjin, po nuk mentoj as

një ovull[1] t' ju lerë kapitalëve, ose t' ju ndanjë fukarenjëve, po të gjitha sa kish, ja la familjes së tij. Këjo është egoizm'e dobët !

Kemi detyrë me ç'do mënyrë të ndihmojmë të afërmit. Njerzit, si shtetas, si pjesëtar të një feje ose besimi, njerëzit si njerës të gjithë pa një përjashtim e kan'atë detyrë.Ungjilli, Bibla e Vjetër, të gjitha n'a e tregojn këtë detyrë, që t'i ndihim shoqi shoqit, t'i lehtësojnë barrën e rëndë që ka, t'i ngushëllojmë në mjerimin që i shkrepi, se kështu ndihmojnë shoqërinë njerëzore, njerëzinë, se vetëm ashtu vjen përparimi e lumëri' e vërtetë. Bota ka shumë njerës të varfër a të mjerë, ata që munden, a që kanë, duhet t'i shohin. Të vobektët e të sëmurët i kemi përpara derës edhe i kemi për dit' e s'mundim t'i dbojmë.

Gjenden njerës të pazotë për punë, sakatë, galamshë[2], epileptikë, të çmëndur; gjënden të sëmurë që vuajn prej gjithfarë lëngatash e që janë aqë fukarenj sa të mos kenë as mjetet për shërimin e tyre. Për këta nuk harrin vetëm metaliku[3], ose një ndihmë hollore që j'u bëjmë kur i gjejmë rrugës; detyrën t'onë duhet t'a bëjmë ndryshe.

Lumërisht ka edhe njerës të dhëmshur e zembër–bardhë që e ndjejnë detyrën, edhe shumë prej tyre janë edhe të pasur edhe e përmbushin detyrën për të afërmin. Disa e kryejnë personalisht tyke vizituar ata që vuajn e tyke ju ndihmuar; disa pas vdekjes së tyre lenë shumë të holla të mbëdha. Të tilla shëmblla janë të panumurta.

Përzjerja me njerzit e tjerë ësht'e nevojshime, se njeh njeriu vehten e tij.Vetëm kur të përzjehet njeriu në jetën shoqënore ahere munt të çmonjë taman gradën e vleftës së tij dhe kapacitetin e tij. Ajy që s'e ka përfituar këtë experiencë, rrezikon të bëhet njeri nopran, madhështor e fodull. Ajy s'njeh vehten e tij, sepse vetëm me vehten e tij shoqërohet. Edhe në qoftë se ka idhè të madhe për vehten e tij, nuk do bënjë as një përshtypje të mirë ne të tjerët, në qoftë se dyshon pa masë për meritën e tij, aherë

[1] Ovull = monetë turke me vlerën më të vogël

[2] Galamsh = Ai që është paralizuar plotësisht, ulok që s'lëviz dot as këmbë as duar

[3] Metalik ose metelik = parà, të holla, monedha

dëmton vehten e tij. Prandaj duhet të ketë njeriu sa ësht' e mundur një dijeni më të plottë për vehten e tij, në qoftë se do diçka të jetë, ose diçka të bënjë në botë.

Po që të dijë njeriu ç'mund të bënjë kjo nuk mjafton; duhet të dijë edhe ç'farë s'mund të bënjë; ndryshe nuk do bënjë kurrë ndonjë herë një gjë me rëndësi. Njeriu që ka mënt për të përfituar me anë të experiencës, gjykon punët mirë, sa që sheh përpara syve edhe sa që stërdit udhës për dit. Ajy që i themi *mendja e rregullshme*, s'është tjetër gjë përveç se përfundimi vetëm i experiencës, të zbatuar urtë e me mënt.

Që të përfitonjë dikushi duhet durim dhe vërrejtje më shumë se sa një mëndje e jashtzakonshme. Prandaj njerzit më të mënçim janë zakonisht ata që përzjehen në botë, ose për shkak të punëve të tyre, ose për shkak të relacjoneve të tyre sociale. Këta bazojnë gjykimet e tyre në sa panë e njohin, në vënt të ngatrrohen me syllogjisma[1] theoritike, që s'i lipset të ishin, a si munt të ishin punët.

Gjithë për këtë arsye gratë kanë nga ndo njëherë më tepër mënt se sa burrat, se nuk kanë potenca të mbëdha edhe se gjykojnë punët anallogjikisht simbas ndërshtypjeve automatike, të cilën shkaktuan në mëndjen e tyre. Kuptimi i tyre është më i shpejtë edhe më tepër i çvilluar, si edhe ndjenjat edhe sympathit e tyre më të gjalla. Sjelljet e tyre iu ndihmojnë sa të transmetojnë edhe ne të tjerët përshtypjet e tyre. Kështu shpjegohet që si nga ndonjë herë gra të cilat mendarisht nuk çquajn e nuk duken, udhëheqin edhe drejtojnë burra të pabindur e të pamposhtur.

Përfundimet e eksperiencës nuk i ndjejmë përveç se tyke përparuar jeta; edhe jeta është çështje kohe. Njeriu i pjekur msohet t'a shohë kohën si më të madhe ndihmën e tij. Thohet, se sa më tepër shkon koha, ajo n'a ngushëllon, se n'a bën t'i shohim sendet (punët) më të bukura. Po ka edhe këtë privilegjë më të madhe që n'a mson, harrin e regj experiencën edhe shkakton blerimin e urtisë.

[1] Syllogjizma = një lloj arsyetimi duke lidhur ngushtësisht dy apo më shumë gjëra njera me tjetrën si p.sh. "nuk bie shi, por mundet edhe të bjerë".

Koha munt të jetë ose miku, ose armiku i djalërisë. Për pleqtë është ose ngushëllimtari ose xhelati i tyre,si pas përdorimit që i bënë kohës edhe sipas jetës që shkuan. Kur jemi të rinj, bota n'a duket e çkëlqyer edhe e bukur; të gjitha n'a duken të reja dhe sikur n'a premtojnë gëzime e dëfrime. Po sa më tepër shkojnë vjetët shohim se mjerimet e trishtimet që n'a bije moti janë më shumë se gëzimet e tij, edhe sa më tepër i afrohemi pleqësisë e gjejmë më të mjergulltë horizontin e jetës. Jeta është mundim i vështirë, shumë herë mjerim dhe katastrofë. Të lumur jan'ata që i përcjellin mjerimet e motit me mendjen në vent e me zembrën e kulluar edhe tuke ruajtur qetësin e shpirtit të tyre, dajandisin[1] në rëndësirën e barrës së tyre sado e rëndë që të jetë.

Njeriu ka nevojë për gjithë energjinë që pjell enthusiasmin në do të dalë faqe bardhë e t'i nxjerë në skaj gjithë qëllimet e jetës së tij. Ndryshe pengimet e vështirësitë që stërdit zakonisht përpara do t'a mposhtnin pa fjalë.

Po në qoftë se ka burrni dhe qëndrim ahere ndjen fuqin e tij të zonjën t'i përballonjë të gjithë rreziqet e të largonjë e të çporrë ç'do pengim. Shembëll e mirë është Kollombua. I bindur se existonte një botë e re përbuzi të gjithë rreziket e deteve të panjohun; edhe ahere kur shokët e tij u trempnë e u dëshpëruan dhe ju kundrështuan, tyke e friksuar se do t'a hidhnin në det, ay mbeti i patundur e burrë, gjer sa bota e re, bota e madhe e e pa anët ju çfaq në horizondin, si e përmendonte !

Edhe për burrat edhe për gratë është e mirë të kenë një farë besimi mbi vehten e tyre edhe të marrin prej atij kurajo e qëndrim, në vënt që të mbeten apathikë e të plogët. Pa u munduar e pa u përpjekur nuk fitohet gjë. Po të mos kish vështirsi këjo botë nuk do ish nevoj'e fëllqinjave për t'i mundur; po të mos ishin tentacjone nuk do ish as nevoja t'i vinim frenë ndërgjegjes s'onë; edhe po të mos ishin mjerimet, si do përfitonim qëndrimin e durimin ? Prandaj vështirësitë, mjerimet e tentacjonet e jetës nuk janë të këqija, se janë përzjerë edhe me një të mirë; përkundrazi, prej atyre shpesh herë mburrojnë fuqija e shpirtit e virtytat. Ashtu

[1] Dajandis = Duroj, bëj ballë

edhe përpjekja kundra vobeksisë shumë herë përfundon me dobi, se xgjon aktivitetin, mpreh durimin edhe formon karakterin e qëndruarshim. Shumë njerës kanë nevojë të gjejnë pengime që të ndjejnë fuqin e tyre edhe vështirësia që muntnë t'a mposhtnë një herë bëhet shkak për fëllqinja të reja e për mundje të reja.

Të rënit jashtë[1] në qëllimet t'ona e në vepërimet n'a bëhet një mësim në jetën t'onë. Eksperienca më e dobishme përfitohet prej kujtimit të gabimeve t'ona, të cilat i bëmë në relacjonet t'ona me shokët t'onë në rrjedhjen e sipër të jetës. Porositë, studimet, këshillat nuk n'a mësojnë aqë sa një gabim i bërë. Nga ndo një herë gabimet kanë edhe këtë të mirë që i gabuari kthen sytë në veprimet e tij e përpjekjet në nji drejtim tjetër të ri, në një punë, ku çilësit e dëshirat e tija gjejnë një karierë më të mirë e më pjellore që munt t'a përfitojnë. Shëmblla të këtilla kemi shumë. Jeta e shum njerësve të mbëdhenj s'ish tjetër për veç se një luft'e gjattë kundra vështirsive e pengimeve, që ju vinin njëra pas tjetrës. Vjershëtori i math i Anglisë *Miltoni* edhe passi u verbua nuk u përkul, po vazhdoj me çape më të mbëdha rrugën e tij përpara e më të mbdhatë veprat e tija u shkruan në periudhën mê të mjerë të jetës së tij, ahere kur ish i vobekt, i pafuqishëm, plak, i verbër, ahere kur e djallëzonin e e mohonin, ahere kur e ndiqnin! Gjithashtu poeti i famëshëm italjan Danti e shkroj poesin'e tij të pa vdekur tyke qënë në arrati ! Poeti i math i Portugalit Camoëns, gjith'ashtu shëndriti atdhen e tij, tyke qenë n'arrati ! *Torquato Tassua*, e shkoj jetën e tij i mjerë, theror i përjetëshmë i bigonisë e ligësisë të anmiqve të tij.

Do t'ishte shum'i gjatë katallogu i poetëve të famëshëm e i shkrimtarëve,të cilët u madhnuan e llamburitnë në për mes të mjerimevet. Po edhe shqenca ka edhe ajo martyrët e saj. Shum zbulime nga ato më të mbëdhat si edhe çpikje u bënë në mes të ndjekjeve e të poterave.

Veprat e atyre njerësve të mbëdhenj u përkryen me mundime të mbëdha, me vështirësi me durime e me pengime. U munduan e u përpoqnë kundra rrjedhjeve të rrepta e harrinë në breg të

[1] Të rënit jashtë = falimentimi

lodhur, të këputur e të raskapitur prej mundimit e drobitjes,shkelë tokën e bekuar edhe cok atje dhanë edhe shpirtin e tyre, tyke e qojtur vehten të lumur se mbaruan detyrën e tyre !

Gjithkush ka borç t'a përmbushë detyrën e tij brenda qarkut ku u ndoth, ose u rrjeshtua. Vetëm detyra përmban të vërtetën; pa atë vepra s'munt të quhet e mirë e e pëlqyer. Detyra është qëllimi edhe fundi i ç'do jete fisnike edhe ndjenja që detyra u përkrye është dëfrimi më i mirë, më i kulluar e më i shêjtë.

Funt

Këndoni me vërejtje
N ë n - fletën
KARAKTERI

(Shënim i Kristo Floqit botuar në gazetën
"Indipendenca Shqiptarë"Nr. 1
dt. 17 Janar 1925 faqe 4)

Ngjarjet e fundit dhe më fort ngjarja e të dy operacioneve, të qeverisë revolucionare[1], si edhè të pushtimit të Shqipërisë prej ushtrive të Ahmet Zogut e impresionuan aqe shumë popullin Shqiptar, sa të hutohet pothua krejt e të mos dijë si të sillet. Lè të mos çuditemi në qoftë se shohim njerës që brohoritnë aqe për qeverinë revolucionare, sa edhè për qeverin'e tashme; gjith'ashtu të mos na vinjë çudi në qoftë se shohim njerës gjer djè kundër Ahmet Zogut dhe sot pro, ose njerës që ndrojnë mendim ç'do 24 orë, ose njerës që gjer dje flisnin një mijë e një e sot i puthin edhè këmbët, njerës të mërzitur, se mbetnë pa punë, ose të dëshpëruar se shihen me sŷ të dyshimtë. Ndofta s'ka faj i mjeri popull po udhëheqësit e tij, të cilët e suall në këtë shkallë. Pra, që të njohë mirë ku gjëndet, që të hetonjë më mirë vehten e tij e të dijë si të sillet është nevoja të këndonjë veprën e pavdekur të moralistit të

[1] Qeveri revolucionare = qeveria e Fan S. Nolit qershor – dhjetor 1924, kurse ky artikull është botuar duke filluar nga janari 1925

famshim ingles Samuel Smiles, së cilës shkurtim po ja paraqitim këtu këndonjësve t'onë të përkthyer.

Këndoni pra të gjithë me vërejtje nënë fletën

K A R A K T E R I

Prej së cilës do të kini një dobi shumë të madhe. Është vepër që e kanë përkthyer shumë kombe, vepër e çmuar e e rrallë.

Veprat letrare të Kristo Floqit

I.
Drama e tragjedi

1) Fè e kombësi
2) Karllo Topija
3) Pirro Neoptolemi
4) Triumfi i Lirisë
5) Fat-zeza
6) Skënderbeu n' Itali
7) Qypërlinjtë
8) Omer-ag-Ulqini
9) Meço Qafëzezi
10) Të dy rashterët
11) Atdheu
12) Fedora
13) Mbreti Oedipus
14) Antigoni
15) Elektra
16) Medêa

II.
Komedi

17) Rrogat e nëpunësve
18) Lodrat e studentëve
19) Do të vras vehten

20) Vllazëri e interesë
21) E bij' e banqerit
22) Dhëndër me përdhuni
23) Merre t' a marrim
24) Nder e qytetni
25) Kundrështarët e prikës
26) Psimet – mësime
27) Zi e më zi
28) Reklamë e blofë
29) E mbes' e krahinarit
30) Akraballëket
31) Ministri kandidat
32) Doktorllëket
33) Veteranët
34) Fat i papritur
35) Përfundimet e zilisë
36) Burri burrë
37) Usta Patozi
38) Tetua e Karllit
39) Kopraci (përkthim)
40) Muratorium
41)Horr-horr Topalltija
42) Kopanët e batatis
43) Zuzarkat
44) Të tërbuarit

III.

Farsa e monolloge

45) Një nat' e tmeruar
46) Gungaçi
47) Byrokratija
48) Si do të vejë halli
49) Shpina jeme

IV.
Operetta

50) Një natë Krishtlindjesh
51) Babagjyshi

V.
Juridike

52) E Drejta themelore
53) Administrata
54) Ekonomia politike e shoqnore
55) Ligja e Përmbarimit

VI.
Letrare

56) Historija e Greqisë
57) Historija e Romës
58) Historija e Shqipërisë
59) Historija e letërsisë Shqiptare
60) Kritoni i Platonit
61) Karakteri (përkthim)
62) Patriotizmë e Nacionalizmë
63) Fjalor i gjuhës shqipe me 22.000 e sa fjalë

VI.
Poezi e satira

64) Tingëllimet e zembrës
65) Tallaze e valë
66) Shkëndija
67) Shqyptarët
68) Qerthulli politik
69) Epopè e Korçës
70) Epopè e Vlorës (Lahuta e Labërisë)

71) Epopè e Skënderbeut

Shënim: Kjo listë e veprave të Kristo Floqit është hartuar nga vetë autori dhe është botuar tek "Tingëllimat e zembrës", botim i vitit 1940.

VIII.
Poezi, vjersha, artikuj

(Mbledhur andej-këndej nga Henrik Kaçulini)

FJALOR I TERMINOLOGJIS JURIDIKE ME SKANJIME TEKNIKE
PREJ 5.000 E SA TERMASH E SHPREHJESH JURIDIKE QË PËR-
DOREN EDHE SOT NË SISTEMIN JURIDIK SHQIPTAR
PELLASGË E HELENË – Studim ethnollogjik e linguistik
KOSOVA (SERBI E VJETËR?) – Studim ethnografik e statistik
HYMN PËR MBRETIN WIED
MARSHI I AHMET ZOGUT – (Hymni i Mbretërisë Shqiptare)
TEMPULL' I DODONES Studim arkeologjik
FORMIMI I SHOQERISE "VATRA" – Artikull
KONT UGOLINI – Poezi nga "Divina Commedia"
VDEKJA E SOKRATIT
MIKUT TE VLERTE NDRE MJEDA – Poezi kushtuar Dom Ndre Mjeda
ESHTE I PAVDEKUR SHPIRTI? – Poezi
POETI DYKE VDEKUR – Poezi perkthyer nga K. Floqi.
ANKIM I QIPARIZIT – Poezi
SHKA DON ME THÂNË AUTONOMI – Artikull
AUTOBIOGRAFIA IME[1] 1788 faqe
ISMAIL QEMALI–BEQIR GREBENEA – Kujtime historike
INDIPENDENCA SHQIPTARE – Gazetë (Janar 1925-Korrik 1926)
themeluar nga K.Floqi,drejtor, redaktor e gazetar i saj.
GAZETA "ZËRI I POPULLIT", themeluar nga Kristo Floqi më
1912 në New-York.
REVISTA "AGIMI" – organ letrar i shoqërisë "Vllaznija"
Shkodër themelues, drejtor e gazetar i saj.
GAZETA "SHQIPRIJA E RE", e përdyjavshme, Milano.

[1] "Autobiografia ime" e Kristo Floqit me shkrim dore në 4 volume, ndodhet në Arkivin Qëndror Shtetror Fondi 429 Dok. 1